RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Financiar dhe Përputhshmërisë)

BASHKIA PRRENJAS

Tiranë 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3 – 15**
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	**HYRJA**	**15 – 19**
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**19 - 233**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	19 – 20
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**21 - 233**
2.1	*Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025.*	*21 – 48*
2.2	*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*	*48 – 57*
2.3	*Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025*	*57 - 78*
2.4	*Auditimi i prokurimeve publike.*	*78 – 148*
2.4.3	*Auditim mbi zbatimin e kontratave punime ndërtimi.*	*148 – 186*
2.5	*Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit*	*186 – 192*
2.6	*Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)*	*192 – 201*
2.7	*Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.*	*202 – 208*
2.8	*Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*	*209-233*
IV	**REKOMANDIME**	**233-256**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. *Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim*.

Bashkia Prrenjas, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Prrenjas për periudhën e aktivitetit financiar të vitit 2024-2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e vijim KLSH), sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Prrenjas si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, nenit 50 pikat 1 dhe 2.

Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Prrenjas si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.

Për *auditimin financiar*, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për *auditimin e përputhshmërisë*, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, nëpërmjet analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024 deri më datën 31.12.2025.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 – 31.12.2025, janë si vijon:

-Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025.

-Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

-Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

-Auditimi i prokurimeve publike.

-Auditim mbi zbatimin e kontratave punime ndërtimi.

-Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

-Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

-Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.
-Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

***d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave*.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. *Auditimi është kryer mbi bazë risku*. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël.
Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.
Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 14,914 mijë lekë për vitin 2025.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur tekN...t e auditimi si: *Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*
Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekN...t e mëposhtme:
-Verifikimi i transaksioneve;
-Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
-Intervistat;
-Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.

e. *Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve*:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **33** gjetje dhe ka dhënë **38** rekomandime, *nga të cilat;* masa organizative 20 gjetje me 25 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 9 gjetje me 9 rekomandime për vlerën 6,764 mijë lekë, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara 4 gjetje dhe 4 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- *Në fushën e zbatimit të buxhetit:*

Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi, kundrejt plani të rishikuar gjatë vitit në vlerën 1,329,712 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 1,058,747 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 270,965 mijë lekë ose 20% e totalit të shpenzimeve të planifikuara. Mosrealizimi rezultoi kryesisht në shpenzimet operative, me 51,050 mijë lekë, pasi nga 137,206 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 86,156 mijë lekë, ose 63%, si dhe në shpenzimet për investime, me 134,472 mijë lekë, pasi nga 352,305 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 217,833 mijë lekë, ose 62%. Mosrealizimi i shpenzimeve për investime lidhet me lidhjen e kontratave në fund të periudhës buxhetore, duke sjellë shtyrjen e likuidimit të tyre në vitin pasardhës dhe, për rrjedhojë, ndikim në realizimin e shpenzimeve brenda vitit buxhetor dhe në ofrimin në kohë të të mirave publike për komunitetin.

Në evidentimin e detyrimeve te palikujduara për taksa e tarifa vendore, leje legalizimi, gjoba IMTV, etj.

-Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv për taksa e tarifa vendore 261 subjekte për vlerën 27,795,242 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën* 13,896,788 *lekë),* debitorë progresiv familjarë janë 5415 familje për vlerën 61,122,267 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 12,138,013 lekë)* dhe debitorë për tarifën e rregjistrimit në Kopshte e Çerdhe debitorë në vlerën 1,016,760 lekë, pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 89,934,269 lekë, **nga e cila vlera prej 27,051,761 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë ".**

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 1,942,440 lekë për gjatë vitit 2025, janë shtuar detyrimet në shumën 2,219,268 lekë dhe janë arkëtuar detyrime në vlerën 1,342,557 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **92 objekte të personave** në vlerën 2,819,151 lekë, **nga e cila vlera prej 2,219,268 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse ka njoftuar me shkresë nr. 55 prot., datë 0701.2026, për shlyerjen e detyrimi tatimor në vlerën 900,000 lekë nga subjekti "L. B." dhe për subjektin "B. G" me shkresë nr. 1536/3, datë 24.05.2022 është kërkuar bllokim llogarie për shlyerjen e deturimit në vlerën 900,000 lekë për periudhën objekt auditimi këto subjekte nuk kanë likujduar detyrimet gjithsej **në vlerën 1,800,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas**.

Nga auditimi për vendimet e gjobave të nxjerra nga IMTV për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025, rezulton se janë nxjerr 41 vendime gjobash në vlerën **18,940,000 lekë**, nga të cilat janë likuiduar 5 gjoba në vlerën **1,220,000 lekë**, ndërsa 3 gjoba për vlerën **1,020,000 lekë,** janë falur në zbatim të Ligjit nr. 127/2024 *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit....", neni 2 dhe pika 3 e VKM-së nr. 274, datë 09.05.2025 "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara".*Lidhur me gjobat e mbetura për vlerën **16,700,000 lekë,** rezulton se nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre si dhe për dërgimin e kërkesave drejtuar gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv,

- *Në hartimin e pasqyrave financiare viti 2025:*

-Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 17,346,680,860. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar vlera 2,770,029 lekë për shpenzime "Prodhim, transport dhe stivim dru zjarri" si shtesa aktivesh duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione".

-Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" paraqitet në

vlerën 759,238,243 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari vlera prej 42,919,940 lekë nuk është e analizuar me objekte, nuk ka regjistër me të dhëna për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare për kryerjen e inventarit fizik

-Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera prej 215,844,097 lekë, për 22 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Pogradec, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.

➢ *<u>Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave:</u>*

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Blerje karburant me lote – Loti 1: Naftë"***, rezultoi se Drejtoritë/Sektorët e Bashkisë administrojnë dhe paraqesin kërkesat për nevojat e tyre për karburant, të cilat shërbejnë si bazë për përllogaritjen e fondit limit dhe planifikimin e procedurës së prokurimit, por konstatohet se kërkesat e paraqitura përmbajnë vetëm vlerën financiare të nevojës për karburant, pa specifikuar sasinë e kërkuar (në litra) dhe pa u shoqëruar me një argumentim ose përllogaritje të bazuar në konsumin real, aktivitetin e planifikuar apo të dhënat historike të konsumit. Mungesa e përcaktimit të sasive konkrete kufizon gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e procesit të planifikimit të nevojave, duke e bërë të vështirë vlerësimin nëse fondi limit dhe sasia e planifikuar janë ndërtuar mbi nevoja reale dhe të dokumentuara.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"**Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik)**"*, me FL 8,754 mijë lekë, u konstatua mangësi në hartimin e specifikimeve teknike, konkretisht në përcaktimin e disa parametrave teknikë të mjetit:

Në dokumentet e procedurës rezulton se është kërkuar gjatësia maksimale e mjetit **6,223 mm**, pa u shoqëruar me argumentim teknik apo funksional që të justifikojë domosdoshmërinë e këtij kufizimi, duke mos evidentuar nevojat konkrete të autoritetit kontraktor apo kushtet specifike të përdorimit të mjetit që do të impononin një parametër të tillë.

Gjithashtu, është kërkuar që koha e kompresimit të jetë **fikse 35 sekonda**, ndërkohë që ky parametër teknik duhej të ishte përcaktuar në formën e një intervali ose me vlera të arsyeshme tolerance, në mënyrë që të lejonte pjesëmarrjen e mjeteve me karakteristika të ngjashme teknike, të afta për të përmbushur të njëjtin funksion.

Përcaktimi i këtyre parametrave pa argumentim teknik nuk rezulton të jetë mbështetur në një analizë të dokumentuar të nevojave funksionale të autoritetit kontraktor, duke krijuar kufizime të panevojshme në hartimin e specifikimeve teknike.

-Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 7 raste për procedura të realizuara nga Bashkia Prrenjas me fond limit 339,740 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, konkretisht në procedurat:

- *"Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë*" e vitit 2024 me FL 142,631 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas*" – e vitit 2024 me FL 17,507 mijë lekë;
- "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas*" – e vitit 2024 me FL 16,709 mijë lekë;

- "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"*, - e vitit 2025 me FL 80,783 mijë lekë;
- *"Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas"* – e vitit 2025 me FL 17,387 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas",* - e vitit 2025 me FL 32,570 mijë lekë;
- *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara"*, - e vitit 2025 me FL 32,153 mijë lekë;

Mangësitë konsistojnë në kërkesat e kategorisë së licencës NP-12 për punime të cilat nuk kanë për objekt "*Punimet e inxhinierisë së mjedisit",* kërkesat për dëshmitë e sigurimit teknik të lëshuara nga ISHTI ose institucionet e autorizuara, ndërkohë objekti për të cilin lëshohen këto dëshmi nuk lidhet me profilet e punonjësve dhe zërat e punimeve që ata kryejnë, kërkesa për kontrata furnizimi me prodhues ose distributor për produkte të cilat gjenden lehtësisht në treg, kërkesa për deklarimin e drejtuesit teknik të pa angazhuar në kontrata të tjera për punime me vlerë nën 30 milion lekë, kërkesa për numër të lartë inxhinierësh që të figurojnë njëkohësisht në listëpagesat e shoqërisë, kërkesë e dublikuar për tipologjinë e mjetit, janë kërkesa të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurave të zhvilluara.

- Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Prrenjas përgjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2025, në 4 raste me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej **227,568 mijë lekë**, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së disa kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, konkretisht në procedurat me objekt,
- *"Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë"* – e vitit 2024 me fitues OE "E." shpk me vlerë kontrate 128,614 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2024 me fitues OE "O." shpk me vlerë kontrate 11,452 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2025 me fitues OE "M." shpk me vlerë kontrate 61,945 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2025 me fitues "K." shpk me vlerë kontrate 25,557 mijë lekë;

Mangësitë konsistojnë në mos përmbushje të kritereve për likuidimin e taksave dhe detyrimeve vendore, ku OE shmangin hapjen e NIPT-e sekondare dhe likuidimin e detyrimeve, mangësi me autorizimet e prodhuesve ose dokumente në gjuhë të huaj e të pa përkthyera, mangësi në dokumentacion e mjeteve, mangësi në kapacitetin e mjeteve.

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt *"Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"* dhe *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"*, ka rezultuar vonesë në përfundimin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, duke tejkaluar afatin prej 15 ditësh të përcaktuar për procedurat nën kufirin e lartë monetar, mangësi e ardhur si pasojë e mungesës së administrimit në kohë të procesit të vlerësimit nga KVO. Vonesa e konstatuar ndikon negativisht në miradministrimin e procedurave të prokurimit publik, duke shtyrë afatet për lidhjen e kontratave dhe fillimin e zbatimit të tyre, si pasojë e së cilës cenohet realizimi në kohë i investimeve dhe përfitimi në kohë i shërbimeve.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Asfaltim i rrugës së fshatit Kotodesh", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (me TVSH) 12,410,031.9 lekë, realizuar nga OE "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **175,678** lekë pa TVSH.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (me TVSH) 39,444,209 lekë, realizuar nga OE "I." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,138,336** lekë pa TVSH.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NJA Qukës", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (me TVSH) 48,333,972.82 lekë, realizuar nga OE "R.." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,713,914** lekë pa TVSH.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion i rrugës Rrashtan", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (pa TVSH) 34,826,282.4 lekë, realizuar nga OE "K." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **850,820** lekë pa TVSH.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Dalip Toçka" Kotodesh", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (pa TVSH) 25,912,506 lekë, realizuar nga BOE "M." SHPK & L. K." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **352,492** lekë pa TVSH.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Ndërtimi i shkollës së mesme "Sali Halili", Rrajcë Fushë", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (pa TVSH) 151,856,222 lekë, realizuar nga OE "E." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **576,405** lekë pa TVSH.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksioni i kanalit të Lingajcës, Faza II", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (pa TVSH) 13,742,911 lekë, realizuar nga OE "O." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **516,000** lekë pa TVSH.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksioni i kanalit të Xhelos, Faza II dhe sistemimi i ujërave të larta në Krastën e Prrenjasit", Bashkia Prrenjas,*** me vlerë të kontratës (pa TVSH) 14,505,977 lekë, realizuar nga OE "A. I." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **387,800** lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të vitit 2024 me objekt *"**Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik)**"*, me fond limit prej 8,754,458 lekë dhe vlerë kontrate 8,490,000 lekë me fitues OE "T." shpk, u konstatua se operatori ekonomik ka dorëzuar mjetin me 31 ditë vonesë, për të cilin duhet të mbahej penaliteti i cili sipas përllogaritjeve rezulton në vlerën **1,052,760 lekë,** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

➢ *Në fushën e zbatimit të dispozitave ligjore për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të përdorimit:*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan disa mangësi si më poshtë:

-Në 8 raste mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore;

-Në 4 raste, konstatohen mangësi me Planvendosjen si mos pozicionim i saj mbi rilevimin topografik, mos pasqyrimi i aksesit për në objekt, mos pasqyrimi i kateve të objekteve me të cilën kufizohet aplikanti;

-Në 5 raste konstatohen mangësi me Projektin Arkitektonit, pasi ai paraqitet i pa plotë, duke mos pasqyruar prerjet dhe fasadat teknike;
-Në 5 raste kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara 3 muajt fundit;
-Në 1 rast, mungon kopja e policës së sigurimit të projektuesit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale;
-Në 8 rastet e audituara, mungon projekti për eficiencën energjetike;
-Në 8 rastet e audituara, përgjithësisht mungojnë Mendimet e Institucioneve të cilat duhet të shprehen përpara miratimit të lejes së ndërtimit;
-Në 2 raste, konstatohen mangësi me distancat e objektit me kufirin e pronës;
-Në 8 raste mungojnë projektet në DWG.

- *Në fushën e organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM***.**

Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje e kullota) të transferuara sipas VKM u konstatua se:
1. Menaxhimi i pronave të transferuara me VKM dhe i aseteve në Bashkinë Prrenjas nuk mbështetet nga një strukturë e dedikuar, por nga punonjës me funksione të tjera të organizuar si "Struktura e posaçme e administrimit të pronës", ndërsa vetëm një specialist është caktuar për këtë proces, duke kufizuar efektivitetin e administrimit të pronave, mosveprim në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 3, neni 9 pika 1/c dhe neni 27;
2. Bashkia Prrenjas dhe Struktura e posaçme e administrimit të pronës nuk kanë hartuar një plan pune vjetor për verifikimin në terren të pronave të transferuara me VKM, duke realizuar çertifikimin e atyre pronave për të cilat është paraqitur kërkesë për zhvillimin e saj.
Mungesa e verifikimit të plotë në terren të pronave ka sjellë mospërputhje ndërmjet numrit të pronave të evidentuara në listën bashkëlidhur VKM-ve dhe informacionit të raportuar nga SPAP si dhe mosregjistrimin e plotë të tyre në regjistrin ekonomik të pasurive të paluajtshme nga drejtoria e financës dhe buxhetit;
Mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*" i ndryshuar, Ligjin nr. 10296/2010 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
3. Nga Bashkia Prrenjas dhe SPAP nuk është miratuar asnjë plan vjetor dhe strategjik mbi pajisjen e aseteve me çertifikatë pronësie, ku të përcaktohen kriteret orientuese për përzgjedhjen e atyre prioritare veçanërisht ato arsimore e shëndetsore, si dhe afati kohor për përmbylljen e kësaj procedure, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2011 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Kreu II neni 8 pika 8 dhe Manualin MFK i ndryshuar, Kap. 2../Kap 2.4.1, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;.si dhe Udhëzimeve të MARS dhe MSHMS: Udhëzimi i MARS nr. 30 datë 12.09.2014 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit parashkollor"; Udhëzimi i MARS nr. 18 datë 04.05.2018 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit profesional dhe konviktet"; Udhëzimi i MSHMS nr. 12 datë 20.03.2015 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve qendrave shendetsore dhe ambulancave" etj.
4. Numri i pronave të pajisura me çertifikatë pronësie rezulton i ulët. Gjithashtu nuk është përcaktuar një objektiv vjetor për numrin e procedurave që duhet të përfundohen, ndërsa

performanca ka shënuar rënie nga viti në vit, duke dëshmuar një ecuri me efektivitet të ulët të procesit.

5. Nga Struktura e posaçme e administrimit të pronës nuk është bërë asnjë inspektim në terren i apartamenteve të pajisura me Çertifikatë pronësie, me qëllim komunikimin dhe orientimin e banorëve të akomoduar në këto apartamente për nisjen e procedurave të privatizimit, duke mundësuar fitimin e të drejtës së pronësisë.

- Njëkohësisht, mungesa e këtyre veprimeve ka penguar edhe identifikimin dhe aplikimin e saktë të taksa e tarifave vendore në dobi të interesave financiare të bashkisë.
- Nga ana Strukturës së posaçme nuk është ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin dhe verifikimin në terren të pronave me qëllim fillimin e procedurave të regjistrimit në ASHK të apartamenteve të ndërtuara nga ish-ndërmarrjet, të cilat faktikisht janë në përdorim nga banorët.

➢ *Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit*.

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Prrenjas për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë në RPA me shkresën e saj nr. 403/9 prot., datë 22.10.2025, konstatohet se është një numër i vogël masash, për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit"*, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht:

a. Masa Organizative janë lënë 33 masa që janë pranuar 33 masa nga subjekti, nga të cilat: 13 masa janë zbatuar, 17 masa janë në proçes zbatimi, 3 masa janë pjesërisht zbatuar dhe 0 masa pa zbatuar; **rikërkohen 3 masa të cilat janë pjesërisht zbatuar;**

b. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) janë lënë 6 masa në vlerën totale 97,796,446 lekë (pa kamatë) ose 103,063,541 lekë (me kamatë) që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat: 5 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe **rikërkohet 1 masë pjesërisht e zbatuar**;

c. Masa disiplinore është lënë 1 masë për 4 punonjës e cila është pranuar dhe është zbatuar.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

➢ *Në fushën e zbatimit të buxhetit.*

Bashkia Prrenjas nëpërmjet strukturave përgjegjëse, gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programeve buxhetore afatmesëm, të bazohet në parashikimet realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm, duke pasur në konsideratë mosrealizimin e të ardhurave dhe analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime.

➢ *Në evidentimin e etyrimeve te palikujduara për taksa e tarifa vendore, leje legalizimi, gjoba IMTV, etj.*

-Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas të marrë masa për zbatmin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksa e tarifa vendore për 261 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 5415 familje, me vlerë 89,934,269 lekë.

-Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 92 persona me vlerë 2,819,151 lekë.

-Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për pajisjen me Autorizim/Liçensë për shitje karburanti nga 2 subjekte të vlerës 1,800,000 lekë.

-Kryeinspektori i IMTV, të marra masa në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, për përgatitjen e kërkesë padive për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv dhe kryerjen e gjithave procedurave ligjore dhe administrative për të bërë të mundur arkëtimin e tyre në vlerën 16,700,000 lekë.

- *Në hartimin e pasqyrave financiare viti 2025:*

-Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Prrenjas të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të inventarit kontabël në llogarinë 211 "Pyje, kullota plantacione" të vlerës 2,770,029 lekë që janë shpenzime për prodhim , transport dhe stivim dru zjarri.

- Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Prrenjas, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Bashkia Prrenjas, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" SH.A, të 22 artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 215,844,097 lekë.

- *Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave:*

-Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe komisionet e përfshira për përllogaritjen e fondit limit, të forcojnë procedurat e planifikimit të nevojave për karburant, duke kërkuar që çdo Drejtori/Sektor, gjatë paraqitjes së kërkesave për prokurim, të dokumentojë jo vetëm vlerën financiare, por edhe sasinë e kërkuar të karburantit (në litra), të mbështetur në analiza të konsumit historik, numrin dhe llojin e mjeteve, aktivitetet e planifikuara dhe nevoja të tjera objektive.

-Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për forcimin e kontrolleve në fazën hartimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, duke siguruar që kriteret dhe karakteristikat teknike të jenë të argumentuara, objektive, proporcionale dhe të bazuara në nevojat reale funksionale të institucionit. Të shmanget përcaktimi i parametrave teknikë me kufizime të panevojshme ose vlera fikse me përjashtim të rasteve kur këto mbështeten me analizë dhe dokumentacion teknike përkatës.

-Titullari i Autoritetit Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit, të marrë masa për përzgjedhjen e zyrtarëve pjesëmarrës në proces, duke siguruar që ata të jenë specialistë të fushës përkatëse. Gjithashtu Njësia e Prokurimit të marrë masa që kërkesat, specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht, të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

- Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

-Titullari i AK Bashkia Prrenjas, personat e ngarkuar si anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për kryerjen e vlerësimit të ofertave brenda afatit, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por për të shmangur çdo vonesë të paargumentuar që lidhet me shpenzimin e planifikuar nga Bashkia Prrenjas.

-Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **175,678 lekë pa TVSH** nga OE "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 436 prot, datë 09.02.2023, me objekt "Asfaltim i rrugës së fshatit Kotodesh", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm

ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
-Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,138,336 lekë pa TVSH** nga OE "I." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3025 prot, datë 06.11.2023, me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,713,914 lekë pa TVSH** nga OE "R." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 613 prot, datë 11.03.2025, me objekt "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NJA Qukës", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **850,820 lekë pa TVSH** nga OE "K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 508 prot, datë 16.02.2023, me objekt "Rikonstruksion i rrugës Rrashtan", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
-Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **352,492 lekë pa TVSH** nga BOE "M." SHPK & L. K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 815 prot, datë 07.03.2024, me objekt "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Dalip Toçka" Kotodesh", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **576,405 lekë pa TVSH** nga OE "E." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2598 prot, datë 11.10.2024, me objekt "Ndërtimi i shkollës së mesme "Sali Halili", Rrajcë Fushë"", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **516,000 lekë pa TVSH** nga OE "O." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2849 prot, datë 06.11.2024, me objekt "Rikonstruksioni i kanalit të Lingajcës, Faza II", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **387,800 lekë pa TVSH** nga OE "A. I." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2705 prot, datë 24.10.2024, me objekt "Rikonstruksioni i kanalit të Xhelos, Faza II dhe sistemimi i ujërave të larta në Krastën e Prrenjasit", Bashkia Prrenjas, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
- Titullari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,052,760 lekë** ndaj Operatorit Ekonomik "T." shpk, vlerë e cila përllogaritet si penalitet për vonesën në dorëzimin e mallit në zbatim të kontratës me nr. 1943 prot., datë 16.07.2024, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.

- *Në fushën e zbatimit të dispozitave ligjore për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të përdorimit:*

-Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Aplikimit të Projekteve dhe Pronave, të sigurojë që para miratimit të lejeve të ndërtimit, të verifikohet dhe dokumentohet plotësisht përmbushja e të gjitha kërkesave ligjore dhe procedurale, përfshirë përditësimin e dokumentacionit kadastral,

saktësinë e planvendosjeve, licencimin e projektuesve, saktësinë e projeteve arkitektonike dhe disponimin e projekteve të eficiencës energjitike si dhe respektimin e distancave, me qëllim garantimin e ligjshmërisë së procesit.

- *Në fushën e organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM.*

-Kryetari i Bashkisë të marrë masat për për forcimin e kapaciteteve ekzistuese apo krijimin e një strukture të dedikuar për verifikimin në terren, regjistrimin, administrimin, monitorimin dhe kontrollin e pronave të transferuara me VKM dhe aseteve publike në Bashkinë Prrenjas.

- Struktura e posaçme e administrimit të pronës të marrë masat:

Për hartimin e një plani pune për verifikimin në terren të pronave të transferuara me VKM, për saktësimin e numrit dhe statusit fizik e juridik të tyre me qëllim edhe plotësimin e regjistrit ekonomik të pasurive nga drejtoria e financës;

Për hartimin e grafikut të përgatitjes së praktikave dokumentare të pajisjes me certifikatë pronësie të pronave sipas llojit, funksionit dhe rëndësisë së tyre;

Fillimin e procedurës së privatizimit të pronave që janë objekte banimi të cilat janë pajisur me çertifikatë pronësie;

Verifikimin në terren dhe sensibilizimin e komunitetit, banorë në objektet e banimit të ndërtuara nga ish ndërnmarrjet, për regjistrimin, pajisjen me çertifikatë pronësie në ASHK dhe procedurës së privatizimit të tyre;

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Prrenjas për periudhën ushtrimore 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Prrenjas janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar**.*

Baza për opinionin e kualifikuar[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Prrenjas, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin

1 Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar me rezervë", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (SNA-700).
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 14,914 mijë lekë.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, si më poshtë:
-Referuar inventarit kontabël të llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione" u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar vlera 2,770,029 lekë, që janë shpenzime "Prodhim, transport e stivim dru zjarri", si shtesë aktivesh.
-Referuar inventarit kontabël të llogarisë 212 "Ndërtime konstruksione" u konstatua vlera prej 42,919,940 lekë nuk është e analizuar me objekte.
- Llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në inventarin kontabël ka të përfshirë 22 aktive të llojit ujësjellës kanalizime në vlerën kontabël 215,844,097 lekë, të cilët duhet të ishin transferuar në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh A.

II. Opinion për përputhshmërinë:

Ne kemi auditor përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Përrenjas, sa i takon shkallës së zbatueshme risë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Përrenjas, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2025.
*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Prrenjas, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinioni të kualifikuar**.*

Baza për opinionin të kualifikuar:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme[2] për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000), si më poshtë:
-Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2024-31.12.2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 7 raste për procedura të realizuara nga Bashkia Prrenjas me fond limit 339,740 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim.
-Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Prrenjas përgjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2025, në 4 raste me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej 227,568 mijë lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së disa kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.
-Nga auditimi i 2 procedurave të prokurimit publik ka rezultuar vonesë në përfundimin e shqyrtimit të vlerësimit të ofertave nga KVO, i përcaktuar 15 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2 *ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: "Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme"*

Nga auditimi ka rezultuar një dëm ekonomik **në vlerën 6,763,485 lekë.**
-Në 8 raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, në vlerën 5,710,725 lekë.
-Në një rast nuk është llogaritur kamatëvonesë në vlerën 1,052,760 lekë, për vonesë të kryerjes së shërbimit sipas kushteve të kontratës.
-Nga auditimi për vendimet e gjobave të nxjerra nga IMTV për periudhën objekt auditimi, rezultoi se nuk janë marrë masa për arkëtimin e gjobave **në vlerën 16,700,000 lekë.**
-Janë konstatuar detyrime për debitorë progresivë për subjekte e familjarë për taksa e tarifa vendore për të cilat nuk janë zbatuar procedurat për arkëtimin e tyre gjithsej në vlerën 89,934,269 lekë, nga e cila vlera prej **27,051,761 lekë** janë debitorë të vitit 2025 që janë të **ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë.
-Janë konstatuar të ardhura të munguara për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, **në vlerën 1,800,000 lekë.**
-Janë konstatuar të ardhura të munguara nga mos arkëtimin e detyrimeve për leje legalizimi në **vlerën 2,219,268 lekë.**

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" , i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 380/1 prot., datë 09.04.2026 "*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Prrenjas*", i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Prrenjas nga data 14.04.2026 deri në datën 17.07.2026, u krye auditimi për periudhën nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:
1. Z. P. Gj, *përgjegjës grupi;*
2. Zj. S. J, *audituese;*
3. Z. Sh. H, *audites;*
4. Z. A. Z, *audites;*

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

- Objektivat dhe Qëllimi i auditimit. Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
Në *auditimin e përputhshmërisë* synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 – 31.12.2025.
Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do realizohet pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.
- Identifikimi i çështjes. Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke

saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*", duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.
Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Prrenjas, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë.
- ***Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.*** Strukturat drejtuese të Bashkisë Prrenjas, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, etj.
- ***Përgjegjësitë e audituesve.*** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.
Përgjegjësia jonë (*audituesit e KLSH-së*), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
- *Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;*
- *Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;*
- *Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;*
- *Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e*

mëparshme;

- *Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).*
- *Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;*

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Prrenjas, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

-Kriteret e vlerësimit. Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.
- Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar.;
- Ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar.
- Vendim nr. 325, datë 31.5.2023 "*Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike*".
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *"Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";*
- VKM nr. 5, datë 11.1.2023 "*Për përcaktimin e vlerës së tarifave dhe pagesave, masës së penaliteteve, si dhe të mënyrës së llogaritjes, mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave të arkëtuara nga proceset kalimtare të pronësisë*""*;*
- Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, i ndryshuar;*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";*
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 *"Për procedurat standarde te monitorimit te buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore";*
- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura",* i ndryshuar;

Udhëzimet standarde vjetore të Ministrisë së Financave për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit;

- Rregullore e Brendshme *"Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH-së",* miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme *"Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr.07,*

datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë, etj.

- *Standardet e auditimit.*
ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të auditimit financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë*"; etj. Standardet kombëtare të kontabilitetit; Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i auditimit të brendshëm, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

- *Metodat e auditimit*.
Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:
- *Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe*
- *Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit*.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin: Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën tekN...t e auditimit*:*
- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatohet se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese,* konsistoi në ekzaminimin e aktiveve,

llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve.* Përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmimi nga të tretët.* Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.*

- ***Dokumentimi i auditimit*.**

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raport Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresë nr. 380/14, datë 06.08.2026, mbi të cilin, nga subjekti i audituar nëpërmjet shkresës nr. 920/71 prot., datë 09.09.2026, administruar në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2026 për njohjen mbi Projekt Raportin e Auditimit për të cilin u paraqitën observacione dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia Prrenjas është një bashki në Qarkun e Elbasanit, e cila kufizohet në veri me Bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është Qyteti i Prrenjasit është krijuar si njësi administrative në vitin 1958. Popullsia sipas Regjistrit Civil shkon ne 33,031 banorë.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*

Objektivat, burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni, ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.
Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.
Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
Bashkia Prrenjas, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.
Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Prrenjas për periudhën e aktivitetit 2024-2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

Pika 2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për vitin 2025.

***I** Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-së*
Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Prrenjas, nga grupi i auditimit u kryen verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët MFK: *"Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i*

riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi & Komunikimi" si dhe *"Monitorimi & Raportimi",* në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 "*Për disa shtesa dhe ndryshime*", ku titullari i njësisë në sektorin publik *krijon dhe vlerëson* sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 "Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli", titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit"*; neni 9 pika 4/a *"Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues*", në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i ndryshuar, Kreu IV "*Zbatimi i MFK*", pika, 4,2,10/a "*Roli i nëpunësit autorizues të njësisë*", rezulton se *me* VKB nr. 18 datë 23.03.2017[3], *janë hartuar/miratuar*: "Plan i Përgjithshëm Vendor" - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe "Rregullore e Planit Vendor", të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT[4] dhe miratuar me Vendim të KKT nr. 3 datë 14.04.2017; Në Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse, kjo në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c.

[PPV] përmban: objektivat strategjikë dhe rregullat e zhvillimit me instrumentet për zbatueshmërinë e tyre për periudhën 2016-2030; për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, respektim dhe mbrojtje të tokës me vlera natyrore, bujqësore, kulturore, të krijojnë vende pune, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe me përdorimin e kujdesshëm të instrumenteve financiare, të sigurojnë të ardhura të drejtpërdrejta dhe përfitime për projekte investimi publik në nivel vendor.

Tabela nr.1

Qarku	Qendra e Bashkisë Prrenjas	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Elbasan	Prrenjas	Prenjas	2	18 768- C2023
		Qukës	11	
		Rrajcë	7	
		Stravaj	5	33031- GJ.C

Punoi:Grupi i Auditimit[5]

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

[3] https://portavendore.al/ëp-content/uploads/2018/06/Prrenjas-Plani-i-Zhvillimit.pdf

[4] Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) emëruar sipas VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017

[5] https://portavendore.al/bashkia-prrenjas/pasaporta-e-bashkise-prrenjas/njesite-administrative/

a. Bashkia Prrenjas ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme "Mbi organizimin**,** funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën e Bashkisë Prrenjas**",** hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar neni 9 pika 1/1 germa 'b', Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] për vitin ushtrimor 2025 "Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë dhe njësive administrative për vitin 2025" me nr. 116 datë 26.12.2024 me nr. 3264 prot., datë 27.12.2024 konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 66/1 prot., datë 13.01.2025 si dhe Urdhri i Kryetarit nr. 16 datë 10.01.2025 me nr. 101 prot., datë 10.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave në Bashkinë Prrenjas", Rregullore e miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 53 datë 26.03.2025 dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 16 datë 10.01.2025.

Për periudhën nën auditim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuar janë reflektuar në *Rregulloren e brendshme të bashkisë.*

b. *Mbi respektimin e etikës*: Me Urdhrin e Kryetarit nr. 306 datë 13.08.2025 me nr. 1814 prot., datë 13.08.2025, është ngritur grupi i punës për hartimin e Manualit Praktik për etikën në Administratën e Bashkisë Prrenjas. Grupi i punës përbëhet nga 21 anëtarë, dhe është ngritur në zbatim të VKM nr. 874/2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike" dhe Udhëzimit nr. 22 datë 21.01.2025 "për rolin e burimeve njerëzore në zbatimin e legjislacionit për etikën në institucionet e administratës publike". Me Vendimin nr. 113 datë 22.08.2025 dhe me nr. 1883 prot., datë 22.08.2025 është miratuar "Manuali praktik për etikën në administratën publike të Bashkisë Prrenjas".

c. Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar me Vendim të Kryetarit nr**.** 17 datë 10.01.2025 dhe me nr. 97 prot., datë 10.01.2025 **"**Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i përditësuar, konform Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike*" i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, neni 9, pika 1/1 germa 'b', neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*" i ndryshuar; Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

"Kodi i Etikës" dhe " Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit" përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

Punësimi në Bashkinë Prrenjas bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë

Prrenjas:- Punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar ;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar;
Për *vitin 2025* [KPP] në Bashkinë Prrenjas është ngritur KPP nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit nr. 196 dhe nr. 197 datë 27.05.2025 me nr. 1107 prot., dhe nr. 1108 prot., datë 27.05.2025[6], i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:

Tabela nr.2

Nr	Emër Mbiemër	Statusi	Pozicioni në strukturë
1	Znj. Z. Ç.	Kryetar	Drejtore e DMBNJ
2	Znj.S. D.	Anëtar	Përgjegjëse e SBNJ
3	Znj.S. K.	-//-	Drejtore e DMFE/NZ
4	Z. A. M.	-//-	
5	Z. A. Gj.	-//-	

Burimi:Bashkia Prrenjas

KPP është konform VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pika 2,3.
- Strukturat përgjegjëse të çdo bashkie hartojnë në fillim të çdo viti "Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe miratimin e numrit të aplikantëve jashtë shërbimit civil" në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar neni 18, VKM nr. 108/2014 "*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*", të atyre me Kontratë Pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë*" i ndryshuar, VKB "Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre" si dhe Vendimeve të Kryetarit "Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Prrenjas". Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil hartohet mbi nevojat e institucionit për personel për vitin e ri ushtrimor dhe përmban: numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës vakante të hapura për konkurrim, klasifikimin e tyre për çdo kategori dhe klasë, vendin e publikimit. Për *vitin 2025* është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë është miratuar me nr. 18 datë 27.02.2025 dhe me nr. 531 prot., datë 03.03.2025. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Prrenjas bëhet në faqen zyrtare të saj, në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA si dhe në stendat për njoftime publike të Institucionit, konform kjo VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar Kreu II pika 6; Ligjit nr. 7961/1995 "Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 19 pikat 1,2.
Konstatim: Nga Bashkia Prrenjas për pozicionet me Kod Pune (pa afat apo provizorë), nuk bëhet shpallja në AKPA, por publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas, në rrjetet sociale, dhe në stendat e Bashkisë, në mospërmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2;
- Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, neni "përshkrimet e

[6] Ky komision është i vlefshëm edhe për procedurën e ngritjes në detyrë dhe të lëvizjeve paralele

punës" si dhe e dosjes së personelit. [DFB/BNJ] nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit; Kjo procedurë realizohet në zbatim të përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin nr. 152/2015 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, VKM nr. 108/2014 "Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil", VKM nr. 243/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.
Rezultoi se praktika e plotë e punësimit (për NC) e kandidatëve të kualifikuar, nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij, nuk është bërë pjesë e dosjes së personelit, por janë sistemuar në dosje të veçantë
- Në Bashkinë Prrenjas ka gjetur zbatim në afat Udhëzimi i Komisionerit të Shërbimit Civil sipas shkresës nr. 1331 prot., datë 10.10.2024, në kuadër të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil të Bashkisë Prrenjas",
- Të punësuarit (NC) gjatë vitit 2025 në Bashkinë Prrenjas pasqyrohen si në tabelën mëposhtme:

Numri i të punësuarve viti 2025	**Niveli arsimor**	
	I lartë	I mesëm
4	4	-

- Në Bashkinë Prrenjas struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, reflektuar edhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe prokurimeve si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Prrenjas, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë dhe mbi numrin e punonjësve të miratuar me VKB, me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Për vitin 2025 plani vjetor i rekrutimeve është miratuar me nr. 18 datë 27.02.2025 dhe me nr. 531 prot., datë 03.03.2025. Është konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 310/1 prot., datë 10.03.2025.
Plani vjetor i pranimeve në Shërbimin civil 2025 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.3

Kategoria e pozicionit	Niveli i lartë drejtues / 1	Sekretar i Përgjithshëm	I - 5
	Niveli i mesëm drejtues / 3	Drejtor në Drejtorinë e Integrimit	II - 2
		Drejtor në Drejtorinë e zhvillimit ekonomik	
		Drejtor në Drejtorinë e urbanistikës	
	Niveli i ulët drejtues / 5	Përgjegjës Sektori IT	III - 2
		Përgjegjës Sektori i Bujqësisë	
Numri		Përgjegjës Sektori i Planifikimit territorit	
		Përgjegjës Sektori Taksa e Kontabilitet	
		Përgjegjës Sektori i planifikimit & Implementimit projekteve	
	Niveli ekzekutiv / 32	Specialist	IV - 3
Punonjës me Kod Pune	Nuk ka informacion		
Punonjës provizor	Nuk ka informacion		
	41 pozicione NC		

Në Planin vjetor të punësimit, nuk janë përfshirë ato pozicione vakante që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune si dhe nevojat e Bashkisë për punonjës provizor, pasi ky informacion miratohet me VKB "mbi numrin e punonjësve dhe për pozicionet".
- Struktura organizative e Bashkisë Prrenjas për vitin 2025 ka këtë kompozim:

Nr	Viti	Numri drejtorive	Numri sektorëve +NJA	Numri i punonjësve /Plan
1	2025	5	42	325

Burimi: Bashkia Prrenjas

Bashkia Prrenjas për vitin 2025 shpërndarjen e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2025 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Tabela nr.4

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil 2025	Vende vakante 2025	Kodi i Punës 2025	Funksion politik
Kategori e lartë	1	0	-	3
E mesme drejtuese	4	1		2
E ulët drejtuese	11	1		3
Ekzekutive	34	6		-
Totali	50	8	279	8

Burimi: Bashkia Prrenjas

Nga auditimi dhe informacioni i paraqitur në tabelë *rezultoi se* për vitin 2025 janë 8 pozicione vakante: 1 niveli i mesëm drejtues- drejtori i DBNJSHM, 1 nivel i ulët drejtues- përgjegjës i SPHIP, 4 nivel ekzekutiv: 2 specialistë të SPHIP, 1 specialist finance, 1 punonjës sporteli, 1 inspektor në IMPK dhe 1 edukatore në çerdhe.
Nga komunikimi me BNJ na u komunikua se 4 pozicione janë plotësuar deri në 3 mujorin e parë të vitit 2026.
- Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në Bashkinë Prrenjas ka qenë i vogël, prej 31 punonjësish.
Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5


Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2025	Punësimi 2025
1	KMCAP	2	9
2	Pension pleqërie	9	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	14	
4	Shkurtime/ristrukturime	-	
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	2	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura	2	
7	Ndërruar jete	1	
8	Refuzim të vendit të punës	-	
9	Leje Lindje	-	
TOTALI		30	28

Burimi: Bashkia Prrenjas

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Bashkinë Prrenjas, referuar strukturës5 organizative të miratuar në planifikim për vitin 2025 është 325 punonjës.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Prrenjas funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore". Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak:



Skemë e thjeshtuar e strukturës së NJVQV

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak
B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë
Për një menaxhim me efektivitet të burimeve njerëzore, nëpërmjet Urdhrit të Kryetarit nr. 83 datë 27.02.2025 dhe me nr. 499 prot., datë 27.02.2025 është ngritur Njësia e Menaxhimit të burimeve njerëzore [NJMBNJ].

Tabela nr.6

Përbërja e NJMBNJ	Statusi	Pozicioni në strukturë
Znj.Z. Ç.	Përgjegjëse	Drejtor DBNJSHM
Znj. S. D.	Anëtare	Përgjegjëse e SBNJ
Znj. M. Z.	-//-	Specialiste e SJP

Burimi: Bashkia Prrenjas

Për periudhën 01.01.2025- 31.12.2025 që ne auditojmë, struktura organizative e Bashkisë Prrenjas ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë. Këto ndryshime kanë qenë kryesisht në riorganizimin e njësive të strukturës. Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Vendim Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2025	VKB nr. 116 datë 26.12.2024	4	5	39	325
	Vendim Kr. Nr. 16 datë 10.01.2025				

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme *rezulton* se në vitin 2025 ka patur rikompozim të strukturës organizative me ndryshime të cilat janë pasqyruar në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Prrenjas.

- Ndërsa shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative për vitin 2025 sipas njësive përbërëse të saj, pasqyrohen në tabelën 1 në Aneks 1/MFK.

Struktura organizative e miratuar për vitin 2025 përmban 325 punonjës.
Nga auditimi ***rezultoi se*** Bashkia Prrenjas gjatë vitit 2025:
- *Ka* të punësuar sezonalë: Gjatë vitit 2025 kanë qenë të punësuar sezonalë me kontratë të përkohshme 3 mujore 10 punonjës pastrimi, te sektori i ujitjes dhe kullimit, punonjës shërbimesh-murator, numri i të cilëve është miratuar me VKB nr. 116 datë 26.12.2024 dhe me nr. 3264 prot., datë 27.12.2024. *rezultoi se* në Relacionin bashkëlidhur vendimit me nr. 3264/1 prot., datë 27.12.2024, nuk janë paraqitur pozicionet dhe strukturat për të cilat nevojiten punonjësit provizorë. VKB është konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 66/1 prot., datë 13.01.2025;
- *Nuk ka* të punësuar nga ekselenca;
- *Ka* të punësuar nga Grupi i veçantë;
- *Ka* të punësuar me kohë të pjesshme: Këshilltar i Kryetarit, punonjës për organizimin e eventeve në QKP, punonjës shërbimesh.
- Për vitin 2025 *ka* patur 8 vende vakante;

- Referuar Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, mbi funksionet e bashkive, po japim një pasqyrim se si është kompozuar Struktura e Bashkisë Prrenjas për vitin 2025, në zbatim të funksioneve që i jep ky ligj, sipas *tabelës 2.*.ë Aneks/MFK.

Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Prrenjas me të cilat ka ushtruar funksionet e veta konform konpetencave që i jep ligji, *rezultoi se* ka shërbime të cilat nuk

mbulohen me njësi përkatëse në strukturë, por vetëm me pozicione të veçanta të inkuadruara në struktura me aktivitet të ngjajshëm, si: "shërbimi parësor shëndetësor" i funksionit "infrastruktura dhe shërbimet publike"[7] dhe funksioni "Mjedisi"[8] duke riskuar mungesën e ofrimit të tyre për komunitetin; gjithashtu *rezultoi se* pozicioni i specialistit të aseteve në Sektorin e planifikimit të lejeve/legalizimeve dhe regjistrimit të pronave është i pamjaftueshëm për të zhvilluar me efektivitet këtë proces, pasi struktura e posacme për menaxhimin e pronave të transferuara me VKM, nuk ka prioritet këtë proces[9]. Duke iu referuar fokusit turistik të përcaktuar si prioritar në këtë bashki, mungesa e një strukture të veçantë për mjedisin, ka cenuar efektivitetin e aktivitetit turistik dhe zhvillimit të tij.

Konkluzion: Struktura organizative nuk ka siguruar mbulim të plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, veçanërisht atyre prioritare të bashkisë, duke kufizuar menaxhimin e aseteve, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit, duke bërë që zhvillimi ekonomik vendor dhe shfrytëzimi i potencialeve të zonës të jenë me ritme të ngadalta.

1.4 Përcaktimi i përgjegjësive

Në Bashkinë Prrenjas ndarja e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive janë përcaktuar qartë në Rregulloren e brendshme funksionale të Bashkisë, miratuar nga Kryetari me Vendim nr. 53 datë 26.03.2025.

Rezulton se në Bashkinë Prrenjas është aplikuar procedura e përkohshme e delegimit të detyrave. Me Urdhrin e Titullarit nr. 100 datë 25.07.2025 dhe me nr. 1641 prot., datë 25.07.2025, është bërë delegimi i disa detyrave për Nënkryetarin e Bashkisë;

Me Urdhrin nr. 293 datë 04.08.2025 dhe me nr. 1715 prot., datë 04.08.2025 "Për përcaktimin e përgjegjësive dhe kompetencave" i janë përcaktuar përgjegjësi shtesë (me delegim) Nënkryetarit të bashkisë, veprime konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 28 datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit në njësinë publike", Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Riskut dhe Koordinatorit të MFK në njësinë publike".

1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve.

- a Për të audituar *dosjet e personelit*, përzgjodhëm kryesisht dosjet e të punësuarve në vitin 2025 në aparatin e bashkisë dhe në Njësitë Administrative për kategoritë: pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Prrenjas. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961/1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar.

- Në **7** dosjet e punonjësve të larguar nga puna mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale e cila i bashkëlidhet Urdhrit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës;

- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjet e të punësuarve në vitin 2025, ***rezultoi se*** praktika ishte e plotë me dokumentacionin bazë të domosdoshëm, por u konstatuan këto mangësi: vërtetim nga prokuroria dhe gjykata, certifikata familjare, formulari i vetëdeklarimit si dhe mospërditësimi i raportit të aftësisë për punë dhe i certifikatës familjare, mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 117/2014 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të

[7] Vetëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës shëndetsore dhe garantimin e ofrimit të shërbimit për komunitetin

[8] Në zbatim të ligjit nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"; Ligji nr. 9587/2006 "mbrojtja e diversitetit" i ndryshuar; Ligji nr. 9774/2007 "Për vlerësimin dhe mbrojtjen nga zhurmat në mjedis" etj

[9] Trajtuar gjerësisht në Akt Konstatimin e pikes 4 të programit "administrimi i aseteve"

personelit e të regjistrit qendror të personelit" i ndryshuar me VKM nr. 833/2020 datë 28.10.2020, kreu I/pika 3;

- b *Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Prrenjas***.**

Trajnime të Buxhetuara/Parashikuara			Trajnime të realizuara në 2025		
Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesmarrës	Nr. i trajnimeve	Kosto totale	Nr i personelit pjesmarrës
19		Të gjithë	86		Të gjithë

Burimi: Bashkia Prrenjas

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përftimin e statusit të nëpunësit civil dhe jo vetëm. Nga auditimi ***rezultoi se*** nga Bashkia Prrenjas, struktura përgjegjëse e saj [SJBNJ] *çdo vit ka hartuar* Planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e saj, dhe për vitin 2025 është miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 1624 prot., datë 24.07.2025; trajnimet e punonjësve realizohen nga programet që ofron ASPA dhe jo vetëm, duke patur kështu një orientim mbi rëndësinë në përzgjedhjen e atyre temave që lidhen ngushtë me proceset e punës të përditshmërisë; me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualin për MFK i ndryshuar. Referuar tabelës së planifikimit vjetor të trajnimeve dhe temave dhe punonjësve pjesëmarrës në trajnimet e realizuara gjatë vitit 2025, *rezultoi se:* janë të përfshirë gjithë punonjësit si dhe temat e përzgjedhura për trajnime janë gjithëpërfshirëse.

Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

c. 1. Në zbatim të Vendimit nr. 9 datë 30.01.2024 "Për fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore për vitin 2024 dhe ngritjen e e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces (nga KMSHC)", me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas nr. 458 datë 26.10.2024 dhe me nr. 2629 prot., datë 26.10.2024, është ngritur Komiteti i vlerësimit [KV] me përbërje si më poshtë:

Tabela nr.7

Përbërja e NJMBNJ	Statusi	Pozicioni në strukturë
Znj.Z. Ç.	Përgjegjëse	Drejtor DBNJSHM
Znj. S. D.	Anëtare	Përgjegjëse e SBNJ
Znj. M. Z.	-//-	Specialiste e SJP

Burimi: Bashkia Prrenjas

Nga auditimi ***rezulton se*** KV ka komunikuar zyrtarisht me shkresën nr. 2629/1 prot., datë 26.10.2024 dhe në rrugë elektronike datë 24.10.2024 me menaxherët e çdo strukture për hartimin e përshkrimeve të punës dhe pozicionet efektive të çdo sektori. Rezultoi se pikat e Vendimit nr. 9 datë 30.01.2024 të KMSHC-së janë plotësuar në bashkëpunim të KV me secilin sektor dhe drejtori;

c. 2. Me shkresën nr. 999/1 prot., datë 21.11.2025 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil/Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes regjistruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 2789 prot., datë 25.11.2025 për "Njoftim për fillim të procesit të inspektimit të thelluar në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të ndjekur për vlerësimin e nëpunësve civilë, në Bashkinë Prrenjas", në zbatim të Urdhrit të Komisionerit Nr. 111 datë 21.11.2025 me nr. 999 prot., datë 21.11.2025.

- Grupi i inspektimit i KMSHC ka hartuar dhe ka dorëzuar në Bashkinë Prrenjas Vendimin paralajmërues nr. 7 datë 27.01.2026 me nr. 189/1 prot., datë 27.01.2026 dhe dërguar me shkresën përcjellëse nr. 189/2 prot., datë 27.01.2026 dhe regjistruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 294 prot., datë 28.01.2026. Grupi i inspektimit ka lënë detyra për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet reflektimit për konstatimet me afat 2 mujor, të përmbledhura në 5 pika.
- Me shkresën nr. 183/8 prot., datë 18.05.2026 të KMSHC/ Drejtoria e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes regjistruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 295/4 prot., datë 20.05.2026, është përcjellë Vendimi i KMSHC "Mbi përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes në vazhdim ndaj institucionit të Bashkisë Prrenjas, në lidhje me zbatimin e Vendimit paralajmërues nr. 7 datë 27.01.2026".
Në Vendimin përfundimtar është vendosur:
a. Përmbylljen e procesit të inspektimit të thelluar në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të ndjekur për vlerësimin e nëpunësve civilë, në Bashkinë Prrenjas;
b. Konstatimin e rregullshmërisë nga ana e institucionit të Bashkisë Prrenjas, duke përmbushur detyrimet e përcaktuara në Vendimin nr. 7 datë 27.01.2026;
c. Ky vendim i njoftohet institucionit të Bashkisë Prrenjas dhe publikohet në faqen zyrtare të KMSHC.

Parimet e Mjedisit të Kontrollit

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritetin dhe vlerat etike;
Parimi 2 – Titullari / Bordi i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;
Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;
Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave;
Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale;

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Vendosja e objektivave

Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t'u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike (drejtoritë dhe sektorët) duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t'i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë. Këto objektiva të vendosur tregojnë qartësisht atë që njësia synon të arrijë dhe se si do të matet ecuria, për këtë arsye ato duhet të jenë SMART: konkrete-të matshme-të arritshme-realiste-në kohë.
Nga auditimi *rezulton se* drejtoritë e Bashkisë Prrenjas objektivat vjetore i kanë përfshirë në planin vjetor të punës, të cilat kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.
Nga GMR në bashkëpunim me GMS dhe gjithë njësitë e strukturës organizative të bashkisë, janë marrë masat për evidentimin, vlerësimin, menaxhimin dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Prrenjas. Ky angazhim konsiston në përcaktimin e risqeve, strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tyre si dhe masat konkrete për parandalimin apo minimizimin e risqeve. Rezultati i zbatimit të tij është si më poshtë vijon:
2.1 Regjistri i Riskut: Grupi i auditimit lidhur *me menaxhimin e riskut*, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave në Bashkinë Prrenjas. Bashkia Prrenjas ka hartuar për vitet 2024 dhe 2025 Regjistrin e Riskut, në të cilin është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga

burime të jashtme, si dhe vlerësimi i tyre bëhet nga drejtuesit e EPB, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* "*Planifikimin dhe Përdorimin me eficencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave*". Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sektor, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjidhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Për vitin 2024 *është miratuar* nga titullari me nr. 317 prot., datë 26.01.2024, për vitin 2025 është miratuar me nr. 155 prot., datë 20.01.2025, konform Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, Manualit MFK miratuar nga Ministri i Financave me nr. 4 datë 26.01.2024, si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike", Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 28 datë 15.12.2011 "Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm".

✓ Bashkia Prrenjas ka ngritur *Grupin e Punës për hartimin e programit buxhetor afatmesëm (të njëjin funksione me grupin e menaxhimit strategjik* [GMS]) me Urdhrin e Kryetarit nr. 04 datë 08.01.2025 me nr. 64 prot., datë 08.01.2025 "Për krijimin e GMS për hartimin e PBA 2026-2028", me përbërje si në *tabelën nr.3* të Aneks /MFK. Nga auditimi **u konstatua** se:
- Kryetari i GMS duhet të jetë titullari i njësisë publike, pra kryetari i Bashkisë Prrenjas dhe se referuar kuadrit ligjor për MFK ky pozicion nuk delegohet, si në rastin konkret që është caktuar nënkryetari i Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar neni 27 dhe Manualit MFK miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016 i ndryshuar me Urdhrin nr. 4 datë 26.01.2024, Kap.II paragrafi 2.4.2; Udhëzimit të MF nr.4 datë 29.01.2020 "Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme";
- GMS nuk ka hartuar planin vjetor dhe grafikun e takimeve, por ka dokumentuar vetëm takimet e realizuara për hartimin e kalendarit për përgatitjen e PBA-së dhe ato për hartimin e PBA-së; rrjedhimisht ka përpiluar raporte vjetore të fokusuara në përgatitjen e PBA dhe projekt planit vjetor të buxhetit.
Roli dhe përgjegjësitë funksionale të GMS janë të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar neni 27 dhe Manualin e MFK i ndryshuar Kap. II/2.4.2; *GMS duhet të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme*:
• Të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimeve strategjike të njësisë;
• Të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm dhe efektiv i MFK, që siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
• Të kuptojë se si njësia realizon objektivat e MFK;
• Të rishikojë proçesin e menaxhimit të riskut;
• Të garantojë se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrolle të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet;
• Të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t"i përmbushin objektivat e tyre;
• Të vendosë standardet dhe vlerat e njësisë;
• Të verifikojë raportet e audituesve mbi MFK dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore;

• Të përcaktojë nëse janë raportuar dobësi materiale, kushte të tjera të raportueshme, apo gjetje të tjera;
• Të rishikojë përmirësimet e sugjeruara për MFK si dhe të ndjekë në vazhdimësi korrigjimin e dobësive në kontrollin e brendshëm;
• Të verifikojë deklaratën e titullarit të njësisë mbi sistemin e kontrollit te brendshëm;
• Të udhëheqë dhe të mbikëqyrë procesin e ndryshimit, që shton kapacitetin e njësisë për të punuar me rezultate të larta";

Nr	Viti	Nr. Anëtarëve GMS	GMS/EMP	Nr. i Programeve	Nr. Anëtarëve EMP
1	2024	23	√	14	23
2	2025				

Burimi:Bashkia Prrenjas/Punoi: Grupi i auditimit

✓ *Detyrat e NA si Koordinator i MFK*

NA është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të MFK në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar e transparencës.

Hapat kryesor që duhen ndjekur:

- Organizimi i procesit të zhvillimit të sistemeve të MFK – *pjesërisht realizuar*;
- Përcaktimi dhe vlerësimi i misionit, vizionit dhe objektivave kryesorë të njësisë *-realizuar;*
- Krijimi i një sistemi efikas të MR – *pjesërisht realizuar*
- Hartimi i listës dhe manualeve të proceseve të punës – *pjesërisht realizuar*
- Përgatitja e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës - *pa realizuar*
- Analizimin e kontrolleve ekzistuese dhe atyre të pritshme – *pjesërisht realizuar*
- Ndërmarrja e veprimeve korrigjuese – *pjesërisht realizuar;*
- Vlerësimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm – *realizuar*
- Raporti përmbledhës mbi kontrollet e brendshme – *pjesërisht realizuar*

✓ *Grupi i Menaxhimit të Riskut (GMR)* është organ monitorimi dhe koordinimi midis linjës së parë dhe të dytë mbrojtëse. NA si Koordinator i MFK është kryetar i GMR, por mund të jetë dhe një person i deleguar prej tij. Kryetari i GMR adreson risqet prioritare dhe masat e kontrollit për vendimmarrje në mbledhjet e GMS si dhe raporton te titullari i njësisë. Aktivitetet e monitorimit të GMR përfshijnë tre kategoritë e objektivave: operacionale, të raportimit, të përputhshmërisë. GMR si organ koordinues dhe komunikimi përbëhet nga përfaqësues të caktuar nga menaxherët e çdo strukture të njësisë publike. Me Urdhrin e Kryetarit nr. 85 datë 08.01.2025 është ngritur GMR (Grupi i menaxhimit të riskut) dhe është caktuar Koordinatori i Riskut konform Ligjit nr. 10296/2011 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, dhe Manualit MFK i ndryshuar, Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit. financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut".

Konstatim 1. GMS/Bashkia Prrenjas për asnjë vit nuk ka hartuar planin e punës dhe grafikun e takimeve, duke e kufizuar aktivitetin e GMS vetëm për përgatitjen PBA-së dhe Planit të buxhetit vjetor të njësisë. Kjo ka ardhur si rezultat i mos pasjes mjaftueshëm të njohurive rreth rolit të GMS, pasi edhe pse në takimet e planifikuara të GMS mbi PBA janë diskutuar edhe problematika të tjera të konstatuara në aktivitetin e përditshëm të strukturave përbërëse të Bashkisë, nuk kanë qenë i mjaftueshëm aq sa për të mos realizuar takime sipas një plani të miratuar vjetor. rolin dhe aktivitetin e GMS në shërbim të Njësisë publike, si dhe mos përpilimit të raportit vjetor mbi aktivitetin e tij, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar*

dhe kontrollin" i ndryshuar, Kap II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe "Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin" miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 i ndryshuar, Kap II pika 2.4.2; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;

Konstatim 2. GMR nuk ka kryer me përpikmëri përgjegjësitë që i atribuon kuadri ligjor, konkretisht: Sigurimin e kuadrit rregullator për proceset dhe risqet e lidhura me to (manualet e procedurave, gjurmët e auditimit, regjistrin e risqeve, planet e menaxhimit të risqeve, si dhe planet e trajtimit të masave për risqet), identifikimin dhe monitorimin e çështjeve që prekin risqet dhe kontrollet e njësisë si dhe dhënien e udhëzimeve dhe trajnimin e personelit lidhur me menaxhimin e risqeve dhe proceset e kontrollit.[10], mosveprime në kundërshtim me Manualim MFK kap II pika 2.4.4 dhe me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike";

Konstatim 3. GMS dhe GMR përbëhen nga të njëjtët anëtarë, dhe referuar detyrave, përgjegjësive dhe rolit të secilit grup në njësinë publike, njehsimi i përbërjes së GMS dhe GMR paraqet risk për faktin se dy funksione të ndryshme kontrolli dhe vendimmarrjeje bashkohen në të njëjtët persona duke krijuar risk të mungesës së ndarjes së funksioneve dhe të vetëvlerësimit të vendimmarrjes, duke ndikuar në efektivitetin e procesit të menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm.

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut mbështetet mbi objektivat që njësia publike përcakton, konkretisht nga titullari, NZ dhe menaxherët e njësisë, përgatitet (në këtë rast) nga Koordinatori i Riskut, dhe pasi miratohet duhet t'u vihet në dispozicion punonjësve.

Duhet theksuar fakti se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Strategji e riskut përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Njësitë e Strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas, GMS dhe GMR kanë hartuar "Planin Strategjik të Menaxhimit të Riskut 2024-2029" dhe miratuar me VKB nr. 107 datë 26.11.2024 dhe me nr. 3003 prot., datë 27.11.2024, konform Ligjit nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualit të MFK, Kap. II, paragrafi 4.2.

 # Parimet e Menaxhimit të Riskut:

Parimi 6: *Njësia publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva;*
Parimi 7: *Njësia publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave;*
Parimi 8*: Njësia publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime;*
Parimi 9*: Njësia publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm;*

3. Veprimtaritë e Kontrollit

Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

[10] Mënyra e funksionimit dhe afatet përkatëse janë të përcaktuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 'Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike'

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.
Për këtë çdo Njësi Publike dhe NJVQV duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësisë i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre. Nga strukturat e Bashkisë Prrenjas janë hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Planet vjetore të punës ku përfshihet edhe plani dhe instrumentet e kontrollit të brendshëm, konform nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, "Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Kapitulli III pika 3.3.
- Në Bashkinë Prrenjas për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	**»** Manuali i Klasifikimit te llogarive
		» Manuali i pasqyrave financiare
2	Sektori i Urbanistikes	**»** Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015" Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.
3.1 Kategoritë e kontrollit
- Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë Prrenjas është ai parandalues nëpërmjet NJAB, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen çdo vit *vetëm nga KLSH*, pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit;

a. Kontrolle në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;
b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);
c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i dy firmave);
d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj. Është miratuar nga kryetari "Regjistri i risqeve për menaxhimin e aktiveve të bashkisë" me nr. 140/1 prot., datë 21.01.2025;
e. Ka rregullore ka rregullore që përcakton EOL(endo of life) e pajisjeve duke u nisur nga sistemi operativ, kur këto pajisje e kalojnë kohën e përdorimit;
f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor dhe elektronik;
g. Komunikimi dhe trajtimi i urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni;
h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, duke miratuar "Procedurën standarde të veprimit (PSV) për menaxhimin e arkivës miratuar nga kryetari me nr. 274 prot., datë

30.01.2025, por *rezultoi se* në këtë dokument nuk janë përshkruar masat për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës;
i. Në Bashkinë Prrenjas është miratuar nga kryetari "Regjistri i risqeve për menaxhimin e aktiveve të bashkisë" me nr. 140/1 prot., datë 21.01.2025 konform ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 64 pika j dhe Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar;
j.1 Bashkia Prrenjas me Urdhër e Kryetarit nr. 324 datë 31.12.2021 dhe nr. 3522 prot., datë 31.12.2021, ka miratuar (ndryshimin) "Ngritjen e njësie përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkinë Prrenjas" të përbërë nga 2 anëtarë: përgjegjës i SBJNP në cilësinë e përgjegjësit të [NJSMS], audituese e NJAB;
- Kjo njësi *ka hartuar* Rregulloren e përditësuar "Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit" dhe *miratuar* nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas me nr. 3016 prot., datë 29.12.2025, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 "*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*", neni 13 pika 10;
- Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI[11] me nr. 3016/1 prot., datë 29.12.2025 për vitin 2025, i cili rezulton pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Deri më 29.12.2025 në bashkinë Prrenjas nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit dhe e mbrojtjes së sinjalizuesit;
k.1. Me Urdhrin e Kryetarit nr. 615 datë 19.12.2024 dhe me nr. 3178 prot., datë 19.12.2024 "Për ngritjen e Autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave" i ndryshuar me atë nr. 537 datë 16.12.2025 me nr. 2935 prot., datë 16.12.2025, strukturë e cila përbëhet nga 3 anëtarë, dhe si përgjegjës i NJPKI është caktuar specialiste/juriste e SBNJP;
2. Bashkia Prrenjas *ka hartuar* "Rregulloren e Parandalimit të konfliktit të interesave" dhe miratuar i përditësuar me Vendim nr. 01 datë 08.01.2026 dhe me nr. 83 prot., datë 08.01.2026;
- Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI[12] me nr. 35 prot., datë 10.01.2026 për vitin 2025, i cili rezulton pa raste konflikti interesi në procedurat e realizuara në punë publike, mallra e shërbime gjatë vitit 2024; Deri më 31.12.2025 në Bashkinë Prrenjas nuk ka patur raste informacioni/denoncimi nga komuniteti, grupe interesi apo media për raste të konfliktit të interesit;
m. Bashkia Prrenjas ka faqen e saj zyrtare në web me adresë ***https://www.bashkiaPrrenjas.gov.al/*** dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë ***https://portavendore.al/bashkia-Prrenjas/pasaporta-e-bashkise-Prrenjas/*,** të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connectionsecurity) *HTTPS* (HyperTextTransferProtocolSecure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;
3.2 Manuali i proceseve të punës/Harta e proceseve të punës.
*Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës***.** Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen

[11] Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,
[12] Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave). Bashkia Prrenjas ka hartuar manualin për të gjitha proceset që kryhen sipas sektorëve të bashkisë dhe e ka miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 3087 prot., datë 31.12.2025, konform Ligjit nr. 10296 /2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe "Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 i ndryshuar me nr. 4 datë 27.01.2024, Kapitulli III pika 3.3.

3.3 Gjurmët e Auditimit janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Nga sa më sipër nga ana e Bashkisë Prrenjas, grupit të auditimit iu vu në dispozicion vetëm "Gjurmët e Auditimit" të hartuar nga DFB për efekt të PBA, "Gjurmët e Auditimit" të hartuar nga DBNJSHM miratuar me nr. 2998 prot., datë 24.12.2025 kjo pasi Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA, nuk ka miratuar gjurmët e unifikuara të auditimit të njësisë.

Konstatim: Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset e strukturave të Bashkisë Prrenjas, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.100/2016 i ndryshuar me Urdhrin nr. 04. Datë 26.01.2026 kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, neni 121 e122.

3.4 Plani i kontrollit të brendshëm janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Çdo Njësi Publike duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm (periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësisë i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre. *Rezultoi se* nga strukturat e Bashkisë Prrenjas është hartuar/miratuar Plani vjetor ku përfshihen dhe Kontrolli i Brendshëm, periodik e vjetor, kjo në zbatim të nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, "Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar Kapitulli III pika 3.3.

3.5. Lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Sistemeve IT, nga specialisti IT i Bashkisë Prrenjas, u vu në dispozicion informacioni si në **tabelën nr. 4** në Aneks /MFK.

- Nga specialisti IT çdo vit paraqiten në Drejtorinë e financës kërkesat buxhetore mbi nevojat institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjet IT**.** Kështu për vitin 2025 kërkesat buxhetore paraqiten si në *tabelën nr. 4* të Aneks/MFK.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelat respektive, ***rezultoi* se** në Bashkinë Prrenjas nga GMS nuk është bërë analizë e mirëfilltë mbi nevojat e atyre strukturave të njësisë për programe të avancuara, me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimeve, si në rastin e administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore etj.**,** mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 87/2019 "*Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit*", i ndryshuar neni 2/b; Udhëzimit nr. 16, datë 3.4. 2020 "*Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit*" neni 4/2 dhe neni 4/3.d e në vijim;

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, ***konstatua se***:

1. Bashkia Prrenjas nuk ka ende një organizim të mirëfilltë për sistemet IT, që do të thotë nuk ka Dhomë serverash të ndërtuar sipas standardeve të përcaktuara në aktet ligjore dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga AKSHI. Ka vetëm 1 sistem dhe një dhomë ku ruhen pajisjet për monitorimin e kamerave të qytetit Prrenjas për rritjen e sigurisë në shkolla dhe për qytetarët;

2. Nuk ka miratuar Rregulloren "Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit të Bashkisë Prrenjas, por ka rregullore që përcakton EOL (endo of life) e pajisjeve duke u nisur nga sistemi operativ kur këto pajisje e kalojnë kohën e përdorimit;

3. Specialisti IT nuk monitoron procedurat *back up,* por monitoron hapësirat e disponueshme nëpër kompjutera dhe i verifikon periodikisht, për të garantuar integritetin, disponueshmërinë dhe rikuperimin e suksesshëm të të dhënave, si dhe testim periodik të rikthimit (restore) për të siguruar që të dhenat mund të rikuperohen. Specialisti IT ndjek problematikat e çdo sektori në funksionimin e paisjeve IT si dhe sistemeve që përdoren.

4. Ka hartuar Planin Vjetor të punës për vitin 2025 i cili është zbërthyer në plane mujore;

5. Ka bërë raportim mujor te titullari mbi punën e kryer referuar planit mujore të miratuar;

6. Gjatë viti 2025 Specialisti IT ka marrë pjesë në trajnime specifike të fushës kryesisht në fushën e mbrojtjes kibernetike, organizuar nga ASKS ku dhe bëhet raportim i përjavshëm për sulmet kibernetike etj.;

7. Mungon dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj., ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe eficenca e tyre; në moszbatim të VKM nr. 710/2013 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit"; "Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverave" hartuar nga AKSHI/2008;

Konkluzion: Megjithëse funksioni IT kryen aktivitetet bazë operacionale dhe monitoruese, sistemi i kontrollit dhe administrimit të teknologjisë së informacionit nuk është i plotë dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat rregullatore dhe standardet përkatëse.

 # Parimet e Aktiviteteve të kontrollit:

Parimi 10: *Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit;*
Parimi 11: *Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë;*
Parimi 12: *Vendosja e politikave të kontrollit përmes politikave dhe proçedurave;*

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Prrenjas janë paraqitur observacionet me nr. 920/71 prot., datë 09.09.2026 dhe të administruara në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2025 si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Mbi pikën nr. 1 të programit të auditimit nr. 380/1 prot., datë 09.04.2026 "Auditim mbi Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik" në Bashkinë Prrenjas.

1- Përsa i përket pikës 1.2, pozicionet vakante pjesë e shërbimit civil janë publikuar në portalin e punësimit

AKPA, ndërsa për pozicionet me Kod Pune janë marrë masa për publikimin e shpalljeve jo vetëm në faqen zyrtare të bashkisë dhe stendat për informim por edhe në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive; Janë hartuar përshkrimet e punës dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, të përcaktuara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës.(bashkëngjitur formulari i përshkrimit të punës)
Në Planin vjetor të punësimit do të mërren masa për përfshirjen jo vetëm të pozicioneve pjesë e shërbimit civil, por edhe të pozicioneve vakante që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me kod pune si dhe nevojat për punonjës provizor.
2- Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse ka përcaktuar një pikë më vete në urdhrin e shkëputjes, në të cilën citohet se punonjësit të bëjnë dorëzimin e detyrës sipas përcaktimeve të VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" .(Bashkëngjitur procesverbal dorëzim detyre)
3- Në lidhje me pikën 1.3 në strukturën organizative Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse do të merren masat e nevojshme për punësimin e "ekselencës" sipas percakimeve të VKM-së nr 586, datë 30.08.2019. Bashkia Prrenjas është pjesë e projektit "Të rinjtë për tregun e punës", një nismë që synon të mbështesë të rinjtë në rrugëtimin e tyre drejt punësimit dhe integrimit në tregun e punës. Përmes këtij projekti të rinjtë përfitojnë këshillim profesional,orientim në karrierë,ndërmjetësim për punësim dhe mbështetje për zhvillimin e aftësive të nevojshme, në partneritet me AKPA. Bashkia Prrenjas me anë të programit të Praktikave të Punës mbështet të rinjtë me praktika 3 mujore pranë zyrave përkatëse të institucionit të bashkisë Prrenjas.
Gjatë vitit 2025 është parashikuar punësimi i punonjësve sezonalë me kontratë të përkohëshme kryesisht tek shërbimet, sektori i ujitjes dhe kullimit, punonjës shërbimesh-murator, numri i të cilëve është miratuar me VKB nr 116 datë 26.12.2024 me nr. 3264 prot datë 27.12.2024 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr. 66/1 prot datë 13.01.2025.
4- Përsa i përket pikës 1.5 në lidhje me dosjet e të punësuarve, në fillimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e rinj, nga Sektori i Burimeve Njerëzore është bërë njoftimi për dorëzimin e dokumentacionit të dosjes personale. Në vijimësi Sektori i Burimeve Njerëzore do marrë masa për të njoftuar të gjitha drejtoritë/sektorët/njësitë administrative për përditësimin e dokumetacionit në dosjen personale. (bashkëngjitur njoftimi për përditësimin e dosjes së personelit me nr. 2112 prot., datë 08.09.2026)
5- Në lidhje me pikën 2.1, deri në datë 31.12.2024 në bashkinë Prrenjas janë zhvilluar takime të dokumetuara referuar procesverbalit të datës 26.02.2024 "Procesverbal mbi analizimin e risqeve dhe masat parandaluese", procesverbal i datës 09.09.2024, Procesverbal i datës 2.12.2024 "Procesverbal për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027".
6- Përsa i përket GMS dhe GMR do merren masat për rishikimin dhe ndryshimin e antarëve sipas parashikimeve të kuadrit ligjor.
7- Përsa i përket pikës 3.3 dhe 3.4 nga ana e bashkisë Prrenjas janë hartuar gjurmët e auditimit, si dhe është hartuar/miratuar Plani Vjetor ku përfshihet edhe Kontrolli i Brenshëm, periodik apo vjetor, në zbatim të nenit 22, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrolli", i ndryshuar, "Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me sqarimet e përcjella nga Drejtoria Juridike, burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse/Bashkia Prrenjas, grupi i auditimit sqaron si vijon:

- Konstatimet e grupit të auditimit përcjellë në PRA në çdo rast kanë referencën ligjore e cila ose nuk është zbatuar (për paragrafët 1,3,6) ose është zbatuar pjesërisht (për paragrafët 2,4,5,7);
- Në sqarimet tuaja konfirmohet se konstatimet e grupit të auditimit qëndrojnë si dhe angazhimin tuaj për zbatimin e rekomandimeve të përcjella në PRA. Efektiviteti i masave që po merrni do të vlerësohet në vijimësi, në funksion të zbatimit të plotë dhe të qëndrueshëm të tyre. Kështu që dhe zbatueshmëria e rekomandimeve nga ana juaj mbetet për tu vlerësuar për periudhën në vijim.

4. Informacioni dhe Komunikimi

Drejtuesit e institucionit (NZ dhe menaxherët e të gjitha niveleve) kanë informacion *të mjaftueshëm* për qëllimet dhe rëndësinë e Menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe gjatë vitit 2025 stafi i bashkisë është përfshirë i gjithë në trajnime, veçanërisht në ato mbi Ligjin *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" të organizuar nga ASPA. Pjesëmarrja e stafit në trajnime për njohjen dhe zbatimin e ligjit "Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualin MFK, ka ndikuar për harmonizimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve si dhe ndërmjet sektorëve me personin përgjegjës për çështjet ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë apo Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel horizontal dhe vertikal në mënyrë shkresore dhe elektronike. Bashkia Prrenjas disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miratuar mbështetur strukturës organizative me të cilën funksionon bashkia sipas VKB-ve përkatëse.

a. Në Bashkinë Prrenjas në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*" i ndryshuar[13] neni 5,neni 6 "Për programin e transparencës" janë marrë masat si vijon:

- Me Urdhrin Kryetarit nr. 50 datë 04.02.2025, specialiste/koordinator i rinisë, marrëdhënieve me publikun dhe median Znj.R. K. është caktuar edhe me detyrën e *Koordinatorit për të Drejtën e Informimit* dhe *Transparencës [KDIT]*, në përmbushje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 "*Për Informimin Publik*" i ndryshuar neni 2 pika 6, neni 10. Punonjësja për marrëdhënien me publikun dhe median ka përpiluar raporte vjetore mbi punën e kryer prej saj dhe i ka përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronja b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftimet publikohen në ŴEB-in e Bashkisë Prrenjas;

Mos hartimi dhe mos miratimi i Gjurmëve të Auditimit të unifikuar të njësisë, pavarësisht përditësimit të Rregullores së brendshme referuar strukturës organizative të miratuar me ndryshime, riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

b. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit;

c. Zhvillohen analiza vjetore të arritjes së objektivave të Bashkisë Prrenjas në takimet e GMS dhe GMR, dhe *rezulton se* është dokumentuar për çdo rast;

d. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll arkivës është përgjegjës për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespodencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), për të evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;

e. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);

f. Punonjësit e të njëjtës strukturë komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë verbale dhe shkresore, rrallëherë në rrugë elektronike.

#Parimet e Informacionit dhe komunikimit:

Parimi 13: *Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor;*

[13] Me ligjin nr. 78 datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

***Parimi 14**: Komunikimi i brendshëm;*
***Parimi 15**: Komunikimi i jashtëm;*

5. Monitorimi

5.1 Monitorimi i vazhdueshëm

Mos hartimi i gjurmëve të auditimit dhe i hartës/manualit të proceseve të punës për periudhën 2024-2025, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, pasqyruar kjo: në aktivitetin e kufizuar të GMS dhe rrjedhimisht vetëm në hartimin e raporteve vjetore për përgatitjen e PBA; të mungesës së dokumentimit të analizave dhe të raporteve periodike jo rregullisht të menaxherëve të nivelit të ulët dhe të mesëm tek titullari i njësisë mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë (Bashkia Prrenjas), si dhe identifikimin e atyre fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse.

Raportimet bëhen nga personi përgjegjës i çdo sektori tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4, 8 mujor dhe ai vjetor i monitorimit të buxhetit [RMB], i cili i dërgohet Ministrisë së Financave.

- Ky Raportim (RMB) bëhet në zbatim të nenit 48 të Ligjit nr. 68 /2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, nenit 65 të Ligjit nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë*" e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MF: *Për vitin 2025* mbi Raportimin e zbatimit të buxhetit për 4, 8 dhe 12 mujorin me Vendimin nr. 16 datë 12.02.2026 dhe me nr. 496 prot., datë 16.02.2026; Nga auditimi rezultoi se DFB/Bashkia Prrenjas respekton hallkat e procesit të përgatitjes së PBA-së nga miratimi i Kalendarit të PBA-së në Këshillin Bashkiak, raportim në MF për çdo fazë të PBA-së deri në miratimin në Këshillin Bashkiak, raportimin e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas në Këshillin Bashkiak "Mbi realizimin e Buxhetit të vitit 2025. Çdo akt i miratuar me VKB është konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekt i Qarkut Elbasan.
- Raportet për në MF/Drejtoria e Harmonizimit të sistemeve të kontrollit të cilat përmbajnë: Pyetësorin e Vetëvlerësimit dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut me shkresën nr. 542 prot., datë 20.02.2026; Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm; Raporti për ngritjen dhe funksionimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe Plani i Veprimit për MFK; në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 "*Për MFK*" i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së i ndryshuar, Udhëzimit MFE nr. 28 datë 15.12.2011 "Për paraqitjen e Deklaratës të Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Njësinë Pubike";
- Bashkia Prrenjas raporton çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Ministria e Mjedisit dhe AKEM[14]/Drejtoria e Monitorimit dhe performancës, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" i ndryshuar, Ligjit nr. 10463/2011 "*Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve*" i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 "*Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve*" me shkresën nr. 144/1 prot., datë 23.01.2026 me objekt "Raportim i statistikave vjetore të mbetjeve për vitin 2025";
- Drejtoria e Zhvillimit ekonomik, bujqësisë dhe turizmit në Bashkinë Prrenjas raporton çdo 6 mujor në Këshillin e Qarkut Elbasan/Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së tokës informacion mbi gjendjen e tokës bujqësore, konkretisht: me shkresën nr.2872/1 prot., datë 22.12.2025 raprotin vjetor "Të dhëna mbi dëmtimin e tokës bujqësore", me shkresën nr. 31/1 prot., datë 12.01.2026

[14] Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

"Të dhëna mbi dëmtimin e tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve" konform kuadrit ligjor në fuqi për tokën bujqësore;
- Bashkia Prrenjas raporton në MM[15], AKP[16] "mbi të dhënat e fondit pyjor e kullosor në pronësi të Bashkisë Prrenjas" dhe për kontratat e përdorimit apo shfrytëzimit nga ana e subjekteve apo individëve në këto prona. Për vitin 2025 ky informacion është dërguar me shkresën nr. 309 prot., datë 29.01.2026, konform Ligjit nr. 27/2020 datë 20.04.2020 "*Për pyjet*" i ndryshuar, VKM nr. 570 datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe organizimin e AKP" etj.
- Bashkia Prrenjas dërgon informacion në MEKI/Drejtoria e përgjithshme e politikave të nxitjes së biznesit dhe çështjeve të tregëtisë/Drejtoria e Politikave të tregut të brendshëm, konform Ligjit nr. 9902/2008 datë 17.04.2008 "*Për mbrojtjen e konsumatorit*" i ndryshuar ligjit nr. 10465/2004 "*Për shërbimin veterinar*" i ndryshuar, VKM nr. 475 datë 30.047.2021 "Për bashkëpunimin e NJVQV me shërbimin veterinar" etj; Për vitin 2025 nga AFSKU në Bashkia Prrenjas, ky informacion është përcjellë me shkresën nr. 213 prot., datë 22.01.2026;
- Gjatë vitit 2025 nga NA janë përpiluar 36 shkresa "kthim përgjigje" duke dhënë informacion për Prefekturën, instutucioneve të ndryshme, etj;

5.2 Vetëvlerësimi

Çdo akt administrativ i Bashkisë Prrenjas publikohet në faqen zyrtare të saj konform kjo Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar Kreu VI, neni 15 dhe Programit të Transparencës konform ligjit nr. 119/2014 "*Për informimin publik*" i ndryshuar.
Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të bashkisë, rezulton se për çdo vit janë hartuar Pyetësorët e Vetëvlerësimit për komponentët e MFK, Planin e ngritjes dhe zhvillimit të sistemit të MFK dhe Regjistrin e Riskut dhe dërguar zyrtarisht në MF.
Një bazë rregullatore e plotë, e përditësuar dhe e zbatuar në praktikë është një parakusht për funksionimin efektiv të njësie publike dhe për arritjen e objektivave të saj afatshkurtra apo afatgjata.
Nga auditimi *konstatohet se,* baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e përditësuar por e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në funksion të forcimit të sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet), me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen, ndaj mbetet detyrë për tu realizuar. Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të Riskut, njohjen e stafit me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualin MFK i ndryshuar, si dhe plotësimit të kuadrit rregullator të njësisë, në zbatim të Ligjit nr. 10296 "*Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin*", Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut*", Udhëzimit të MF nr. 21, datë 25.10.2016 "*Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve*"; Udhëzimit MFE nr. 28, datë 15.12.2011 "*Për paraqitjen e Deklaratës të Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Njësinë Publike*";

5.3 Auditimi i Brendshëm[17]

[15] Ministria e Mjedisit
[16] Agjencia Kombëtare e Pyjeve
[17] Aktiviteti i NJAB të Bashkisë Prrenjas është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 2 datë 19.06.2026

#Parimet e Monitorimit:

Parimi 16: *Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe /ose të veçanta;*
Parimi 17*: Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive;*

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:
Në Bashkinë Prrenjas për implementimin e Ligjit nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualit MFK i ndryshuar, rezultoi se:
Komponenti I - Mjedisi i Kontrollit
- Pozicionet vakante që rregullohen me Kodin e Punës nuk shpallen në portalin e punësimit në AKPA, si dhe nuk i janë nënshtruar procesit të rishikimit të përshkrimeve të punës;
- Struktura organizative nuk ka parashikuar pozicione nga "ekselenca" dhe "grupi i veçantë" në mospërmbushje të VKM nr. 586, datë 30.08.2019 "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore"; Ligj nr. 15/2019 "*Për nxitjen e punësimit*" neni 3, pikat 1,2,3,4 e në vijim;
- Numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 116 datë 26.12.2024 dhe me nr. 3264 prot., datë 27.12.2024. u konstatua se në Relacionin bashkëlidhur vendimit me nr. 3264/1 prot., datë 27.12.2024, nuk janë paraqitur pozicionet dhe strukturat për të cilat nevojiten punonjësit provizorë;
- Mospërditësimi i dosjeve të personelit;
Komponenti II- Menaxhimi i Riskut
- Bashkia Prrenjas deri më 31.12.2024 nuk ka takime të dokumentuara të *Grupit të Menaxhimit Strategjik,* ka realizuar vetëm takimet e mbi tavanet buxhetore të PBA dhe duke mos realizuar takimet e detyrueshme vjetore, për trajtimin e çështjeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Njësisë;
- GMR nuk ka kryer me përpikmëri përgjegjësitë që i atribuon kuadri ligjor;
- GMS dhe GMR përbëhen nga të njëjtët anëtarë, dhe referuar detyrave, përgjegjësive dhe rolit të secilit grup në njësinë publike, njehësimi i përbërjes së GMS dhe GMR paraqet risk;
- Nga institucioni *nuk ka një Plan të mirëfilltë të Kontrollit të Brendshëm* (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;
Komponenti III- Veprimtaritë e Kontrollit
- Bashkia Prrenjas deri më 31.12.20245 nuk ka hartuar *Gjurmët e unifikuara të Auditimit*;
- Sistemi i kontrollit dhe administrimit të teknologjisë së informacionit nuk është i plotë dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat rregullatore dhe standardet përkatëse, konkretisht: nuk ka dhomë serverash, nuk monitoron sistemin back up, nuk ka rregullore për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjeve IT, dhe në mungesë të saj nuk janë zhvilluar programe trajnimi me punonjësit, mungon dokumentimi i procedurave dhe veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave (incidenteve) etj.

Për sa më lart nuk janë zbatuar në mënyrë rigoroze:
1. Ligji nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe Manuali MFK i ndryshuar;

2. Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut*",
3. Udhëzimit nr. 21 datë 25.10.2016 "*Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve*";
4. Kuadri ligjor mbi menaxhimin e burimeve njerëzore.

II Organizimi dhe vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

I.1 .*Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm* sipas përcaktimeve në VKM nr. 83,datë 03.02.2016 "Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar;

Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Prrenjas [NJAB] është krijuar mbështetur në VKB nr. 116 datë 26.12.2024 "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve buxhetore në varësi të saj" konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 66/1 prot., datë 13.01.2025 dhe me nr. 3264/3 prot., (i bashkisë) datë 15.01.2025; Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 101 datë 10.01.2025 dhe nr. 16 prot., datë 10.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi të saj", dhe funksionon në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Brendshëm luan rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë audituese të NJAB Bashkia Prrenjas, është miratuar nga kryetari me shkresën nr. 87 prot., datë 09.01.2025 është dërguar në Drejtorisë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF;

2. Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm ka për qëllim të promovojë një kulturë etike nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Kodi Etik i NJAB e Bashkisë Prrenjas është miratuar me nr. 86 prot., datë 09.01.2025;

3. Rregullorja e NJAB është përfshirë në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Bashkisë miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 53 datë 26.03.2025, në të cilën në nenet 94, 95, 96 janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësisë e NJAB;

Për sa më lartë NJAB Bashkisë Prrenjas ka vepruar konform me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, Manualin e AB në Sektorin publik miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 i ndryshuar;

4. Plani strategjik 2025-2027 dhe Plani vjetor 2025, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2 të seksionit 3, kreu II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm (kap.III), pika 3.3, pika 3.5 "Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm", p*ër vitin 2025*, janë hartuar referuar shkresës udhëzuese nr. 12429 prot., datë 19.09.2024 të MF/DPKBFPRF/DHAB[18] miratuar me nr. 2482/2 prot., datë 07.10.2024 dhe janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF me shkresën nr. 2482/1 prot., datë 07.10.2024;

Me shkresën nr. 1422/1 prot., datë 01.07.2025 nga NJAB/Bashkia Prrenjas është dërguar "Plani strategjik për veprimtarinë e NJAB për periudhën 205-2027" me reflektimet e bëra për mangësitë e evidentuara dhe përcjellë nga DHAB me shkresën nr. 9729/21 prot., datë 18.06.2025.

Për vitin 2025 nga NJAB nuk ka patur ndryshim të Planit vjetor dhe si rrjedhojë as rishikim të tij. Plani vjetor i auditimit është dokumenti bazë i veprimtarisë audituese, i cili parashtron kritere e procedura të parashikuara në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve,

[18] Ministria e Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar/ Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm

përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.
- Njësia e auditimit të brendshëm - [NJAB] e Bashkisë është e organizuar në nivel Sektori edhe e ushtron funksionin e saj duke patur si orientim faktin se "Njësia e Auditimit të Brendshëm" ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Prrenjas, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 10, germa "c" si dhe nenit 64, germa "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

a Struktura e NJAB e Bashkisë /Prrenjas nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit nr. 16 date 10.01.2025 me nr. 101 prot., datë 10.01.2025 dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.1

NjAB	Përgjegjës	Specialist Audituesi	Kualifikimi profesional	Statusi	Numri i punonjesve Plan / Fakt	
Viti 2025	1	2	ekonomist	Me certificatë /2	3	3

Punoi: Grupi i Auditimit

Referuar ligjit nr.114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar, në çdo institucion bazuar në disa kritere të përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "Mbi miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, për vitin 2025 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.2

Nr	Struktura e NJAB	2025 plan	fakt
1	Përgjegjës	x	x
2	Auditues	x	x
Totali i audituesve në NJAB		**3**	**3**

Punoi: Grupi i auditimit

Vendimet e Kryetarit të Bashkisë e kanë miratuar strukturën e NJAB konform Ligjit nr.114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 "Mbi Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik";. Edhe pse audituesit e NJAB janë me përvojë, informatizimi i shumë proceseve operacionale në bashki dhe shumëllojshmëria e tyre, lind si domosdoshmëri plotësimin e tyre në pamundësi me personel të përhershëm, edhe me personel të jashtëm si ekspertë të fushës inxhinierike kryesisht IT apo dhe ligjore sipas rastit. Kjo për të rritur efektivitetin e aktivitetit të NJAB. Dy nga tre audituesit janë të pajisur me certifikatën e "Audituesit të brendshëm" në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"* i ndryshuar, "Manualit të Auditimit të Brendshëm" i ndryshuar miratuar nga Ministër i Financave nr. 100/2016 dhe VKM nr. 83/2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik". Gjatë periudhës së auditimit, NJAB e Bashkisë Prrenjas ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë me këtë personel:

Tabela nr. 3

Nr	Periudha	Pozicioni	Arsimimi	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi	Trajnim të vijueshëm
Viti 2025							
1.	B. K.	përgjegjës	I lartë	37	8 vite	Në vitin 2021	Po
2.	A. B.	auditues	I lartë	12	12 vite	Në vitin 2013	Po
3.	D. H.	auditues	I lartë	8	2 vite	*Në proces çertifikimi*	Po

Burimi: NJAB/Bashkia Prrenjas

I.2 Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet

Referuar ligjit nr.10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 8980, dt. 15.07.2010 i ndryshuar[19], Ligjit nr.114/2015 "*Mbi Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar dhe "Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, NJAB ka hartuar një plan vjetor trajnimesh të detyrueshme për audituesit NJAB referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe gjatë vitit 2025 NJAB ka kryer trajnimet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 4

Nr	Temat e Trajnimit	Vendi	kohëzgjatja	Nr.Pjesëmarrësve	Data
1	Vlerësimi, kontrolli, auditi	online	2 orë	3	28 Maj 2025
2	Trajtuar 4 Tema	online	3 ditë	3	3-5 Qershor
3	Trajtuar 3 tema	online	3 ditë	3	21-23 Tetor
4	Auditimi i efektivitetit te Sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashki	Korçë	3 ditë	3	16-18 Dhjetor

Burimi: NJAB/Bashkia Prrenjas

Trajnimi i audituesve të NJAB duhet të përmbushi planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo audites, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo për mirëfunksionimin e auditit të brendshëm në njësinë publike, për të cilën gjatë procedurës audituese, duhet të mbështetet në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme, të cilat janë:

a) ligjshmëria,
b) paanësia,
c) integriteti,
ç) pavarësia dhe objektiviteti,
d) profesionalizmi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional
dh) kompetenca
e) konfidencialiteti

Nga sa më lart përshkruam, 2 audituesit e certifikuar të [NJAB] të Bashkisë Prrenjas për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 rezultojnë të kenë zhvilluar orët e plota të trajnimit të detyrueshëm të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MF, vërtetuar kjo nga Vërtetimet e lëshuara nga DPHKBFP/DHAB si dhe certifikatat me të cilat janë pajisur për temat jashtë planifikimit vjetor, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

2 Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm;

2.1 [NJAB] për Bashkisë Prrenjas ka hartuar dhe miratuar nga Kryetar i Bashkisë Planet Strategjike dhe ato Vjetore respektive, konform përcaktimeve ligjore, i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor (20 Tetor). Plani Strategjik 2025-2027, përmban këto 5 (pesë) pasqyra:

Pasqyra Nr.1 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2025-2027

Plotësuar

Pasqyra Nr.2 - Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2025

Plotësuar

Pasqyra Nr.3 - Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2025

Plotësuar

[19] I ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4 datë 26.01.2024

Pasqyra Nr.4 - Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2025

Plotësuar

Pasqyra Nr.5 - Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen për vitin 2025

Plotësuar

Subjektet që janë objekt auditimi nga NJAB e Bashkisë Prrenjas, janë paraqitur në *tabelën nr*. 6. në Aneks 1/MFK/NJA.

Nga analiza e informacionit të paraqitur në Planin strategjik 2025-2027 të pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme, *rezulton se* në Bashkinë Prrenjas: me koeficent vlerësimi "të ulët" risku nuk ka asnjë strukturë; me koeficent "të mesëm" janë 8 struktura dhe me koeficent "të lartë" janë 8 struktura.

- Nga NJAB është hartuar Regjistri i Riskut të veprimtarisë së NJAB për vitin 2025 dhe është miratuar nga Titullari me nr. 155 prot., datë 20.01.2025;

- Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe në Planin strategjik të miratuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5

	Plani Strategjik 2024-2026			**Plani Strategjik 2025-2027**								
Viti	**2025**			**2025**			**2026**			**2027**		
Numri i auditimeve plan	8			**9**			9			9		
Numri i auditimeve fakt	8			9								
					=			=				
Niveli i riskut	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri për cdo nivel fakt	5	3	-	7	2	-						
Shprehur në % (ndaj planit)	**100**	**100**		**100**	**100**							

Punoi:Grupi i Auditimit

Referuar të dhënave në tabelë *rezultoi se*:

- numri i misioneve audituese të NJAB ka ardhur në rritje nga viti 2024 në vitin 2025;
- për vitin 2025 është realizuar numri i audtimeve të planifikuara në Planin Strategjik dhe atë vjetor;
- Nuk ka patur ndryshim të planit vjetor 2025 për shtim apo pakësim të misioneve audituese;

- Planifikimi i angazhimeve të auditimit në Planin strategjik 2025-2027 referuar vlerësimit të riskut të çdo strukture objekt auditimi, rezulton të jetë shpërndarë si më poshtë:

Tabela nr.6

Emërtimi	Koeficenti riskut	Frekuenca	Emërtimi	Koeficenti riskut	Frekuenca
DFB			SMZSH		
DA			DASK		
DJPPBNJ			DKIENHMP	Mesëm	2 herë në 3 vjet
DPZHTAP			SPB		
IVMT	Lartë	Çdo vit	Zyra me 1 ndalesë		
DBMK					
DAPK					
DSHUIRRSHP					
SMC					
9 subjekte			**5 subjekte**		

Burimi:NJAB/Bashkia Prrenjas/Punoi:Grupi i auditimit

Nga të dhënat në tabelë *rezulton se*: 9 subjekte objekt auditimi që janë vlerësuar me koeficent "të lartë" risku, janë planifikuar në Planin strategjik 2025-2027 të auditohen çdo vit, ndërsa 5 subjekte të vlerësuara me koeficent "të mesëm" risku janë planifikuar të auditohen 2 herë. Me koeficent "të ulët" risku nuk është vlerësuar asnjë subjekt.

Nga sa më lart ***konstatohet se*** pavarësisht se NJAB/Bashkia Prrenjas administron një regjistër risku të miratuar, në planin strategjik /vjetor të auditimeve [2024-**2025**-2026] dhe [**2025**-2026-2027] nuk janë përfshirë auditime në fushën e prokurimeve publike, zbatimit të kontratave, sistemet e monitorimit me kamera etj,.

2.2 Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga [NJAB] në Bashkisë Prrenjas, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2024	9	9	8	-	1	-	-
2	**Viti 2025**	**9**	**9**	**7**	**-**	**2**	**-**	**-**
3	**Total**	**18**	**18**	**15**	**-**	**3**	**-**	**-**

Burimi: NJAB/Bashkia /Prrenjas

- Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga [NJAB] mbi aktivitetin e saj për vitin 2025, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2024	49	22	21	6	-	-	-	-
2	**Viti 2025**	**40**	**24**	**15**	**1**	**-**	**-**	**-**	**-**
Trendi		↘	↗	↘	↘				

Burimi: NJAB/Bashkia /Prrenjas

Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara *rezultoi se:*-
numri i rekomandimeve të lëna ka ardhur në rënie nga viti 2024 në vitin 2025;
- numri i rekomandimeve të zbatuara ka ardhur në rritje nga viti 2024 në vitin 2025 ose 60% ndaj totalit të rekomandimeve të 2025;
- numri i rekomandimeve në proces dhe i atyre të pazbatuara ka ardhur në rënie nga viti 2024 në vitin 2025 ose 37.5% dhe 2.5% ndaj totalit të rekomandimeve të lëna në vitin 2025;

2.3 Nga auditimi i dosjeve të subjekteve të audituar për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, *rezultoi se* dosjet përmbanin dokumentacionin konform akteve ligjore/nënligjore në fuqi si dhe iu është hartuar fleta e inventarit të dokumenteve që përmban me nënshkrimin e audituesve; U verifikua dosjet e angazhimeve audituese të realizuara në vitin 2025, si në tabelën nr.6 të Aneks /MFK.
- Nga auditimi i 9 dosjeve të auditimit ***u konstatua*** se:
1. Nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor nga dorëzimi i RPA në subjektin e audituar, me anë të të cilit vihet në dijeni [NJAB] mbi pranimin ose jo të rekomandimeve të lëna dhe përsonat përgjegjës për zbatimin e tyre; mosveprime në kundërshtim me Manualin AB miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 4.1.12 Hapi 11;
2. Nga NJAB nuk janë planifikuar dhe rrjedhimisht as zhvilluar angazhime "shërbime këshilluese" të cilat ofrojnë këshilla, lehtësira dhe orientime në fushat e kontrollit të brendshëm, kontrollit të menaxhimit financiar, etikës së institucionit, për vlerësimin e riskut etj. Mungesa e zhvillimit të tyre, është reflektuar në mos hartimin e "planit të veprimit" nga subjektet e audituara për adresimin

e rekomandimeve të auditimit. Mosveprimet nga ana e NJAB nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në Manualin e AB miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, Kapitulli II, paragrafi 2.4.5;
- Nga ana e NJAB janë realizuar misione audituese "Mbi vlerësimin e detyrimeve të prapambetura" në zbatim të udhëzimit dhe trajnimit nga ana e MF në periudhën mars-prill 2022, si dhe "Mbi Zbatimin e rekomandimeve të lëna" ku dhe është vlerësuar statusi i zbatimit të tyre, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 42 datë 27.10.2020 "Mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik".

3. Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.

Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera si çdo vit edhe për vitin 2025, është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit, pra nga [NJAB] të bashkisë Prrenjas. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" me emërtesën "Njësia e Auditimit të Brendshëm".
- Programi për Sigurimin e Cilësisë së punës së Auditimit Brendshëm për vitin 2023 dhe Vlerësimin e Performancës së veprimtarisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2022 me nr. 407/1 prot., datë 03.03.2023;
- Për auditimet e zhvilluara në vitin 2025 nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Prrenjas, rezulton se si procesi i auditimit ashtu dhe dokumentimi i tij janë hartuar, miratuar dhe përcjellë në përputhje me afatet ligjore në fuqi;
- Për *vitin 2025* nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Prrenjas janë lënë në total **40** rekomandime të natyrës organizative, nga të cilat: janë pranuar 40 rekomandimet e lëna, janë zbatuar plotësisht 24 rekomandime ose 60% e tyre, në proces zbatimi 15 rekomandime dhe 1 rekomandim pa zbatuar;
- Nga auditimi rezultoi se *për vitin 2025* është raportuar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm/MFE, me formatet e miratuara konform kuadrit ligjor në fuqi.

Dosja e përhershme

Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet.
Njësia e Auditimit të Brendshëm dosjet e përhershme të auditimit i ka krijuar nga viti 2019 e në vijim.
Konkluzion: Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se struktura e NJAB e Bashkisë Prrenjas, për vitin 2025 ka ushtruar funksionin e vet me kapacitet të plotë dhe e strukturuar sipas kërkesave ligjore; ka planifikuar dhe realizuar auditime në sektorë me risk të lartë si dhe në procese të veçanta: zbatimi i buxhetit, detyrimet e prapambetura dhe zbatimi i rekomandimeve. Megjithatë aktiviteti i auditimit ka qenë i fokusuar kryesisht në vlerësimin e veprimtarisë së njësive organizative dhe proceseve specifike të administrimit, ndërsa nuk rezultojnë auditime të sistemeve me risk të lartë, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike, zbatimit të kontratave, sistemeve IT -konkretisht Sistemi i monitorimit me kamera, me qëllim për të përfshirë në planet strategjikë e vjetorë 2025-2027 e në vijim, misione audituese të llojeve të ndryshme, për të patur një mbulim sa më të gjerë me auditim të të gjitha sistemeve/fushave, me të cilat operohet në aktivitetin e

përditshëm të bashkisë. Kjo rezulton nga mosmbulimi me auditim i të gjitha sistemeve/fushave, veçanërisht për ato IT, prokurimeve dhe atyre të punimeve në terren të investimeve të bashkisë (dhe jo vetëm) në shërbim të komunitetit, ku të shikohet mundësia dhe për personel të jashtëm (ekspert të fushës inxhinierike); veprime apo mosveprime këto në kundërshtim me Ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar dhe "Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"i ndryshuar.

Pika 2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Në zbatim të programit të auditimit,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.
- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;
Për vitin 2025, sipas Strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryetarit të bashkisë nr. 16, datë 10.01.2025 ka funksionuar Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale me 14 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 3(tre) Përgjegjës Sektori dhe 8(tetë) Specialist, 1(një) arkëtarë dhe 1(një) punonjës Social. Numri i përgjithshëm i drejtorisë është miratuar me VKB nr.116, datë 26.12.2024 me 14 punonjës dhe në fakt kanë punuar 13 punonjës.

-Programimi i PBA për vitet 2025-2027.
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se miratimi i treguesve ekonomik financiarë dhe tavanet përgatitore janë miratuar me VKB nr. 51 datë: 27.03.2024 "Për miratimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së dhe tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2025-2027". Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.104 datë 08.02.202 është miratuar "Ngritja e grupit për menaxhim strategjik" dhe sipas Udhëzimit të brendshëm nr. 364, datë 02.08.2024 "Për përgatitjen e programeve buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027", ka vazhduar puna e përgatitjes së PBA 2025-2027, e detajuar sipas 14 programeve buxhetore, njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik, për vitin 2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj totalit
1	Planifikimi Menaxhimi Administrimi	222,830	34.3%
2	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	27,308	4.2%
3	Shërbimet e Policisë Vendore	4,707	0.7%
4	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	13,761	2.1%
5	Rrjeti Rrugor Rural	142,431	21.9%
6	Menaxhimi I mbetjeve	26,215	4.0%
7	Menaxhimi I pyjeve dhe kullotave	26,204	4.0%
8	Shërbimet Publike Vendore	41,895	6.5%
9	Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	79,240	12.2%
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	20,700	3.2%
11	Sport dhe argëtim	23,500	3.6%
12	Trashëgimia kulturore , monumente , muzetë dhe biblioteka	3,600	0.6%
13	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	12,043	1.9%
14	Fondi Rezerve	4,683	0.7%
	TOTAL	**649,117**	**100%**

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale.

Programimi i shpenzimeve sipas llogarive për periudhën viti 2025-2027, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	%	000/lekë	%	000/lekë	%
1	Paga (600)	286,293	44%	288,283	49%	288,283	48%
2	Sig. Shoq. (601)	48,184	7%	48,580	8%	48,580	8%
3	Shp. Operative (602)	102,789	16%	120,564	21%	126,765	21%
4	Shpenzime (603,604,606,609)	13,383	2%	16,700	3%	17,000	3%
5	Investime (230,231)	198,468	31%	111,407	19%	119,050	20%
	TOTAL	649,117	100%	585,534	100%	599,678	100%

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale.

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se tendenca e shpenzimeve sipas PBA për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime në vlerën 649,117 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 585,534 mijë lekë ose me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 63,585 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 599,678 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 14,144 mijë lekë.

Sipas PBA tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

Nr.	Të ardhurat	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1	Të ardhura tatimore	48,622	62,570	63,470
2	Të ardhura jo tatimore	88,378	78,650	81,760
	Total të ardhura	**137,000**	**141,220**	**145,230**
3	Transferta e pakusht. e përgjithshme	282,219	292,110	301,832
4	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	151,800	152,204	152,616
	Total transferta	**434,019**	**444,314**	**454,448**
5	Të ardhura të mbartura	78,098	0	0
	Totali	**649,117**	**585,534**	**599,678**

Burimi: Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale.

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se të ardhurat sipas PBA për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 649,117 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 585,534 mijë lekë ose me ulje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 63,585 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 599,678 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 14,144 mijë lekë.

-Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Buxheti fillestar i vitit 2025, është miratuar me VKB nr.128, datë 26.12.2024, bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "*Për Financat e Vetë Qeverisjes Vendore*" i ndryshuar, ligjit nr. 115/2024 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresën nr. 65/1prot., datë 15.01.2025, si më poshtë:

Nr.	Vendimi K.B		Struktura e të ardhurave	Të ardhura Plan (në 000/lekë)	Struktura e shpenzimeve	Shpenzimet (në 000/lekë)
	Nr.	Datë				
	128	26.12.2024				
1			Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	137,000	Paga (600)	286,301
2			Të ardhura të trashëguara nga viti 2024	34,203	Sig. Shoq. (601)	48,176
3			Të ardhura të trashëguara të paçelura viti 2024	26,068	Shp. Operative (602)	133,891

4			Të trashëguara nga transfertat e përgjithshme + transfertat sektoriale	114,407	Shpenzime (603,604,606,609)	14,673
5			Transferta specifike për menaxhimin e mbetjeve	7,215	Investime (230,231)	262,656
6			Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	243,662		
7			Të ardhura nga transfertat pakushtëzuar sektoriale	144,585		
8			Fond shtesë për rritjen e pagave	38,557		
			Total	**745,697**	**Total**	**745,697**

Burimi i financimit të buxheti fillestar për vitin 2025, janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta të vitit në shumën 137,000 mijë lekë ose 18 % e totalit, nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme në shumën 243,662 mijë lekë ose 33 % e totalit, nga transfertae pakushtëzuar sektoriale në shumën 144,585 mijë lekë ose 19% e totali, të ardhurat e trashëguara në shumën 60,271 mijë lekë ose 8 % e totalit, të ardhura të trashëguara nga transferta e përgjithshme e sektoriale në shumën 114,585 mijë lekë ose 19 % e totalit dhe fond shtesë për rritjen e pagave në shumën 38,557 mijë lekë ose 5 % e totalit.
Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2025 shpenzimet për paga e sigurime zënë 45 % ose në vlerën 334,477 mijë lekë, shpenzime operative zënë 18 % ose për vlerën 133,891 mijë lekë, shpenzime për (603,604,606,609) zënë 2% ose në vlerën 14.673 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 35% ose në vlerën 262,656 mijë lekë.
Për vitin 2025, buxheti ka pësuar ndryshime në rritje për vlerën 584,015 mijë lekë, kjo e analizuar si më poshtë:

000 leke

Art	**2025**				
	Plan Fillestar	**Ndryshimet +/-**	**Plani fund viti**	**Realizimi**	**Realizimi %**
600	286,301	1,758	288,059	251,984	87%
601	48,176		48,176	42,019	87%
602	133,891	1,581	135,472	84,262	62%
604-609	14,673	22,000	36,673	16,313	44%
230-231	262,656	154	262,810	118,597	45%
Tr. Kushtëzuar			0		
600		6,045	6,045	5,806	96%
601		1,001	1,001	840	84%
602		1,894	1,894	1,894	100%
604		1,560	1,560	1,560	100%
606		441,043	441,043	431,622	98%
231		106,979	106,979	103,851	97%
TOTAL	***745,697***	***584,015***	***1,329,712***	***1,058,748***	80%

Ndryshimet e buxhetit në rritje për vlerën 584,015 mijë lekë, kanë të bëjnë me transfertat e Ministrive të linjës për artikullin 606 në vlerën 441,371 mijë lekë (*për fonde të ndihmës ekonomike dhe paaftësia në shumën 414,371 mijë lekë, vendime gjygjësore për paaftësinë në shumën 16,548 mijë lekë, fond për shtëpinë e të moshuarve në shumën 2,340 mijë lekë, subvencione bonos qiraje në shumën 7,784 mijë lekë),* në artikullin (604) Ndihmë financiare për familjet për fatkeqësitë natyrore në vlerën 1,560 mijë lekë dhe në artikullin (231) Investime në vlerën 106,979 mijë lekë *(për objektin "Ndërtim i shkollës "Sali Halili" , në shumën 72, 567 mijë lekë, objektin "Rikonstruksion i kanalit të Ligajcës faza e II dhe III", në shumën 6,832 mijë lekë, objektin "Qendra Rinore" në shumën 8,146 mijë lekë, objektin "Përmirësim i kushteve të banesave për komunitetet e varfëri" në shumën 15, 434 mijë lekë dhe objektin "Ndërtim kanalesh të ujërave të larta" në shumën 4,000 mijë lekë).*

Për gjatë vitit 2025 buxheti ka pësuar ndryshime për lëvizje brenda për brenda artikujve për shtesa e pakësime të cilat janë kryer me VKB nr. 120 date 26.12.2024 VKB nr. 31 date 30.05.2025 "Për një ndryshim te programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit 2025, VKB nr. 44 date 27.06.2025 "Për një ndryshim te programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit 2025, VKB NR 79 date 21.11.2025 "Për miratimin e shtesës së fondit për transfertën sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi "Urdhra të Kryetarit të Bashkisë nr. 182 date 22.05.2025, Urdhra të Kryetarit të Bashkisë nr. 400 date 26.09.2025, në zbatim të nenit 44, germa a, b, c, ç, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

-Mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor (grande dhe të ardhura) dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit në total për Bashkinë për periudhën **viti 2025,** referuar aktrakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	286,301	294,104	257,789	88%
2	Llog 601 -	48,176	49,177	42,859	87%
3	Llog 602-	133,891	137,206	86,156	63%
4	Llogaria 604	2,490	27,050	14,483	54%
5	Llogaria 606	11,080	451,122	433,942	96%
6	Llogaria 609	1,103	1,103	1,070	97%
7	Llog 230	15,544	17,645	4,615	26%
8	Llog 231	247,112	352,305	217,833	62%
	Shuma	**745,697**	**1,329,712**	**1,058,747**	80%

Për vitin 2025, me VKB nr 116, datë 26.12.2024 " Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative për vitin 2025" ka vendosur për miratimin e numërit të përgjithshëm/maksimal prej 325 punonjësish *(Administrata e bashkisë me 106 puninjës, Policia Bashkiake me 6 punonjës Ujitja dhe kullimi me 7 punonjës, Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave me me 13 pononjës, Rrugë Rurale e mirëmbajtja e makinerive me 34 punonjës, Shërbimet publike me 44 punonjës, Shërbimi Zjarrfikës me 14 punonjës, Arsimi Bazë me 67 pononjës, Arsimi mesëm me 4 punonjës, Çerdhet me 14 punonjës, Gjendja Civile me 4 punonjës, Qendra etë Moshuarve me 2 punonjës dhe Punonjës me kontratë dhe sezonal 10 punonjës)* në fakt për gjatë vitit 2025 kanë punuar 317 punonjës.

Me urdhrin nr. 16, datë 10.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Prrenjas dhe institucioneve në varësi bazuar në numrin maksimal dhe kategorinë e pagave të miratuara nga Këshilli Bashkiak për vitin 2025" ka miratuar strukturën dhe nivelin e pagave të miratuar me VKB.

Realizimi i buxhetit në tërësi sipas akt akordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 1,329,712 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 1,058,747 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 270,965 mijë lekë ose 20% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Pagat janë planifikuar për vlerën 294,104 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 257,789 mijë lekë ose 88%, Sigurimet shoqërore janë planifikuar për vlerën 49,177 mijë lekë dhe janë realizuar 42,859 mijë lekë ose 87%.

Me mosrealizim më të madh janë shpenzimet operative në vlerën 51,050 mijë lekë *(planifikuar 137,206 mijë lekë janë realizuar 86,156 mijë lekë ose 63%),* nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se arsyet e mosrealizimit vijnë si rezultat vonesave të kryerjes së procedurave të prokurimit për shërbime, mirëmbajtje, blerje karburanti etj., shpenzimet për investime në vlerën 134,472 mijë lekë *(planifikuar 352,305 mijë lekë janë realizuar 217,833 mijë lekë ose 62%),* kjo si rezultat vonesave në procedurat e prokurimit publik, duke shtyrë zbatimin e projekteve përtej vitit buxhetor 2025, për objektet "Rikonstruksion dhe asfaltim i Unazës Katjel, Nj/Ad. Rrajcë, Bashkia Prrenjas", "Rikonstruksionin dhe asfaltim i Unazës Urakë, Nj.A.Rrajcë, Bashkia Prrenjas", "Rikonstruksion dhe Asfaltim i Unazës së fshatit Prrenjas, Bashkia Prrenjas", "Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugës së Lagjes Leka, Cela dhe Marta Nj.A. Qukës, Bashkia Prrenjas", "Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugës së fshatit Gurrë, Nj/Ad. Qukës, Bashkia Prrenjas", "Blerje mjet transporti (Kamionçinë), për Drejtorinë e Shërbimeve", "Blerje Mjeti për Administraten","Sistemim dhe Asfaltim i Rrugës së "Lagjes Së Re", Qyteti Prrenjas,Bashkia Prrenjas", "Sistemim dhe Asfaltim i Rrugës "Domosdova" me Rrugën "Minatori" në pjesën Jugore, Bashkia Prrenjas", "Sistemim dhe Asfaltim i Rrugës së Fshatit Rashtan, Faza e dytë Bashkia Prrenjas", "Rikonstruksion dhe Asfaltim i Rrugës "Lagjes Karriqi" Bashkia Prrenjas", "Ndertimi muri mbajtës tek fusha e futbollit, Bashkia Prrenjas ", "Vendosje bordurash shtrim pllakash (baza materiale nga FZHSH) trotuareve rruga Minatori , Bulevardi Rinia Prrenjas", "Rikonstruksion I Kanaleve Ujitës Bashkia Prrenjas" dhe "Mbrojtje dhe rehabilitim i tokave të dëmtuara, ndërtimin e mureve mbajtës, argjinaturave të ndryshme, Bashkia Prrenjas" shpenzimet për projekte në vlerën 13,030 mijë lekë *(planifikuar 17,645 mijë lekë janë realizuar 4,615 mijë lekë ose 26%)* si rezultat i vonesës së procedurës së prokurimit me objekt *"*Studim dhe projektim për hartimin e projektit me objekt: "Asfaltim i Rrugës Stravaj, Bashkia Prrenjas" kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi i cili është realizuar në masën 80%.

<u>Sipas burimeve të financimit buxheti i rishikuar për vitin 2025 është realizuar si më poshtë:</u>

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga grandi i pakushtëzuar.**

000/lekë

Nr.	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	142,365	139,321	136,572	98%
2	Llog 601 -	24,118	23,535	22,600	96%
3	Llog 602-	69,393	67,927	47,662	70%
4	Llogaria 604	0	22,000	10,794	49%
5	Llogaria 606	1,000	1,000	820	82%
6	Llogaria 609	1,413	1,103	1,070	97%
7	Llog 230	4,930	9,761	2,749	28%
8	Llog 231	39,000	26,992	15,049	56%
	Shuma	**282,219**	**291,639**	**237,316**	**81%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga grand i pakushtëzuar sipas akt akordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 291,639 mijë lekë është realizuar

në fakt në vlerën 237,316 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 54,323 mijë lekë ose 17% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.
Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 20,265 mijë lekë *(planifikuar 67,927 mijë lekë janë realizuar 47,662 mijë lekë ose 70%),* dhe shpenzimet për projekte dhe investime në vlerën 18,955 mijë lekë *(planifikuar 36,753 mijë lekë janë realizuar 17,798 mijë lekë ose 48%)* kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi nga grandi i pakushtëzuar i cili është realizuar në masën 81%.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga të ardhurat e veta të vitit dhe ato të trashëguara** paraqitet si më poshtë:

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga,	28,050	28,050	7,618	27%
2	Llog.601 Sig.	4,647	4,647	1,433	31%
3	Llog 602	52,933	59,904	32,530	54%
4	Llogaria 604	2,490	3,490	2,129	61%
5	Llogaria 606	6,500	4,684	1,500	32%
6	Llogaria 609	3,270	70		0%
7	Llog 230	6,000	7,884	1,866	24%
8	Llog 231	207,788	213,395	98,524	46%
	Shuma	**311,678**	**322,124**	**145,600**	**45%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e veta dhe ato të trashëguara, sipas akt akordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 322,124 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 145,600 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 176,524 mijë lekë ose 55% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga transferta specifike të pa kushtëzuara** paraqitet si më poshtë:

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	115,887	120,688	107,793	89%
2	Llog 601 -	19,409	19,994	17,986	90%
3	Llog 602-	11,565	7,481	4,070	54%
4	Llog 231	4,939	4,939	409	8%
	Shuma	**151,800**	**153,102**	**130,258**	85%

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga transferta specifike të kushtëzuara, sipas akt akordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 153,102 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 130,258 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 22,844 mijë lekë ose 15% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga transferta e kushtëzuara** paraqitet si më poshtë:

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga,		6,045	5,806	96%
2	Llog.601 Sig.		1,001	840	84%
3	Llog 602		1,894	1,894	100%
4	Llogaria 604		1,560	1,560	100%
5	Llogaria 606		445,368	431,622	97%
6	Llog 231		106,979	103,851	97%
	Shuma	**0**	**562,847**	**545,573**	**97%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga transferta e kushtëzuara, sipas akt akordimit me thesarin për vitin 2025, plani sipas situacionit në vlerën 562,847 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 545,573 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 17,274 mijë lekë ose 3% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2025, janë miratuar në KB me Vendimin nr. 32, datë 30.05.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë", nr. 65, datë 30.09.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin" dhe nr. 16, datë 12.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", të cilat janë dërguar MFE me emali brenda afateve ligjore.

Konkluzion: Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas akt akordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 1,329,712 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 1,058,747 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 270,965 mijë lekë ose 20% e totalit të shpenzimeve të planifikuara, konstatohet se ka diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative në vlerën 51,050 mijë lekë *(planifikuar 137,206 mijë lekë janë realizuar 86,156 mijë lekë ose 63%),* dhe shpenzimet për investime në vlerën 134,472 mijë lekë *(planifikuar 352,305 mijë lekë janë realizuar 217,833 mijë lekë ose 62%) ,* si rezultat i lidhjes së kontratave për investime në fund të periudhës e cila ka sjellë shtyrjen e likuidimit në vitin pasardhës, me ndikimin në realizimin e shpenzimeve brenda vitit buxhetor dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar neni 5, germa **"a"** *ku përcaktohet.....në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.*

-Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve;

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime Gjykate, rezulton se bashkia Prrenjas në fund të periudhës 31.12.2025, nuk ka detyrime.

Për sa trajtuar më lart mbahet akt konstatimi me znj. S. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, dhe z. A. B. me detyrë Përgjegjës Sektori Financës dhe Buxhetit për periudhën objekt auditimi.

<u>Nënpika 2.4.3. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.</u>

Për vitin 2025, sipas Strukturës së miratuar me Urdhrin e Kryetarit të bashkisë nr. 16, datë 10.01.2025 ka funksionuar Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore me 5 punonjës, nga të cilët 1 (një) Përgjegjës Sektori, 2(dy) Specialist dhe 2(dy) inspektorë.
Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është bërë duke mbajtur në konsideratë numrin e bizneseve dhe familjeve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.
Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte dhe familjarë që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

LlojiBiznesit	Viti 2025			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	398	16	30	384
B. Madh	108	1	6	103
Institucione	10	-	-	10
Familjare	7806	41	-	7847
Gjithsej	**8322**	**58**	**36**	**8344**

Për periudhën objekt auditimi planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është kryer në zbatim të VKB nr. 126, datë 26.12.2025 "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrenjas për vitin 2025", të cilat janë planifikuar për vlerën 137,000 mijë lekë dhe janë realizuar në fakt në vlerën 97,691 mijë lekë, ose 71 % me mosrealizim në vlerën 39,309 mijë lekë.
Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 paraqiten në pasqyrën në pasqyrën Aneks nr 1, bashkëlidhur.
Nga të dhënat rezulton se, për vitin 2025, të ardhurat gjithsej, nga 137,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 97,593 mijë lekë ose 71 %, **me një mosrealizim në vlerën 39,407 mijë lekë** *(të ardhura tatimore nga 26,552 mijë lekë të parasikuara, janë realizuar në vlerën 23,265 mijë lekë ose 84%, të ardhura jo tatimore nga 88,378 mijë lekë të parasikuara, janë realizuar në vlerën 48,178 mijë lekë ose 55 % dhe të ardhura taksat e ndara nga 22,070 mijë lekë të parasikuara, janë realizuar në vlerën 26,249 mijë lekë ose 119 %),* **mungesë të ardhurash** në buxhetin e bashkisë, **veprime në kundërshtim me** ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr. 126, datë 26.12.2025 "Për miratimin e paketës fiskale të Bashkisë Prrenjas për vitin 2025"
Me mosrealizim paraqiten taksa për ndërtesën nga familjarët e cila nga 3,462 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 930 mijë lekë ose 27%, tarifë pastrimi e cila nga 25,300 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 12,614 mijë lekë ose 55 % dhe tarifë gjelbërimi nga 3,100 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 974 lekë ose 31%, më e ulët se realizimi i të ardhurave gjithsej.
Nga të dhënat e Sektori i Tatim Taksave, për vitet 2025 të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore të cilat mblidhen me agjent tatimorë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Të ardhura nga taksat e ndara	**22,070**	**26,249**	**119**
Taksë mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	20	0	
Taksë e përvitshme e Automjeteve	11,300	13,402	
Renta Minerare	250	307	
Tatim page (2%)	10,500	12,441	
Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	-	99	

Përsa më sipër: Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia.
Taksa e rentës është planifikuar sipas realizimit të vitit të mëparshëm po kështu dhe TAP është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më pare, të cilat për vitin 2025 rezultojnë me tejkalim.
Pra likuidimet janë kryer pa pasur të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 117 dhe UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Gjendja e debitorëve me datë 31.12.2025.

Nga të dhënat e vëna në dizpozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas listave që disponon mbi debitorët për taksa e tarifa vendore për biznesin, familjarë për taksa e tarifa vendore, pikat e trgtimit të karburanteve, lejet e legalizimeve për ndërtimet pa leje, për ujin e pijshëm dhe debitorë për tarifën e rregjistrimit në kopshte e çerdhe rezulton se fillim të vitit 2015 kanë qenë për vlerën 102,687,183 lekë për gjatë vitit janë shtuar debitorë në shumën 60,146,090 lekë dhe pakësuar(arkëtuar) në vlerën 55,425,337 lekë dhe gjëndja në fund me datë 31.12.2025 janë për vlerën 107,412,936 lekë, të cilët nga Sektori Taksave e Tarifave Vendore janë dërguar me shkresë shkresë nr. 302 prot., datë 29.01.2026 për kontabilizimin e tyre Drejtorisë e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale.
Dinamika e debitorëve për shtesa e paksime për periudhën object auditimi paraqiten si më poshtë:
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion u konstatua se debitorë të biznesit të madh e të vogël dhe familjarë në fillim të vitit 2015 kanë qenë për vlerën 81,758,753 lekë për gjatë vitit janë shtuar debitorë në shumën 53,644,715 lekë dhe pakësuar(arkëtuar) në vlerën 46,490,959 lekë dhe gjëndja në fund debitorë progresiv me datë 31.12.2025 janë për vlerën 88,917,509 lekë *(për 261 subjekte në shumën 27,795,242 lekë dhe 5415 familjarë në vlerën 61,122,267 lekë)* në mënyrë të përmbledhur pasqyra e debitorëve si më poshtë:

EMËRTIM	**Gjendja 31.12.2024**	**Shtesa për Vitin 2025**	**Paksime viti 2025**	**Gjendja progresiv 31.12.2025**	**Numëri Subjekte Familjarë**
Debitorë ne total	**81,758,753**	**26,034,801**	**18,876,045**	**88,917,509**	**5 676**
Biznesi i madh e vogël	25,868,811	13,896,788	11,970,357	27,795,242	261
Familje për taksa tarifa	55,889,942	12,138,013	6,904,108	61,122,267	5415

Vlera e debitorëve të krijuar gjatë vitit 2025 për mospagesëne detyrimeve për taksa e tarifa vendore për biznesin dhe familjarë për taksa e tarifa vendore **në shumën 26,034,801 lekë e janë të ardhura të muguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.**
Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Sektori Taksave e Tarifave Vendore edhe pse ka zbatuar përcaktimet në Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv 261 subjekte për vlerën 27,795,242 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën* 13,896,788 *lekë)* dhe debitorë progresiv familjarë janë 5415 familje për vlerën 61,122,267 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 12,138,013 lekë)*, pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 88,917,509 lekë, **nga e cila vlera prej 26,034,801 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 1,942,440 lekë për gjatë vitit 2025, janë shtuar detyrimet në shumën 2,219,268 lekë dhe janë arkëtuar detyrime në vlerën 1,342,557 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **92 objekte të personave** në vlerën 2,819,151 lekë, **nga e cila vlera prej 2,219,268 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3/c

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar duke njoftuar me shkresë nr. 55 prot., datë 0701.2026, për shlyerjen e detyrimi tatimor në vlerën 900,000 lekë nga subjekti "L. B." dhe për subjektin "B. G" me shkresë nr. 1536/3, datë 24.05.2022 është kërkuar bllokim llogarie për shlyerjen e deturimit në vlerën 900,000 lekë për periudhën objekt auditimi këto subjekte nuk kanë likujduar detyrimet gjithsej **në vlerën 1,800,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për tarifën e rregjistrimit për kopshte e çerdhe sipas listave që disponon Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, rezultoi se në fillim të periudhës kanë qenë debitorë familjarë në vlerën 1,255,623 lekë, nuk kanë likujduar në vlerën 3,382,107 lekë janë arkëtuar për vitin 2025 në vlerën 3,620,970 lekë, pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë në vlerën 1,016,760 lekë, **ku vlera prej 1,016,760 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

Për sa trajtuar më lart mbahet akt konstatimi me z. A.G. me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore, znj. O. M. dhe z. B. O. me detyrë Specialist të taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën objekt auditimi.

Pika 2.3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025

Në zbatim të programit të auditimit,u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

-Vlerësimi nëse aktivet dhe pasivet janë llogaritur saktë si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

-Inventarizimi i aktiveve për vitin e raportimit financiar.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2025.

Për vitin 2025, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 606 prot., datë 27.02.2026 me prot., nr. 65, datë 27.02.2026 të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).
Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.
Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.
Pasqyrat financiare janë hartuar nga Bukoroshe Kanani me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit, të firmosura nga znj. S. K. si nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. N. B. Nëpunës autorizues.

***Mbajtja e kontabilitetit v. 2025*.**

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale.
Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2025, të pozicionit financiar Bashkia Përrenjas; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:
Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 19,116,165,880 lekë.

Aktivet	19,422,484,326 lekë
Pasivet	306,318,446 lekë
Aktivet neto	19,116,165,880 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **588,313,588 lekë** dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 272,854,762 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 55,634,802 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 259,824,024 lekë,

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
520	Disponibilitete në thesar	272,489,127	237,089,210	35,399,917
532	Vlera të tjera	365,635	515,645	(150,010)
Totali		**272,854,762**	**237,604,855**	**35,249,907**

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 272,489,127 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin datë 31.12.2025 dhe përbëhet nga gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 "Pasqyra e pozicionit financiar" paraqitet në vlerën 225,994,705 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 40,310,841 lekë, grandi papërdorur në vlerën 152,197,644 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 33,486,220 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 46,494,422 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	23,002,705	25,824,235	(2,821,530)
32	Inventar i imët	31,428,366	31,607,016	(178,650)
35	Mallra	1,203,731	1,468,831	(265,100)

	Totali	**55,634,802**	**58,900,082**	**(3,265,280)**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Prrenjas në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 55,634,802 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 23,002,705 lekë, nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 31,428,366 lekë dhe llogarinë 35 "Mallra" në vlerën 1,203,731 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën (3,265,280) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën 3,265,280 lekë.

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 23,002,705 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	**Vlera në lekë**
Gjendje në 01.01.2025	**25,824,235**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025	42,480,412
Dalje nga magazI..gjatë vitit	45,301,942
Gjendja në 31.12.2025	**23,002,705**

Llogaria 32 "Inventarë i imët", ka vlerën 31,428,366 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	**Vlera në lekë**
Gjendje në 01.01.2025	**31,607,016**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	3,801738
Dalje nga magazI..gjatë vitit 2025(K)	3,980,388
Gjendja në 31.12.2025	**31,428,366**

Llogaria 35 "Mallra", ka vlerën 1,203,731 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	**Vlera në lekë**
Gjendje në 01.01.2025	**1,468,831**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	5,409,685
Dalje nga magazI..gjatë vitit 2025(K)	5,674,785
Gjendja në 31.12.2025	**1,203,731**

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2025 Bashkia Prrenjas.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve/ shtesat/ pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)*", pasqyrën nr. 7/b, "*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)*", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për

gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazI..etj.,.
Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2025, ka dalë Urdhri nr. 404, datë 01.10.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për Bashkinë Prrenjas dhe vlerësimin e aktiveve te qëndrueshme dhe gjithë institucioneve për periudhën janar–dhjetor 2025, përkatësisht në shkolla, kopshte, Bashki dhe Njësi Administrative, si më poshtë:
Bashkinë Prrenjas, komisioni i përbërë nga:
1. E. B.
2. O. M.
3. E. C.
4. R. R.
Në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 20.11.2025 për të cilën gjatë procesit të inventarizimit janë konstatuar inventarë për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:
-llogaria 214 ‘’Instalime teknike, makineri e pajisje’ vlera 478,050 lekë
-llogaria 218 ‘’Inventar ekonomik’ ’vlera 261,300 lekë
-llogaria 32 ‘’Objekte inventari’ ’vlera 978,400 lekë
Nj/A Rrajcë, komisioni i përbërë nga:
1. I. G.
2. E. M.
3. J. B.
4. J. K.
Në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 20.11.2025 për të cilën gjatë procesit të inventarizimit janë konstatuar inventarë për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:
-llogaria 218 ‘’Inventar ekonomik’ ’vlera 2,386,750 lekë
-llogaria 32 ‘’Objekte inventari’ ’vlera 1,443,309 lekë
Nj/A Qukës, komisioni i përbërë nga
1. O. B.
2. E. K.
3. L. K.
4. A.M.
5. E. Sh.
Në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 20.11.2025 për të cilën gjatë procesit të inventarizimit janë konstatuar inventarë për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:
-llogaria 214 ‘’Instalime teknike, makineri e pajisje’ vlera 22,227 lekë
-llogaria 218 ‘’Inventar ekonomik’ ’vlera 1,064,337 lekë
-llogaria 32 ‘’Objekte inventari’ ’vlera 536,988 lekë
Nj/A Stravaj, komisioni i përbërë nga
1. N. Ç.
2. A. E.
3. M. Z.
4. V. Sh.

Në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 20.11.2025 për të cilën gjatë procesit të inventarizimit janë konstatuar inventarë për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:
-llogaria 32 ''Objekte inventari'' vlera 59,034 lekë
Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, komisioni i përbërë nga
1. E. D.
2. E. V.
3. Y. K.
4. M. K.
5. D. T.
Në përfundim të procesit të inventarizimit nga komisioni është mbajtur procesverbali datë 20.11.2025 për të cilën gjatë procesit të inventarizimit janë konstatuar inventarë për jashtë përdorimit sipas llogarive si më poshtë:
-llogaria 32 ''Objekte inventari'' vlera 359,349 lekë
Inventarizimi i AAGJM, komisioni i përbërë nga
1. M. A.
2. L. L.
3. S. H.
4. Sh. H.
5. Y. K.
6. J. B.
7 Administratorët e Njësive.
Për inventarët e konstatuara për jashtë përdorimit me VKB nr. 92, datë 24.12.2025 është miratuar nxjerrja e materialeve jashtë përdorimit në vlerën 7,598,744 lekë.
Gjatë vitit 2025, nga Bashkia Prrenjas në zbatim të VKB nr 115, datë 26.12.2024 "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të Bashkisë Prrenjas" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresë nr. 51/1, datë 20.01.2025 ka dalë urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 59, datë 07.02.2025 "Për ngritjen e komisionit të asgjësimin e materjaleve të dala jashtë përdorimit nga inventarizimet e vitit 2024" në vlerën 7,341,657 lekë. Nga komisioni për asgjësimin e materialeve me procesverbal datë 28.03.2025 është kryer procesi i asgjësimit.

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**259,824,024**	**297,329,946**	**(37,505,922)**
468	Debitorë te ndryshëm	124,762,436	97,815,946	26,946,490
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	135,061,588	199,514,000	(64,452,412)

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 97,815,946 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 124,762,436 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje në vlerën 83,586,327 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 **"Debitorë të ndryshëm**" kemi detyrimet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2025	**97,815,946**
Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	83,586,327

Pakësimi gjatë vitit 2025 (K)	56,639,837
Gjendja në 31.12.2025	**124,762,436**

Nga analiza e llogarisë 468 **"Debitorë të ndryshëm**" kemi detyrimet të dhënat në pasqyrën si më poshtë:.

Debitorë analitik në fund të vitit 2025.

Debitorët analitikë.	**Çelja 01.01.2025**	**Shtesa gjatë vitit 2025 (debi)**	**Paksime gjatë vitit 2025 (kredi)**	**Gjendja me 31.12.2025**
Biznes i madh	11,815,034	29,129,832	28,097,800	12,847,066
Biznes i vogël Përrenjas & Stravaj	5,929,372	6,586,733	4,620,470	7,895,635
Biznes i vogël Qukës	892,170	720,321	439,001	1,173,490
Biznes i vogel Rrajce	965,062	1,437,073	1,022,857	1,379,278
Regjistri pasiv	4,420,775			4,420,775
Subjekte me tender	28,249	50,749		78,998
Pikat e tregetimit te karburantit detyrime KLSH	1,400,000	900,000	500,000	1,800,000
DEBITOR BIZNES I MADH	**25,450,662**	**38,824,708**	**34,680,128**	**29,595,242**
Qyteti Prrenjas familjaret	19,589,530	6,644,312	4,755,643	21,478,199
Njesia Administrative Qukes	14,497,299	4,015,182	1,662,054	16,850,427
Njesia Administrative Rrajce	15,455,434	5,944,697	5,020,273	16,378,858
Njesia Administrative Stravaj	6,347,679	933,965	866,861	6,414,783
DEBITORE TAKSA E TARIFA VENDORE	**55,889,942**	**17,538,156**	**12,305,831**	**61,122,267**
Bashkia Prrenjas	1,395,089		369	1,394,720
Njesia Rrajce	6,620,194		378,893	6,241,301
Njesia Qukes	3,720,462			3,720,462
Njesia Stravaj	1,522,034		19,001	1,503,033
DEBITORE UJI I PIJSHEM	**13,257,779**		**398,263**	**12,859,516**
Debitore kopshti	966,484	2,621,349	2,861,999	770,834
Debitore cerdhe	289,139	760,758	803,971	245,926
DEBITORE KOPESHT CERDHE	**1,255,623**	**3,382,107**	**3,620,970**	**1,016,760**
Legalizime	1,942,440	2,219,268	1,342,557	2,819,151
DEBITOR LEGALIZIME	**1,942,440**	**2,219,268**	**1,342,557**	**2,819,151**
DRSHTRR		3,072,588	3,072,588	0
GJITHSEJ	**97,796,446**	**61,964,239**	**55,420,337**	**107,412,936**
IVMT		18,400,000	1,200,000	17,200,000
GJOBA POLICISE	19,500	149,500	19,500	149,500
SHUMA TOTALE	**97,815,946**	**83,586,327**	**56,639,837**	**124,762,436**

Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" vetëm për vitin 2025 janë për vlerën 83,586,327 lekë të cilat janë kontabilizuar sipas listave që disponon Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorë familjarë në vlerën 17,538,156 lekë, debitorë të biznesit në vlerën 38,824,708 lekë, debitorë për kopshte e çerdhe në vlerën 3,382,107 lekë, debitorë për leje legalizimi në vlerën 2,219,268 lekë gjobat e IVMT në vlerën 18,400,000 lekë dhe gjobat e policisë në vlerën 149,500 lekë të dërguara me shkresën nr 302, datë 29.01.2026, drejtuar Drejtorisë e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale për kontabilizimin e tyre.

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 135,061,588 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe fatura të palikujduara në fund të periudhës dhe kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 135,061,588 lekë.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog. 202 "Studime dhe kërkime", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 6,826,944 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 7,217,363 lekë (viti 2024: 12,225,033 lekë).

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr 1, bashkëlidhur.

Nga dokumentacioni i vënë në dizpozicion rezulton se janë bërë shtesa në vlerën 4,614,570 lekë të cilat konsistojnë në kapitalizimin e aktiveve afatgjata jomateriale kryesisht për "Hartim projekti i unazës Katjel Prrenjas fshati Urake Qukës" të cilat janë likujduar sipas kontratës nr. 2395, datë 18.09.2024 me vlerë 4,614,570 lekë, me Urdhër shpenzimi nr. 183, datë 27.05.2025 vlera 4,614,570 lekë për faturën nr. 20/2025 datë 06.05.2025 dhe paksime në vlerën e projekteve të cilat janë vënë në zbatim dhe i kanë kaluar vlerës së objekteve në vlerën 46,000 lekë dhe transferime të projekteve me objekt "Hartim projekti ujesjellesi Urake Kotodesh Katjel" në vlerën 4,418,640 lekë dhe "Projekt KUZ qyteti Prrenjas" në vlerën 5,157,600 lekë, shoqërisë UK Pogradec me shkresë nr 2248/1, datë 29.09.2025.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llog 210 "Toka,troje Terrene" paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025, paraqiten në vlerën 4,918,360 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, paraqiten në vlerën 4,918,360 lekë (viti 2024: 4,918,360 lekë).

Llog 211 "Pyje, kullota Plantacione" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 17,346,680,860 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 17,346,680,860 lekë (viti 2024: 17,349,552,179 lekë), shtesa me pagesë në vlerën 4,425,600 lekë të cilat janë likujduar sipas kontratës nr. 3133, datë 14,11.2023 me vlerë 4,425,600 lekë, me Urdhër shpenzimi nr. 39, datë 19.01.2024 vlera 1,327,680 lekë për faturën nr. 2/2024 datë 03.01.2024, Urdhër shpenzimi nr. 350, datë 29.07.2024 vlera 1,770,240 lekë për faturën nr. 20/2024 datë 17.07.2024 dhe Urdhër shpenzimi nr. 118, datë 07.04.2025 vlera 1,327,680 lekë për faturën nr. 6/2025 datë 25.032025, paksuar për vlerën 7,296,919 lekë nga sistemime duke kaluar në llgarinë e shpenzimeve (dru zjarri) vlerën 4,198,999 lekë dhe vlerën 3,097,920 lekë për transferimin nga llogaria 231 "Investime në proces" për projektin "Hartimin e planit të mbarshtimit Sopot" që është kontabilizuar gabim për vitin 2024 në vlerën 3,097,920 lekë.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr 2, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 17,346,680,860. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar vlera 2,770,029 lekë për shpenzime Prodhim transport dhe stivim dru zjarri të periudhës 2018 dhe 2019 duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione", në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

Llog 212 "Ndërtesa konstruksione" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 542,114,437 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 759,238,243 lekë (viti 2024: 703,306,598 lekë). Pra kemi rritje në vlerën 55,931,645 lekë.
Shtesa me pagesë në vlerën 169,194,892 lekë për objektet si më poshtë:
1- Objekti "Kolaudim rehabilitim përforcim banesash ' në vlerën 31,422 lekë, sipas kontratës nr. 1445/1 datë 29.05.2019 me vlerë 31,422 lekë, likuiduar me Urdhër shpenzimi nr.177, datë 26.05.2025 vlera 31,422 lekë për faturën nr. 08/2025 datë 17.05.2025.
2- Objekti "Kolaudim rikonstruksion palestra shkolla Qybra Sokoli" në vlerën 14,514 lekë, sipas kontratës nr. 888, datë 13.03.2024 me vlerë 14,514 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 159, datë 8.05.2025 vlera 14,514 lekë për faturën nr. 53/2025, datë 07.05.2025.
3- Objekti "Kolaudim rikonstruksion kalceto Prrenjas Fshat" në vlerën 5,799 lekë, sipas kontratës nr. 862, datë 12.03.2024 me vlerë 5,799 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 247, datë 04.07.2025 vlera 5,799 lekë për faturën nr. 09/2025, datë 27.06.2025.
4- Objekti "Mbikëqyrje punimesh këndi lojërash Prrenjas Fshat" në vlerën 19,350 lekë, sipas kontratës nr. 3315 datë 05.12.2023 me vlerë 19,350 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 230 datë 20.06.2025 vlera 19,350 lekë për faturën nr. 04/2025 datë 04.04.2025.
5- Objekti "Mbikëqyrje punimesh kënd lojëra lagje Bitumi "në vlerën 19,348 lekë, sipas kontratës nr. 3313 datë 05.12.2023 me vlerë 19,348 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 229 datë 20.06.2025 vlera 19,348 lekë për faturën nr. 03/2025 datë 04.04.2025.
6- Objekti 'Kolaudim Fushe Mini Futbolli Karkavec' në vlerën 7,616 lekë, sipas kontratës nr. 502 datë 27.02.2025 me vlerë 7,616 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 243 datë 03.07.2025 vlera 7,616 lekë për faturën nr. 04/2025datë 28.03.2025.
7-Objekti" Ndërtim fushe mini Futbolli (kalceto) shkolla Karkavec" në vlerën 2,317,224 lekë, sipas kontratës nr. 3189 datë 20.12.2024 me vlerë 2,317,224lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 104 datë 26.03.2025 vlera 2,317,224 lekë për faturën nr. 16/2025 datë 19.03.2025.
8- Objekti "Mbikëqyrje fushe mini futbolli(kalceto) Karkavec' në vlerën 73,621 lekë, sipas kontratës nr. 578 datë 02.12.2024 me vlerë 73,621 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 128 datë 10.04.2025 vlera 73,621 lekë për faturën nr. 10/2025 datë 07.03.2025.
9- Objekti 'Mbikëqyrje punimesh fshati Gurre' në vlerën 808,414lekë, sipas kontratës nr612 datë 11.03.2025 me vlerë 808,414 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 443 datë 19.11.2025 vlera 808,414 lekë për faturën nr. 43/2025, datë 03.11.2025.
10- Objekti "Kolaudim punimesh fshati Gurre' në vlerën 97,009 lekë, sipas kontratës nr. 613 datë 11.03.2025 me vlerë 97,009 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 478 datë 11.12.2025 vlera 97,009 lekë për faturën nr. 72/2025 datë 05.12.2025.
11- Objekti "Ndërtim shkolla Kotodesh" në vlerën 5,737,284 lekë, sipas kontratës nr. 815 datë 07.03.2024 me vlerë 5,737,284 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 28 datë 06.02.2025 5,737,284 lekë për faturën nr. 51/2024 datë 31.12.2024.
12- Objekti "Mbikqyrje punimesh shkolla Kotodesh" në vlerën 496,547 lekë, sipas kontratës nr. 824 datë 07.03.2024. me vlerë 496,547 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 233 datë 26.06.2025 vlera 496,547 lekë për faturën nr. 7/2024 datë 25.04.2025.
13- Objekti" Kolaudim punimesh shkolla Kotodesh" në vlerën 65,880 lekë, sipas kontratës nr. 3207 datë 23.12.2024 me vlerë 65,880 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 59 datë 19.02.2025 vlera 65,880 lekë për faturën nr. 24/2024 datë 27.12.2024.

14- Objekti "Kolaudim terrene sportive" në vlerën 2,220 lekë, sipas kontratës nr. 735 datë 09.03.2023 me vlerë 2,220 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 160 datë 08.05.2025 vlera 2,220 lekë për faturën nr. 2/2025 datë 03.05.2025.

15- Objekti "Rikonstruksion shkolla Kotodesh "në vlerën 20,153,190 lekë, sipas kontratës nr. 815 datë 07.03.2024 me vlerë 20,153,190 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 237 datë 16.05.2024,285 date 10.06.2024,343 date19.07.2024,430 date 24.09.2024 vlera 20,153,190 lekë për faturën nr. 19/2024, datë 05.06.2024, fatura nr. 11/2024 date 30.04.2024, fatura nr. 21/2024 date 15.07.2024 ,fatura nr. 28/2024 date 03.09.2024.

16- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce" në vlerën 15,779,999 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 15,779,999 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 182, date 27.05.2025. vlera 15,779,999 lekë për faturën nr. 33/2025 datë 23.04.2025

17- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce' në vlerën 3,300,020 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 3,300,020 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 189, date 29.05.2025. vlera 3,300,020 lekë për faturën nr. 33/2025 datë 23.04.2025

18- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce" në vlerën 26,300,005 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 26,300,005 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 369, date 03.10.2025. vlera 26,300,005 lekë për faturën nr. 70/2025 datë 26.09.2025

19- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce "në vlerën 19,478,413 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 19,478,413 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr370, date 03.10.2025. vlera 19,478,413 lekë për faturën nr. 70/2025 datë 26.09.2025

20- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce "në vlerën 10,520,002 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 15,779,999 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 470, date 10.12.2025. vlera 10,520,002 lekë për faturën nr. 70/2025 datë 26.09.2025

21- Objekti "Ndërtim shkolla e mesme Sali Halili Rrajce" në vlerën 19,967,015 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 19,967,015 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 517, date 31.12.2025 vlera 19,967,015 lekë për faturën nr. 86/2025 datë 10.12.2025

22- Objekti "Ndërtim shkolla Sali Halili Rrajce "viti 2024 në vlerën 44,000,000 lekë, sipas kontratës nr. 2598 datë 11.10.2024 me vlerë 44,000,000 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 588datë 27.12.2025vlera 44,000,000 lekë për faturën nr. 108/2024 datë 27.12.2024, dhe lëvizje të brendshme në vlerën 3,188,981 lekë, për sistemime veprimesh të llogarive 211 dhe 213.

Paksime në vlerën 116,452,228 lekë vlere e cila kalon te llogaria 213 (Rruge ,rrjete vepra ujore).

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" paraqitet në vlerën 759,238,243 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari vlera prej 42,919,940 lekë nuk është e analizuar me objekte, nuk ka regjistër me të dhëna për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare për kryerjen e inventarit fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me vlerë kontabël (kosto-amortizim/provigjone) është larg vlerës reale të tyre. Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove

të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 0 – 8,025 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105 "Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar" dhe Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël), pasi nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre.

Llog 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 858,055,134 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,172,116,939 lekë (viti 2024: 1,004,538,064 lekë). Pra kemi rritje në vlerën 167,578,875 lekë, për shtesa me pagesë në vlerën 75,522,779 lekë dhe lëvizje të brendshme në vlerën 116,784,087 lekë për objektet si më poshtë:

1- Objekti "Rikonstruksion i rrugës brendshme Muhamet Kadia" në vlerën 37,149 lekë, sipas kontratës nr. 705 datë 26.02.2024 me vlerë 37,149 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr144 datë 06.05.2025. vlera 37,149 lekë për faturën nr. 46/2025 datë 29.04.2025

2- Objekti "Mbikëqyrje punimesh mbrojtja dhe rehabilitimi i tokave te dëmtuara ndërtimi i mureve mbajtës dhe argjinaturave" në vlerën 22,612lekë, sipas kontratës Nr. 3453 datë 19.12.2023 me vlerë 22,612 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 252 datë 08.07..2025. vlera 22,612 lekë për faturën nr. 18/2025 datë 10.04.2025

3- Objekti "Kolaudim punimesh mbrojtja dhe rehabilitimi i tokave te dëmtuara ndërtimi i mureve mbajtës dhe argjinaturave" në vlerën 3,392lekë, sipas kontratës nr. 1380 datë 09.05.2024 me vlerë 3,392 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 245 datë 03.07.2025. vlera 3,392 lekë për faturën nr. 08/2025 datë 27.06.2025

4- Objekti "Kolaudim asfaltim rruga kotodesh' në vlerën 33,201 lekë, sipas kontratës nr. 1675 datë 20.06.2023 me vlerë 33,201 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr401 datë 21.10.2025. vlera 33,201 lekë për faturën nr. 118/2025, datë 20.10.2025

5- Objekti "Supervizim punimesh ndërtime rikonstruksion te lerave uji për bagëtinë" në vlerën 110,240 lekë, sipas kontratës nr. 1095 datë 12.04.2023 me vlerë 110,240 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 251, datë 08.07.2025 vlera 110,240 lekë për faturën nr. 35/2025 datë 25.06.2025

6- Objekti "Rikonstruksion kanalet vaditëse' në vlerën 409,117 lekë, sipas kontratës nr. 2030 datë 29.07.2024 me vlerë 409,117 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 43 datë 10.02.2025 vlera 409,117 lekë për faturën nr. 38/2024, datë 13.12.2024

7- Objekti "Mbikëqyrje punimesh rikonstruksion kanalet vaditëse" në vlerën.65,984 lekë, sipas kontratës nr. 2029 datë 29.07.2024 me vlerë.65,984 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 63 datë 21.02.2025. vlera 65,984. lekë për faturën nr. 84/2024 datë 24.12.2024

8- Objekti "Kolaudim rikonstruksion kanale vaditëse "në vlerën. 9,898 lekë, sipas kontratës nr. 3194 datë 20.12.2024 me vlerë 9,898 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 56 datë 17.02.2025 vlera 9,898 lekë për faturën nr. 58/2024 datë 24.12.2024

9- Objekti "Rikonstruksion kanale vaditës "2024 në vlerën.2,140,433 lekë, sipas kontratës nr. 2030 datë 29.07.2024 me vlerë 2,140,433 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 471 datë 15.10.2024 vlera 2,140,433 lekë për faturën nr. 24/2024 datë 03.09.2024

10- Objekti “Kolaudim punimesh ura mbi lumin Shkumbin” në vlerën.1,049. lekë, sipas kontratës nr. 3531 datë 26.12.2023 me vlerë 1,049 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr227 datë 20.06.2025 vlera 1,049 lekë për faturën nr. 01/2025 datë 04.04.2025
11- Objekti “Kolaudim punimesh kanali i xhelos faza I “në vlerën 6,397 lekë, sipas kontratës nr 3533 datë 26.12.2023 me vlerë 6,397 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 228 datë 20.06.2025vlera 6,397 lekë për faturën nr. 02/2025 datë 04.04.2025
12- Objekti “Mbikëqyrje punimesh kanali Xhelos faza II Kraste “në vlerën 369,759 lekë, sipas kontratës nr. 2719 datë 25.10.2024 me vlerë 369,759 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 68 datë 26.02.2025 vlera 369,759 lekë për faturën nr. 56/2024 datë 20.12.2024
13- Objekti “Kolaudim punimesh kanali Xhelos Faza II Kraste “në vlerën 69,330 lekë, sipas kontratës nr 3188 datë 20.12.2024 me vlerë 69,330 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr 176 datë 26.05.2025 vlera 69,330 lekë për faturën nr 13/2024 datë 27.12.2024
14- Objekti “Mbikëqyrje punimesh kanali Xhelos faza II Kraste.” në vlerën. 92,439 lekë, sipas kontratës nr 2719 datë 25.10.2024 me vlerë 92,439 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr 96 datë 17.03.2025 vlera 92,439 lekë për faturën nr 3/2025 datë 13.01.2025
15- Objekti “Mbikëqyrje punimesh kanali i lingajces faza II Rrajce” në vlerën 354,307 lekë, sipas kontratës nr. 2881 datë 11.11.2024 me vlerë 354,307 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 101 datë 20.03.2025 vlera 354,307 lekë për faturën nr. 7/2025 datë 06.03.2025
16- Objekti ‘Rikonstruksion asfaltim i rrugës Leka Marta Qukës” në vlerën 13,500,000 lekë, sipas kontratës nr 2288 datë 02.10.2025 me vlerë 13.500.000 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr 515 datë 31.12.2025. vlera 13,500,000 lekë për faturën nr 1765/2025 datë 31.12.2025
17- Objekti “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës fshati Gurre” në vlerën. 32,191,810 lekë, sipas kontratës nr. 613 datë 11.03.2025 me vlerë 32,191,810 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 471 datë 10.12.2025 vlera 32,191,810 lekë për faturën nr. 190/2025 datë 04.12.2025
18- Objekti “Rikonstruksioni i rrugëve fshati gurre “ në vlerën 9,141,408 lekë, sipas kontratës nr. 613 datë 11.03.2025 me vlerë 9,141,408 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr223, datë 19.06.2025 vlera 9,141,408 lekë për faturën nr. 66/2025 datë 03.06.2025
19- Objekti “Rikonstruksion kanali i lingajces faza II “në vlerën 578,232 lekë, sipas kontratës nr. 2849 datë 06.11.2024. me vlerë 578,232 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 100 datë 20.03.2025. vlera 578,232 lekë për faturën nr. 6/2025 datë 19.03.2025
20- Objekti “Kolaudim kanali i lingajces” në vlerën 78,000 lekë, sipas kontratës nr3162 datë 18.12.2024 me vlerë 78,000 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr127 datë 09.04.2025 vlera 78,000 lekë për faturën nr. 8/2025 datë 17.02.2025
21- Objekti “Rikonstruksion kanali lingajces faza II Rrajce” viti 2024 në vlerën 13,164,678 lekë, sipas kontratës nr2849, datë 06.11.2024. me vlerë 13,164,678 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 558 datë 05.12.2024 vlera 4,078,530 lekë për faturën nr. 41/2024 datë 02.12.2024 dhe Urdhër shpenzimi nr. 582 date 24.12.2024 vlera 9,086,148 leke për faturën nr. 47/2024 date 23.12.2024.
22- Objekti “Mbikëqyrje kanali i lingajces” viti 2024 në vlerën 151,846 lekë, sipas kontratës nr. 2881 datë 11.11.2024 me vlerë 151,846 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 560 datë 06.12.2024 vlera 151,846 lekë për faturën nr. 52/2024 datë 02.12.2024
23- Objekti “Supervizim punimesh rruga karkavec” në vlerën 16,717 lekë, sipas kontratës nr 934 datë 28.03.2023 me vlerë 16,717 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 161 datë 09.05.2025 vlera 16,717 lekë për faturën nr. 31/2025 datë 29.04.2025

24- Objekti "Kolaudim punimesh rruga karkavec" në vlerën. 2,005 lekë, sipas kontratës nr. 1665 datë 20.06.2023 me vlerë 2,005 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 262 datë 11.07.2025 vlera 2,005 lekë për faturën nr. 10/2025 datë 07.05.2025
25- Objekti "Kolaudim punimesh rruga Rashtan "në vlerën. 10,060 lekë, sipas kontratës nr. 2390 datë 18.09.2024 me vlerë 10,060 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 144 datë 06.05.2025 vlera 10,060 lekë për faturën nr. 30/2025 datë 29.04.2025
26- Objekti "Ndërtim kanali ujerave te larta rruga Halit Berzeshta "në vlerën. 2,776,800 lekë, sipas kontratës nr. 2612 datë 04.11.2025 me vlerë 2,776,800 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 499 datë 23.12.2025 vlera 2,776,800 lekë për faturën nr. 20/2025 datë 19.12.2025
27- Objekti " Ndërtim kanali ujerave te larta rruga Halit Berzeshta "në vlerën. 185,916 lekë, sipas kontratës nr2612 datë 04.11.2025 me vlerë 185,916 lekë likuiduar me Urdhër shpenzimi nr516 datë 31.12.2025 vlera 185,916 lekë për faturën nr. 21/2025datë 30.12.2025
Paksime në vlerën 24,727,991 lekë nga transferimet për UK Pogradec në vlerën 24,682,930 dhe lëvizje të brendshme në vlerën 45,061 lekë.
Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 4, bashkëlidhur.
Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera prej 215,844,097 lekë, për 22 artikuj për ujësjellës-kanalizimeve, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Pogradec, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.
Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 6,182,123 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjëndja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 20,073,114 lekë (viti 2024: 19,317,336 lekë). Pra kemi rritje në vlerën 167,578,875 lekë.
Shtesa me pagesë në vlerën 1,544,448 lekë dhe lëvizje të brendshme në vlerën 0 lekë për si më poshtë:
1- Objekti blerje kompjutera në vlerën.1,199,904. lekë, sipas kontratës nr1552 datë 15.07.2025 me vlerë.1,199,904 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr277 datë28.07.2025 vlera 1,199,904 lekë për faturën nr47/2025 datë 17.07.2025
2- Objekti blerje kondicioner. në vlerën 344,544 lekë, sipas kontratës nr1566 datë 16.07.2025 me vlerë344,544 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr278 datë.28.07.2025 vlera 344,544 lekë për faturën nr32/2025 datë 18.07.2025
Paksime në vlerën 788,670 lekë nga nxjerrjet jasht perdorimit.
Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr 5, bashkëlidhur.
Llogaria 215 "Mjete transporti" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 11,976,408 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e

aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjëndja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 55,454,396 lekë (viti 2024: 55,454,396 lekë).

Gjendje e kësaj llogarie e analizuara sipas inventarit në vlerë bruto, dhe lëvizjet e për shtesa e paksime paraqitet në pasqyrën Aneks nr 6, bashkëlidhur.

Llogaria 218 "Iventar ekonomik". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjëndja e llogarisë 218 *"Iventar ekonomik"* në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 21,736,053 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 22,900,123 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjëndja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 55,540,831 lekë (viti 2024: 50,116,650 lekë), e analizuar për 595 artikuj.

Në këto gjëndje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 777,600 lekë dhe shtesa pa pagesë në vlerën 7,654,680 lekë, si më poshtë:

1- Blerje aparat per urbanistiken në vlerën777,600 lekë, sipas kontratës nr 980 datë date 08.05.2025 me vlerë 777,600 lekë likujduar me Urdhër shpenzimi nr185, datë 27.05.2025 vlera 777,600 lekë për faturën nr 42/2025 datë 13..05.2025

Është paksuar për vlerën 2,572,599 lekë nxjerrje jasht përdorimit. 2,572,599 leke dhe në vlerën 435,500 lekë paksime të tjera si më poshtë:

TavolI.. nxenesish 40 cope x 4,600 =184,000 leke
TavolI..nxenesish 29 cope x 3,200 = 92,800 leke
Karrige nxenesish 10 cope x 3,800 = 38,000 leke
Karrige nxenesish 71 cope x 1,700 = 120,700 leke
Shuma 435,500 leke

Llogaria 26 "Pjesmarrje në kapitalin e vet" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,570,000 lekë, e cila përfaqëson Shoqerine E.. – E.. në vleren 280,000 leke dhe Shoqerine e UK Pogradec ne vleren 1,290,000 Leke..

Llogaria 231 "AAGJM Investime në proces" paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 82,708,067 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 32,946,349 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2025.

Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Analizae llogarise 231 "AAGJM Investime në proces", sipas objekteve.	**Çelja 01.01.2025**	**Shtesa gjatë vitit 2025**	**Paksime gjatë vitit**	**Gjendja me 31.12.2025**
Rikonstruksion i kanalit te lingajces faza III	**13,316,524**	**7,504,236**	13,316,524	7,504,236
Hartimi i planit te mbareshtimit pyjeve kullotave		**10,000,000**		10,000,000
Rikonstruksioni dhe asfaltimi i unazes Katjel		**2,650,800**		2,650,800
Qendra rinore dixhitale per rinine dhe punesimin		**6,055,456**		6,055,456
Permiresimi banesave per komunitete e varfra		**1,423,738**		1,423,738
Permiresimi banesave per komunitete e varfra2023 me 20% ardhura bashkise		**5,312,119**		5,312,119
Rikonstruksion kanalesh	2,140,433		2,140,433	
Rikonstruksion shkolla Kotodesh	20,153,190		20,153,190	
Hartimi i planit mbareshtimit ekonomia sopot	3,097,920		3,097,920	
Ndertim shkolla Rrajce	44,000,000		44,000,000	
SHUMA	**82,708,067**	**32,946,349**	**82,708,067**	**32,946,349**

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Prrenjas më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të

muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ndryshimi
	Llogari të pagueshme			
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	104,691,074	152,568,658	(47,877,584)
42	Detyrime ndaj personelit	17,742,388	17,583,806	158,582
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,346,899	1,278,681	68,218
435	Sigurime shoqërore	5,366,210	5,251,015	115,195
436	Sigurime shëndetësore	737,376	722,035	15,341
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	46,494,422	38,675,760	7,818,662
467	Kreditorë të ndryshëm	5,177,641	22,109,805	(16,932,164)
470	Llogari në pritje të ardhura për tu rimarrë	124,762,436	97,815,946	26,946,490

Llogaria 401-408 "Furnitor e llogari të lidhura me to", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 në vlerën 104,691,074 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën aneks nr. 7, bashkëlidhur.

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 17,742,388 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Celje e vitit 2025	17,583,806
Shtesa (K)	212,181,990
Pakësime (D)	212,023,408
Gjendja në 31.12.2025	17,742,388

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 1,346,899 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Celje e vitit 2025	1,278,681
Shtesa (K)	16,062,800
Pakësime (D)	15,994,582
Gjendja në 31.12.2025	1,346,899

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, perkatsisht në vlerat 5,366,210 lekë dhe 737,376 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Celje e vitit 2025	5,251,015
Shtesa (K)	64,028,065
Pakësime (D)	63,912,870
Gjendja në 31.12.2025	5,366,210
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Celje e vitit 2025	722,035
Shtesa (K)	8,797,549
Pakësime (D)	8,782,208
Gjendja në 31.12.2025	737,376

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 38,675,760 lekë dhe

në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 46,494,422 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në pasqyrën Aneks nr. 8, bashkëlidhur.
Për vlerat e garancive për objektet të cilat nga bashkia janë marrë në dorëzim dhe u ka kaluar afati i garancisë duhet të bëjë njoftimin e subjekteve me qëllim likuidimin e këtyre garancive, për pasqyrimin e saktë të vlerës së llogarisë në mbyllje të vitit ushtrimorë.
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 në vlerën 5,177,641 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 10, bashkëlidhur.
Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.
Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 1,070,129,534 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Librazhd paraqitet më poshtë:
Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 83,422,978 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 46,097,404 lekë, me ulje në vlerën 37,325,574 lekë.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**46,097,404**	**83,422,978**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**98,829**	**37,140,724**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale		-
7001	Tatimi mbi fitimin		-
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	98,829	143,504
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	36,997,220
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**8,783,862**	**10,388,971**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	8,783,862	10,388,971
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë		67,259
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**37,207,813**	**35,877,363**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	13,402,124	11,861,483
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	23,805,689	24,015,880
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	**5. Taksë e rrugës**		**0**
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**	**6,900**	**15,920**
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**		

Referuar të dhënave të akt rakordimit të të ardhurave me Degën e Thesarit Librazhd datë 31.12.2025 kemi informacioni si mëposhtë:
1) Sipas kodifikimit 700 *" Tatim mbi të ardhurat"* e cila është kontabilizuar për vlerën 98,829 lekë janë përfshirë.
-Tatim mbi biznesin e vogël me vlerë 98, 829lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 700 *"Tatim mbi të ardhurat"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
2) Sipas kodifikimit 702 *"Tatim mbi Pasuritë"* e cila është kontabilizuar për vlerën 8,783,862 lekë janë përfshirë.
a)Tatim mbi pasuritë e paluajtshme me vlerë 8,873,862 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Taksë mbi tokën bujqësore me vlerë 2,800,291 lekë;
-Taksa e ndërtesës me vlerë 5,983,571 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
3) Sipas kodifikimit 703 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* e cila është kontabilizuar për vlerën 37,207,813 lekë janë përfshirë.
a) Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie (7033) me vlerë 13,402,124 lekë
a)Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie (7035) me vlerë 23,805,689 lekë.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim (7033) *"Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie"* 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Taksë Automjeteve të përdorura DPSHTR me vlerë 13,402,124 lekë;
-Taksë tregu për zënien e hapsirës publike me vlerë 1,121,233 lekë;
-Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja Aluizni me vlerë 9,756,740 lekë;
-Taksë vendore për fjetjen në hotel me vlerë 10,800 lekë;
-Taksë vendore për reklamat me vlerë 715,500 lekë;
-Taksë vendore e tabelës me vlerë 1,195,784 lekë;
-Tarifë vendore për shfrytëzim (dru të prerë) me vlerë 301,500 lekë;
-Taksë vendore e përkohëshme arsimi me vlerë 215,214 lekë;
-Taksë vendore e gjelbërt me vlerë 974,507 lekë;
-Tarifë vendore për ndriçimin me vlerë 2,197,862 lekë;
-Taksë vendore për truallin me vlerë 1,465,550 lekë;
-Tarifë vendore për certifikatën e përdorimit me vlerë 274,010 lekë;
-Tarifë vendore për urbanistikën me vlerë 195,064 lekë;
-Tarifë vendore për sisteme të jashtme ndërtimi me vlerë 740,738 lekë;
-Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi me vlerë 113,592 lekë;
-Tarifë vendore uji me vlerë 398,263 lekë;
-Tarifë për vërteime me vlerë 84,538 lekë
-Tarifë vendore për leje ndërtimi me vlerë 467,879 lekë;
-Tarifë vendore për varrezat me vlerë 511,765 lekë;
-Tarifë vendore për shfrytëzim karburantesh me vlerë 1,500,000 lekë;
- Tarifë vendore për mirmbajtje rrugëve me vlerë 1,322,000 lekë;
-Tarifë vaditje me vlerë 243,870 lekë
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit (7033) *"Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie"* dhe 7035 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
4) Sipas kodifikimit 708 *"Të tjera tatime e taksa kombëtare "* e cila është kontabilizuar për vlerën 6,900 lekë janë përfshirë.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 708 *"Të tjera tatime e taksa kombëtare"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Gjendja civile me vlerë 6,900 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 708 *"Të tjera tatime e taksa kombëtare"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 33,994,606 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë **33,390,364 lekë** ose me ulje në vlerën 604,242 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën në vijim:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**33,390,364**	**33,994,606**
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia		
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	**33,388,864**	**33,994,606**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë	18,378,714	0
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	3,620,970	24,401,971
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	156,400	0
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	1,476,040	65,845
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	9,756,740	9,526,790
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	**1,500**	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas

1) Sipas kodifikimit 711*"Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare"* e cila është kontabilizuar për vlerën 33,388,864 lekë janë përfshirë.

a)Tarifa administrative dhe rregullatorë (7110) me vlerë 18,378,714 lekë;

b)Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh (7111) me vlerë 3,620,970 lekë;

c) Të ardhura nga shitja e mallrave (7113) me vlerë 156,400 lekë;

d)Gjoba Kamatvonesa sekuestrime e zhdëmtime (7115) me vlerë 1,476,040 lekë;

e) Të ardhura nga transferimet e pronës (7116) me vlerë 9,756,740 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Tarifë administrative e akteve ligjore me vlerë 443,250 lekë;

-Tarifa për leje transporti me vlerë 563,486 lekë;

-Tarifë për linja ajrore dhe nëntoksore me vlerë 520,401 lekë;

-Tarifë pastrimi dhe higjene me vlerë 12,613,800 lekë;

-Tarifë për mirmbajtje dhe përmirsim mjedisit me vlerë 3,203,753 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"*nuk rakordojn me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin në vlerën 1,034,024 lekë.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Të ardhurat nga kopshtet dhe çerdhet me vlerë 2,816,999 lekë;

-Tarifë rregjistrimi për kopshtet dhe cerdhet me vlerë 803,971 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* janë për vlerën 156,400 lekë:

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* për*:*

-Të ardhura nga shërbimi MNZ me vlerë 136,000 lekë;
-Të ardhura të tjera nga shitja me vlerë 20,400 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7119 *"Të tjera të ardhura jo tatimore "* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
- Të tjera të ardhura jo tatimore me vlerë 1,500 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7119 *"Të tjera të ardhura jo tatimore "* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7115 *"Gjoba. Kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* janë për vlerën 1,476,040 lekë :
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115 *"Gjoba. Kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* për*:*
-Gjoba shpërblim dëmi me vlerë 1,459,000 lekë;
- Sekuestro me vlerë 12,500 lekë;
-Gjobat e Policisë me vlerë 4,540
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115 *"Gjoba. Kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7116 "*Të ardhura nga transferimet e pronës legalizimet e ndërtimeve pa leje "* janë për vlerën 9,756,740 lekë :
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7116 "*Të ardhura nga transferimet e pronës"* për*:*
-Gjoba shpërblim dëmi me vlerë 1,459,000 lekë;
- Sekuestro me vlerë 12,500 lekë;

3. Grante korente:

-Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 965,486,620 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 990,641,766 lekë ose me një rritje në vlerën 25,155,146 lekë.
Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	V. GRANTE KORENTE	**990,641,766**	**965,486,620**
720	1. Grant korent i brendshëm	**990,641,766**	**965,486,620**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	449,494,784	478,177,765
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	392,881,782	269,937,902
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	12,748,479	10,601,603
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	135,061,588	199,514,000
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	455,133	7,255,350
7209	Të tjera grante korente të brendshme		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas

<u>Analiza e shpenzimeve</u> në vitin 2025 , të cilat në total janë në vlerën 844,134,829 lekë paraqitet më poshtë:

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 223,432,091 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 258,074,794 lekë ose me një rritje në vlerën 34,642,701 lekë.

-Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 37,344,568 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 43,158,802 lekë ose me një rritje në vlerën 5,814,234 lekë.

Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	258,074,792	223,432,091
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	38,771,531	33,532,936
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	4,387,271	3,811,632

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 98,853,134 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 90,141,171 lekë ose me ulje në vlerën 8,711,963 lekë.

Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën në vijim:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	**90,141,171**	**98,853,134**
602	Mallra dhe shërbime të tjera	0	0
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,696,578	946,560
6021	Materiale dhe shërbime speciale	276,240	916,200
6022	Shërbime nga të tretë	10,186,008	10,947,115
6023	Shpenzime transporti	0	0
6024	Shpenzime udhëtimi	2,077,300	1,007,170
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	7,648,634	11,871,888
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,700,000	2,471,380
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	0	0
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	66,556,411	70,692,821

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas

Sipas akt rakordimit me thesarin shpenzimet operative (602), janë për vlerën 86,274,031 lekë ndërsa në bilanc janë raportuar për vlerën 90,141,171 lekë ose më shumë në vlerën 3,867,148 lekë, vlerë e cila vjen nga llogaria e aktiveve afatgjata materjale e pasqyruar gabim në vitet paraardhëse.

3. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë" paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 478,177,765 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 449,494,784 e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin, e cila paraqitet në vlerën 449,494,784 lekë

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE	**449,494,784**	**478,177,765**

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
604	Transferime korente të brendshme		
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	449,494,784	478,177,765
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore		

Burimi i të dhënave: Bashkia Prrenjas

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
63	Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	3,265,280	-22,108,530
	Shpenzime të tjera		

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 1,070,129,534 lekë dhe totali shpenzimeve është 844,134,829 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 225,994,705 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 225,994,705 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit për likujdimin e kontratave për investime dhe blejë mallrash e shërbimesh, rezultoi se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, referuar kontratave, ndodhej i gjithë dokumentacioni ligjor bashkëshoqërues, në përputhje me kërkesat e pikave 34 dhe 35, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, dhe pikës 2.2 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Urdhër prokurimi;
- Kontrata bazë në të cilën janë të përcaktuar vlera e kontratës, data e fillimit dhe mbarimit;
- Amendament shtesë kontrate në rastet kur është kërkuar shtesë për afat përfundimi;
- Urdhër shpenzimi për likuidimin e faturave;
- Urdhëri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim si të mallit dhe të investimeve;
- Fletë hyrjes në rastet e kontratave për blerje malli;
- Procesverbal i komisionit të marrjes në dorëzim të kontratave blerje malli;
- Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim e kontratave për investime;
- Akt-kolaudim përfundimtar në rastet e likuidimit të përfundimit të garancisë së punimeve, etj.;

Nga auditimi, rezultoi se kryerja e shpenzimeve është bërë në përputhje me Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.20218 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar.

Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik, pika 6 ku cilësohet:

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikues (faturë blerje/shitje, fletë-hyrje/dalje, mandat-arkëtim/ pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike, dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhër-shpenzimi/Urdhër-pagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabilitetisi dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme".*

Si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2013 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" cilësohet:

"Pika 35. *Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:*

a. *Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.*

b. *Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.*

c. *Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.*

Pika 36. *Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve".*

Për sa trajtuar më lart mbahet akt konstatimi me znj. S. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, dhe znj. B. K. me detyrë Përgjegjës Kontabiliteti, për periudhën objekt auditimi.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Bashkia Prrenjas janë paraqitur observacionet me nr. 920/71 prot., datë 09.09.2026 dhe të administruara në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2025 si vijon:

Pretendimi i subjektit:

1.Në lidhje me konstatimin për llogarinë 211 "Pyje kullota plantacione"

Vlera 2,770,029 lekë në regjistrin e aktiveve dorzuar nga punonjësit e e mëparshëm me emërtimin:

-Investim dru zjarri 1,294,080 lekë viti 2018

-Prodhim, transport stivim në fushën e bashkisë dru zjarri 1,475,949 lekë viti 2019.

Në lidhje me këto dy zëra në rregjistrin e aktiveve të viteve të mëparshme të dorzuara rezultunte se gabimisht këto vlera kanë kaluar në llogarinë 211 "Puje kullota plantacione" dhe jo në llogarinë 602 Shpenzime dru zjarri që ishin shpërndarë nëpër institucione me flet dalje dhe plan shpërndarje sipas viteve (2018-2019). Sistemimi i kësaj vlere është bërë në pasqyrat financiare të këtij viti pasi kjo vlerë nuk mund të rezultojë si aktiv gjendje në regjistrin e Aktiveve. 2.

2.Në lidhje me llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" diferenca në vlerën 57,966,654 lekë që rezulton në regjistrin e aktiveve është veprim i ardhur nga vitet e kaluara dhe jo i këtij viti, si vlera e aktiveve si prona të ish-Komunave të cilat me shkrirjen e tyre si rezultat i reformës teritorjale në vitin 2015nuk janë bashkëngjitur pasqyrave financiare dhe listat e pronave mëe vlerat fillestare e vlerë neto.

Për këtë me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr 134, datë 09.04.2025 nga drejtoria e Financës janë gjetur disa vlera në ditarët e bankave dhe ka mbetur vlera 42,919,940 lekë e paanalizuar me objkte.

3.Në lidhje me llogarinë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" është vlerë e cila nuk është transferuar nga punonjësit e asaj periudhe vitet 2022 dhe 2023 Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Pogradec.

4 Në lidhje me llogarinë 7110 "Tarifa administrative dhe rregullatorë vlera 1,034,024 lekë gabimisht ka kaluar nga llogaria 7109.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me sqarimet e përcjella nga Drejtori i Finacës dhe Përgjegjës i Kontabilitetit, Bashkia Prrenjas, grupi i auditimit sqaron si vijon:
- Konstatimet e grupit të auditimit përcjellë në PRA kanë të bëjnë me paraqitjen jo të drejtë të disa llogarive të pasqyrave financiare të vitit 2025 për të cilat kërkohet dokumentacion justifikues për çdo vlerë të paraqitur në këto pasqyra dhe nuk mund të merren të shkëputura nga periudhat e mëparshme, për të cilat në në sqarimet tuaja konfirmohet se konstatimet e grupit të auditimit qëndrojnë dhe nga ana juaj janë ndërmarrë hapa për saktësimin e vlerave të këtyre llogarive. Pra mbetet për tu verifikuar në vijim zbatueshmëria e rekomandimeve që do lihen për përmirsimin e gjendjes.

Pika 2.4 Auditimi i prokurimeve publike.

Për periudhën 01/01/2024 – 31/12/2025, nga Bashkia Prrenjas referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka realizuar gjithsej **44** procedura prokurimi me vlera të larta me vlerë të fondit limit 569,324 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate të lidhur prej 472,651 mijë lekë pa TVSH, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 96,673 mijë lekë pa TVSH ose 17 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Vlera në mijë lek

Procedura 01/01/2024 - 31/12/2025	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	**44**	**569,324**	**472,651**
-Të hapura	11	458,654	372,515
- E Hapur e Thjeshtuar	33	110,670	100,136
Sipas objekteve	**44**	**569,324**	**472,651**
-Objekte në fushën e investimeve	15	409,523	326,027
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	29	159,801	146,624

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej 185 OE/BOE, nga të cilat janë s'kualifikuar 64 OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE pjesëmarrës janë gjithsej 10 procedura ose 22%.
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe dokumentacionin elektronik të marrë nga sistemi SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:
Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit, etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura
Nga grupi i auditimit mbi bazën e riskut dhe të materialitetit nga **44** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit prej **569,324** mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **15** procedura me fond limit prej **486,447** mijë lekë ose **85%** e fondit të prokuruar, nga ku kanë rezultuar disa parregullsi në shkelje apo mos zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të LPP.
Nga auditimi i **15** procedurave, janë konstatuar në shkelje të LPP dhe akteve nënligjore si vijon:
a. Në **7 procedura me fond limit 339,740** kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, ku mangësitë janë më të përhapura në procedurat e llojit për punë publike.
b. Në **4 procedura me vlerë kontrate 227,568 mijë lekë**, OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK.
c. Në **1 procedurë**, nuk janë mbajtur penalitetet për vonesat në zbatimin kontratës në vlerën

1,052,760 lekë.
d. Në **1** procedurë, specifikimet teknike nuk janë të mirëargumentuara.
e. Në **2 procedura,** rezulton se Vlerësimi i ofertave është kryer përtej afatit 15 ditë.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar: Neni 2, *"Qëllimi";* Neni 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", Neni 36 *"Specifikimet teknike"*, Neni 77, *"Kërkesat për kualifikim"*, Neni 82, *"Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit",* Neni 92, *"Shqyrtimi i ofertave"*, Neni 98, *"Anulimi i një procedure prokurimi"*: VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Neni 26, "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", Neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", Neni 40 *"Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave",* Neni 41 *"Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve"*, Neni 73 "Titullari i autoritetit/entit kontraktor", Neni 74 *"Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit",* Neni 78 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"*.

Procedurat e vitit 2024 paraqiten si vijon:

1. Tenderi me objekt: "*Blerje karburanti me lote*", Loti 1, Blerje nafte me këto të dhëna:

1. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburani me lote" Loti 1 Blerje nafte**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.08, datë 12.02.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 65, date 31.01.2024 1.E. V. - Kryetar 2.M. K. - Anëtar 3.A. G. - Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 118, datë 14.02.2024 1. A. K. – (Kryetar) 2. R. D. - (Anëtar) 3. M. Z. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) Loti 1 – Nafta 6,894,857 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "G. C. G." shpk me ofertë me normë fitimi 23.5 lek/litër, me lidhje kontrate datë 25.03.2024 me afat 12 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 0 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 27.02.2024 Ora 10:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 08 datë 12.02.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **6,894,857 lekë** me objekt**: *"Blerje karburani me lote" Loti 1 – Blerje nafte.***
Me urdhër nr. 65, datë 31.01.2024, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga E. V. (Kryetar), M. K. dhe A. G. (Anëtar).
Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Përrenjas, mirëtuar me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. 06, datë 27.12.2023 "Për miratimin Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxheti 2024". Administrohen kërkesa për sasitë e nevojshme nga secila Drejtori/Sektor i Bashkisë. Kërkesat shoqërohet vetëm me vlerën dhe jo sasinë e kërkuar të karburantit, ndërkohë që kërkesat duhet drejtuar dhe detajuar për sasitë sipas nevojave reale, dhe të administrohet dhe dokumentohet sipas përcaktimit të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe të nenit 2 pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është mbajtur PV i datës 12.02.2024 nga NJP për përllogaritjen e fondit limit, ku përcaktohet se përllogaritja është bazuar në çmimet sipas Buletinit nr. 8, datë 12 Shkurt 2024 të APP mbi çmimet

e karburanteve dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe Kursin zyrtar të këmbimit valutor të Bankës së Shqipërisë i datës 12.02.2024. Në preventivin e mbajtur, rezulton se janë përcaktuar sasitë dhe çmimi i përllogaritur, ndërkohë nuk argumentohet teknikisht përllogaritja e sasive të nevojshme, bazuar në llojet e mjeteve në përdorim dhe normativat përkatëse të tyre.

Vlerësimi i Kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit i datës 15.02.2024 dhe firmosur nga NJP, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Referuar rekomandimeve të APP, janë bërë modifikimi të dokumenteve të tenderit, të cilat janë pasqyruar me shtojcën përkatëse.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me rregullat e LPP.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	G. C. G. shpk	23.5 lek/litër	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 118, datë 14.02.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K. (kryetar), R. D. dhe M. Z. (anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar, dhe shpallur fitues OE "G. C. G." shpk me ofertë me normë fitimi në vlerë absolute **23.5 lekë/Litër.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 27.02.2024, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 01.03.2024.

Me shkresën nr. 765 prot., datë 01.03.2024 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 793 prot., datë 05.03.2024. Është mbajtur PV nga KVO i datës 07.03.2024 sipas të cilit OE ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me datë 18.03.2024.

Është lidhur kontrata me nr. 937 prot., datë 25.03.2024 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

A.Nga verifikimi i dokumentacionit, OE plotëson kriteret e vendosura.

2. Tenderi me objekt: "*Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Përrenjas"* me këto të dhëna:

2. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Përrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.07, datë 12.02.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 07, date 12.02.2024 1.A. K. - Person Përgjegjës 2.Xh. Xh. - Anëtar 3.S. H. - Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 132, datë 20.02.2024 1. L. L. – (Kryetar) 2. M. Z. - (Anëtar) 3. R. D. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 6,664,000 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "K." shpk me ofertë në vlerën 6,009,500 lekë, me lidhje kontrate datë 11.04.2024, me afat deri 31.12.2024.	7.Diferenca me fondin limit: 654,500 - lekë pa tvsh

8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 04.03.2024 Ora 10:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N.B. me nr. 07 datë 12.02.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **6,664,000 lekë** me objekt**: *"Blerje dru zjarri për shkollat, kopshtet, çerdhet dhe institucionet në varësi të Bashkisë Përrenjas".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. K. (Pers.Përgjegjës), Xh. Xh. dhe S. H. (Specialist – Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Përrenjas, mirëtuar me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. 06, datë 27.12.2023 "Për miratimin Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxheti 2024", konfirmuar me shkresën me nr.69/1 Prot, datë 12.01.2024 "Konfirmim i aktit" e Prefektit të Qarkut Elbasan, prot me tonën nr.63/2 datë 12.01.2024. Administrohet kërkesa nga Drejtoria e Arsimit, Sportit dhe Kulturës e datës 05.02.2024 drejtuar Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Prrenjas, për marrjen e masave për blerje dru zjarri për institucionet arsimore. Është hartuar një plan shpërndarjeje, ku përcaktohen sasitë e nevojshme për Bashkinë Prrenjas dhe Njësitë Administrative, ku në total planifikohen 1190 mst. Me urdhër nr. 97, datë 07.02.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e vlerës së fondit limit i përbërë nga Xh. Xh., S. H. dhe A. R. Komisioni ka administruar 3 oferta duke përllogaritur mesataren e tyre për caktimin e fondit limit.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procerverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Janë bërë modifikime të disa kritereve bazuar në asistencën e APP.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me objektin e kontratës.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A. shpk	5,996,410	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik "A." shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin me nr. 5 të dokumenteve standarde te tenderit nga ku rezultoi se: - Nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik të tre mjetet e transportit të paraqitura rezultojnë të jenë kamionë (referuar përllogaritjes për kapacitetin mbajtës sipas lejeve të qarkullimit për secilin mjet të paraqitur) dhe si rrjedhojë operatori nuk ka paraqitur mjet transporti "*kamionçinë me vinç ", sipas kriterit nr.5 tek Kriteret e Veçanta të DST.* Referuar ligjit Nr. 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës se Shqipërisë" i ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore, Ligjit Nr. 8308, datë 18.03 1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar dhe të gjithë akteve të tjera nënligjore VKM, Udhëzime, etj., ndarja e automjeteve të transportit të mallrave është:

			- *ATP-Automjete te transportit te Posaçëm (Kamionçinë) me mase maksimale te autorizuar deri ne 3.5. ton* . Pra, asnjë nga mjetet të paraqitura nga operatorit ekonomik, nuk plotëson kërkesën e AK për mjetin e kërkuar *kamionçinë me vinç*. 2-Për mjetin me targa .... P OE "A." shpk ka paraqitur Certifikatën për transport mallrash brenda vendit me nr.16747 datë 05.05.2022 ,e cila rezulton se i mungon firma dhe vula. Referuar dokumenteve standarde të tenderit (dst) : Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. 3 - Operatori ekonomik "A.", shpk nuk ka arritur të paraqesë konfirmimin nga Agjencia e Prokurimit Publik që nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.
2	K. shpk	6,009,500	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 132, datë 20.02.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga L. L. (kryetar), M. Z. dhe R. D. (anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 2 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "K." shpk me ofertë me në vlerën **6,009,500 lekë** me diferencë nga fondi limit **654,500 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 04.03.2024, vlerësimi i të cilës është bërë me PV e datës 06.03.2024.

Është njoftuar i rendituri në vend të parë, OE "A." shpk për dorëzimin e dokumentacionit me shkresën nr. 809 prot., datë 06.03.2024. Me PV e datës 11.03.2024 për kontrollin e dokumentacionit të këtij OE, janë konkluduar mangësi të evidentuar në tabelën e mësipërme dhe është skualifikuar ky OE. Pas rivlerësimit është njoftuar i rendituri në vend të dytë, OE "K." shpk me shkresën nr. 855 prot.,d atë 11.03.2024, i cili ka paraqitur dokumentacionin e administruar me nr. 884 prot., datë 13.03.2024. Është mbajtur PV nga KVO me datë 20.032024 sipas të cilit dokumentacioni është i plotë dhe i rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën e datës 03.04.2024.

Është lidhur kontrata me nr. 1127 prot., datë 11.04.2024 me afat nga nënshkrimi i saj deri më 31.12.2024.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se përmbush kriteret e vendosura.

B. Me urdhër nr. 200, datë 11.04.202 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga A. K., A. K. dhe K. L.

Është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit me PV e datës 26.12.2024. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me FH nr. 70, datë 26.12.2024. Është lëshuar fatura tatimore me nr. 205/2024, datë 26.12.2024, likuiduar me USH nr. 591, datë 30.12.2024.

3. Tenderi me objekt: "*Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik)*" me këto të dhëna:

3. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.21, datë 22.04.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 21, date 22.04.2024 1.O. A. – Spec.Fushe	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 210, datë 22.04.2024 1. Z. Ç. – (Kryetar)

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"	2.A. K. - Person Përgjegjës 3.R. D. - Anëtar	2. M. R. - (Anëtar) 3. M. Z. – (Anëtar)
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 8,754,458 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "T." shpk me ofertë në vlerën 8,490,000 lekë, me lidhje kontrate datë 04.09.2023, me afat 60 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 264,458 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.05.2024 Ora 10:30	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë + Grand i Ambasadës Japonese në Shqipëri	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 21 datë 22.04.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **8,754,458 lekë** me objekt**: *"Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik".***
Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. K. (Pers.Përgjegjës), O. A. dhe R. D. (Specialist – Anëtar).
Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë, miratuar me VKB nr. 34, datë 28.02.2024 "Për një ndryshim të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxheti vitit 2024" dhe Grantit të dhuruar nga Ambasade e Japonisë në Republikën e Shqipërisë, mirëtuar me VKB nr. 36, datë 28.02.2024 "Për miratimin e kontratës së grantit ndërmjet Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë dhe Bashkisë Prrenjas për projektin e sigurimit të kamionit të plehrave për Bashkinë Prrenjas". Administrohet kërkesa e datës 28.03.2024 drejtuar Titullarit nga Drejtoria e Shërbimeve Utilitare dhe Infrastrukturës Rrugore si dhe Drejtoria për Koordinimin e Integrimit Evropian, Ndihmës së Huaj dhe Monitorimit të Performancës për zhvillimin e procedurës. Me urdhër nr. 185, datë 28.03.2024 të Titullarit, është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike. Komisioni ka administruar 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, mesatare e të cilave ka nxjerrë FL.

Vlerësimi i specifikimeve teknike

- Është hartuar procerverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit i datës 24.04.2024 dhe firmosur nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me specifikimet teknike të vendosura, rezultuan disa prej tyre jo në përputhje me rregullat e LPP.

-Gjatësia maksimale e mjetit, kërkohet 6223 mm. Nuk ka asnjë argumentim teknik për përcaktimin e kësaj gjatësia në këto vlera;

-Koha e kompresimit kërkohet të jetë fiks 35 sekonda. Duhej përcaktuar kohë me kufij me të arsyeshëm ose me vlera nën ose mbi 35 sekonda, dhe jo fiks koha 35 sekonda.

Specifikimet teknike rezultojnë të paargumentuara, ndërkohë që disa prej tyre të evidentuara më sipër nuk janë në përputhje me pikën 2 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, i cili përcakton se *2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

Për mangësitë në hartimin e specifikimeve teknike, ngarkohen me përgjegjësi komisioni i përbërë nga ***O. A., D. T. dhe B. O..***

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	C. T. shpk	6,900,000	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga operatori ekonomik "C.T." shpk u konstatua se operatori ekonomik "C.T." shpk nuk ka arritur të paraqes dokumentacionin e plot dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e kritereve te përgjithshme dhe te veçanta dhe për kualifikim, me konkretisht : 1 .Nuk ka paraqitur Vërtetimin se Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. *Në kundërshtim me Nenin 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", **"b",** "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[20] , si dhe ne kundërshtim me Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.* 2. Operatori ekonomik nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; (konkretisht për muajt Shkurt dhe Mars) . Operatori ekonomik ka dorëzuar vërtetim me nr. T.10143318 date 13.03.2024 për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, ku vërtetohet se ka paguar kontributeve të sigurimeve shoqërore **vetëm për muajin Janar 2024 .** Operatori ekonomik **nuk ka paguar të gjitha detyrimet** për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; ***(konkretisht nuk ka paguar për muajt Shkurt dhe Mars)***, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 11, të Ligjit Nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar*, si dhe ne kundërshtim të Nenit 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", **"dh",** "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të

			këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[21], *si dhe ne kundershtim me Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit.* 3.Operatori ekonomik "C.T." shpk, nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 07.05.2024, detyrimet e energjisë elektrike për **muajin mars 2024** janë te maturuara në kuptim të përcaktimeve ligjore, afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 30.04.2024. Nëse i referohemi vërtetimit te OSHEE – 2024-7735974-YD date 12.04.2024 rezulton se muaji MARS 2024 është i pa likuiduar. Sipas këtij vërtetimi debie rezulton se operatori ekonomik C.....T.. rezulton te ketë ne total 0 (zero) leke detyrime për faturat e energjisë elektrike deri ne datën 12.04.2024, **pa përfshire faturën koherente te muajit MARS 2024.** Data e zhvillimit te procedurës se prokurimit është 07.05.2024 dhe ne ketë mënyrë sipas përcaktimit ligjor shlyerja e detyrimeve te energjisë elektrike për muajin MARS e cila mund te behej deri ne datën 30.04.2024 (detyrime këto te muajit MARS te cilat janë te maturuara) nuk është realizuar. Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (07.05.2024), KVO gjykon se, nuk ka plotësuar kriterin lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi. 4.Në pikën 2/a të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit është kërkuar: 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se ky dokument nuk është paraqitur fizikisht por vetëm ne SPE, në kundërshtim me Nenin 26 pika 6 të V.K.M nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "**e",** "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[22].
2	T.-R shpk	8,630,000	*Kualifikuar*
3	T. shpk	8,490,000	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 210, datë 22.04.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga Z. Ç. (kryetar), M. R. dhe M. Z. (anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 3 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe shpallur fitues OE "T." shpk me ofertë me në vlerën **8,490,000 lekë** me diferencë nga fondi limit **264,458 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 07.05.2024, vlerësimi i të cilës është pasqyruar me PV e datës 14.05.2024.
I rendituri në vend të parë, "C.T." shpk, është njoftuar për dorëzimin e dokumentacionit me shkresën nr. 1421 prot., datë 14.05.2024, i cili ka paraqitur dokumentacionin e administruar me shkresën nr. 1445 prot., datë 16.05.2024. Është mbajtur PV për kontrollin e dokumentacionit me nr. 1445/1 prot., datë 20.05.2024 ku janë evidentuar mangësi në dokumentacion, pasqyruar në tabelën e mësipërme.
Është mbajtur procesverbali për rivlerësimin e ofertave me datë 20.05.2024, dhe është njoftuar i renditurit në vend të dytë "T." shpk për dorëzimin e dokumentacionit me shkresën nr. 1421/1 prot., datë 20.05.2024, i cili ka paraqitur dokumentacionin e administruar me shkresën nr. 1484 prot., datë 22.05.2024. Është mbajtur PV me nr. 1505 prot., datë 24.05.2024, sipas të cilit dokumentacioni i dorëzuar është i plotë dhe i rregullt.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën datës 04.06.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 1943 prot., datë 16.07.2024 me afat lëvrimi 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se përmbush kriteret e vendosura.

B.Me urdhër nr. 343, datë 16.07.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga A. G., D. T. dhe G. P.. Është bërë amendament kontrate me nr. 1943/3 prot., datë 12.09.2024, ku bëhet shtyrja e afatit nga data 13.09.2024 deri më datë 20.09.2024 pra me 7 ditë, me argumentin e vonesave dhe rradhëve të gjata të mjeteve të tonazhit të rëndë për kalimin nga Greqia në Maqedoni.
Komisioni ka mbajtur PV e datës 20.09.2024 sipas të cilit mjeti i paraqitur nuk është i pajisur me dokumentacionin e kërkuar si Leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik dhe policën e sigurimit, në emër të Bashkisë Prrenjas, kjo si pjesë detyruese e dokumenteve të tenderit. Rezulton se është mbajtur një PV tjetër me datë 21.10.2024 për marrjen në dorëzim të mjetit, ku evidentohet se mjeti është sipas specifikimeve teknike dhe me dokumentacionin e nevojshëm. Është lëshuar fatura tatimore me nr. 95/2024, datë 21.10.2024, likuiduar me USH nr. 494, datë 25.10.2024. Mjeti është bërë hyrje në magazinë me FH nr. 63, datë 21.10.2024.
Lidhur me marrjen në dorëzim të mjetit, rezulton se dorëzimi i tij me dokumentacionin përkatës është realizuar përtej afatit të përcaktuar në kontratë, i cili kishte si afat pëfundimtar datën 20.09.2024, ndërkohë që mjeti është dorëzuar me datë 21.10.2024, pra me 31 ditë vonesë. Referuar nenit 17 "Dëmet e likujduara", pika 17.1 germa (a), përcaktohet se *Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur nga çmimi i përgjithshëm i kontratës...*
Vlera 8,490,000*4/1000 = 33,960 lekë penalitet për çdo ditë vonesë.
33,960 lekë * 31 ditë vonesë = 1,052,760 lekë është penaliteti i cili duhej mbajtur për OE "T." shpk, për zbatimin e kontratës përtej afatit të përcaktuar, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.
Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit për marrjen në dorëzim të mallit, A. G., D. T. dhe G. P..

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga punonjëset e Bashkisë Prrenjas M. R. dhe A. K, janë paraqitur observacioni me nr. 920/70 prot., datë 09.09.2026, administruar në KLSH me nr. 380/70 prot., datë 10.09.2026 si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Nga auditimi është konstatuar se lidhur me marrjen në dorëzim të mjetit, rezulton se dorëzimi i tij me dokumentacionin përkatës është realizuar përtej afatit të përcaktuar në kontratë.

Bashkëngjitur ju dërgojmë dokumentacionin e shtyrjes së afatit të kontratës dhe observacionin e subjektit "T." shpk dhe kërkojmë rishikimin dhe mos përfshirjen në raportin përfundimtar me përgjegjësi të anëtarëve në lidhje me procedurën e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me komentet e paraqitura, grupi i auditimit sqaron se dokumentacioni i paraqitur prej jush ka qenë i evidentuar në material, ndërkohë që pretendimet e subjektit "T." shpk, nuk janë objekt shqyrtimi nga grupi i audituesve. Lidhur me përgjegjësitë për zbatimin e kontratës, referuar pikës 6 të nenit 107 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, *Komisioni i ngritur nga Titullari i AK, sipas legjislacionit të fushës në fuqi është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikmëri të ecurisë së zbatimit të kontratës...*

4. Tenderi me objekt: "*Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sektorin e gjelbërimit, blerje kripe, blerje materiale për riparime"* me këto të dhëna:

4. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sektorin e gjelbërimit, blerje kripe, blerje materiale për riparime"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.36, datë 13.06.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 36, date 13.06.2024 1.A. K - Person Përgjegjës 2.A. G. - Anëtar 3.M. K. - Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 293, datë 13.06.2024 1. Z. Ç. – (Kryetar) 2. M. R. - (Anëtar) 3. R. D.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 5,832,520 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "A. 2." shpk me ofertë në vlerën 5,774,390 lekë, me lidhje kontrate datë 09.08.2024, me afat 30 ditë.	7.Diferenca me fondin limit: 58,130 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 28.06.2024 Ora 10:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 36 datë 13.06.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **5,832,520 lekë** me objekt**: *"Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sektorin e gjelbërimit, blerje kripe, blerje materiale për riparime".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. K (Pers.Përgjegjës), A. G. dhe M. K. (Specialist – Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë, miratuar me VKM nr. 6, datë 27.12.2023 "Për miratimin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti i vitit 2024". Është administruar kërkesa e datës 24.05.2024 Drejtoria e Shërbimeve Utilitare dhe Infratrukturës Rrugore dhe Sektorët përkatës për çeljen e procedurës për blerjen e materialeve sipas objektit të

procedurës. Bashkëlidhur gjendet edhe lista e materialeve të nevojshme dhe sasitë përkatëse. Me urdhër nr. 265, datë 24.05.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga E. V., A. G. dhe M. K.. Është mbajtur procesverbali i datës 10.06.2024 sipas të cilit për përllogaritjen e FL janë bazuar çmimeve referuar faqes e-Albania(SIM) për disa zëra të çmimeve për njësi dhe ojesa tjetër sipas testimit të tregut, të cilat administrohen bashkëlidhur këtij procesverbali.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procerverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga NJHDT, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan në përputhje me rregullat e LPP.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	E. L. p.f	5,748,000	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim që subjekti nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; 2.Nuk ka paraqitur një vërtetim që vërteton se operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [23]të kontributeve të sigurimeve shoqërore
2	A. shpk	5,774,390	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 293, datë 13.06.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga Z. Ç. (kryetar), M. R. dhe R. D.(anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "A." shpk me ofertë në vlerën **5,774,390 lekë** me diferencë nga fondi limit **58,130 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 28.06.2024, vlerësimi i të cilës është pasqyruar me PV datë 02.07.2024.

I rendituri në vend të parë, E. L. p.f, është njoftuar për paraqitjen e dokumentacionit me shkresën nr. 1854 prot., datë 02.07.2024. Pas dorëzimit të dokumentacionit, është mbajtur PV i vlerësimit ku evidentohet se ky OE ka mangësi të evidentuara në tabelën e mësipërme, duke u skualifikuar. Në vijim është bërë kërkesa drejtuar OE "A." shpk me nr. 1854/2 prot., datë 10.07.2024 për dorëzim dokumentacioni, i cili është administruar pranë AK me nr. 18544/3 prot., datë 12.07.2024. Është mbajtur nga KVO, PV i datës 18.07.2024 për vlerësimin e dokumentacionit, sipas të cilit rezulton i plotë dhe i rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me shkresën e datës 26.07.2024.

Është lidhur kontrata me nr. 2116 prot., datë 09.08.2024 me afat 30 ditë nga nënshkrimi i saj.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se përmbush kriteret e vendosura.

B.Me urdhër nr. 372, datë 09.08.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallit i përbërë nga P. Ç., B. O. dhe V. A..

Mallrat janë marrë në dorëzim me PV nr. 2128/1 prot., datë 01.10.2024. Është lëshuar fatura tatimore me nr. 85/2024, datë 01.10.2024, likuiduar me USH nr. 480, datë 18.10.2024. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me FH. Nr. 51 – 58, datë 01.10.2024.

5. Tenderi me objekt: "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë"* me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili"3kat, Rrajcë Fushë"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr.40, datë 26.07.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 40, date 26.07.2024
1.Z. Ç. - Person Përgjegjës
2.M. P. - Anëtar
3.E. B. – Anëtar
4.R. D.– anëtar
5.N. B.- anëtar</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 358, datë 29.07.2024
1. M. R. – (Kryetar)
2. A. K. - (Anëtar)
3. M. H.– (Anëtar)
I ndryshuar me urdhër nr. 381, datë 21.08.2024 ku zëvendësohet M. H. me O. A.</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa Tvsh)
142,631,465 - lekë pa tvsh</td><td>6.Oferta fituese:
OE "E." shpk me ofertë në vlerën 128,614,852 lekë, me lidhje kontrate datë 11.10.2024, me afat 12 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
14,016,613 - lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 22.08.2024
Ora 09:00</td><td>9.Burimi Financimit:
-Ministria e Arsimit 85%
-Buxheti i Bashkisë Prrenjas 15%</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 10 OE
b) Skualifikuar 7 OE,
c) Kualifikuar 3 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të AK, PA z. A. K.me nr. 40 datë 06.07.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **142,631,465 lekë** me objekt**: *"Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili"3kat, Rrajcë Fushë".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P., E. B., R. D.dhe N. B. (Anëtar).

Burimi i financimit është nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në masën 85%, përcjellë me shkresën nr. 1815/3 prot., datë 11.03.2024 *"Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pran Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin"* dhe nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas në masën 15%, miratuar me VKB nr. 49, datë 27.03.2024 "Për miratimin e kryerjes me prioritet të investimit për objektin "Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili", 3 Kat, Rrajcë Fushë". Vlera totale e investimit është 168,374,778 lekë me TVSH, nga të cilat buxhetimi për vitin 2024 është 44,000,000 nga MAS dhe 6,600,000 nga buxheti bashkisë dhe për vitin 2025 do jetë 99,118,561 lekë nga MAS dhe 18,656,217 lekë nga buxheti bashkisë.

Preventivi punimeve është hartuar në bazë të një kontrate dhurimi, adminsitruar me nr. 347 prot., datë 29.01.2024 ndërmjet Bashkisë Prrenjas dhe studios E.-G me licencë Nr. N.5...../17.

Me urdhër nr. 285, datë 10.06.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e vlerës së fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga M. P., N. B.dhe, të cilët kanë mbajtur procesverbalin me nr. 1674/1 prot., datë 27.06.2024 sipas të cilit përllogaritja e fondit limit është kryer për secilin zë duke ju referuar faqes web e-Albania (SIM) si dhe analizat e çmimeve të hartuara nga studio projektuese.

Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar Bashkisë Prrenjas me shkresën nr. 559/2 prot., datë 13.05.2024
Është miratuar Leja e Ndërtimi me nr. 31, datë 04.10.2024.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit i datës 30.07.2024 dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Janë bërë modifikime të disa kritereve bazuar në asistencën e APP.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.

1.Kërkesa e pikës **2** e cila kërkon ndër të tjera kategorinë e licencës NP-12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Nuk ka asnjë zë në preventiv i cili mund të konsiderohet ri riaftësim mjedisor i specializuar, projekte botanike/zoologjike etj, por janë zëra rutinë ndërtimi të pranishëm në çdo ndërtim.

2.Kërkesa e pikës **4** e cila kërkon ndër të tjera 1 Arkitekt dhe 1 inxhinier mjedisi, janë jo në përputhje me objektin e prokurimit. Proceset qe lidhet me arkitektin janë realizuar në fazën e projektimit, ndërkohë që këtu jemi në zbatim të kontratës, dhe zbatimi i saj kryhet nga inxhinieri. Lidhur me kërkesën për 1 inxhinier mjedisi, nuk ka zëra punimesh që përkojnë me kërkesën për këtë lloj inxhinierie.

3.Kërkesa e pikës **6.1** e cila kërkon nga OE që për stafin e nevojshëm të kërkuar sipas pikës **6** për zbatimin e kontratës, të paraqesë ndër të tjera edhe dëshmitë e sigurimit teknik nga institucionet e autorizuara/ ish IQT, është kërkesë jo në përputhje me kërkesat e ligjit me nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike" i ndryshuar. Pjesa më e madhe e stafit të kërkuar, nuk lidhet me punime të cilat kanë për objekt garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike.

4.Kërkesa e pikës **7** e cila kërkon nga OE të paraqesë kontratë noteriale furnizimi me prodhuesin ose distributorin për produktet, *Hekur, pajisje elektrike, pajisje hidraulike, pajisje sistemi i ngrohjes, dyre dhe dritare, pajisje hidroizolimi, bojra hidroplastike importi, cilësia e parë,* është kërkesë e paargumentuar teknikisht. Të gjitha produktet e mësipërme janë produkte të cilat gjendet lehtësisht në treg, dhe disponimi i një kontrate furnizimi nuk është asnjë garanci shtesë, por më shumë kosto administrative. Ndërsa për produktin bojra hidroplastike, cilëisa e parë, përcaktimi cilësia e parë është evaziv, pasi nuk përcaktohet se mbi çfarë standardi konstatohet cilësia e parë e produktit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P., E. B., R. D.dhe N. B. (Anëtar)

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	2. shpk	101,216,880	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Ne formularin e ofertës/Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit te paraqitur nga OE "2." shpk, rezulton se të preventivi, në paragrafin 19 (Instalimet elektrike) mungojnë zërat me nr.21,22,23,24,25,26,27,28,29,30,31.

			Ne preventivin e paraqitur, në paragrafin 19 (Instalimet elektrike) mungojnë zërat si me poshtë: nr.21-2.481/5 F.V përcjellës PV -500ø10mm² nr.22-2.481/4 Përcjellës CU-1X6 mm² nr.23-2.481/3 Përcjellës CU-1X4 mm² nr.24-2.481/2 Përcjellës CU-1X2.5 mm² nr.25-2.481/1 Përcjellës CU-1X1.5mm² nr.26-2.546 Panel metalik IP65(700x550x250mm) nr.27-2.561Llampe sinjalizimi 220V;1.2Ë nr.28-An Fiber optike nr.29-4.131/3.9F.V ne toke kabllo AL fuqie 1000V me izolim gome e mbulese plasmasi te armuar 3x50+25 mm² nr.30-3.182 F.V elektroda tokëzimi te xinguara profil ;l=150m nr.31-2.503 Përcjellës shirit zinku tokezimi, Zn=30x3mm
2	I. shpk	97,379,743	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Vlera e ofertuar e operatorit ekonomik "I.." sh.p.k është më e vogël se 85% i mesatares së ofertave të vlefshme si rrjedhojë oferta është anomalisht e ulët.
3	R. shpk	104,835,373	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik nuk ka vendosur çmimin dhe vlerën për zërin: 23 SISTEMI I NGROHJES 34 F.V. Filtër DN 20, Ø 3/4 " cope 1.
4	B.-S shpk	112,376,914	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* OE **B. - S** sh.p.k nuk ka të deklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) punonjësit si më poshtë: 1(një) punonjës Teknik ndërtimi 1(një) punonjës hidraulik 2 (dy) punonjës betonues 2 (dy) punonjës pllakashtrues 2 (dy) punonjës për punime në lartesi 1(nje) punonjës manovrator / automakinist 1 (një) punonjës buldozerist 2. OE "B. – S" sh.p.k nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 7 Kapaciteti Teknik të dst, Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se OE "B.– S" sh.p.k nuk ka paraqitur autorizimet per pajisjet: *a.Hekur* *b.Pajisje elektrike* *c.Paisje hidraulike* *d.Pajisje sistemi i ngrohjes* *e.Dyer dhe dritare* *f.Pajisje hidroizolimi* *i. Bojra hidroplastike importi ,cilesia e pare* 3. OE "B.. – ..S" sh.p.k nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 9 të Kapacitetit Teknik të dst ku eshte kerkuar :***9.** *Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për transportim dhe riciklim i mbetjeve jo të rrezikshme" ose të këtë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licencuara. Mbështetur në: Ligjin Nr. 9010, date 13.02.2003 "Për administrimin*

			mjedisor te mbetjeve te ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin ne fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin. Kreu II N.9 N. 12...24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit ku minimalisht te përfshihen kodet 17 05 04 dhe 17 09 04. -Nga shqyrtimi i licences se paraqitur nga OE "B.. – ..S" sh.p.k rezultoi se Licenca e paraqitur nuk e përfshin kodin *17 09 04.* 4. OE BE - IS SH.P.K nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 10 të Kapacitetit Teknik të dst ku eshte kerkuar :10.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8), Nga shqyrtimi i formularit të vetedeklarimit të paraqitur nga OE "B..-..S" sh.p.k, rezultoi se nuk janë deklaruar mjetet dhe pajisjet si më poshtë: 1 Kamion me kapacitet mbajtës jo me pak se 3.5 ton e jo më shumë së 12 ton 1 Kamionçine me kapacitet mbajtës deri 1.5 ton 1 Pajisje goditesi (çekiç) për ekskavator për prishje ndërtimesh 2 Krik ngritës me kosh 1 Autobetoniere 5. OE "B.. – ..S" sh.p.k nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 12 Kapaciteti Teknik të dst ku është kërkuar:***12.*** *Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 –1:2019, SSH EN 12390-8:2019.* Konkretisht OE B.. -..S SH.P.K nuk ka paraqitur kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit.
5	Sh. shpk	122,891,781	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në preventiv zërin: PAISJET E SISTEMIT TE NGROHJES KUNDRA ZJARRIT. 5. F.V Pompa e furnizimit me ujë te hidranteve, Karakteristikat Teknike jo me te < se: - Prurja: 15 m³ / h- Prevalenca: 45 mkH2O- Lidhjet: Ø 2" / PN16 Në DST Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, Shtojca 2 "LISTA E CMIMEVE SIPAS ZERAVE TE PREVENTIVIT" përcaktohet: *Të gjithë zërat në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.*
6	B. shpk	132,552,515	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim të pikës 2.3 për punë të ngjashme. Për sa më sipër rezulton se

			operatori ekonomik ka paraqitur si punim të ngjashëm kontratën me objekt: "Rikonstruksion i palestrave dhe terreneve Sportive, Shkolla e Mesme e Bashkuar "Luigj Gurakuqi", Elbasan". Nga verifikimi rezulton se vlera e objektit (37,000,000 leke pa tvsh) nuk plotëson masën 45% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontratës. 2. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE B. nuk ka te deklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit 1 (një) Arkitekt. 3.-Nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar sipas pikës 6 Kapaciteti Teknik: Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE B. nuk ka te deklaruar ne formularin përmbledhës te vetedeklarimit: • 1 (nje) Teknik ndërtimi • 1 (një) Teknik topograf • 1 (nje) punonjës hidraulik • 1(nje) punonjës elektricist • 2 (dy) punonjës murature/suvatues • 2 (dy) punonjës betonues • 1(nje) punonjës specialist sisteme ngrohje/ftohje • 2 (dy) punonjës për punime gipsi • 2 (dy) punonjës për punime në lartesi • 1(nje) punonjës manovrator / automakinist • 1 (nje) punonjës manovrator/ ekskavatoriste • 11 (njembedhjete) punonjës të thjeshtë ndërtimi 4. -Nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar sipas pikës 7 Kapaciteti Teknik ku është kërkuar: ***7.*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin ose distributorin për* *a.Hekur* *b.Pajisje elektrike* *c.Paisje hidraulike* *d.Pajisje sistemi i ngrohjes* *e.Dyer dhe dritare* *f.Pajisje hidroizolimi* *i. Bojra hidroplastike importi ,cilesia e pare* *Në rast paraqitje kontrate me distributorin duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, në te cilen te theksohet prodhuesi/distributori autorizon operatorin ekonomik të ofertojë në këtë procedurë për produktet qe prodhon apo distribuon.* Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE B. nuk ka paraqitur asnjë prej autorizimeve të mësipërme. 5.OE nuk përmbush kriterin e pikës 10 për mjetet dhe makineritë, pasi nuk ka deklaruar mjetet kamion me kapacitet mbajtës jo më pak se 3.5 T dhe jo më shumë se 12 T, pajisje goditësi për ekskavator për prishje ndërtimesh, rru goma hekur jo më pak se 18 T, Autovinç me kapacitet mbajtës deri 2.5 T, Krik ngritës me kosh, vinç kullë, autobetoniere, autopomë betoni, autobot uji, pajisje për prerjen, kthimin, përpunimin e hekurit, pompë suvatimi,

			armatura beton forma, kontejner, total station, impiant prodhim betoni me QKL. 6.OE nuk përmbush kriterin e pikës 12. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE B. nuk ka paraqitur kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit.
7	N. shpk & E. K. shpk	101,942,354	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE N... shpk nuk ka paraqitur licencën nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B "Për transportim dhe riciklim i mbetjeve jo të rrezikshme "referuar nenit 88 te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet shprehimisht se "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;* Referuar marrëveshjes së ndarjes së punimeve rezulton se zërat e punimeve si më poshtë do të realizohen në masën 50% nga OE N. shpk dhe 50% E. K. shpk -Prishje e objektit me makineri (shkolla) -Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km
8	M. shpk & L. K. shpk	134,227,781	*Kualifikuar*
9	A.-2. Co shpk	135,365,818	*Kualifikuar*
10	E. shpk	128,614,852	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK, PA z. A. K.me nr. 358, datë 29.07.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga M. R. (kryetar), A. K. dhe M. H.(anëtar), ndryshuar me urdhër nr. 381, datë 21.08.2024 ku zëvendësohet M. H.me O. A.. Në këtë tender ka marrë pjesë 10 OE, janë kualifikuar 3 OE, dhe shpallur fitues OE "E." shpk me ofertë në vlerën **128,614,852 lekë** me diferencë nga fondi limit **14,016,613 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 22.08.2024, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 04.09.2024 pasqyruar me PV përkatës.

Me shkresën nr. 2013/4 prot., datë 04.09.2024 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 2313 prot., datë 09.09.2024.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 24.09.2024.

Është lidhur kontrata me nr. 2598 prot., datë 11.10.2024 me afat 12 muaj.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se përmbush të gjitha kriteret e vendosura.

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **7** për kontratat e kërkuara për disa nga materialet e nevojshme për zbatimin e kontratës.

-Për pajisjet elektrike, është paraqitur marrëdhënia me subjektin "I. G." si distributor, por mungon autorizimi i prodhuesit;

2.Për pajisje hidraulike dhe sistemin e ngrohjes, është paraqitur një autorizim i lëshuar nga subjekti "A. G." i cili rezulton në gjuhë të huaj i pa përkthyer.

3.Për dyer e dritare, është paraqitur një kontratë furnizimi me subjektin "R. B." p.f, ndërkohë është paraqitur një autorizim nga subjektin "P." që autorizon subjektin "R. A.". Ky autorizim është në gjuhë të huaj i pa përkthyer.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës **10** për disa nga mjetet dhe makineritë e nevojshme.
-Konkretisht për mjetin kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton, është deklaruar mjeti me targa AA...SA, i cili rezulton me kapacitet 2.35 Ton, pra më shumë se 1 Ton poshtë kapacitetit të kërkuar.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: M. R. (kryetar), A. K. dhe M. H.(anëtar).

6. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas"* me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas ë"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr.43, datë 31.07.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 43, date 31.07.2024
1.Z. Ç. - Person Përgjegjës
2.M. P. - Anëtar
3.E. B.– Anëtar
4.R. D.– Anëtar
5.N. B.– Anëtar
Ndryshuar me urdhër nr. 382, datë 21.08.2024 ku largohen nga njësia E. B. dhe N. B..</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 367, datë 08.08.2024
1. M. R. – (Kryetar)
2. A. K. - (Anëtar)
3. M. H.– (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa Tvsh)
17,507,535 - lekë pa tvsh</td><td>6.Oferta fituese:
OE "A. I.." shpk me ofertë në vlerën 12,088,314 lekë, me lidhje kontrate datë 24.10.2024, me afat 3 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
5,419,221 - lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
Data e zhvillimit: 17.09.2024
Ora 09:00</td><td>9.Burimi Financimit:
-Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 12 OE
b) Skualifikuar 3 OE,
c) Kualifikuar 9 OE</td></tr>
<tr><td>11.Ankimime AK,
Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,
Nuk ka</td><td>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</td></tr>
</table>

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 43 datë 31.07.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **17,507,535 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas".***
Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P., E. B., R. D.dhe N. B.(Anëtar), ndryshuar me urdhër nr. 382, datë 21.08.2024 ku largohen anëtarët E. B.dhe N. B..
Burimi i financimit është nga Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 307, datë 22.04.2024 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2024 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".
Vlera e financimit është 21,009,043 lekë me TVSH.
Me urdhër nr. 313, datë 27.06.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga M. P., N. B.dhe G. B., të cilët me procesverbalin e datës 17.07.2024 kanë evidentuar se përllogaritja është kryer duke ju referuar e-Albania (SIM),

mbështetur në projekt zbatimin dhe preventivin nga subjekti "V. E." shpk me licencë N.7...., projekt i dhuruar dhe administruar me nr. 3511 prot., datë 22.12.2023.
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shkresën nr. 819/2 prot., datë 14.08.2024, administruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 1573/1 prot., datë 19.08.2024.
Është miratuar Leja e Infrastrukturës me nr. 32, datë 18.10.2024.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për argumentimin e kritereve kualifikuese nga NJHDT i datës 27.08.2024, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.
1.Kërkesa e pikës **3** e cila kërkon nga OE të deklarojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, është kërkesë në kundërshtim me pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 5, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", i cili përcakton se *Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt.*
Vlera e këtij investimi është më e vogël se vlera e kërkuar për drejtuesin teknik me kohë të plotë në kantier.
2.Kërkesa e pikës **7** e cila kërkon nga OE staf teknik të nevojshëm 1 teknik ndërtimi, 1 manovrator, 2 shofer dhe 25 punonjës ndërtimi, është evazive pjesa e kërkuar për 25 punonjës ndërtimi duke mos specifikuar specializimin e nevojshëm nëse konsiderohen staf i kualifikuar, në të kundërt nëse konsiderohen thjesht si fuqi punëtore, nuk është e nevojshme përcaktimi i këtij numri. Gjithashtu, kërkesa ku ndër të tjera kërkohen për tu paraqitur dëshmitë e sigurimit teknik të lëshuara nga ISHTI ose subjekte juridike private të akredituara, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me legjislacionin me të cilin lëshohen këto dëshmi, konkretisht ligjit me nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike" i ndryshuar. Gjithë stafi i kërkuar, nuk lidhet me punime të cilat kanë për objekt garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P., E. B., R. D.dhe N. B.(Anëtar).

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	R. C. shpk	14,357,574	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në rrugë elektronike rezulton se OE R. C. shpk, është subjekt mbështetës (për 2 mjete) për OE A. shpk, njëkohësisht edhe ofertues në të njëjtën procedurë prokurimi, në kundërshtim me nenin 90 pika 7 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku citohet: "*7.Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit."*Mospërmbushja e këtij kriteri e bën ofertën e OE R. C. shpk, të pavlefshme.

2	C. M shpk	10,539,784	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e OE C. M shpk është anomalisht e ulët. Vlera e ofertuar nga Operatori Ekonomik C. M shpk është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme si rrjedhojë oferta është anomalisht e ulët.
3	E. E. shpk & S. shpk	15,096,520	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* - 1. Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim. 1.BOE "E. E. shpk & S." shpk nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 5 Kapaciteti Teknik të DST ku është kërkuar: *5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te përfshirë ne liçensen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:* *-1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/M.;* *-1 (një) Inxhinier Hidroteknik;* BOE E. E. shpk & S. shpk nuk ka deklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8): -1 (një) Inxhinier Hidroteknik; 2. BOE E. E. shpk & S. shpk nuk ka përmbushur Kriteret e Përgjithshme te Kualifikimit ku është përcaktuar se: *Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :* *-Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.* Në nenin 81 pika 1 te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: *1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet* palëve". Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se BOE E. E. shpk & S. shpk kane hartuar marrëveshjen e bashkëpunimit midis tyre ne date 09.09.2024. Në marrëveshje është deklaruar përfaqësuesi dhe përqindja e pjesëmarrjes për secilin anëtar të bashkimit, por nuk janë përcaktuar elementet (zërat e punimeve) që do të realizojë secili prej tyre.
4	M. shpk & L. K. shpk	13,685,081	*Kualifikuar*
5	2. K. shpk & G. shpk	14,738,325	*Kualifikuar*
6	A. shpk	13,074,080	*Kualifikuar*
7	F. shpk	12,924,261	*Kualifikuar*

8	I. shpk & L. K. shpk	13,563,501	*Kualifikuar*
9	O. shpk	13,857,921	*Kualifikuar*
10	R. shpk	12,227,244	*Kualifikuar*
11	2. shpk	15,679,041	*Kualifikuar*
12	A. I. shpk	12,088,314	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 367, datë 08.08.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga M. R. (kryetar), A. K. dhe M. H.(anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 12 OE, janë kualifikuar 9 OE, dhe shpallur fitues OE "A. I." shpk me ofertë në vlerën **12,088,314 lekë** me diferencë nga fondi limit **5,419,221 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 17.09.2024, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 23.09.2024 pasqyruar me procesverbalin përkatës.

Me shkresën nr. 2051/2 prot., datë 23.09.2024 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 2051/3 prot., datë 25.09.2024. është mbajtur PV i datës 02.10.2024 pas kontrollit të dokumentacionit, sipas të cilit ky OE ka paraqitur të plotë dhe të rregullt të gjithë dokumentacionin e ofertës.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 11.10.2024.

Është lidhur kontrata me nr. 2705 prot., datë 24.10.2024 me afat 3 muaj.

7. Tenderi me objekt: *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas"* me këto të dhëna:

7. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.51, datë 20.09.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 51, date 20.09.2024 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.M. P. - Anëtar 3.E. B.- Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 428, datë 20.09.2024 1. A. K – (Kryetar) 2. M. Z. - (Anëtar) 3. M. H.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 16,709,565 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "O." shpk me ofertë në vlerën 11,452,425 lekë, me lidhje kontrate datë 06.11.2024, me afat 1 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 5,527,140 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 11.10.2024 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 13 OE **b)** Skualifikuar 4 OE, **c)** Kualifikuar 9 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 51 datë 20.09.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **16,709,565 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë,Bashkia Prrenjas".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P. dhe E. B.(Specialist – Anëtar).

Burimi i financimit është nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas shkresës me nr. 6448/6 prot., datë 02.10.2024 të MBZHR "Mbi çeljen e fondit për investimin e kërkuar nga ju", me vlerë 16,709,565 lekë pa TVSH, financim i planifikuar për buxhetin e vitit 2024.

Me urdhër nr. 410, datë 16.09.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga E. B., J. B.dhe N. B.. Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 16.09.2024, sipas të cilit përllogaritja është kryer për secilin zë të preventivit bazuar në faqen e-Albania (SIM) dhe mbështetur në projekt zbatimin dhe preventivin e haratuar nga subjekti E.-G shpk me licencë me nr. N.5.../17, dhuruar Bashkisë Prrenjas me kontratën nr. 346 prot., datë 29.01.2024.
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar Bashkisë Prrenjas me shkresën nr. 1389/2 prot., datë 03.12.2024, administruar me nr. 2446/1 prot., datë 05.12.2024.
Është miratuar Leja e Infratrukturës me nr. 33, datë 04.11.2024.

Vlerësimi i kritereve
- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit i datës 30.07.2024 dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Janë bërë modifikime të disa kritereve bazuar në asistencën e APP.
- Është mbajtur procesverbali për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim i datës 25.09.2024 në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.
1.Kërkesa e pikës **4.1** e cila kërkon nga OE staf teknik të nevojshëm 2 teknik ndërtimi, 1 manovrator/ekskavatorist, 1 manovrator/automakinist, 3 shofer dhe 22 punonjës të thjesht ndërtimi, është evazive pjesa e kërkuar për 22 punonjës të thjesht ndërtimi të cilët nuk konsiderohen staf i kualifikuar. Gjithashtu, kërkesa ku ndër të tjera kërkohen për tu paraqitur dëshmitë e sigurimit teknik të lëshuara nga ISHTI ose subjekte juridike private të akredituara, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me legjislacionin me të cilin lëshohen këto dëshmi, konkretisht ligjit me nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike" i ndryshuar. Gjithë stafi i kërkuar, nuk lidhet me punime të cilat kanë për objekt garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P. dhe E. B.(Specialist – Anëtar).

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	G.shpk & B. II shpk	14,864,867	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 2.31 të Kapacitetit Teknik të Dt, konkretisht OE G. shpk ka paraqitur si pune te ngjashme kontraten me objekt: "Riparim shkarje ne kanalin kryesor Peqin – Kavaje" me Drejtorine e Ujitjes dhe Kullimit Durres, por qe nuk e permbush kriterin e kerkuar per arsye se i mungon Formulari i Vleresimit per realizimin e punimeve. 2. BOE G. shpk & B. II shpk**,** nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 5 të Kapacitetit Teknik të dt,

			per arsye se BOE G. shpk & B. II shpk nuk ka paraqitur deklaratat sipas pikave e,f,g te kriterit nr. 5 të Kapacitetit Teknik të dst.
2	N. shpk	10,575,916	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. OE N... shpk nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 5 të Kapacitetit Teknik të dst ,nga shqyrtimi i formularit te vetedeklarimit te paraqitur nga OE N. shpk rezultoi se nuk ka deklaruar disponimin e mjetit: Tokmak elektrik.
3	T & C shpk	10,872,680	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 2 të Kapacitetit Teknik të dt , konkretisht: Nuk disponon ne Liçencën e shoqërisë kategoritë e mëposhtme: N.S 18- A Punime topogjeodezike, Referuar marrëveshjes se bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit, rezulton se T& C. shpk , ka marr përsipër të realizojë punime per zerat e preventivit konkretisht: 3.88/b - Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3 ,ne kanale gjeresi >2m ,prani uji kategoria III ,me shk ne toke. Punimet qe do te kryeje ky operator ekonomik jane punime qe i permban kategoria e licences :N.S 18- A Punime topogjeodezike, per te cilen OE T&C shpk nuk eshte i licensuar. Referuar nenit 88 te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku percaktohet shprehimisht se "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje; Referuar edhe vendimeve te KPP. Nr.208/5prot. Nr.294/2022 Vendimi, date 30.03.2022
4	M. shpk & L. K. shpk	10,625,892	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga krahasimi dhe formula e përdorur rezultoi se oferta e BOE "M." shpk & L. K. shpk, është anomalisht e ulët.
5	2. K. shpk	14,250,761	*Kualifikuar*
6	A. shpk	12,427,110	*Kualifikuar*
7	C. M shpk	13,478,889	*Kualifikuar*
8	I. G. shpk	12,342,778	*Kualifikuar*
9	I. shpk & L. C. shpk	11,656,880	*Kualifikuar*
10	K. shpk	14,037,643	*Kualifikuar*
11	K. shpk	13,592,282	*Kualifikuar*
12	R. C. shpk	12,887,000	*Kualifikuar*
13	O. shpk	11,452,425	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 428, datë 20.09.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K (kryetar), M. Z. dhe M. H.(anëtar). Në këtë tender kanë marrë pjesë 13 OE, janë

kualifikuar 9 OE, dhe shpallur fitues OE "O." shpk me ofertë në vlerën **11,452,425 lekë** me diferencë nga fondi limit **5,527,140 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave i datës 11.10.2024, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 16.10.2024 pasqyruar me procesverbalin përkatës.
Me shkresën nr. 2423/2 prot., datë 16.10.2024 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 2423/3 prot., datë 18.10.2024.
Është mbajtur procesverbali për kontrollin e dokumentacionit i datës 22.10.2024, sipas të cilit dokumentacioni është i plotë dhe i rregullt.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 01.11.2024.
Është lidhur kontrata me nr. 2849 prot., datë 06.11.2024 me afat 1 muaj.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK të OE fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura, dhe konkretisht:
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2/2** për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 – 2024. Ky OE ka paraqitur 2 vërtetimi të lëshuara nga Bashkia Kukës dhe Bashkia Tiranë, ndërkohë që rezulton se për vitin 2023 dhe 2024, ky OE ka kontrata të lidhura me Bashkinë Has, në të cilën rezulton se nuk ka hapur NIP-t sekondar dhe njëkohësisht ka shmangur pagesën e taksave vendore pranë kësaj bashkie.
Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: A. K (kryetar), M. Z. dhe M. H.(anëtar).

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni me nr. 920/69 prot., datë 09.09.2026, administruar në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2026 si vijon:
Pretendimi i subjektit:
Lidhur me gjetjen, sqarohet se në DST është kërkuar të paraqitet vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 dhe për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.25006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të OE , çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.
KVO gjykon se AK ka detyrimin të vlerësojë ofertat e OE vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit. KVO ka bërë vlerësimin referuar kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, konkretisht sipas regjistrit të QKB, subjekti "O." shpk, rezulton se vënd të ushtrimit ka në Kukës dhe Tiranë për të cilën ka paraqitur vërtetimin. Përfundimi i nxjerrë nga ju se meqënëse OE ka kontrata në qytete të tjera duhet të paraqesë vërtetim dhe për këto vende ku ka ushtruar aktivitet është tërësisht i pabazuar pasi nuk mund të bëhet korrelacion i tillë midis dy kritereve të cilat janë vendosur oër qëllime tërësisht të ndryshme nga njëra tjera. Sa më sipër, komisioni gjykon se OE ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj bashkisë ku ushtron aktivitet të regjistruar në QKB për vitin 2025. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin nr. 487/2018 dhe vendimi APP nr. 14, datë 07.03.20025 për Bashkinë Prrenjas në lidhje me auditimin e KLSH për vitin 2022-2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Lidhur me sqarimet dhe pretendimet e paraqitura, grupi i auditimit nuk pranon qëndrimin e paraqitur nga observuesit, dhe rithekson se OE "O." shpk, përfitues i fondeve publike nëpërmjet procedurave të

prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 "Përditësimi i të dhënave të regjistrimit" të Ligjit nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se,
1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia, dhe pavarësisht se për vitin 2024 ka lidhur kontrata me Bashkinë Has, nuk ka kryer detyrimin ligjor për regjistrimin dhe hapjen e nipt-eve sekondare pranë kësaj njësie dhe njëkohësisht të kryej likuidimin e detyrimeve vendore. Në këto kushte, pretendimi i audituesve është tërësisht i bazuar në legjislacion dhe konkretisht në dispozitën e cituar më sipër, e cila kërkon dhe përcakton në mënyrë eksplicite se çdo subjekt duhet të regjistrohet **në çdo rast përpara ushtrimit të veprimtarisë..** Nga ana juaj, po kërkohet që të ligjërohet shmangia e detyrimeve duke mos kryer regjistrimin për hapjen e niptit sekondar, sikurse ka vepruar OE "O." shpk i cili figuron se ka lidhur kontrata duke përfituar fonde publike, por njëkohësisht duke shmangur detyrimet që lindin nga neni 43, pika 1/1 të ligjit nr. 9920 cituar më sipër. Gjithashtu, vijimi i kësaj praktike, ku OE nuk regjistrohen pranë njësive ku lidhin kontrata për kryerjen e punimeve, është edhe vet Bashkia Prrenjas me kontratën e lidhur me këtë OE pikërisht për procedurën e mësipërme, e cila referuar ekstraktit të QKB nuk ka asnjë adresë të hapur në Bashkinë Prrenjas.

<u>Procedurat e vitit 2025 paraqiten si vijon:</u>

8. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, Njësia Administrative Qukës Bashkia Prrenjas"* me këto të dhëna:

8. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, Njësia Administrative Qukës Bashkia Prrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.53, datë 09.10.2024	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 53, date 09.10.2024 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.M. P. - Anëtar 3.E. B.– Anëtar 4.A. K – Anëtar 5.R. D.- Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 456, datë 15.10.2024 1. M. R. – (Kryetar) 2. A. B. - (Anëtar) 3. M. H.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 60,555,366 - lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "R.." shpk me ofertë në vlerën 40,278,310 lekë, me lidhje kontrate datë 11.03.2025, me afat 5 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 20,277,056 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: Data e zhvillimit: 07.11.2024 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 13 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 12 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 53 datë 09.10.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **60,555,366 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, Njësia Administrative Qukës Bashkia Prrenjas".***
Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), M. P., E. B., A. K dhe R. D.(Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë miratuar me vendimin nr. 72, datë 31.07.2024 "Për miratimin e kryerjes me prioritet të investimit për objektin "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NjA Qukës, Bashkia Prrenjas", me vlerë të plotë projekti 72,666,439 lekë me TVSH, ku financimi për vitin 2024 është në vlerën 10,000,000 lekë me TVSH, për vitin 2025 në vlerën 31,333,219.5 lekë me TVSH dhe për vitin 2026 në vlerën 31,333,219.5 lekë me TVSH.
Me urdhër nr. 388, datë 02.09.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e vlerës së fondit limit i përbërë nga E. B., G. B. dhe J. B., të cilët kanë hartuar procesverbalin e përllogaritjes sipas të cilit preventivi është referuar sipas e_Albania (SIM) dhe projektit dhe preventivit të hartuar nga studio projektuese "A." shpk me Licencë Nr. N.6.../6, dhuruar Bashkisë Prrenjas me kontratën nr. 363 prot., datë 31.01.2024.
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shkresën nr. 1219/2 prot., datë 30.10.2024, administruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 2209/1 prot., datë 04.11.2024.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Janë bërë modifikime të disa kritereve bazuar në asistencën e APP.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, përgjithësisht rezultuan në përputhje me objektin e prokurimit dhe rregullat e LPP, por kërkesa e pikës 6 e cila kërkon 14 punonjës të thjeshtë ndërtimi në rubrikën e stafit teknik të kualifikuar është evazive pasi punonjësit e thjesht të ndërtimit nuk konsiderohen staf i kualifikuar.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	N. shpk	38,714,558	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Operatori ekonomik "N." shpk, nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 8 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Konkretisht: -Për mjetin Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton, me targa AB...KV, të deklaruar me qira nuk ka paraqitur "Certifikatë për transport mallrash brenda vendit për te trete dhe me qira", ne kundërshtim me nenin 41 te ligjit nr.8308, datë 18.3.1998" Për transportet rrugore" i ndryshuar dhe me piken 8/b te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit, të Dokumenteve Standarde të Tenderit . -Për mjetin Autobot me targa AA...NV të deklaruar me qira, nuk ka paraqitur "Certifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qira", ne kundërshtim me nenin 41 te ligjit nr.8308, datë 18.3.1998" Për transportet rrugore" i ndryshuar dhe me piken 8/b te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit te Dokumenteve Standarde te Tenderit. -Për mjetin Autobitumatriçe me targa AA...UL të deklaruar me qira nuk ka paraqitur "Certifikatë për transport mallrash brenda vendit per te trete dhe me qira", në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998" Për transportet rrugore" i ndryshuar dhe me piken 8/b të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të Dokumenteve Standarde te Tenderit, gjithashtu "Certifikata për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet" për mjetin Autobitumatriçe

			me targa AA...UL rezulton të jetë në emër të subjektit "B.-AB" shpk dhe jo të "A-K.-B. A." shpk i cili është qiradhënësi i mjetit. -Për mjetin Traktor me targa AZMB.. të deklaruar me qira nuk ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik të mjetit, ne kundërshtim me ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe me piken 8/b te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit te Dokumenteve Standarde te Tenderit. -Për mjetin Asfaltoshtruese Vogele nuk ka paraqitur aktin e zhdoganimit dhe faturën përkatëse, ne kundërshtim me ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar . 2.Në formularin përmbledhës te vetedeklarimit operatori ekonomik N. shpk ka deklaruar: :*Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve* ***dhe nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike****, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti ,* Nga verifikimi i kryer rezulton se: OE N. shpk ne fazën e paraqitjes se formularit te vetedeklarimit dhe te dokumentacionit ne SPE ka pasur 2 (dy) kontrata aktive (ne proces zbatimi te punimeve) me Bashkinë Korçë me objekte si me poshtë : "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazi" "Rikonstruksion i Muzeut Oriental "Bratko" , kontrata per te cilat rezulton se ka patur të angazhuara mjetet dhe punonjesit si më poshtë: -Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton me targa AB...NL -Rrul ngjeshës me deklaratë eksporti R19.... dt.21/03/2008 -Asfaltoshtruese Deklaratë eksporti: Vogele me nr. Shasie 095.....80 -Kamionçinë me targa AA...TL -Autovinç me targa AB...MK -Inxhinierin G. M. -J.J punëtor i thjeshtë. -A.H punëtor i thjeshtë.
2	BOE A.&D shpk & Z. shpk	45,177,900	*Kualifikuar*
3	B-X shpk	46,082,097	*Kualifikuar*
4	B. shpk	44,810,881	*Kualifikuar*
5	BOE C. M shpk & N. 19 shpk	42,334,318	*Kualifikuar*
6	I. shpk	45,418,449	*Kualifikuar*
7	K.shpk	48,373,126	*Kualifikuar*
8	K. shpk	45,823,351	*Kualifikuar*
9	L.T.E C. shpk	44,892,423	*Kualifikuar*
10	BOE Rr. U. A. Nr. 2 E. sha. & D. I.shpk	47,601,853	*Kualifikuar*
11	R. C.shpk	42,335,884	*Kualifikuar*

12	V. H.shpk	52,942,781	*Kualifikuar*
13	R. shpk	40,278,310	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 456, datë 15.10..2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga M. R. (kryetar), A. B. dhe M. H.(anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 13 OE, janë kualifikuar 12 OE, dhe shpallur fitues OE "R." shpk me ofertë në vlerën **40,278,310 lekë** me diferencë nga fondi limit **20,277,056 lekë.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 14.11.2024, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 27.11.2024 pasqyruar me procesverbalin përkatës.

Me shkresën nr. 2581/4 prot., datë 27.11.2024 është njoftuar i rendituri në vend të parë, OE "N." shpk. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të këtij OE nga komisioni, kanë rezultuar mangësi duke skualifikuar ofertën e këtij OE. Është mbajtur procesverbali i rivlerësimit me datë 19.12.2024. Me shkresën nr. 2581/5 prot., datë 19.05.2024 është njoftuar i renditurі i radhës OE "R." shpk, administruar me shkresën nr. 2581/6 prot., datë 23.12.2024. është mbajtur procesverbali me nr. 113 prot., datë 15.01.2025 sipas të cilit dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe i rregullt.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 24.01.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 613 prot., datë 11.03.2025 me afat 5 muaj.

9. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"* këto të dhëna:

9. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel,Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.28, datë 05.06.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 28, date 05.06.2025 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.E. B. - Anëtar 3.M. P. – Anëtar 4.R. D.– Anëtar 5.G. B. – Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 209, datë 05.06.2025 1. A. K – (Kryetar) 2. M. H. - (Anëtar) 3. M. A.– (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 80,783,446 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "M." shpk me ofertë me vlerë 61,945,806, me lidhje kontrate datë 02.10.2025, me afat 10 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 18,837,640 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 17.07.2025 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 19 OE **b)** Skualifikuar 11 OE, **c)** Kualifikuar 8 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 28 datë 05.06.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **80,783,446 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel,Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas".***
Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B., M. P., R. D.dhe G. B. (Anëtar).
Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas, miratuar me vendimin e KB me nr. 128, datë 26.12.2024 "Për miratimin Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027 dhe

buxheti i vitit 2025. Financimi për këtë projekt është planifikuar të ndahet në dy vite, konkretisht 43,725,298.75 lekë pa TVSH për vitin 2025 dhe 37,058,147.54 lekë pa TVSH për vitin 2026.
Me urdhër nr. 174, datë 14.05.2025 të Titillarit është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga E. B., M. P. dhe J. B.. Komisioni ka hartuar procesverbalin me nr. 1005, datë 22.05.2025 preventivi i punimeve është hartuar nga studio projektuese "Z. & Co" shpk dhe bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shkresën nr. 268/2 prot., datë 04.04.2025, administruar nga Bashkia Prrenjas me nr. 512/1 prot., datë 11.04.2025.
Janë miratuar Lejet e Infrastrukturës me nr. 15, 16, 17, 18, datë 30.09.2025.

Vlerësimi i kritereve
- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.
1.Kërkesa e pikës **8** e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera 1 Autobitumatriçe dhe 1 makineri spërkatje me bitum. Kjo kërkesë është e dublikuar, pasi Autobitumatriçja kryen edhe spërkatjen me bitum.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B., M. P., R. D.dhe G. B. (Anëtar).

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	BOE A. I. shpk & C. R. 2. shpk	59,353,360	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. 1. A. I. SHPK & C. R. 2. SHPK, nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 8 Kapaciteti Teknik të DST ku është kërkuar: *8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)…* Konkretisht : BOE A. I. SHPK & C. R. 2. SHPK, nuk ka deklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) makineritë si me poshte: -1(një) Ekskavator (mjet teknologjik) -1(një) Kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton -1(një) Mini Fadrome (mjet teknologjik)
2	B. N. shpk	60,877,585	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.OE nuk ka arritur te përmbushë kriterin nr.5 të Kapacitetit Teknik të DST ku është kërkuar: *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të*

			vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht: *1 (një) Inxhinier Ndërtimi* *1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;* Konkretisht : - OE B. N. shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8): 1 (nje) Inxhinier ndërtimi: ing. A.T, nga ku rezulton se inxhinieri i ndërtimit z. A.T nuk figuron në licencën profesionale të shoqërisë B. N. shpk.
3	BOE K. shpk & C. M. shpk	56,709,648	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga Operatori ekonomik BOE K. shpk, me nipt L.....E, me administrator Z. K. C. & C. M. shpk, me nr. NIPT L.....O, me administrator Z M. C., u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kritereve te veçanta per kualifikim sipas dokumenteve standarde te tenderit me konkretisht : 1.Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 6 të KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT / 2.3 Kapaciteti teknik/ të DST: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht rezulton se: 1- Për Punonjësin N. F. të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si i punësuar pranë OE K. shpk në rolin e Automakinistit referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se : Punonjësi N. F (Automakinist pranë OE K. shpk). • Leja e drejtimit për kategorinë C ka skaduar më 25.02.2023 dhe nuk është e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës. • Certifikata e aftësisë profesionale ka skaduar më 10.05.2023 dhe nuk është e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës. Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin N.F nuk plotëson kërkesat e pikës 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit të DST - 2- Për Punonjësin K.B, të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si i punësuar pranë OE C. M. shpk në rolin e automakinistit, ka paraqitur dokumentacion fizik që përmban një leje manovrimi me datë 05.06.2008, e lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe TelekomuN...cionit dhe Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë. Sipas Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 (Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë), i ndryshuar, aftësia profesionale për drejtuesit e mjeteve të rënda duhet të vërtetohet me dokumente të lëshuara ose të njohura nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR). Leja e paraqitur nuk është e lëshuar nga DPSHTRR dhe për pasojë nuk plotëson kërkesat ligjore dhe teknike të pikës 6.1 të DST.

			Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin K. B është i pavlefshëm dhe nuk përmbush kriteret e kualifikimit, pika 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit të DST 3. Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas 8 të kapaciteteve teknik të kritereve të kualifikimit të DST. 8. *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike,* Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga operatorët ekonomikë rezultuan këto mangësi: 1.Për mjetin Autobetoniere me targë TR....M të deklaruar me qira nga OE K. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 2.Për mjetin Autobetoniere me targë TR....P të deklaruar me qira nga OE K. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 3. Për mjetin Autobetoniere me targë TR....P të deklaruar me qira nga OE C. M shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 4. Për mjetin Autobot uji me targë AA...HA të deklaruar me qira nga OE K. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 5.Për mjetin Autobot uji me targë AA...VE të deklaruar me qira nga OE C. M shpk, certifikata e kontrollit teknik ka skaduar në datë 01.11.2022, dhe siguracioni i mjetit ka skaduar në datë 28.12.2023, në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 6. Për mjetin Kamionçinë me targë AA...ZD të deklaruar me qira nga OE K. shpk ka tonazh më të lartë se 3.5 ton, ndërkohë që kërkohet kamionçinë deri në 3.5 ton, në kundërshtim me pikën 8 të kapaciteteve teknike, referuar njoftimin/shtojces për ndryshimin e dokumenteve të tenderit. 7. Për mjetin Kamionçinë me targë AA...EM të deklaruar me qira nga OE K. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike . 8. Për mjetin Kamionçinë me targë AB...IV të deklaruar me qira nga OE C. M shpk ka tonazh më të lartë se 3.5 ton, ndërkohë që kërkohet kamionçinë deri në 3.5 ton, në kundërshtim me pikën 8 të kapaciteteve teknike, referuar njoftimin/shtojcës për ndryshimin e dokumenteve të tenderit. Në nenin 41 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, parashikohet se : Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.
4	K. shpk	56,621,624	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se : - Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim.

			1.Nga dokumentacioni i paraqitur nga OE K. SHPK,rezulton se nuk vërteton se plotëson kriterin nr.2.3 të Kapacitetit Teknik te dokumenteve te tenderit, Konkretisht : -Përsa i përket përvojës së mëparshme te realizuara me institucione shtetërore OE K. SHPK ka paraqitur kontratën me objekt : "Ndërtimi i rrugës Argjinatura nga Kryqëzimi i rrugës Berisha, me rrugën Besëlidhje (Albavija) deri tek rruga Dajti" të lidhur me Bashkinë Kamzë, dhe nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur për këtë kontrate u konstatua se mungon *Certifikatën e marrjes ne dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorëzim.*
5	L. K. shpk	76,740,757	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se : - Nuk i plotëson kriteret e Vecanta për kualifikim, të përcaktuara në DT. Konkretisht : Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se tek preventivi i paraqitur nga OE L. K. SHPK, për objektin III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas" ka përllogaritur fondin rezerve ne vlerën 1% ne kundërshtim me preventivin e AK ,pasi tek preventivi i AK për objektin III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas "fondi rezerve është 0% . Sa me sipër oferta e paraqitur nga ky Operator ekonomik, me fond rezerve te shtuar, rrit vlerën e ofertës përtej asaj që AK ka përcaktuar , krijon paqartësi në çmimin real që OE po ofron , e bën ofertën të papërputhshme me kërkesat e tenderit dhe per pasoje konsiderohet e parregullt ne te gjithe elementet e saj. Ne kundërshtim dhe me Projektin dhe Preventivin e miratuar te cilat janë pjese e dokumenteve te tenderit.
6	N. shpk	51,808,695	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se : - Nuk i plotëson kriteret e Veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT. Konkretisht : Tek OE N. shpk rezulton se te preventivi i paraqitur ka gabime aritmetike . Gabimet aritmetike janë: -Tek objekti III " Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas" paragrafi 3 Analiza teknike ,shuma 3 është llogaritur gabim, OE ka vendosur vlerën 3,927,000 ,ndërkohë qe shuma e sakte duhej te ishte 7,526,750. -Tek objekti III " Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas" paragrafi 6 Punime shtresash 2 ,shuma 6 është llogaritur gabim OE ka vendosur vlerën 1,100,000 ,ndërkohë qe shuma e sakte duhej te ishte 1,867,000 -Tek objekti IV " Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Urake" paragrafi 3 Ndërtim i veprave te artit +kanalizime , shuma 3 është llogaritur gabim OE ka vendosur vlerën 46,200, ndërkohë qe shuma e sakte duhej te ishte 1,062,200.

			Vlera totale e shumes te te gjitha korrigjimeve është 5,382,750 2% i vlerës së ofertës ekonomike të ofruar është 1,036,173.9, pra vlera totale e te gjitha korrigjimeve është me e madhe se 2% i vlerës së ofertës ekonomike të ofruar (5,382,750>1,036,173.9) Bazuar në nenin 82, të VKM nr. 285, date 19.02.2021"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, *"Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar";* Për sa më sipër KVO konstaton se OE N. shpk ka dorëzuar ofertë ekonomike ku vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës.
7	N. shpk	54,056,824	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se : - Nuk i plotëson kriteret e Veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT. Konkretisht : Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se tek preventivi i paraqitur nga OE N. shpk, - për objektin III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas" ka përllogaritur fondin rezerve ne vlerën 1% ne kundërshtim me preventivin e AK, pasi tek preventivi i AK për objektin III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas "fondi rezerve është 0% . - Gjithashtu tek objekti III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës fshati Prrenjas" tek zëri me numër rendor 13 "3.164/1a-Mbushje me material te gërmuar ne trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri është vendosur gabim "njësia" Tek preventivi i AK zëri me numër rendor 13 "3.164/1a-Mbushje me material te gërmuar ne trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri" e ka njësinë ne m^3 , ndërsa OE N... shpk tek zëri me numër rendor 13 "3.164/1a-Mbushje me material te gërmuar ne trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri ka vendosur njësinë m^2.
8	R. C. shpk	59,171,942	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga Operatori ekonomik R. C. shpk, u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kritereve te veçanta për kualifikim sipas dokumenteve standarde te tenderit me konkretisht : I Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 6 të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / 2.3 Kapaciteti teknik/ të DST: - 1- Për Punonjësin D.M të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si i punësuar në rolin e Automakinistit referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar *se mungojnë Leja e drejtimit dhe Certifikata e aftësisë profesionale.* Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin D. M, nuk plotëson kërkesat e pikës 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit të DST.

			- 2- Për Punonjësin S.S., të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit në rolin e shofer kamioni, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se : *Mungon Certifikata e aftësisë profesionale* -3-Për Punonjësin M.H, të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si punonjës pranë subjektit mbështetës D-1 shpk, në rolin e automakinistit, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se :*Mungon Leja e drejtimit* . -II- Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikes 8 të kapaciteteve teknik të kritereve te veçanta të Kualifikimit të DST. *8. (Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës…)* Dokumentacioni i paraqitur nga OE R. C. SHPK, nuk vërteton se plotëson kriterin 8 të kapaciteteve teknik të kritereve te veçanta të Kualifikimit të DST, përkatësisht: 1.Për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton me targë AA...YG të deklaruar në pronësi nga OE R. C. mungon certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/a të kapaciteteve teknike. 2.Për mjetin Autobetoniere me targë TR....M të deklaruar me qira nga OE R. C. mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 3. Për mjetin Autobetoniere me targë AA...ZK të deklaruar me qira nga OE R. C. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 4. Për mjetin Autobot uji me targë AB...FZ të deklaruar me qira nga OE R. C. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 5.Për mjetin Autobitumatriçe me targë AB...JU të deklaruar me qira nga OE R. C. shpk, mungon Leje te Transportit te Mallrave te rrezikshme (te vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/c të kapaciteteve teknike. 6. Për mjetin Për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton me targë AA...DZ të deklaruar me qira nga OE R. C. shpk mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike.
9	R. shpk	71,684,446	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE u konstatua se: 1.Nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 6 të Kapacitetit Teknik të DST. <u>Konkretisht:</u> OE R.. SHPK nuk ka të deklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) punonjësit si më poshtë: 1 (një) Teknik topograf, 6 (gjashte) punetor asfalti,

			2. Nuk vërteton se plotëson kriterin 8 të kapaciteteve teknik të kritereve te veçanta të Kualifikimit të DST, përkatësisht: Nuk ka të deklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) makineritë si më poshtë: -1 (një) Autobetoniere (mjet teknologjik) -1 (një) Mini Fadrome (mjet teknologjik)
10	OE Rr. U. A.. nr. 2 E. Sh.a	63,172,495	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se : - Nuk i plotëson kriteret e Vecanta për kualifikim, të përcaktuara në DT. Konkretisht : Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se tek preventivi i paraqitur nga OE Rr. U. A. nr. 2 E. Shoqëri Aksionare, për objektin III "Rikonstruksion dhe asfaltim i unazës së fshatit Prrenjas", është parashikuar një fond rezervë në vlerën 1%, në kundërshtim me përcaktimet e AK-së, pasi në preventivin e AK-së për këtë objekt, fondi rezervë është 0%." Sa me sipër oferta e paraqitur me fond rezerve te shtuar, rrit vlerën e ofertës përtej asaj që AK ka përcaktuar dhe miratuar, krijon paqartësi në çmimin real që OE po ofron , e bën ofertën të papërputhshme me kërkesat e tenderit. Për pasojë, kjo konsiderohet e parregullt në të gjitha elementet e saj pasi është në kundërshtim edhe me projektin dhe preventivin e miratuar, të cilat janë pjesë e dokumentacionit të tenderit."
11	Z. shpk	61,742,599	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht nga Operatori ekonomik Z. SHPK, u konstatua se nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e kritereve te veçanta për kualifikim sipas dokumenteve standarde te tenderit me konkretisht : -I- Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikës 6 të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / 2.3 Kapaciteti teknik/ të DST: - 1- Për Punonjësin M.S të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit si i punësuar në rolin e Automakinistit referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se : *Mungon Leja e drejtimit* .Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin M.S nuk plotëson kërkesat e pikës 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit të DST 2- Për Punonjësin A.G, të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit në rolin e Automakinistit, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se :*Mungon Leja e drejtimit,* Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin A.G nuk plotëson kërkesat e pikës 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit të DST 3-Për Punonjësin V.M, të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, në rolin e shofer kamioni, referuar dokumentacionit fizik të paraqitur është konstatuar se :Mungon Certifikata e aftësisë profesionale, Dokumentacioni i paraqitur për punonjësin V.M nuk

			plotëson kërkesat e pikës 6.1 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit të DST. -II- Nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e plotë sipas pikes 8 të kapaciteteve teknik të kritereve te veçanta të Kualifikimit të DST. *8. (Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës…).* Dokumentacioni i paraqitur nga OE Z. SHPK, nuk vërteton se plotëson kriterin 8 të kapaciteteve teknik të kritereve te veçanta të Kualifikimit të DST, përkatësisht: 1.Për mjetin Autobetoniere me targë AMMT.. të deklaruar me qira, mungojnë fotoja e mjetit dhe certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b/e të kapaciteteve teknike. 2. Për mjetin Autobitumatriçe me targë AB...KM të deklaruar me qira, mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 3. Për mjetin Autobot me targë AA...GG të deklaruar me qira, mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike 4.Për mjetin Minifadromë (mjet teknologjik) me targa ARMT.. të deklaruar me qira, mungon fotoja e mjetit, në kundërshtim me pikën 8/e të kapaciteteve teknike. 5. Për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton me targë AB...KG të deklaruar me qira, mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 6. Për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton me targë AA...PE të deklaruar me qira nga OE Z. SHPK mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike.
12	2. shpk	66,987,677	*Kualifikuar*
13	A. K. shpk	76,744,943	*Kualifikuar*
14	B.-S. shpk	64,606,075	*Kualifikuar*
15	I. shpk	70,193,340	*Kualifikuar*
16	L. VII shpk	67,736,660	*Kualifikuar*
17	L. K. shpk	66,778,959	*Kualifikuar*
18	Xh. shpk	65,050,360	*Kualifikuar*
19	M. shpk	61,945,806	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 209, datë 05.06.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K (kryetar), M. H. dhe M. A.(anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 19 OE, janë kualifikuar 8 OE, dhe shpallur fitues OE "M." shpk me ofertë me 61,945,806 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 18,837,640 lekë.

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 17.07.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 08.08.2025 pasqyruar me PV përkatës. Vlerësimi i ofertave ka zgjatur 23 ditë, pra është tejkaluar me një javë afati vlerësimit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së

nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton afatin 15 ditor të kohëzgjatjes së vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.
Me shkresën nr. 1185/4 prot., datë 08.08.2025 është njoftuar BOE "K." shpk & "C. M." shpk. Është mbajtur procesverbali me nr. 1185/6 prot., datë 27.08.2025 sipas të cilit ky OE nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plotë. Është mbajtur procesverbali i rivlerësimit me nr. 1185/7 prot., datë 27.08.2025. Me shkresën nr. 1185/8 prot., datë 27.08.2025 është njoftuar OE "R. C." shpk për dorëzim dokumentacioni. Me shkresën nr. 1185/10 prot., datë 01.09.2025 është mbajtur procesverbali për kontrollin e dokumentacionit, sipas të cilit ky OE nuk ka arritur të paraqesë të plotë dhe të rregullt dokumentacionin. Është mbajtur procesverbali për rivlerësimin e ofertave me nr. 1185/11 prot., datë 01.09.2025. Është njoftuar i renditurri i radhës, OE "Z." shpk me shkresën nr. 1185/12 prot., datë 01.09.2025. Nga KVO është mbajtur procesverbali për kontrollin e dokumentaciont të këtij OE, sipas të cilit dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e kritereve të veçanta të kualifikimit. Është mbajtur procesverbali i rivlerësimit të ofertave me nr. 1185/15 prot., datë 04.09.2025. Me shkresën nr. 1185/16 prot., datë 04.09.2025 është njoftuar i renditurri i radhës, OE "M." shpk për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar nga OE me shkresën nr. 1185/17 prot., datë 09.09.2025. Është mbajtur procesverbali për kontrollin e dokumentacionit me nr. 1185/18 prot., datë 12.09.2025, sipas të cilit dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe i rregullt.
Është miratuar Raporti Përmbledhës procesverbali e datës 22.09.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 2288 prot., datë 02.10.2025 me afat 10 muaj.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur pranë AK nga OE fitues, rezulton se nuk përmbush disa nga kriteret e vendosura, dhe konkretisht:
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3** për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshi këstin e maturuar për vitin 2025. Ky OE ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga Bashkia Gramsh, Cërrik dhe Tiranë për vitin 2025, ndërkohë rezulton se përgjatë vitit 2025, përpara lidhjes së kontratës objekt shqyrtimi, ka lidhur dy kontrata të tjera, konkretisht me Bashkinë Himarë me objekt *"Rikonstruksioni i rrugës Borsh – Fterrë"* dhe me Bashkinë Poliçan kontratën me objekt *"Rikonstruksioni dhe zgjerimi i ambienteve të Qëndrës Polivalente të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për të moshuarit"*. Nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për likuidimin e detyrimeve pranë këtyre bashkive, ku rezulton se ky OE ka shmangur gjithashtu hapjen e NIPT-it sekondar.
Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: A. K (kryetar), M. H.dhe M. A.(anëtar).

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni me nr. 920/68 prot., datë 09.09.2026, administruar në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2026 si vijon:
Pretendimi i subjektit:
Lidhur me gjetjen, sqarohet se në DST është kërkuar të paraqitet vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2025 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.25006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të OE , çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.
KVO gjykon se AK ka detyrimin të vlerësojë ofertat e OE vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentet e procedurës së prokurimit. KVO ka bërë vlerësimin referuar kërkesave dhe

specifikimeve të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, konkretisht sipas regjistrit të QKB, subjekti "M." shpk, rezulton se vënd të ushtrimit ka në Gramsh, Cërrik dhe Tiranë për të cilën ka paraqitur vërtetimin. Përfundimi i nxjerrë nga ju se meqënëse OE ka kontrata në qytete të tjera duhet të paraqesë vërtetim dhe për këto vende ku ka ushtruar aktivitet është tërësisht i pabazuar pasi nuk mund të bëhet korrelacion i tillë midis dy kritereve të cilat janë vendosur oër qëllime tërësisht të ndryshme nga njëra tjera. Sa më sipër, komisioni gjykon se OE ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj bashkisë ku ushtron aktivitet të regjistruar në QKB për vitin 2025. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin nr. 487/2018 dhe vendimi APP nr. 14, datë 07.03.20025 për Bashkinë Prrenjas në lidhje me auditimin e KLSH për vitin 2022-2023.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>

Lidhur me sqarimet dhe pretendimet e paraqitura, grupi i auditimit nuk pranon qëndrimin e paraqitur nga observuesit, dhe rithekson se OE "M." shpk, përfitues i fondeve publike nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, në kundërshtim me nenin 43, pika 1/1 "Përditësimi i të dhënave të regjistrimit" të Ligjit nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se,

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia, dhe pavarësisht se për vitin 2025 ka lidhur edhe 2 kontrata me Bashkinë Himarë dhe Bashkinë Poliçan të cilat janë evidentuar në gjetje, nuk ka kryer detyrimin ligjor për regjistrimin dhe hapjen e nipt-eve sekondare pranë këtyre dy njësive dhe njëkohësisht të kryej likuidimin e detyrimeve vendore. Në këto kushte, pretendimi i audituesve është tërësisht i bazuar në legjislacion dhe konkretisht në dispozitën e cituar më sipër, e cila kërkon dhe përcakton në mënyrë eksplicite se çdo subjekt duhet të regjistrohet **në çdo rast përpara ushtrimit të veprimtarisë..** Nga ana juaj, po kërkohet që të ligjërohet shmangia e detyrimeve duke mos kryer regjistrimin për hapjen e niptit sekondar, sikurse ka vepruar OE "M." shpk i cili figuron se ka lidhur kontrata duke përfituar fonde publike, por njëkohësisht duke shmangur detyrimet që lindin nga neni 43, pika 1/1 të ligjit nr. 9920 cituar më sipër.

10. Tenderi me objekt: "*Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025 - 2027*" me këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Grumbulim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025 - 2027"</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr.74, datë 20.12.2024</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 74, date 20.12.2024
1.M. R. - Person Përgjegjës
2.G. K. - Anëtar
3.A. G. – Anëtar
I ndryshuar me urdhër nr. 69, datë 18.02.2025 ku zëvendësohet M. R. me anëtarin P. C..</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 624, datë 27.12.2024
1. Z. Ç. – (Kryetar)
2. A. K - (Anëtar)
3. M. H.– (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur" – Marrëveshje Kuadër 3 vjet</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa Tvsh)
39,169,904 - lekë pa tvsh</td><td>6.Oferta fituese:
OE "R." shpk me ofertë në vlerën 34,594,884, me lidhje kontrate datë 22.04.2025, me afat 36 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
4,575,020 - lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:03.03.2025
Ora 10:00</td><td>9.Burimi Financimit:
-Të ardhurat e bashkisë</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE
b) Skualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
</table>

11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 74 datë 20.12.2024, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **39,169,904 lekë** me objekt**: *"Grumbulim dhe transport i mbetjeve urbane për vitet 2025 - 2027".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga M. R. (Pers.Përgjegjës), G. K.dhe A. G. (Anëtar), i ndryshuar me urdhër nr. 69, datë 18.02.2025 ku zëvendësohet M. R. me anëtarin P. C..

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas, miratuar me vendimin nr. 57, datë 30.04.2024 "Plani vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Prrenjas 2025 – 2029".

Me urdhër nr. 502, datë 30.10.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga G. K., E. V., A. G., dhe N. B.. Komisioni ka hartuar procesverbalin për përllogaritjen e fondit limit, sipas të cilit përllogaritja është kryer për secilin zë të preventivit në përputhje me Planin Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Prrenjas miratuar me vendimin e KB të mësipërm dhe në VKM nr. 319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe VKM nr. 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore". Është hartuar preventivi i cili ka 3 zëra,

Nr.	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Grumbullimi dhe Transporti i mbetjeve urbane	Ton	8,802	3876.789	34,123,496.778
2	Freskimi i rrugëve (2 herë në ditë)	m^2	24,841,998	0.176	4,372,191.648
3	Larja, dezinfektimi dhe deritazimi i kontejnerëve	Copë	3.213	209.84	674,215.92
	Shuma pa TVSH				**39,169,904.346**
	TVSH 20%				**7,833,980.8692**
	Totali				**47,003,885.2152**

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Lidhur me kriteret, rezulton se pranë AK është administruar elektronikisht ankesa e subjektit "P. S" shpk.

Ky OE, sqaron se ka mospërputhje ndërmjet kërkesave të pikës 2.3.3, 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.7. Kërkohen 4 punonjës në total sipas pikës 2.3.3, ndërsa nga përllogaritja e punonjësve sipas pikave të tjera, rezultonse numri total është 7 punonjës. Në vijim, kërkesa e pikës 2.3.7 e cila kërkon një punonjës përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", kërkohet modifikimi i këtij kriteri, pasi nuk argumentohet siç duhet nga AKm ndërkohë që sipas ankuesit, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 285/2021, përcaktohet se punëdhënësi është përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe përveç një personi të brendshëm, mund të përcaktohet edhe një kompani/person i jashtëm për sigurinë dhe shëndetin në punë.

-OE ankohet për kërkesën e pikës 2.3.8 e cila kërkon mjetet dhe makineritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për mjetin 1 makinë teknologjike jo më pak se 10 Ton dhe 1 makinë teknologjike rezervë jo më pak se 10 Ton dhe autobot për lajet e rrugëve, kërkohet të mos jenë të

angazhuara në kontrata tjera. Sipas ankuesit, kjo kërkesë është e ekzagjeruar pasi mjetet nuk mund të mbahen rezervë duke pritur momentin se kur mund të shpallen fitues për angazhimin e tyre. Nuk mund të kërkohet që si automjeti që kryen shërbimin si dhe ai rezervë të mos jenë të angazhuar në kontrata tjera. OE nuk pengohen për kryerjen e shërbimit me të njëjtat automjete të angazhuara edhe në kontrata të tjera.
-OE ankohet për kërkesën për 201 kontejner të rinj. Kjo kërkesë mund të plotësohet vetëm nga OE që merrem me tregtimin e kontejnerëve dhe kërkohet heqja e këtij kriteri.
Me urdhrin nr. 24, datë 22.01.2025 të Titullarit, është pezulluar procedura dhe ngritur KSHA e përbërë nga R. D., O. A. dhe M. Z.. KSHA pas shqyrtimin të ankesës, ka vendosur me me vendimin nr. 24, datë 24.01.2025 refuzimin e ankesës. Për pikën 1 sqaron se numri i punonjësve ka dal si përllogaritje bazuar në VKM nr. 319, datë 31.0.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve". Lidhur me pikën 2 sqaron se nuk pengohet disponimi i personit përgjegjës për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë në çdo lloj forme të ligjshme, pra nuk kërkohet domosdoshmërisht punonjës në listëpagesat e shoqërisë. Lidhur me pikën 3, sqarohet se për AK është e nevojshmë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera, pasi mund të ndikojë në disponueshmërinë e tyre për ofrimin e shërbimit. Angazhimi në kontrata të tjera mund të krijojë vështirësi logjistike. Lidhur me kërkesën për 201 kontejnër, sqarohet se ky kriter është vendosur në përputhje me qëllimin dhe nevojat specifike të proceduës. Qëllimi i kërkesës për kontejnër të rinj, lidhet me përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe sigurimin e standardeve më të larta për komunitetin.
Vendimi i është dërguar OE ankues me shkresën nr. 221/1 prot., datë 24.01.2025.
Me shkresën nr. 305 prot., datë 03.02.2025 të AK dërguar KPP, kërkohet përshperjtimi i një vendimi për objektin e ankesës, pasi kontrata e mëparshme e transportit të mbetjeve përfundon gjatë muajit shkurt, dhe mungesa e shërbimit mund të krijojë ndotje mjedisore për komunitetin.
KPP ka dërguar me shrkesën nr. 185/6 prot., datë 07.02.2025 Vendimin me nr. 207/2025.
Lidhur me pikën 1, KPP ka vendosur pranimin e ankesës dhe modifikimin e pikave2.3.3 dhe 2.3.6. Lidhur me pikën 2.3.7 për personin përgjegjës për mbrojtjen dhe shëndetin në punë, pranohet ankesa e OE, duke kërkuar nga AK sqarimin e kriterin. Lidhur me ankesën për mjetet dhe kontejnerët, KPP ka pranuar pjesërisht ankesën, duke kërkuar nga AK heqjen e kërkesës për mjetin teknologjik 10 Ton rezervë si dhe heqjen e kërkesës që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera, ndërsa për 201 kontejnerët, kërkohet që disponueshmërie e tyre të njihet me të gjitha format e njohura nga legjislacioni përkatës në fuqi dhe të bëhet formulimi i tij pa shkaktuar konfuzion.
Në zbatim të vendimit të KPP, AK ka modifikuar kriteret, duke hequr kriterin e pikës 4, janë bërë modifikime në të kriterit në pikën 2.3.5, 2.3.6 dhe 2.3.7, hiqet kërkesa për mjetin teknologjik jo më pak se 10 (rezervë) dhe modifikohet kërkesa për 201 kontejner. Pas modifikimit të tyre, KPP ka vendosur me vendimin nr. 267/2025 heqjen nga pezullimi të procedurës dhe vijimin me hapat e mëtejshëm.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me rregullat e LPP.
Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	P. S. shpk	38,881,099	*kualifikuar*
2	R. shpk	34,594,884	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 624, datë 27.12.2024, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga Z. Ç. (kryetar), A. K dhe M. H.(anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 2 OE, të cilët

janë kualifikuar, dhe shpallur fitues OE "R." shpk me ofertë në vlerën **34,594,884 lekë** me diferencë nga fondi limit **4,575,020 lekë.**
- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 03.03.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 05.03.2025 pasqyruar me procesverbalin përkatës.
Me shkresën nr. 74/2 prot., datë 05.03.2025 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 74/3 prot., datë 07.03.2025.
Është mbajtur procesverbali nga KVO i datës 11.03.2025 sipas të cilit nga AK ka lind nevoja për sqarime dhe verifikime mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar.
Me shkresën nr. 617 prot., datë 11.03.2025 kërkohet sqarim nga OE për vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin –E-S.02/a.
Me shkresën nr. 618 prot., datë 11.03.2025 dhe 618/1 prot., datë 18.03.2025 drejtuar OSHEE, kërkohet informacion për kontratat e energjisë elektrike për këtë subjekt.
Me kërkesë të KVO për pezullimin e afatit të vlerësimit të ofertave për shkak të kërkesave drejtuar OE dhe OSHEE, Titullari ka vendosur pezullimin e afatit të vlerësimit me urdhrin nr. 96, datë 12.03.2025.
OE ka kthyer përgjigje për kërkesën sqaruese me shkresën nr. 157 prot., datë 13.03.2025, administruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 617/2 prot., datë 17.03.2025 duke bashkëlidhur mandatin e sigurimeve Janar 2025, të cilat janë paguar në datën 20.02.2025 dhe konfirmuar nga banka në datën 13.03.2025, si dhe vërtetimin datë 10.03.2025 me nr. T12720037 ku reflektohet muaji Janar i paguar dhe nr. i punonjësve.
Gjithashtu janë përcjellë 2 përgjigje nga FSHU me nr. 1241 prot., datë 26.03.2025 dhe nr. 1334/2 prot., datë 26.03.2025 të administruara me datë 28.03.2025 në Bashkinë Prrenjas, ku sqarohet kontratat që disponon ky OE.
Me PV nr. 74/4 prot., datë 28.03.2025 është kryer vlerësimi për kontrollin e dokumentacionit, ku evidentohet se ai është paraqitur i plotë dhe i rregullt.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 11.04.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 892 prot., datë 22.04.2025 referuar marrëveshjes kuadër me nr. 880 prot., datë 22.04.2025 me afat 36 muaj.

11. Tenderi me objekt: "*Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas"* këto të dhëna:

<table>
<tr><td colspan="3">11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas".</td></tr>
<tr><td>1.Urdhër Prokurimi :
Nr.11, datë 05.03.2025</td><td rowspan="2">2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit:
Nr. 11, date 05.03.2025
1.Xh. Xh.– Spec. Kadastre - Anëtar
2.S. H.- Spec.Menaxhimi Sekt.Menaxh.Pyjeve. - Anëtar
3.A. K – Person Përgjegjës</td><td rowspan="2">3.Komisioni Vlerësimit Ofertave:
Nr. 106, datë 20.03.2025
1. L. L.– (Kryetar)
2. O. L.- (Anëtar)
3. M. M.– (Anëtar)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"</td></tr>
<tr><td>5.Fondi Limit (pa Tvsh)
17,387,325 lekë pa tvsh</td><td>6.Oferta fituese:
OE "L." shpk me ofertë me vlerë 17,307,741, me lidhje kontrate datë 31.07.2025, me afat 6 muaj.</td><td>7.Diferenca me fondin limit:
79,584 - lekë pa tvsh</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit:
13.05.2025
Ora 10:00</td><td>9.Burimi Financimit:
-Të ardhurat e bashkisë</td><td>10.Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 3 OE
b) Skualifikuar 2 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
</table>

11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 11 datë 05.03.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **17,387,325 lekë** me objekt**: *"Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. K (Pers.Përgjegjës), Xh. Xh.dhe S. H.(Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë, miratuar me vendimin nr. 121, datë 26.12.2024 "Për miratimin e kryerjes me prioritet të investimit për objektin "Për hartimin e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas". Financimi planifikohet në 2 vite, konkretisht 10,000,000 lekë me TVSH për vitin 2025 dhe 10,864,790 lekë me TVSH për vitin 2026.

Me urdhër nr. 40, datë 29.01.2025 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga Xh. Xh., S. H.dhe R. H.. Komisioni ka hartuar procesverbalin e datës 03.03.2025, sipas të cilit përllogaritja është bazuar në Vendimin nr. 361., datë 12.05.2010 "Për miratimin e tarifave profesionale që kryhen në fondin pyjor e kullosor publik" shotjca 1 pika 2, Tarifat për veprimtari e shërbime profesionale për projektime: a) Hartim i planit 10 vjeçar të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Janë bërë modifikime të disa kritereve bazuar në asistencën e APP.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.

1.Kërkesa e pikës **2.3.2/a/b/c,** kërkon për zbatimin e kësaj kontrate një total prej 4 inxhinierë pyjesh, ku secili prej tyre të figurojë minimalisht në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Kjo kërkesë, që krahas numrit prej 4 inxhinierë pyjesh të cilët të figurojnë njëkohësisht në listëpagesa muajin e fundit, është kërkesë e cila potencialisht kufizon OE. AK duhej të mundësonte edhe opsionin që disa prej këtyre inxhinierëve të disponoheshin edhe me kontratë shërbimi për periudhën e zbatimit të kontratës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë A. K (Pers.Përgjegjës), Xh. Xh.dhe S. H.(Anëtar).

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	D. shpk	17,387,325	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori Ekonomik "D. shpk" nuk ka paraqitur ne Sistemin e Prokurimit Elektronik. dokumentacionin e plote sipas shtojcës 9 Formular i Kritereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit. Konkretisht : - nuk ka paraqitur :

			Certifikata e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. -Certifikata e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. -Certifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2023, (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
2	J.& Co shpk	17,366,121	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* - Nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024 ne kundërshtim me piken 2.2.1 te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar tek dokumentet standarde te tenderit. -Nuk ka paraqitur bilancet e viteve 2022 dhe 2023 2024, ne kundërshtim me piken 2.2.2 te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit/ Kapaciteti ekonomik dhe financiar tek dokumentet standarde te tenderit dhe Njoftimit për ndryshimin e dokumenteve të tenderit/shtojcës se modifikimit . -Nuk ka paraqitur dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontratës, ne kundërshtim me piken 2.3.1 te Kritereve te Veçanta te Kualifikimit/ Kapaciteti teknik tek dokumentet standarde te tenderit . - Nuk ka paraqitur : Certifikata e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. -Certifikata e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. -Certifikata e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2023, (e vlefshme) e akreditуar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
3	L. shpk	17,307,741	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 106, datë 20.03.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga L. L.(kryetar), O. L. dhe M. M.(anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 3 OE, është kualifikuar 1 OE, dhe shpallur fitues OE "L." shpk me ofertë me 17,307,741 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 79,584 lekë.

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 13.05.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 28.05.2025 pasqyruar me PV përkatës.

Me shkresën nr. 566/3 prot., datë 28.05.2025 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është administruar pranë AK me shkresën nr. 566/4 prot., datë 29.05.2025. Është mbajtur procesverbali me nr. 566/5 prot., datë 03.06.2025 për kontrollin e dokumentacioni, sipas të cilit dokumentet e paraqitura janë të plota dhe të rregullta.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 23.06.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 1684 prot., datë 31.07.2025 me afat 6 muaj.

12. Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"* këto të dhëna:

12. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.29, datë 12.06.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 29, date 12.06.2025 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.E. B. - Anëtar 3.R. D.– Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 229, datë 12.06.2025 1. A. K – (Kryetar) 2. M. H. - (Anëtar) 3. M. Z. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 32,570,466 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "K." shpk me ofertë me vlerë 25,557,647, me lidhje kontrate datë 22.09.2025, me afat 8 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 7,012,812 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 15.07.2025 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 17 OE **b)** Skualifikuar 9 OE, **c)** Kualifikuar 8 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 29 datë 12.06.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **32,570,466 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas".***
Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B.dhe R. D.(Anëtar).
Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas në masën 20 % ose 7,816,912 lekë me TVSH dhe nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile sipas VKM nr. 127, datë 28.02.2025 "Për miratimin e projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore" në masën 80% ose 31,267,648 lekë me TVSH. Për vitin 2025 financimi është në vlerën 6,253,530 lekë AKMC dhe 1,250,706 lekë Bashkia Prrenjas, ndërsa për vitin 2026 është 25,014,118 lekë nga AKMC dhe 6,566,206 lekë nga Bashkia Prrenjas.
Me urdhër nr. 206, datë 04.06.2025 të Titullarit, është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga G. B., M. K.dhe I. G.. Komisioni ka hartuar procesverbalin me nr. 1182/1 prot., datë 10.06.2025, sipas të cilit preventivi është hartuar nga studio projektuese me subjekt N... P... p.f, dhuruar me kontratën nr. 894 prot., datë 25.04.2025. Preventivi është hartuar bazuar në VKM nr. 2016, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shrkesën nr. 549/2 prot., datë 17.06.2025, administruar nga Bashkia Prrenjas me nr. 938 prot., datë 18.06.2025.
Është miratuar Leja në Infrastrukturë me nr. 14, datë 17.09.2025.
Vlerësimi i kritereve
- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.
1.Kërkesa e pikës **2** e cila kërkon ndër të tjera kategorinë e licencës NP-12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Nuk ka asnjë zë në preventiv i cili mund të konsiderohet ri riaftësim mjedisor i specializuar, projekte botanike/zoologjike etj, por janë zëra rutinë ndërtimi të pranishëm në çdo ndërtim. Zëri prerje bimë të vogla nuk justifikon kërkesën për kategorinë e inxhinierisë së mjedisit.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç., E. B.dhe R. D..

<u>Vlerësimi i ofertave</u>

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A. I. shpk	21,639,970	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Oferta e këtij OE rezulton anomalisht e ulët.
2	N. shpk	21,793,955	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Oferta e këtij OE rezulton anomalisht e ulët.
3	BOE I. shpk & J. shpk	22,110,855	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Oferta e këtij OE rezulton anomalisht e ulët.
4	C. M shpk	25,428,145	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* -Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik C. M SHPK në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) konstaton sa më poshtë: - Nuk i plotëson kapacitetet teknike për kualifikim. Operatori ekonomik C. M SHPK nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 5 të Kapacitetit Teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), për shkak se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 8), ka deklaruar znj. L. P., e cila figuron njëkohësisht në dy pozicione: • Inxhiniere Ndërtimi (Drejtuese Teknike); (e kërkuar në pikën 4 të DST); • Teknik Topograf. (i kërkuar në pikën 5 të DST). Angazhimi i një individi në dy role teknike të njëkohshme konsiderohet shkelje e kërkesave të DST, pasi një individ i vetëm nuk mund të përmbushë detyrimet në të dy funksionet njëkohësisht, sipas parashikimeve të projektit.
5	BOE I. C. and P. shpk & B. K. shpk	26,413,621	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, është përcaktuar që OE I. C. AND P. SHPK, ka 42.62% të zbatimit kontratës, ndërsa OE B. K. SHPK 57.38%. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), rezulton se oferta nuk përmbush kriteret e kapacitetit teknik të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit, konkretisht pika 3, e cila lidhet me zotërimin e licencave profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

			Më konkretisht, operatori ekonomik B. K. SHPK, në licencën e tij profesionale, **nuk përmban kategorinë NS 18-A – Punime topogjeodezike**, ndërkohë që pjesa e punimeve që do të kryejë ky operator përfshin aktivitete që i përkasin kësaj kategorie. Sipas preventivit, punimet e mëposhtme do të kryhen nga ky operator: 3.88/b – Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale me gjerësi > 2 m, në prani uji, kategoria III, me shkëmb në tokë (50% e punimeve nga B. K. SHPK) 3.396 – Mbushje me çakëll pas mureve (50% e punimeve nga B. K. SHPK) 2.262/4 – Shtresë betoni C 16/20 (60% e punimeve nga B. K. SHPK) 3.164/1b – Mbushje me çakëll e gurë gurore në trupin e rrugës, të përhapur dhe të ngjeshur me makineri (50% e punimeve nga B. K. SHPK). Për rrjedhojë, mungesa e licencës për kategorinë përkatëse përbën mospërmbushje të kapacitetit teknik/ Kriteret e Vecanta te Kualifikimit te dokumentave standarte te tenderit,të kërkuar, sipas kërkesave të DST-së dhe legjislacionit për prokurimin publik.
6	I. C. shpk	26,728,189	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nuk ka arritur te përmbushë kriterin e kërkuar sipas pikës 5 të Kapacitetit Teknik te Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të DST, Konkretisht: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se operatori ekonomik I. C. SHPK ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 8) punonjësin z. A. T., i cili figuron njëkohësisht në dy pozicione: -Inxhinier Ndërtimi (i kërkuar në pikën 4 të DST). dhe -Teknik ndërtimi(i kërkuar në pikën 5 të DST). Angazhimi i një individi në dy role teknike të njëkohshme konsiderohet shkelje e kërkesave të DST, pasi një individ i vetem nuk mund të përmbushë detyrimet në të dy funksionet njëkohësisht, sipas parashikimeve të projektit.
7	H. shpk	26,736,677	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* Nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të kërkuar sipas Shtojcës 7 "Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit", përfshirë Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit. Konkretisht, mungon Formulari i Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8, në kundërshtim me pikën 1/a të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit.
8	B. N shpk	26,978,860	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* **1.Nuk është përmbushur kriteri 2.3 i Kapacitetit Teknik** te Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi kontrata e deklaruar si punim i ngjashëm nuk është realizuar **brenda afatit kohor 5 vjeçare** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. 2. **Nuk është përmbushur kriteri 4 i Kapacitetit Teknik**, pasi **inxhinieri i ndërtimit i deklaruar nga operatori nuk rezulton i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë**, siç kërkohet në dokumentet standarde të tenderit.

9	A. shpk	24,522,890	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim/ të kapacitetit teknik sipas pikës 5 të DST: • Punonjësja D. S. është deklaruar si Teknik Ndërtimi, por rezulton e kontraktuar si Projektuese, në kundërshtim me profilin e kërkuar. • Punonjësi A. D. është deklaruar si Teknik Topograf, por zotëron diplomë për Gjeometër, që nuk përputhet me kërkesën. • Për punonjësit K. L. dhe H. Ll. mungon kontrata e punës. • Për punonjësit A. B. dhe A. Sh. (shoferë) mungojnë kontratat e punës, lejet e drejtimit dhe certifikatat e aftësisë profesionale. • Për punonjësin F. T. (eskavatorist) mungon leja e drejtimit përkatëse dhe patenta e manovrimit nga DPSHTRR. • Punonjësi B. T. (hekurkthyes) nuk figuron në listëpagesën e muajit të fundit nga data e hapjes së ofertave. 2. Nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim/ të kapacitetit teknik sipas pikës 9 të DST: -Për mjetin Kamionët vetëshkarkues (targat AB...ON dhe AB...IL), i cili është deklaruar nga operatori ekonomik si i marrë me qira, mungon tërësisht dokumentacioni provues që vërteton disponimin e tij**.** (në kundërshtim me pikën 9 të Kapaciteteve Teknike, Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit). - Për mjetin "Rul Kompresor", i cili është deklaruar nga operatori ekonomik si i marrë me qira, mungon tërësisht dokumentacioni provues që vërteton disponimin e tij. (në kundërshtim me pikën 9 të Kapaciteteve Teknike, Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit). - Për mjetin Autobotin e ujit (targa AA...YH) i cili është deklaruar nga operatori ekonomik si i marrë me qira, mungon tërësisht dokumentacioni provues që vërteton disponimin e tij**.** (në kundërshtim me pikën 9 të Kapaciteteve Teknike, Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit). -Për mjetin Autobetonierën (targa AB...KJ) i cili është deklaruar nga operatori ekonomik si i marrë me qira, mungon tërësisht dokumentacioni provues që vërteton disponimin e tij**.** (në kundërshtim me pikën 9 të Kapaciteteve Teknike, Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit). - Për mjetin Kamionçinën (targa AB...NZ) mungon: Certifikata e kontrollit teknik dhe Certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira. (në kundërshtim me pikën 9 të Kapaciteteve Teknike, Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit).
10	A. shpk	25,737,498	*Kualifikuar*
11	D. 2. shpk	27,016,941	*Kualifikuar*

12	F. shpk	25,579,679	*Kualifikuar*
13	L. VII shpk	30,733,433	*Kualifikuar*
14	O. shpk	29,157,518	*Kualifikuar*
15	S. shpk	29,194,938	*Kualifikuar*
16	Xh. shpk	28,325,103	*Kualifikuar*
17	K. shpk	25,557,647	*Kualifikuar*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 229, datë 12.06.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K (kryetar), M. H.dhe M. Z. (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 17 OE, janë kualifikuar 8 OE, dhe shpallur fitues OE "K." shpk me ofertë me 25,557,647 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,012,812 lekë**.**

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 15.07.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 05.08.2025 pasqyruar me PV përkatës. Vlerësimi i ofertave ka zgjatur 22 ditë, pra është tejkaluar me një javë afati vlerësimit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili përcakton afatin 15 ditor të kohëzgjatjes së vlerësimit për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Me shkresën nr. 1256/3 prot., datë 05.08.2025 është njoftuar OE "A." për dorëzimin e dokumentacionit. Nga KVO është mbajtur PV nr. 1256/5 prot., datë 15.08.2025 sipas të cilit janë konstatuar mangësi në dokumentacion duke skualifikuar këtë OE. Është mbajtur PV për rivlerësimin me nr. 1256/6 prot., datë 15.08.2025 dhe me shkresën nr. 1256/7 prot., datë 15.08.2025 është njoftuar OE i radhës "K." shpk për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar me shkresën nr. 1856 prot., datë 20.08.2025.

Është mbajtur PV me nr. 1856/1 prot., datë 25.08.2025 nga KVO sipas të cilit dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe i rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 08.09.2025.

Është lidhur kontrata me nr. 2174 prot., datë 22.09.2025 me afat deri 8 muaj.

A.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE OE fitues, rezulton se nuk përmbush kriteret e vendosura.

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3** për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025. Ky OE ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga Bashkia Tiranë dhe Kamëz, ndërkohë që rezulton se për vitin 2025 ka lidhur kontratë me Bashkinë Bulqizë me objekt *"Sistemim-asfaltim i rrugëve te fshatrave Zogjaj, Bllace dhe Shtushaj në Njësinë Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë"*, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim të ketë likuiduar detyrimet pranë kësaj bashkie.

2.OE mbështetës "P." shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3** për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025. Sipas ekstraktit të QKB, ky OE ka adresë në Bashkinë Vorë, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025 pranë kësaj bashkie.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **9** për mjetet dhe makineritë. Është deklaruar mjeti Autobot uji me targa AA...HC mjet i cili disponohet nga OE mbështetës "P." shpk. Certifikata e transportit për këtë mjet rezulton për vete dhe jo për të tretë dhe me qira.

Veprimet janë në kundërshtim me nenin 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: A. K (kryetar), M. H. dhe M. Z..

13. Tenderi me objekt: "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara"* këto të dhëna:

13. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.32, datë 10.07.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 32, date 10.07.2025 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.E. B. - Anëtar 3.R. D.– Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 261, datë 11.07.2025 1. A. K – (Kryetar) 2. M. H. - (Anëtar) 3. M. P. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 32,153,855 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "A." shpk me ofertë me vlerë 24,296,065, me lidhje kontrate datë 17.10.2025, me afat 5 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 7,857,790 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 10.09.2025 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Të ardhurat e bashkisë 20% -Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit 80%	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 5 OE **b)** Skualifikuar 3 OE, **c)** Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 32 datë 10.07.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **32,570,466 lekë** me objekt**: *"Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B.dhe R. D.(Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas në masën 20 % ose 7,716,903 lekë me TVSH dhe nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në masën 80% ose 30,867,723 lekë me TVSH. Për vitin 2025 financimi është në vleën 15,433,862 lekë nga Ministria dhe 3,858,465 lekë nga Bashkia Prrenjas, ndërsa për vitin 2026 është 15,433,862 lekë nga Ministria dhe 3,858,437lekë nga Bashkia Prrenjas.

Me urdhër të Titullarit me nr. 28, datë 27.06.2025 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga G. B., H. K.dhe E. K.. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me nr. 1404/1 prot., datë 27.06.2025, sipas të cilit preventivi është përllogaritur nga projektuesi i licencuar K. B., abzuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit teknik të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

Është kryer Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shkresën nr.890/2 prot., datë 16.09.2025, administruar nga Bashkia Prrenjas me nr. 1579/3 prot., datë 19.09.2025.

<u>Vlerësimi i kritereve</u>

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan disa kritere jo në përputhje me rregullat e LPP.

1.Kërkesa e pikës **4** e cila kërkon 2 inxhinier ndërtimi drejtues teknik në licencën e shoqërisë, duhej të mundësonte këtë kërkesë jo domosdoshmërisht që të dy inxhinierët të jenë drejtues teknik,

por të paktën njëri prej tyre të mund të disponohej edhe si inxhinier mbështetës pjesë e shoqërisë ose me kontraktim.
2.Kërkesa e pikës **5** e cila kërkon ndër të tjera 12 punonjës të thjesht ndërtimi, është kërkesë e cila mund të shmangej pasi punëtorët e thjesht të ndërtimit nuk janë punonjës të kualifikuar, dhe mund të klasifikoheshin si të tillë nëpërmjet kërkesës për numrin total të punonjësve të kërkuar. Përsa kohë për punonjësit e thjesht nuk kërkohen dëshmi kualifikimi, diploma etj, konsiderohet kriter i panevojshëm.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B.dhe R. D.(Anëtar).

<u>Vlerësimi i ofertave</u>

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	BOE M. shpk & A. C. shpk	29,263,836	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. -Përsa i përket përvojës së mëparshme te realizuara me institucione shtetërore OE "M. " SHPK ka paraqitur kontratën me objekt : "Rivatilizim i qendrës Gosë, Bashkia Rrogozhine", Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se kjo kontratë ka afat zbatimi nga 28.12.2018 deri më 25.08.2020, çka do të thotë se nuk është realizuar brenda periudhës 5-vjeçare nga data e shpalljes së njoftimit të kësaj kontrate (viti 2025), dhe për rrjedhojë nuk përmbush kriterin kohor të vendosur për përvojën e mëparshme. 2. Gjithashtu, është paraqitur kontrata me objekt: "Rikonstruksion i Shkollës Kotodesh", e lidhur me Bashkinë Prrenjas, kontratë e cila, sipas dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezulton të jetë realizuar në bashkëpunim me një operator tjetër ekonomik, nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi, duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik "M." sh.p.k., rezulton se nuk plotësohet vlera monetare e kërkuar në kriterin 2.3, pasi pjesa e realizuar nga ky operator nuk përmbush kufirin minimal të përcaktuar në kriter. 2.Në preventivin e paraqitur janë konstatuar mospërputhje në sasinë e zërave të punimeve, si më poshtë: • Tek preventivi për z.Z.B Në preventivin e OE-së: Nr. 3| Kodi: 2.166 | F,.V hekur betony periodic 6-10mm(Ɵ per brezin | Njësia: ton | Sasa: 1.18 Në preventivin e AK-së: Nr. 3| Kodi: 2.166 | F,.V hekur betony periodic 6-10mm(Ɵ per brezin | Njësia: ton | Sasia: 0.180 • Tek preventivi për Z. I. K. Në preventivin e OE-së: Nr. 5 | Kodi: 2.267/b | Shtrim me pllaka grez importi 40x40 | Njësia: m2| Sasia: 50

			Në preventivin e AK-së: Nr. 5 | Kodi: 2.267/b | Shtrim me pllaka grez importi 40x40 | Njësia: m2| Sasia: 80 Për sa me sipër për shkak të këtyre mospërputhjeve në sasi, preventivi i paraqitur nga BOE "M. " SHPK 79.40 % & A. C. SHPK 20.60 % nuk është në përputhje me preventivin e AK dhe konsiderohet I parregullt në përmbajtjen e tij. 3. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se OE A. C. SHPK është në rolin e subjektit mbështetës për OE K. C. SHPK në po të njëjtën procedurë, në kundërshtim me nenin 90 pika 7 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku citohet: "*7.Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit."*
2	K. C. shpk	30,186,775	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Operatori ekonomik K. C. SHPK ka paraqitur dokumentacionin e ofertës së tij, në të cilin përfshihet edhe një marrëveshje angazhimi date 10.09.2025 me subjektin mbështetës A. C. SHPK**,** për mbështetje në përmbushjen e kritereve të kualifikimit. Nga ana tjetër, rezulton se A. C. SHPK është gjithashtu anëtar i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë M. SHPK & A. C. SHPK, i cili ka paraqitur ofertën dhe ka nënshkruar marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit më datë 09.09.2025. Për sa më sipër, kemi të bëjmë me pjesëmarrje njëkohësisht si ofertues edhe si subjekt mbështetës nga operatori ekonomik (A. C. SHPK)**,** në të njëjtën procedurë prokurimi. Duke qenë se A. C. SHPK ka qenë i angazhuar më parë në ofertën e BOE "M." SHPK & A C. SHPK, çdo përfshirje e mëvonshme e tij si subjekt mbështetës në ofertën e K. C. SHPK e bën këtë të fundit të pavlefshme dhe në kundërshtim me nenin 90 pika 7 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku citohet: "*7.Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit."*
3	A. I. shpk	23,955,688	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1.Për mjetin Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton me targë AA...DC të deklaruar me qira nga OE A. I. SHPK mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 2. Për mjetin Kamion me targë AA...JN të deklaruar me qira nga OE A. I. SHPK mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike 3.Për mjetin Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton me targë AA...DC të deklaruar me qira nga OE A. I. SHPK mungon certifikata për transport mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. 4.Për mjetin Kamionçinë me targë AB...JP të deklaruar me qira nga OE A. I. SHPK mungon certifikata për transport

			mallrash brenda vendit për të tretë dhe me qira (e vlefshme), në kundërshtim me pikën 8/b të kapaciteteve teknike. *Në nenin 41 të Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, parashikohet se: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.*
4	R. C. shpk	25,162,278	*Kualifikuar*
5	A. shpk	24,296,065	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 261, datë 11.07.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K (kryetar), M. H.dhe M. P. (anëtar). Në ketë tender ka marrë pjesë 5 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe shpallur fitues OE "A." shpk me ofertë me vlerë 24,296,065 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 7,857,790 lekë.

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 10.09.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 15.09.2025 pasqyruar me PV përkatës.

Me shkresën nr. 1882/2 prot., datë 15.09.2025 është njoftuar OE "A. I." shpk për dorëzimin e dokumentacionit. Është mbajtur procesverbali për kontrollin e dokumentacionit të këtij OE me datë 24.09.2025, sipas të cilit OE nuk ka paraqitur dokumentacionin të plotë dhe të rregullt. Me shkresën nr. 1882/5 prot., datë 24.09.2025 është njoftuar OE i radhës, "A." shpk, i cili ka paraqitur dokumentacionin e administruar me nr. 1882/6 prot., datë 26.09.2025.

Është mbajtur procesverbali me nr. 1882/7 prot., datë 06.10.2025 sipas të cilit dokumentacioni i këtij OE është i plotë dhe i rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 15.10.2025.

Është lidhur kontrata me nr. 2440 prot., datë 17.10.2025 me afat 5 muaj.

14. Tenderi me objekt: *"Rikonstruksion Qendra rinore dixhitale për aftësitë e rinisë dhe punësimin dixhital youth hub"* këto të dhëna:

14. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion Qendra rinore dixhitale për aftësitë e rinisë dhe punësimin dixhital youth hub"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.40, datë 15.08.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 40, date 15.08.2025 1.Z. Ç. - Person Përgjegjës 2.E. B. - Anëtar 3.O. A. – Anëtar 4.R. D.– Anëtar 5.M. P. - Anëtar	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 309, datë 15.08.2025 1. A. K – (Kryetar) 2. G. K. - (Anëtar) 3. I. G. – (Anëtar)
4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur e thjeshtuar"		
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 8,327,895 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: OE "M. K. & R. E." shpk me ofertë me vlerë 6,714,446, me lidhje kontrate datë 06..10.2025, me afat 3 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 1,613,449 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 29.08.2025 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 6 OE **b)** Skualifikuar 2 OE, **c)** Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 40 datë 15.08.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **8,327,895 lekë** me objekt**: *"Rikonstruksion Qendra rinore dixhitale për aftësitë e rinisë dhe punësimin dixhital youth hub".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga Z. Ç. (Pers.Përgjegjës), E. B., O. A., R. D.dhe M. P. (Anëtar).
Burimi i financimit është nga Agjencia Kombëtare e Rinisë në masën 90, përcjellë Bashkisë Prrenjas me shrkesën nr. 105/2 prot., datë 11.06.2025, dhe shkresa e Ministrisë së Financave me nr. 5794 prot., datë 09.06.2025 "Për detajimin e buxhetit 2025 – 2027 për shpenzime kapitale", dhe Buxheti i Bashkisë Prrenjas në masën 10%, miratuar me Vendimin nr. 36, datë 27.06.2025 "Për miratimin e kryerjes me prioritet të investimit për projektin: "Qendra Rinore Dixhitale për Aftësitë e Rinisë dhe Punësimin – Digital Youth Hub". Ndarja e financimit është përcaktuar nëpërmjet kontratës së grantit të lidhur mes palëve, Agjencia Kombëtare e Rinisë si autoritet financues dhe Bashkisë Prrenjas në cilësinë e përfituesit me nr. 105 prot., datë 11.03.2025.
Me urdhër nr. 253, datë 01.07.2025 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga E. B., M. P. dhe E. K., të cilët kanë hartuar procesverbalin me nr. 1443/1 prot., datë 06.08.2025, sipas të cilit preventivi është hartuar nga projektuesi i licencuar Gj. P., ku disa nga zërat janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", ndërsa zërat tjerë (mobilim/teknologji), janë vendosur referuar ofertave/çmimeve të tregut.
Është miratuar Oponenca Teknike nga Instituti i Ndërtimit, dërguar me shkresën nr. 528/2 prot., datë 24.07.025, administruar nga Bashkia Prrenjas me nr. 915/3 prot., datë 28.07.2025.

Vlersimi i kritereve
- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me rregullat e LPP.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A. I. shpk	6,881,284	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. 1.Në preventivin e paraqitur nga operatori ekonomik OE "A. I." sh.p.k janë konstatuar këto mospërputhje: -*Gabim në emërtimin e punimeve në seksionin 1.* Punime prishje, zëri me numër rendor 2. Në preventivin e OE "A. I." sh.p.k. figuron: Nr Kodi Emërtimi i punimeve 2 2.426/14 Prishje suvatim muri i brendshëm Ndërsa në preventivin e Autoritetit Kontraktues figuron: Nr Kodi Emërtimi i punimeve 2 2.426/14 Prishje shtrese h/izolim tarace Ky ndryshim i emërtimit për të njëjtin kod dhe numër rendor përbën mospërputhje projektin ,preventivin dhe me dokumentet e tenderit. -Gjithashtu për të gjithë zërat në seksionin 13 të preventivit, operatori ekonomik **nuk ka paraqitur njësitë matëse përkatëse**, çka përbën mangësi në dokumentacionin teknik.
2	Ç. G. shpk	7,163,045	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Në preventivin e paraqitur janë konstatuar mospërputhje në sasinë e zërave të punimeve, si më poshtë: **Seksioni 13 – Instalime për ndriçim**

			Në preventivin e OE-së: Nr. 55 | Kodi: 2.485/g | F.V prizë shuko brenda murit 2-fazore 25A | Njësia: copë | Sasia: 20 Në preventivin e AK-së: Nr. 55 | Kodi: 2.485/g | F.V prizë shuko brenda murit 2-fazore 25A | Njësia: copë | Sasia: 40 **Seksioni 17 – Sinjalet dhe pajisjet shtesë (ngadalësues shpejtësie)** Në preventivin e OE-së: Nr. 75 | Kodi: 3.961 | F.V fidanë pemë dekorative | Njësia: copë | Sasia: 3 Në preventivin e AK-së: Nr. 75 | Kodi: 3.961 | F.V fidanë pemë dekorative | Njësia: copë | Sasia: 30 Gjithashtu në seksionin 13 të preventivit– **Instalime për ndriçim** operatori ekonomik **ka paraqitur gabim njësinë matëse për zërin me nr. rendor 60**, Në preventivin e OE-së: Nr. 60 | Kodi: 2.502 | F.V përcjellës tokëzimi Cu S=50mm2 I zhveshur | Njësia: ml | Sasia: 20 Në preventivin e AK-së: Nr. 60 | Kodi: 2.502 | F.V përcjellës tokëzimi Cu S=50mm2 I zhveshur | Njësia: m | Sasia: 20 Për sa me sipër për shkak të këtyre mospërputhjeve në sasi dhe njësi, oferta e paraqitur nga OE **"**Ç. G." sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit dhe konsiderohet e parregullt në përmbajtjen e saj.
3	D.-1 shpk	7,124,236	*kualifikuar*
4	M. shpk & A. C. shpk	6,880,336	*Kualifikuar*
5	M. shpk	6,831,239	*Kualifikuar*
6	M. K. & R. E. shpk	6,714,446	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 309, datë 15.08.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga A. K (kryetar), G. K.dhe I. G. (anëtar). Në këtë tender ka marrë pjesë 6 OE, janë kualifikuar 4 OE, dhe shpallur fitues OE "M. K. & R. E." shpk me ofertë me vlerë 6,714,446 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,613,449 lekë.

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me datë 29.08.2025, vlerësimi i të cilës është mbyllur me datë 03.09.2025 pasqyruar me PV përkatës.

Me shkresën nr. 1824/3 prot., datë 03.09.2025 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 1824/4 prot., datë 08.09.2025.

KVO ka mbajtur procesverbalin me nr. 1824/5 prot., datë 11.09.2025 sipas të cilit dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe i rregullt.

Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 19.09.2025.

Është lidhur kontrata me nr. 2324 prot., datë 06.10.2025 me afat 3 muaj.

15. Tenderi me objekt: *"Studim dhe Projektim për hartimin e projektit me objekt" Asfaltim i rrugës Stavraj, Bashkia Prrenjas"* këto të dhëna:

15. **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Studim dhe Projektim për hartimin e projektit me object" Asfaltim i rrugës Stavraj, Bashkia Prrenjas"**		
1.Urdhër Prokurimi : Nr.50, datë 03.10.2025	2.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: Nr. 50, date 03.10.2025	3.Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 421, datë 09.10.2025

4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "E hapur"	1.A. K - Person Përgjegjës 2.A. B. - Anëtar 3.G. B. – Anëtar	1. Z. Ç. – (Kryetar) 2. G. K. - (Anëtar) 3. M. Z. – (Anëtar) Ndryshuar me nr. 840, datë 07.11.2025. Zëvendësohet Z. Ç. me M. A.dhe M. Z. me M. P., i ndryshuar me nr. 494, datë 18.11.2025. Zëvendësohet M. A.me M. R..
5.Fondi Limit (pa Tvsh) 10,858,333 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese: BOE "A. MK" shpk & "H.-K 11" shpk & "H. C." shpk me ofertë me vlerë 9,665,344.17, me lidhje kontrate datë 06.03.2024, me afat 6 muaj.	7.Diferenca me fondin limit: 1,192,988.83 - lekë pa tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 03.11.2025 Ora 09:00	9.Burimi Financimit: -Buxheti i Bashkisë	10.Operatorët Ekonomikë **a)** Pjesëmarrës në tender 9 OE **b)** Skualifikuar 2 OE, **c)** Kualifikuar 7 OE
11.Ankimime AK, Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka

Me urdhër të Titullarit të AK. z. N. B. me nr. 50 datë 03..10.2025, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit **10,858,333 lekë** me objekt**: *"Studim dhe Projektim për hartimin e projektit me object" Asfaltim i rrugës Stavraj, Bashkia Prrenjas".***

Në zbatim të urdhrit të mësipërm, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga A. K (Pers.Përgjegjës), A. B. dhe G. B. (Anëtar).

Burimi i financimit është nga Buxheti i Bashkisë Prrenjas referuar VKB nr. 128, datë 26.12.2024 "Për miratimin perfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti vitit 2025,VKB nr.31 datë 30.05.2025 "Për një ndryshim të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti 2025" . Me urdhër nr. 337, datë 04.09.2025 është ngritur komisioni për hartimin e detyrës së projektimit dhe përllogaritjen së fondit limit i përbërë nga E. B., E. K., M. H., A. K. dhe A. B., të cilët kanë mbajtur PV me nr. 1995/1 prot., datë 10.09.2025 ku bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimin në planifikim territore, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimit të punimeve, sipas grupit tarifor III, pika (a) të nenit 45, nga përllogaritja kanë rezultuar vlerat minimale 11,598,413 lekë me TVSH deri në vlerën maksimale prej 13,030,000 lekë me TVSH.

Vlerësimi i kritereve

- Është mbajtur procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe firmosur nga anëtarët, në përputhje me pikën 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

A.Në lidhje me kriteret e vendosura, rezultuan përgjithësisht në përputhje me rregullat e LPP.

Vlerësimi i ofertave

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit, sipas formularit për njoftimin e fituesit
1	A. shpk & L.-I. shpk	9,826,792	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga BOE A. SHPK & L.-I. SHPK rezulton se marrëveshja e bashkëpunimit e paraqitur nuk i referohet pjesëmarrjes ne

			procedurën e prokurimit te shpallur nga bashkia Prrenjas me objekt: "Studim dhe projektim për hartimin e projektit me objekt: Asfaltim i rrugës Stravaj Bashkia Prrenjas",por ka si objekt: **"Shërbim i mbikëqyrjes se punimeve me objekt: "Rikonstruksioni i kopshteve ne Njësitë Administrative, te Bashkisë Lezhë"**.
2	B. P. shpk	0	*Skualifikuar për arsyet e mëposhtme:* 1. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
3	H.-E C. shpk	9,665,344.17	*Kualifikuar*
4	I. C. and P. shpk & T. H.C.	9,665,344.17	*Kualifikuar*
5	K. shpk	9,725,000	*Kualifikuar*
6	N. G. shpk & I. Co shpk	9,726,014	*Kualifikuar*
7	Z. &Co shpk	9,665,344.17	*Kualifikuar*
8	Z. shpk & I. D.– A. shpk	9,665,345	*Kualifikuar*
9	A. MK shpk & H-K.11 shpk & H. C. shpk	9,665,344.17	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

Me urdhër të Titullarit të AK z. N. B. me nr. 421, datë 09.10.2025, është ngritur KVO, e cila përbëhet nga Z. Ç. (kryetar), G. K.dhe M. Z. (anëtar), i ndryshuar me nr. 480, datë 07.11.2025 ku zëvendësohet Z. Ç. me M. A.(kryetar) dhe M. Z. me anëtaren M. P., i ndryshuar me nr. 494, datë 18.11.2025 ku zëvendësohet M. A.me M. R.. Në këtë tender ka marrë pjesë 9 OE, janë kualifikuar 7 OE, dhe shpallur fitues BOE "A. MK" shpk & "H.-K 11" shpk & "H. C." shpk me ofertë me vlerë 9,665,344.17 lekë me diferencë nga fondi limit në vlerën 1,192,988.83 lekë.

- Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave me procesverbalin e datës 03.11.2025. Është mbajtur PV e datë 10.12.2025 "për shtyrjen e afatit të vlerësimit në SPE, duke argumentuar ndryshimet e bëra në përbërjen e KVO të cilat kanë ndryshuar 2 herë, numrin e lartë të OE dhe kompleksitetin e dokumentacionit teknik dhe metodës së vlerësimit. Është mbajtur PV me nr. 2309/2 prot., datë 07.01.2026 për vlersimin e ofertave, duke klasifikuar në vend të parë BOE "A. MK" shpk & "H.S. 11" shpk & "H. C." shpk

Me shkresën nr. 2309/3 prot., datë 07.01.2026 është njoftuar OE fitues për dorëzimin e dokumentacionit, i cili është dorëzuar pranë AK me shkresën nr. 96 prot., datë 09.01.2025.
Është miratuar Raporti Përmbledhës me procesverbalin e datës 09.02.2026.
Është lidhur kontrata me nr. 694 prot., datë 06.03.2026 me afat 6 muaj.

Auditim mbi procedurat e prokurimit/ blerje me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025

Bashkia Prrenjas çdo vit realizon blerje të punëve, furnizimit me mallrave ose shërbime nëpërmjet edhe procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe paketës së Udhëzimeve të MF – APP[24] në periudhën 2021-2023

Nga auditimi mbi dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit për blerje me vlerë të vogël dhe Drejtoria e Financës, rezultoi si më poshtë vijon:

[24] MF Ministria e Financave
APP Agjencia e prokurimit publik

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël *për vitin 2024* është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 02 prot., datë 03.01.2024 dhe me nr. 17 prot., datë 03.01.2024;
- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël *për vitin 2025* është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 02 prot., datë 07.01.2025 dhe me nr. 48 prot., datë 07.01.2025;
Përbërja e komisioneve të çdo viti ushtrimor pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1

Komisioni i Prokurimit/Blerje me Vlerë të Vogël				
Pozicioni në komision	**Viti 2024**	**Formimi Arsimor**	**Viti 2025**	**Formimi Arsimor**
kryetar	M.R.	Juriste	M.R.	Juriste
anëtar	A.K.	Juriste	A.K.	Juriste
anëtar	R.D.	Ekonomiste	R.D.	Ekonomiste

Burimi: Bashkia Prrenjas/Punoi: Grupi auditimit

-Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Financës për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (*nga data 01 janar 2023 deri 31 dhjetor 2025*), lidhur me regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, rezultoi se ky regjistër ka pësuar dryshimet (shtim procedurash) nga regjistri fillestar, si në *tabelën 1/1*dhe *tabelën 1/2* të Aneksit/BVV.
-Nga auditimi i dokumentacionit, *rezultoi se* nga ana e Bashkisë Prrenjas janë dorëzuar në Degën e Thesarit Prrenjas çdo fillim viti buxhetor Regjistri i parashikimeve të Prokurimeve publike, konkretisht:
- *për vitin 2024* me shkresën nr. 201 prot., datë 07.01.2024; shtesat në regjistrin e prokurimeve me shkresat nr.223/1-2 prot., datë 06.02.2024 dhe 20.02.2024, sipas tabelës 1/1;
- *për vitin 2025* me shkresën nr. 160 prot, datë 20.01.2025, shtesat në regjistrin e prokurimeve me nr. 160/1-12 sipas tabelës nr. 1/2.
Janë dërguar në APP emrat e personave përgjegjës për prokurimet publike, konkretisht:
- *për vitin 2024* me shkresën nr. 38 prot., datë 04.01.2024: znj. Z.Ç., znj. M.R., znj. A.K., znj. R.D;
- *për vitin 2025* me shkresën nr.47 prot., datë 07.01.2025: znj. Z.Ç., znj. M.R., znj. A.K., znj. R.D.;
Nga sa më lartë *rezulton se* njoftimet janë bërë konform kuadrit ligjor;
- Ndryshimet në regjistrat e planifikimit të miratuar me VKB janë mbështetur në relacionin shpjegues, ku është pasqyruar nevoja për kryerjen e procedurës, burimi i financimit, ***konstatohet se*** ndryshimet në regjistrat e planifikimit të miratuar nga Titullari janë pa një relacion shpjegues bashkëlidhur, ku të pasqyrohej nevoja për kryerjen e procedurës dhe të argumentohej pamundësia për parashikim, mosveprim në mospërputhje me VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu II, neni 3 pika 7;
- Për sa më lartë ndryshimet e bëra gjatë vitit, janë si rezultat i analizave të pamjaftueshme paraprake dhe mungesës së një studimi të mirëfilltë të nevojave nga strukturat përgjegjëse për mallra, shërbime e punë, në mospërmbushje të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu I, neni 1 pika 2;
- Referuar Regjistrit të parashikimeve të procedurave të blerjeve me vlerë të vogël, miratimi fillestar dhe ndryshimet, pasqyrohen në *tabelën 2/1* dhe *tabelën 2/2* të Aneksit/BVV.
Për periudhën objekt auditimi-periudha raportuese (*nga data 01 janar 2024 deri 31 dhjetor 2025*) referuar të dhënave në *tabelën 2/1* dhe *tabelën 2/2*, rezultoi se nga AK Bashkia Prrenjas:
Në fillim të *vitit 2024* janë parashikuar 17 procedura me vlerë totale të fondit limit 11,148,560 lekë (pa tvsh), nga të cilat: 8 procedura *për mallra*, 8 procedura *për shërbime* dhe 1 procedurë *për punë*;
Në fillim *të vitin 2025* janë parashikuar 19 procedura me vlerë totale 11,732,562 lekë (pa tvsh), nga të cilat: 13 procedura *për mallra*, 6 procedura *për shërbime* dhe asnjë procedurë *për punë*;

Gjatë vitit 2025 ka patur ndryshim të regjistrit të parashikimit të procedurave të BVV me 29 procedura nga të cilat 6 për mallra dhe 23 për shërbime.
Më hollësish procedurat e prokurimit të parashikuara dhe të realizuara me "*vlerë e vogël*", sipas urdhër prokurimit pasqyrohen si në *tabelën 3/1* dhe *tabelën 3/2* të Aneksit /BVV.

- Tabelat e parashikimit

-Referuar regjistrit të parashikimeve *të vitit 2024 rezulton se*:
- Janë parashikuar 46 procedura prokurimi me BVV në vlerën totale të fondit limit 11,616,194.93 lekë, nga të cilat janë 43 procedura BVV aplikimi në SPE me fond limit në total prej 11,404,862 lekë dhe 3 procedura BVV (nën vlerën 100,000 lekë) me fond limit në total prej 211,333 lekë; dhe realizuar 35 procedura, procedura BVV në SPE janë realizuar 32 procedura në vlerën totale të kontratës së lidhur 7,827,878 lekë dhe vlerë totale të fondit limit të procedurës 9,824,357.50; nuk janë realizuar 11 procedura në vlerën totale të fondit limit 1,785,480 lekë nga të cilat 6 procedura janë kolaudim apo mbikqyrje objektesh dhe për 5 procedurat e parashikuara dhe të parealizuara në vitin 2024, nga komisioni i BVV u komunikua arsyeja është se strukturat përkatëse nuk kishin paraqitur kërkesën për zhvillimin e procedurës.
- Nga procedurat BVV (nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë), nga 43 procedura në total me fond limit prej 11,404,862 lekë janë parashikuar 43 procedura me burim financimi nga "buxheti i shtetit" në vlerën totale të fondit limit ose 100% dhe 0 procedura me burim financimi nga "fondet e veta" ose 0%;
- Janë realizuar vetëm 35 procedura nga 46 të parashikuara, por vlera e realizimit të tyre varion nga 44.5% vlera më e ulët deri në 100% vlera më e lartë; diferenca mes vlerës së kontratës dhe fondit limit të parashikuar është (-)3,577 317,lekë ose 69.2% dhe në 4 raste ka një diferencë të konsiderueshme: 44.5%, 50%, 52.8% , 64.7%. Kjo diferencë e konsiderueshme mes fondit limit dhe vlerës së kontratës, në vlerësimin e rezultuar nga auditimi ka ardhur si pasojë e *mungesës së testimit real të tregut*, duke miratuar preventiv dhe përllogaritje të fondit limit jo në vlera reale.
-Referuar regjistrit të parashikimeve *të vitit 2025, rezulton se*:
- Janë parashikuar 48 procedura prokurimi me BVV në vlerën totale të fondit limit 15,475.326 lekë, janë planifikuar 41 procedura BVV në SPE me fond limit në total prej 14,929,499 lekë dhe 7 procedura BVV (nën vlerën 100,000 lekë) me fond limit në total prej 545,827 lekë; nga të cilat nga procedurat BVV në SPE janë realizuar 33 procedura në vlerën totale të kontratës së lidhur 9,485,084 lekë dhe janë realizuar 2 procedura jashtë SPE në vlerën totale të fondit limit 166,666 lekë; janë pa realizuar 15 procedura nga të cilat 2 janë kolaudim apo mbikqyrje objekti dhe për 13 procedurat e tjera u komunikua se "blerje kompjuter" nuk u paraqit asnjë OE i njoftuar; "blerje dosje arkivi" zhvillohet si procedurë nga Arkivi Qendror, të tjerat për mosparaqitje të kërkesës nga ana e strukturave përkatëse.
- Nga procedurat BVV (nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë), janë parashikuar të gjitha procedurat me burim financimi nga "buxheti i shtetit" në vlerën totale të fondit limit 14,929,499 lekë ose 100% dhe 0 lekë me burim financimi nga "fondet e veta" ose 0%;
- Janë realizuar 34 procedura në total nga 48 procedurat e parashikuara, por vlera e realizimit të tyre varion nga 1% vlera më e ulët deri në 100% vlera më e lartë; nisur nga lloji i shërbimit duke përjashtuar "mbikqyrje dhe kolaudim punimesh", realizimi i tyre varion nga 50% deri në 100%. Janë 4 procedura që janë realizuar me një diferencë të konsiderueshme ndaj fondit të parashikuar ose në masën 50%, 57%, 64.4% dhe 69%.
Diferencat mes fondit limit dhe vlerës së kontratës e pasqyruar në tabelën 3/1 dhe tabelën 3/2 , në vlerësimin e rezultuar nga auditimi ka ardhur si pasojë e mungesës së një analize të plotë të të

dhënave të mbledhura nga tregu për përcaktimin e fondit limit, duke mos argumentuar mjaftueshëm nivelin e çmimeve të përdorura.

Efektet që krijohen nga analiza dhe konstatimet e përshkruara më lartë:

- Planifikohen më shumë fonde nga sa nevojiten, duke krijuar fonde të paangazhuara (pavarësisht faktit që trashëgohen për vitin pasardhës), të cilat mund të përdoren për financimin e procedurave të tjera prokuruese apo për mbulimin e nevojave shtesë të bashkisë;
- Mosrealizim të buxhetit në zërin "investime" apo "shpenzime operative" sipas rastit;
- Vështirësi në vlerësimin e ekonomicitetit të procedurës, pasi nuk është e qartë nëse kursimi ka ardhur nga konkurrenca apo nga mbivlerësimi fillestar i fondit limit.etj

Nga auditimi i evidencave dokumentare dhe informacionit të pasqyruar në *tabelat 3/1 dhe 3/2* të Aneksit/BVV, një informacion mbi planifikimin e procedurave për blerje me vlerë të vogël [BVV] për *mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të të njëjtës natyrë, funksioni apo subjektet në cilësinë e OE me të njëjtën fushë aktiviteti*, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Tabela nr.2/1 në lekë

Regjistri i Parashikimeve me procedurën e blerjeve me vlerë të vogël (PBVV) Bashkia Prrenjas për vitin 2024							
Nr. i Grupit	Nr	Objekti i prokurimit	Lloji i procedures	Objekti i kontrates	Fondi limit	Statusi	Totali i fondit për grup
G I	**8**	Blerje siguracioni per mjetet	BVV	SHERBIM	652,894.00	realizuar	**1,002,894.00**
	10	Blerje siguracioni per punonjesit e MZSH		Sherbime	350,000.00		
G 2	**22**	Blerje dhe mirëmbajtje orendish për çerdhen dhe kopështin ,Bashkia Prrenjas	-//-	-//-	621,300.00	realizuar	787,967.00
	31	Blerje dhe mirembajtje orendish per cerdhe dhe kopesht Bashkia Prrenjas		mallra	166,667.00	Pa realizuar	
G 3	**16**	Blerje materiale per riparime, sistemime dhe mirembajtje rrjetit ujites dhe kullues	-//-	mallra	816,667.00	realizuar	**1,164,667.00**
	35	Mbrojtja dhe rehabilitimi i tokave te demtuara, ndertim i mureve mbajtese dhe argjinaturave te ndryshme		punë	348,000.00	Pa realizuar	

Tabela nr.2/2..ë lekë

Regjistri i Parashikimeve me procedurën e blerjeve me vlerë të vogël (PBVV) Bashkia Prrenjas për vitin 2025							
Nr. i Grupit	Nr	Objekti I prokurimit	Lloji I procedures	Objekti I kontrates	Fondi limit	statusi	Totali i fondit për grup
G 1	**20**	Siguracion mjetesh	BVV		628,335.00	realizuar	978,335.00
	24	Sigurim punonjesish MZSH			350,000.00		
G 2	**18**	Blerje paisje mobilerie per kopshtin Sutaj	-//-		250,000.00	realizuar	**1,050,000.00**
	26	Blerje dhe mirembajtje orendish per cerdhe dhe kopesht Bashkia Prrenjas			800,000.00		
G 3	**21**	Blerje materiale për rrethimin e Shkollës së Mesme Arif Kuka Karkavec			212,500.00	realizuar	879,166.00
	38	Blerje materiale per riparime,sistemime dhe mirembajtje rrjetit ujites dhe kullues			666,666.00		
G 4	**39**	Blerje Gazi			83,328.36	Pa realizuar	166,656.72
	40	Blerje gazi			83,328.36		

Punoi:Grupi i auditimit

Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar në tabelën 2/1 dhe tabelën 2/2, ***rezultoi se***: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta*, janë parashikuar* me fonde të copëzuara: *për vitin 2024* në 3 raste, prej të cilave 2 raste janë në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, respektivisht vlera totale të fondit limit pa tvsh për G1 – 1,002,894 lekë dhe G3 – 1,164,667 lekë[25]; *për vitin 2025* në 4 raste, prej të cilave vetëm në 1 rast në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë: G2- 1,050,000 lekë, por nisur nga natyra e shërbimit, fondi është përllogaritur në varësi të investimeve në proces dhe vlera e tejkaluar është relativisht e vogël. Për sa më lart në hartimin e regjistrit të parashikimeve *duhet të kihen në vëmendje* kërkesat e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik", Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 "Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Nga auditimi *rezultoi se*, gjatë periudhën në auditim 2024-2025, ka praktika të BVV pa iu nënshtruar proçedurës elektronike në SPE.

- Kështu *për vitin 2024* janë parashikuar 3 procedura në vlerën totale të fondit limit 211,333 lekë dhe janë realizuar të 3 procedurat me vlerë totale të kontratës (faturës) prej 211,000 lekë;
- *për vitin 2025* janë parshikuar 7 procedura në vlerën totale të fondit limit 545,827 lekë dhe janë realizuar vetëm 2 procedura me vlerë totale të kontratës (faturës) prej 149,000 lekë.
- Nuk ka procedura BVV nën vlerën 100,000 lekë ***emergjente***.

Auditimi i dosjeve të përzgjedhura nga regjistri i realizimeve për procedurat me BVV në SPE.

Viti 2024

Procedura "Blerje pajisje kompjuterike, Bashkia Prrenjas" (Ref -14738)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV;
- Kërkesa e strukturës së: DJPPBNJ, DFBSHS, DPZHTAP, DATTV, PB, datë 15.07.2024;
- Formulari i deklarimit (shtojca 1);
- Urdhri i Kryetarit nr. 346 datë 18.07.2024 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike" me nr. 1963 prot., datë 18.07.2024;
- Anëtarë komisioni: L.A., A.B., N.B.;
- Përcaktimi i specifikimeve teknike, Fondi në buxhet i parashikuar – 716,650 lekë pa tvsh për 12 artikuj/383 copë+ formulari i deklarimit (shtojca 1) i plotësuar sipas rubrikave;
- Kërkesa për studim tregu +Testimi i tregut – janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 41 datë 29.07.2024 me nr. 2036 prot., datë 29.07.2024; Ftesë për ofertë nr. 2036/1 prot., datë 29.07.2024 + Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike datë 18.07.2024;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 29.07.2024, 39 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – 3 copë datë 30.07.2024;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve në SPE datë 05.08.2024;
- Njoftimi i fituesit në SPE datë 02.08.2024+konfirmimi për tërheqje datë 05.08.2024;

[25] G - numri i grupit referuar kolonës së parë të tabelës;

- Proces verbali për kalimin tek OE i radhës datë 06.08.2024;
- Vendimi nr. 118 datë 12.08.2024 dhe ne nr. 2130 prot., datë 12.08.2024 "Për shpallje fituesi"
- Urdhri i Kryetarit nr.373 datë 12.08.2024 "Për marrjen në dorëzim të mallit" me nr. 2132 prot., datë 12.08.2024; Anëtarët: L.A., S.D., V.A.;
- Proces verbali i marrjes në dorëzi të mallit nr, 2131/1 prot., datë 16.08.2024
- Dokumentacion i SPE- në dosje;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 2091 prot., datë 06.08.2024 e subjektit fitues "E. H." PF – M.....S; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim mbi detyrimet në OSHEE/FSHU, në DPT dhe DTTV, licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softwer-it, deklarata e konfliktit të interesit ***mungon*** etj.

Procedura "Blerje detergjente, Bashkia Prrenjas" (Ref -16601)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV - ***mungon*** ;
- Kërkesa e strukturës DASK datë 16.08.2024
- Formulari i deklarimit (shtojca 1) datë 19.08.2024;
- Urdhri i Kryetarit nr. 380 datë 19.08.2024 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit" me nr. 2169 prot., datë 19.08.2024;
- Anëtarë komisioni: A.R., A.K., L.T.;
- Proces verbali datë 19.08.2024 "Për përllogaritjen e fondit limit", Fondi në buxhet i parashikuar 833,333 lekë pa tvsh për 24 artikuj+Plani i shpërndarjes së mallit datë 19.08.2024 + formulari i deklarimit (shtojca 1) datë 20.08.2024;
- Testimi i tregut – kërkesa nr. 2169/1 prot., datë 19.08.2024/ janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 44 datë 20.08.2024 me nr. 2175 prot., datë 20.08.2024; Ftesë për ofertë nr. 2175/1 prot., datë 20.08.2024 + Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike datë 20.08.2024;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 21.08.2024, 29 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – 3 copë datë 20.08.2024;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve në SPE datë 21.08.2024;
- Njoftimi i fituesit në SPE datë 22.08.2024;
- Vendimi nr. 125 datë 04.09.2024 me nr. 2273 prot., datë 04.09.2024 për shpalljen fitues të OE "I & C" me NIPT- M.....H;
- Kontrata nr. 2274 prot, datë 04.09.2024;
- Urdhri i Kryetarit nr.389 datë 04.09.2024 "Për marrjen në dorëzim të mallit/detergjent" me nr. 2275 prot., datë 04.09.2024; Anëtarët: A.R., A.K., V.A. + proces verbali i marrjes në dorëzim datë 16.09.2024;
- Dokumentacion i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 2175/2 prot., datë 22.08.2024 e subjektit fitues "I & C" me NIPT-M.....H; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim mbi detyrimet në DPT, FSHU, DTTV, licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softëer-it, deklarata e konfliktit të interesit etj.
- Procedura "Blerje stufa zjarri, Bashkia Prrenjas" (Ref -97025)
- Inventari i dosjes së prokurimit BVV - ***mungon***;
- Kërkesa e strukturës DASK datë 12.09.2024;
- Formulari i deklarimit datë 16.09.2024 (shtojca 1);

- Urdhri i Kryetarit nr. 411 datë 16.09.2024 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit" me nr. 2366 prot., datë 16.09.2024;
- Anëtarë komisioni: A.R., A.K., L.T.;
- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike, Fondi në buxhet i parashikuar – 415,900 lekë pa tvsh për 5 artikuj+ formulari i deklarimit (shtojca 2) datë 16.09.2024;
- Kërkesë për studim tregu nr. 2366/1 prot., datë 16.09.2024 +Testimi i tregut – janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 47 datë 16.09.2024 me nr. 2367 prot., datë 16.09.2024;
- Ftesë për ofertë nr. 2367/1 prot., datë 16.09.2024+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike datë 16.09.2024;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 16.09.2024, 16 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 17.09.2024:
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve në SPE datë 17.09.2024;
- Njoftimi i fituesit vendi I në SPE datë 017.09.2024; mosparaqitje e OE i vendit të parë; Proces verbali për kalimin tek OE i radhës datë 18.09.2024, datë 20.09.2024, të cilët janë tërhequr;
- Proces verbali për kalim te OE i radhës datë 23.09.2024, rezultojnë 2 subjekte ofertuese;
- Njoftim hedhje shorti shkresa datë 23.09.2024;
- Proces verbali i hedhjes së shortit datë 24.09.2024; njoftim i palës së klasifikuar i pari dhe tërheqja datë 25.09.2024;
- Proces verbali për kalim te OE i radhës datë 25.09.2024, njoftimi i fituesit të radhës në SPE dhe konfirmimi datë 26.09.2024;
- Vendimi nr. 136 datë 01.10.2024 dhe nr. 2499 prot. datë 01.10.2024 për shpalljen e OE fitues "E. B." me NIPT-M.....U;
- Kontrata nr. 2504 prot., datë 01.10.2024;
- Urdhri i Kryetarit nr.442 datë 01.10.2024 "Për marrjen në dorëzim të mallit" me nr. 2505 prot., datë 01.10.2024; Anëtarët: A.R., K.L., V.A.;
- Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit datë 10.10.2024;
- Dokumentacion i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 3935/3 prot., datë 12.12.2024 e subjektit fitues "O. H."– L. R; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim mbi detyrimet në OSHEE /FSHU, DPT, DTTV; licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softwer-it, deklarata e konfliktit të interesit ***mungon*** etj.

Nga auditimi i 3 procedurave BVV të përzgjedhura dhe i dokumentimit të tyre për *vitin 2024*, rezultoi se: fletë e inventarit të dosjes mungonte në të 3 procedurat, në 1 rast nuk është respektuar subjekti i radhës i cili i është nënshtruar procedurës së shortit, deklarata e konfliktit të interesit të OE fitues mungonte në të 3 procedurat, raporti përmbledhës mungonte në të gjitha rastet;

Viti 2025

Procedura "Blerje kondicionerë, Bashkia Prrenjas" (Ref -47450)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV - ***mungon***;
- Kërkesa nga SITP për blerje kondicionerësh nr. 460 prot., datë 21.02.2025
- Formulari i deklarimit datë 25.06.2025 (shtojca 1);
- Urdhri i Kryetarit nr. 244 datë 25.06.2025 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike" me nr. 1377 prot., datë 25.06.2025;
- Anëtarë komisioni: L.A., E.B., L.T.;

- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike nr. datë 25.06.2025, Fondi në buxhet i parashikuar – 416,600 lekë pa tvsh për 43 artikuj + plani i shpërndarjes +formulari i deklarimit (shtojca 1) datë 27.06.2025;
- Kërkesë për studim tregu nr. 1377/1 prot., datë 25.06.2024 +Testimi i tregut – janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 31 datë 16.06.27.06.2025 me nr. 1394 prot., datë 27.06.2025; Ftesë për ofertë nr. 1394/3 prot., datë 03.07.2025+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike datë 03.07.2025;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 03.07.2025, 40 subjekte kanë paraqitur ofertat datë 04.07.2025;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 04.07.2025;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve të kualifikuara në SPE datë 07.07.2025;
- Njoftimi i fituesit në SPE +konfirmimi i subjektit datë 07.07.2025; OE nuk ka dorëzuar dokumentacion të plotë sipas kërkesave, skualifikohet;
- Procesverbali dhe njoftimi në SPE i fituesit pasardhës datë 09.07.2025;
- Vendimi nr. 98 datë 16.07.2025 dhe me nr. 1565 prott., datë 16.07.2025 "Për shpalljen e Fituesit"
- Urdhri i Kryetarit nr.273 datë 16.07.2025 "Për marrjen në dorëzim të mallit" me nr. 1567 prot., datë 16.07.2025; Anëtarët: L.A., E.N., V.A.;
- Kontrata nr. 1566 prot., datë 16.07.2025;
- Proces verbali i marrjes në dorëzim nr. 1567/1 prot., datë 18.07.2025;
- Dokumentacion i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 1394/4 prot., datë 08.07.2025 e subjektit fitues "E. A. C." shpk, me Nipt - M.....T; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim i DPT, DTTV, Vertetim nga FSHU ***mungon***; licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softwer-it, deklarata e konfliktit të interesit etj.

Procedura "Blerje materiale per çerdhe e kopshte, Bashkia Prrenjas" (Ref -44309)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV - ***mungon***;
- Kërkesa nga përgjegjëse e kopshte e çerdhe, për blerje materiale nr. 734 prot., datë 28.03.2025
- Formulari i deklarimit datë 28.03.2025 (shtojca 1);
- Urdhri i Kryetarit nr. 122 datë 28.03.2025 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit" me nr. 737 prot., datë 25.03.2025;
- Anëtarë komisioni: D.Ç., A.K., I.N.;
- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike nr. 2545/1 prot., datë 09.04.2025, Fondi në buxhet i parashikuar – 500,000 lekë pa tvsh për 23 artikuj+ formulari i deklarimit (shtojca 1) datë 09.04.2025;
- Kërkesë për paraqitje oferte studim tregu nr. 737/1 prot., datë 28.03.2025+Testimi i tregut – janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 16 datë 09.04.2025 me nr. 810 prot., datë 09.04.2025; Ftesë për ofertë nr. 810/1 prot., datë 09.04.2025+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike datë 09.04.2025;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 21.07.2025, 33 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 10.04.2025;

- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve të kualifikuara në SPE datë 10.04.2025/ Klasifikimi i OE;
- Njoftimi i fituesit në SPE datë 10.04.2025 +njoftimi i subjektit për tërheqje;
- Njoftimi i fituesit vendi II në SPE datë 11.04.2025+ njoftimi i subjektit për tërheqje
- Njoftimi i fituesit vendi III në SPE datë 14.04.2025+ njoftimi i subjektit për tërheqje
- Njoftimi i fituesit vendi IV në SPE datë 16.04.2025+ njoftimi i subjektit për tërheqje;
- Njoftimi i fituesit vendi V në SPE datë 17.04.2025+ konfirmimi i subjektit;
- Vendimi i Kryetarit nr.63 datë 02.05.2025 "Për shpalljen e fituesit" me nr. 945 prot., datë 02.05.2025;
- Urdhri nr. 160 datë 02.05.2025 "Për komisionin e marrjes në dorëzim të mallit"; Anëtarët: A.K., A.O., V.A.;
- Kontrata nr. 946 prot., 02.05.2025;
- Proces verbali i marrjes në dorëzim nr. 947/1 prot., datë 15.05.2025;
- Dokumentacion i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 870 prot., datë 18.04.2025 e subjektit fitues "N. H." PF– L.....Q; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim i DPT, FSHU, Vërtetimi i TTV ***mungon***; Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softëer-it, deklarata e konfliktit të interesit etj.

Procedura "Blerje pajisje dhe materiale gadishmërie për MZSH, Bashkia Prrenjas" (Ref – 50174)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV;
- Kërkesa nga përgjegjësi i MZSH për blerje pajisje e materiale nr. 316 prot., datë 04.02.2025
- Formulari i deklarimit datë 04.02.2025 (shtojca 1);
- Urdhri i Kryetarit nr. 51 datë 04.02.2025 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit" me nr. 317 prot., datë 04.02.2025;
- Anëtarë komisioni: Xh.F., F.H., E.Rr.;
- Kërkesë për studim tregu nr. 317/1 prot., datë 04.02.2025+ testimi i tregut-janë marrë 3 oferta
- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike nr. datë 04.02.2025, Fondi në buxhet i parashikuar – 917,000 lekë pa tvsh për 12 artikuj + formulari i deklarimit (shtojca 1) –data e deklarimit 04.02.2025;
- Kërkesa për studim tregu nr. 317/1 prot., datë 04.02.2025+Testimi i tregut – janë marrë 3 oferta;
- Procesverbali i miratimit të çmimeve (ofertës më të mirë) - ***mungon***
- Urdhër prokurimi nr. 27 datë 04.06.2025 me nr. 1179 prot., datë 04.06.2025; Ftesë për ofertë nr. 1179/1 prot., datë 04.06.2025+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike data e miratimit 04.06.2025;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 04.06.2025, 23 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 05.06.2025;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve të kualifikuara në SPE datë 09.06.2025;
- Njoftimi i fituesit në SPE +konfirmimi i subjektit për mospjesëmarrje datë 10.06.2025; Njoftimi i fituesit II në SPE + konfirmimi për pjesëmarrje datë 11.06.2025;
- Vendimi nr. 93 datë 30.06.2025 "Për shpalljen e fituesit" me nr.1425 prot., datë 30.06.2025 subjekti "N. H." PF

- Urdhri i Kryetarit nr.252 datë 30.06.2025 "Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit" me nr. 1427 prot., datë 30.06.2025; Anëtarët: Xh.F., I.G., V.A.;
- Kontrata nr. 1426 prot., 30.06.2025;
- Proces verbali i marrjes në dorëzim nr. 1427/1 prot., datë 11.07.2025;
- Dokumentacioni i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 1179/2 prot., datë 11.06.2025 e subjektit fitues "N. H." PF– L.....Q; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, Vërtetim nga DPT dhe FSHU, Vërtetim i detyrimeve nga DTTV ***mungon***; licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softwer-it, deklarata e konfliktit të interesit ***mungon*** etj.

Procedura "Blerje uniforme për MZSH, Bashkia Prrenjas" (Ref -49289)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV;
- Kërkesa nga përgjegjësi i MZSH për blerje uniformash nr. 318 prot., datë 04.02.2025
- Urdhri i Kryetarit nr. 52 datë 04.02.2025 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit & specifikimeve teknike" me nr. 319 prot., datë 04.02.2025;
- Anëtarë komisioni: Xh.F., F.H., E.Rr.;
- Formulari i deklarimit datë 04.02.2025 (shtojca 1) dhe datë 28.05.2025;
- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike nr. datë 04.02.2025, Fondi në buxhet i parashikuar – 226,400 lekë pa tvsh për 5 objekte + formulari i deklarimit (shtojca 1) – data e deklarimit 03.04.2025;
- Kërkesë për studim tregu nr. 319/1 prot., datë 04.02.2025+ testimi i tregut-janë marrë 3 oferta;
- Urdhër prokurimi nr. 25 datë 28.05.2025 me nr. 1112 prot., datë 28.05.2025; Ftesë për ofertë nr. 1112/1 prot., datë 28.05.2025+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike data e miratimit 28.05.2025;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 28.05.2025, 29 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 29.05.2025;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve të kualifikuara në SPE datë 29.05.2025;
- Njoftimi i fituesit në SPE +konfirmimi i subjektit për pjesëmarrje datë 30.05.2025;
- Vendimi nr. 90 datë 24.06.2025 "Për shpalljen e EO fitues" me nr. 1352 prot., datë 24.06.2025;
- Urdhri i Kryetarit nr.243 datë 24.06.2025 "Për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të Mallit" me nr. 1354 prot., datë 24.06.2025; Anëtarët: K.B., L.A., V.A.;
- Kontrata nr. 1353 prot., 24.06.2025;
- Proces verbali i marrjes në dorëzim nr. 1354/1 prot., datë 27.06.2025;
- Dokumentacioni i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 1112/2 prot., datë 30.05.2025 e subjektit fitues "M." shpk– K.....N; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim i detyrimeve nga DPT, FSHU, nga DTTV ***mungon***; licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softëer-it, deklarata e konfliktit të interesit ***mungon*** etj.

Procedura "Blerje mallra festivë për dekorimin e qytetit, Bashkia Prrenjas" (Ref -68057)

- Inventari i dosjes së prokurimit BVV;
- Kërkesa e Sektorit Mirëmbajtje Objekteve, ndriçimit e dekorit me nr. 2537 prot., datë 28.10.2025;

- VKB nr. 44 datë 27.06.2025 "Për ndryshim të PBA 2025-2027 dhe Projekt Buxhetit të vitit 2025" me nr. 724 prot., datë 01.07.2025, konfirmimi nga Prefekti i Qarkut Elbasan,
- Formulari i deklarimit datë 29.10.2025 (shtojca 1);
- Urdhri i Kryetarit nr. 459 datë 29.10.2025 "Për ngritjen e komisionit për përllogaritjen e fondit limit" me nr. 2553 prot., datë 29.10.2025;
- Anëtarë komisioni: E.D., Y.K., M.K.;
- Proces verbali i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike nr. 1417/1 prot., datë 07.04.2025, Fondi në buxhet i parashikuar – 815,000 lekë pa tvsh për 91 artikuj + formulari i deklarimit (shtojca 1) – data e deklarimit 29.10.2025;
- Kërkesë për studim tregu + Testimi i tregut –janë marrë **2** oferta (1 më pak);
- Urdhër prokurimi nr. 56 datë 07.11.2025 me nr. 2650 prot., datë 07.11.2025; Ftesë për ofertë nr. 2650/1 prot., datë 07.11.2025+ Proces verbali i miratimit të specifikimeve teknike data e miratimit 07.11.2025;
- Proces verbali i hapjes së tenderit datë 07.11.2025, 26 subjekte kanë paraqitur ofertat;
- Formularët e deklarimit (shtojca 2) – datë 10.11.2025;
- Proces verbali i vlerësimit të ofertave + radhitja e subjekteve të kualifikuara në SPE datë 10.11.2025;
- Njoftimi i fituesit I në SPE +njoftimi i subjektit të parë për tërheqje datë 11.11.2025; Njoftimi i fituesit II në SPE +konfirmimi i subjektit të dytë për tërheqje datë 12.11.2025;
- Njoftimi i fituesit III në SPE +konfirmimi i subjektit të dytë për pjesëmarrje datë 13.11.2025
- Urdhri i Kryetarit nr.501 datë 20.11.2025 "Për monitorimin dhe zbatimin e kontratës" me nr. 2762 prot., datë 20.11.2025; Anëtarët: E.D., B.L., V.A.;
- Kontrata nr. 2761 prot., 20.11.2025;
- Proces verbali i marrjes në dorëzim dhe ndjekien e zbatimit të kontratës nr. 2762/1 prot., datë 04.12.2025;
- Dokumentacioni i SPE;
- Raporti përmbledhës – ***mungon;***
- Praktika dokumentare nr. 2650/2 prot., datë 13.11.2025 e subjektit fitues "M. O." PF– M.....G; Formulari i Of. Ekonomike, Ekstrakti QKB, vërtetim i detyrimeve nga DTVendore, FSHU, Vërtetim nga DTTV ***mungon***; licenca, Çertifikatë tatimore, marrëveshja e paketës softwer-it, deklarata e konfliktit të interesit të OE ***mungon*** etj.

Nga auditimi i 5 procedurave BVV të përzgjedhura dhe i dokumentimit të tyre për vitin 2025, rezultoi se: fleta e Inventarit të dosjes mungon në të 5 procedurat, vërtetim nga TTV mungon në 4 raste; vërtetim nga FSHU mungon në 1 rast, raporti përmbledhës mungon në të gjitha rastet, deklarata e konfliktit të interesit të OE fitues mungon në të gjitha rastet;

Mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu I neni 1, neni 2/pika 1 e 2, neni 84;

Konkluzion: Mangësitë e konstatuara në administrimin e dosjeve të procedurave BVV të audituara, tregojnë dobësi në zbatimin e kërkesave dokumentare dhe të kontrollit administrativ, duke cenuar plotësinë, gjurmueshmërinë dhe transparencën e procedurave të prokurimit.

≠Mbajnë përgjegjësi Komisioni i BVV të çdo viti respektiv: 2024 dhe 2025

Pretendimi i Subjektit: Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit të përcjella në PRA, nëpërmjet shkresës nr. 920/72 prot., datë 09.09.2026 (i subjektit Bashkia Prrenjas) rregjistruar në KLSH me nr. 380/12 prot., datë 11.09.2026, janë përcjellë pretendimet e drejtorisë juridike dhe shërbimeve mbështetëse si vijon:

Lidhur me konstatimin e auditimit "në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të audituara për periudhën 2024–2025 janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e dosjeve, konkretisht: mungesa e fletës së inventarit të dosjes në 5 procedura, mungesa e vërtetimit nga TTV në 4 raste, mungesa e vërtetimit nga FSHU në 1 rast, mungesa e raportit përmbledhës dhe mungesa e deklaratës së konfliktit të interesit të operatorit ekonomik", ju sqarojme si me poshte vijon:

- Procedurat objekt auditimi janë procedura prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", të ndryshuar. Për shkak të natyrës, objektit dhe vlerës së këtyre blerjeve, procedura e ndjekur ka qenë e thjeshtuar dhe dokumentacioni i kërkuar nga operatorët ekonomikë është përcaktuar në ftesat për ofertë dhe në dokumentacionin përkatës të procedurës.
- Në lidhje me vërtetimet nga TTV, sqarojmë se në 4 rastet e evidentuara nga auditimi, ky dokument nuk ka qenë i përcaktuar si dokument i kërkuar në ftesën për ofertë. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë nuk kanë pasur detyrim procedural për ta paraqitur atë dhe mungesa e këtij dokumenti në dosje lidhet me faktin se ai nuk ka qenë pjesë e dokumentacionit të kërkuar për procedurat konkrete.
- Për sa i përket vërtetimit nga FSHU per proçedurën e prokurimit me objekt "Blerje kondicionere për Bashkinë Prrenjas", sqarojmë se është pjesë e dosjes dhe do jua dergojme nje kopje bashkangjitur .
- Për sa i përket ofertave për studimin e tregut per proçedurën e prokurimit me objekt "Blerje mallra festivë për dekorimin e qytetit Bashkia Prrenjas", sqarojmë se ofertat janë pjesë e dosjes dhe do jua dergojme nje kopje bashkangjitur .
- Sa i përket fletës së inventarit të dosjes, sqarojmë se kjo mangësi ka të bëjë me administrimin dhe sistemimin fizik të dokumentacionit dhe jo me mungesën e veprimeve procedurale të kryera në sistemin e prokurimit. Dokumentacioni kryesor i procedurave dhe gjurma e veprimeve të kryera janë administruar në kuadër të procedurave përkatëse.
- Në lidhje me raportin përmbledhës, institucioni sqaron se bëhet fjalë për procedura me vlerë të vogël dhe me natyrë të thjeshtuar. Megjithatë, duke marrë në konsideratë konstatimin e auditimit dhe me qëllim garantimin e plotësisë së dokumentacionit të dosjes, institucioni do të marrë masa që në vijim raportimi dhe dokumentimi përfundimtar i procedurave të kryhet për të gjitha dosjet.
- Sa i përket deklaratës së konfliktit të interesit të operatorit ekonomik, pranojmë se administrimi i saj në dosje përbën një element dokumentues që duhet të përmirësohet. Në vijim do të sigurohet që dokumentacioni i kërkuar dhe deklarimet përkatëse të administrohen dhe të jenë pjesë e dosjes së çdo procedure, sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se mangësitë e konstatuara janë kryesisht të karakterit formal dhe dokumentues, të lidhura me plotësimin dhe sistemimin e dosjeve, dhe nuk kanë ndikuar në përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë, në rezultatin e procedurave apo në realizimin e objektit të blerjeve.

Gjithashtu, nga procedurat e audituara nuk rezulton që këto mangësi të kenë shkaktuar dëm ekonomik apo pasojë financiare për institucionin, ndërkohë që blerjet janë kryer për nevoja konkrete të institucionit dhe në funksion të përmbushjes së objektit të tyre.

Për sa më sipër, institucioni i konsideron të vlefshme rekomandimet e auditimit për përmirësimin e dokumentimit dhe standardizimin e dosjeve të blerjeve me vlerë të vogël, duke marrë masat e nevojshme që në vijim çdo procedurë të dokumentohet në mënyrë të plotë, të qartë dhe të gjurmueshme, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 285/2021, të ndryshuar dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Përsa më lart kërkojme rishikimin dhe mos përfshirjen në Raportin përfundimtar, ngarkimin me përgjegjësi të antarëve të komisionit te blerjeve me vlerë të vogël në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël për vitet 2024-2025".

Qëndrimi i grupit të auditimi: Lidhur me pretendimet tuaja të përshkruara më lart, referuar kuadrit ligjor mbi të cilin mbështeten konstatimet e grupit të auditimit, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

- Lidhur me paragrafët 1,2 dhe 3 ju sjellim në vëmendjen tuaj se referuar pikës 15 të Udhëzimit nr.5 datë 25.06.2021, anëtarët e komisionit BVV bëjnë verifikimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit të operatorit (sipas shtojcës 9) në 2 momente: pas hapjes së ofertave në sistem, shqyrtojnë paraprakisht nëse operatorët kanë dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit të plotësuar dhe përpara se komisioni të marrë vendimin përfundimtar për shpalljen e fituesit, ai ka detyrimin të verifikojë vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në Formular. Verifikimi në momentin 2 bëhet duke administruar dokumentet provuese zyrtare vetëm për operatorin e renditur në vend të parë; që të bëhet verifikimi nga komisioni i BVV, duhet që të jenë pjesë e kritereve kualifikuese në DST, referuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 i ndryshuar, VKM nr. 285/2021 i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5 /2021;
- Lidhur me paragrafin 3, vertetimi nga OSHEE I dates 30.06.2025 merret në konsideratë;
- Lidhur me paragrafin 4, dokumentet per ofertat e tregut dhe procesverbali i datës për proçedurën e prokurimit me objekt "Blerje mallra festivë për dekorimin e qytetit Bashkia Prrenjas" merret në konsideratë;
- Lidhur me paragrafin 5,6 dhe 7, konfirmoni konstatimet e grupit të auditimit;
Për sa më lart, referuar paketës ligjore të procedurave të prokurimit publik/BVV, mosveprimet nga komisioni BVV i autoritetit kontraktor nuk kanë siguruar dokumentimin e nevojshëm për verifikimin e statusit tatimor të operatorëve fitues. Pra grupi i auditimit e *merr pjesërisht në konsideratë*.

Nga auditimi mbi përbërjen e komisioneve të marrjes në dorëzim, rezulton se anëtarët e komisioneve të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve/punëve të prokuruara, përgjithësisht zotërojnë njohuritë teknike dhe profesionale të nevojshme mbi tipologjinë dhe specifikat e objektit të kontratës, duke garantuar kryerjen e një vlerësimi dhe verifikimi të përshtatshëm të përmbushjes së kërkesave kontraktuale.

Regjistri i Realizimit të procedurave BVV të secilit vit 2024 dhe 2025 janë bashkëlidhur aneksit të Akt Konstatimit

- Tabelat e realizimit

- Nga auditimi i regjistrit të procedurave BVV të realizuara në vitet 2024 dhe 2025 pasqyruar në mënyrë të detajuar në *regjistrat e realizimit n*ë Aneks/BVV, një informacion mbi subjektet që kanë fituar tenderat rezulton si në *tabelat 4/1 dhe 4/2* të Aneksit/BVV.
- *Për vitin 2024* sipas *tabelës 4/1* të Aneksit /BVV, janë zhvilluar 35 procedura prokurimi BVV nga 22 subjekte: subjekti "L.-G." ka fituar 5 procedura prokurimi BVV me vlerë totale 821,975 lekë; subjekti "I. -18" ka fituar 4 procedura prokurimi BVV me vlerë totale 105,214 lekë; "R. 95" ka fituar 3 procedura prokurimi 100,797 lekë; subjektet: "K. 20. C.", "F." dhe "P. D. 19" kanë fituar nga 2 procedura prokurimi BVV seicili me vlerën totale respektive: 85,386 lekë, 431,789 lekë, dhe 7,210 lekë; 17 subjekte kanë fituar nga 1 (një) procedurë prokurimi BVV me vlerën totale 6,486,507 lekë;
- *Për vitin 2025* sipas *tabelës 4/2* të Aneksit/BVV, janë zhvilluar 34 procedura prokurimi BVV nga 25 subjekte: subjektet: "V. E." dhe "N. H." kanë fituar 2 procedura prokurimi BVV me vlerë totale 1,951,246 lekë; subjektet: "B. P.", "AL-Dok", "H. G. C.", "E. M." kanë fituar nga 2 procedura secili në vlerën totale 1,557,836 lekë dhe 19 subjekte kanë fituar nga 1 (një) procedurë prokurimi BVV me vlerën totale 6,142,668 lekë.

Konkluzion: Nga analiza e shpërndarjes së procedurave të prokurimit BVV, rezulton se kontratat janë fituar nga një numër i konsiderueshëm operatorësh ekonomikë, pa u evidentuar përqëndrimi i tyre tek të njëjtët operatorë.

- Nga auditimi i regjistrit të realizimeve pasqyruar në tabelën 2/1 dhe në tabelën 2/2 *rezulton se*: *për vitin 2024* nga 3 procedura të grupuara sipas të njëjtit mall/grupmall apo shërbim/grupshërbim, janë realizuar vetëm 2 procedurat e **G1** me vlerë totale prej 1,002,894 lekë;

<u>për vitin 2025</u> nga 4 grup procedurash sipas të njëjtit mall/grupmall apo shërbim/grupshërbim janë realizuar 3 procedurat e **G1, G2** dhe **G3** nga të cilat vetëm procedurat e G2 janë me vlerë totale prej 1,050,000 lekë mbi fondin limit të procedurës BVV;
Pra për periudhën 2024 -2025 janë realizuar 2 grup procedurash BVV për mallra/grupmallra apo shërbime/grupshërbime në të njëjtin lloj apo tipologji me copëtim të fondit, në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 11 pika 5.

<u>Konkluzion përmbledhës</u>: Nga auditimi i procedurave të prokurimit BVV *rezultoi* si më poshtë:
- Ka një numër të lartë ndryshimesh/shtim i procedurave BVV në regjistrin fillestar të parashikimeve, kryesisht 3 ndryshime për vitin 2024 dhe 12 ndryshime për vitin 2025. Ndryshimet në regjistrat e planifikimit të miratuar nga Titullari, janë pa një relacion shpjegues bashkëlidhur, ku të pasqyrohej nevoja për kryerjen e procedurës dhe të argumentohej pamundësia për parashikim të tyre;
- Në dosjet e procedurave standarde të BVV (nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë) të përzgjedhura rezultoi se:
a. Nga auditimi i 3 procedurave BVV të përzgjedhura dhe i dokumentimit të tyre për vitin 2024, rezultoi se: fletë e inventarit të dosjes mungonte në të 3 procedurat, në 1 rast nuk është respektuar subjekti i radhës i cili i është nënshtruar procedurës së shortit, deklarata e konfliktit të interesit të OE fitues mungonte në të 3 procedurat, raporti përmbledhës mungonte në të gjitha rastet;
b. Nga auditimi i 5 procedurave BVV të përzgjedhura dhe i dokumentimit të tyre për vitin 2025, rezultoi se: fleta e Inventarit të dosjes mungon në të 5 procedurat, vërtetim nga TTV mungon në 4 raste; vërtetim nga FSHU mungon në 1 rast, raporti përmbledhës mungon në të gjitha rastet, deklarata e konfliktit të interesit të OE fitues mungon në të gjitha rastet;
Mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu I neni 1, neni 2/pika 1 e 2, neni 84;
- Nga analiza e regjistrit të parashikimeve dhe të realizimeve të procedurave BVV lidhur me planifikimin dhe realizimin e fondeve të çdo procedure, rezultoi se për cdo procedurë ka diferencë vlerash mes vlerës së kontratës dhe vlerës së miratuar të fondit limit. Kjo diferencë ka ardhur si pasojë e mungesës së një analize të plotë të të dhënave të mbledhura nga tregu për përcaktimin e fondit limit, duke mos argumentuar mjaftueshëm nivelin e çmimeve të përdorura në procedurat e prokurimit BVV.
- Janë parashikuar në 7 raste (grupime) procedura të vecuara për mallra apo shërbime të të njëjtit lloj apo tipologji, pra me fond të copëtuar dhe nga këto grup procedurash janë realizuar në 4 raste;
Mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 dt. 23.12.2020 "*Mbi prokurimin publik*" i ndryshuar; VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 2, neni 13 dhe neni 15;

Për sa më lart, parregullësitë e konstatuara apo mangësitë e dokumentacionit të praktikave të proçedurave të BVV, kanë ardhur si rezultat i mos zbatimit korrekt të akteve ligjore/nënligjore nga ana e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël BVV.

Tabela përmbledhëse

Kategoritë	Viti 2024			Viti 2025		
	planifikim	**realizim**	**diferenca**	**planifikim**	**realizim**	**diferenca**
100,000-1,000,000	46	35	11	48	34	14

Deri në 100,000 jo emergjente	3	3	0	7	2	5
Deri në 100,000 emergjente		-	-		-	-

Burimi: Bashkia Prrenjas/Punoi: Grupi i auditimit

Nënpika 2.4.3. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Prrenjas, u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektet si më poshtë:

1. "Asfaltim i rrugës së fshatit Kotodesh" Bashkia Prrenjas.

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 436 prot, datë 09.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe Operatori Ekonomik "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA, me përfaqësues z. M. H., me licencë profesionale NZ 2.../18. Vlera e kontratës është 12,410,031.9 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 406 prot, datë 07.02.2023, është lidhur kontrata me OE "I. - 18" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../5 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 276,676 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1675 prot, datë 20.06.2023 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "U. -S." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1.../8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 33,201 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme dhe përfundimtare në dorëzim të objektit, në dosje nuk administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, por vetëm Certifikata e Marrjes së Përkohshme, nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës me përbërje E. B., E. V., E. D., G. B. e H. K.dhe zv. Kryetari i Bashkisë z. A. K.për Investitorin, pa nr. prot., datë 07.07.2023.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 08, datë 07.02.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike me nr. 1219/2 prot., datë 30.10.2024, në mospërputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Prrenjas z. N. B..

- Projekti i zbatimit është hartuar nga ing. K. B. në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 09.02.2023 dhe kanë përfunduar me datë 08.05.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 996,138 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 996,165 lekë pa TVSH.
- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar, i cili **nuk** është i miratuar nga Investitori, Bashkia Prrenjas. Nga auditimi konstatohet se në projektin e azhurnuar është bërë një degëzim shtesë, i paargumentuar teknikisht, i cili i shërben vetëm një familjeje.

Nga auditimi i projektit bazë, mbi të cilin është ofertuar dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se ka mangësi në planimetrinë e objektit, në të cilat mungojnë piketat dhe distancat ndërmjet tyre. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi projektuesi.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Asfaltim i rrugës së fshatit Kotodesh" Bashkia Prrenjas				
14.Lidhja e kontratës Nr. 436 prot, datë 09.02.2023	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 12,410,031.9 lekë **Sipërmarrës "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA**		**16.Likuiduar deri dt 07.08.2024** **12,410,000 lekë**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 12,410,000 lekë** **-Vlera pa TVSH 10,341,666.67 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 90 ditë. Fillimi punimeve: 09.02.2023 Perfundimi punimeve : 08.05.2023		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "I. - 18" SHPK	Licenca Nr: MK 3.../5	Kontrata me nr. 406 prot, datë 07.02.2023		
21. Kolaudatori i punimeve "U.-S." SHPK	Licenca Nr: MK 1.../8	Kontrata nr. 1675 prot, datë 20.06.2023		
22.Akt Kolaudimi Datë 26.06.2023	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 07.07.2023			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **175,678 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
I	**Punime gërmimi**							
1+4	Gërmim dheu eskavator+Transport dheu deri 5 km	m^3	399.57 (205.75 + 193.82)				17.7	7,072
III	**Punime shtresash rrugore**							
3+4	Shtresë asfaltobetoni 3 cm + shtresë binder 5 cm shtresë asfaltobetoni 3 cm	m^2	1,806.53 781.89+1024.64)	3260.7	3260.7	3170.4	90.3	163,130
IV	**Punime për ndriçimin rrugor**							

5	FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+4086, çmimi	copë	2505.78 lekë/copë	16	16	1726.05 lekë/copë	779.73 lekë/copë	12,476
							Total	**175,678**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

I- Punime gërmimi

1. Zëri 1+4 Gërmim dheu eskavator+Transport dheu deri 5 km. Në preventivin e ofertës volumi i këtyre zërave janë respektivisht 597.05 m^3 dhe 658.44 m^3. Në situacionin përfundimtar këta zëra pune figuron në sasinë 523.72 m^3 dhe 670 m^3. Në librin e masave volumi i këtyre zërave janë sa në situacionin përfundimtar, të detajuar sipas piketave të rrugës. Nga verifikimi i librit të masave, konstatohet se në dy degëzimet nuk janë hedhur shtresat joasfaltike dhe për pasojë gërmimi në këto segmente, në sasinë 17.7 m^3, nuk është i justifikuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

III- Punime Shtresash rrugore

2. Zëri 3+4. Shtresë asfaltobetoni 3 cm + shtresë binder 5 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 2800 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 3260.7 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 3260.7 m^2, i detajuar për gjithë segmentin rrugor. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar edhe rrugica në piketën 30, me sipërfaqe 90.3 m^2 (gjatësi prej 30.1 m dhe gjerësi 3 m), e cila nuk është në projektin bazë dhe ndryshimi nuk është i miratuar nga Investitori. Për pasojë, vlera e shtuar e këtij volumi, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

IV- Punime për ndriçimin rrugor

3. Zëri 5 FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+4086, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave dhe situacionit përfundimtar, rezulton se janë situacionuar 16 copë puseta, me çmim 2505.78 lekë/copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur 16 copë puseta me përmasa 30x30x30 cm. Nisur nga analiza 3.An/pp, kostoja e pusetës është 72% e kostos së këtij zëri. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri është 1,726 lekë/copë ((72% x 2505.78 lekë/copë x 27/64 (volumet e pusetave) + 0.28 x 2505.78) x 1.18), ose 779.73 lekë/copë më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 779.73 lekë/copë (për 16 puseta), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 175,678 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "I. - 18" SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 406 prot, datë 07.02.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "U.-S." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>*ku përcaktohet se:*</u>

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 1675 prot, datë 20.06.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj. A. N. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. L. B. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr. 128 prot, datë 25.08.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/8, datë 27.07.2026, është observuar edhe nga kolaudatori, z. L. B., si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Në përgjige të shkresës Nr.920/60 Prot. Datë 11.08.2026, të KLSH-së, mbi opinionin dhe gjetjet e grupit të audtimit të Bashkisë Prrenjas, lidhur me PRA të KLSH-së (Shkresa nr. 920/26, datë 17.07.2026), objekti "Asfaltimi i rrugës së fshatit Kotodesh", shoqeria "U. S." shpk, e kontraktuar si Kolaudator i objektit paraqet qëndrimin e vetë mbi opinionin e grupit të auditimit: Ky konstatim nuk përputhet me dokumentacionin teknik të dosjes së administruar nga kolaudatori gjatë procesit të kolaudimit, sepse:
- Projekti i azhurnuar, i ndodhur në dosje, rezulton i firmosur nga Investitori;
- Tabela e ndryshimeve të volumeve, rezulton I firmosur nga Investitori;
- Preventivi I përmirësuar është nënshkruar dhe aprovuar nga investitori;
- Procesverbali mbi preventivin e përmirësuar, është nënshkruar dhe aprovuar nga Investitori.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, mund të gjeni secilin prej dokumentacionit të mësipërm.

<u>Opinioni i grupit të auditimit:</u>

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se:
Në lidhje me sa pretendon kolaudatori i punimeve në këtë observacion siç shihet edhe në dokumentacionin bashkëlidhur, mungon planimetria e objektit e ndryshuar, e cila, sipas pretendimeve, duhet të ishte miratuar me degëzimin e piketës 30. Gjithashtu, "Relacioni Teknik shpjegues për preventivin e përmirësuar" (jo për projektin e azhurnuar), në sqarimin e bërë për "punimet që shtohen", nuk e citon sipërfaqen që shtohet për shkak të këtij degëzimi. Sa sipër,

projekti nuk është miratuar nga Investitori. Pranimi i preventivit të rishikuar nga Investitori është konfrom ligjit, por sipërmarrësi duhet të justifikoje me libin e masave, punimet e kryera sipas projektit të miratuar, që në rastin konkret, është projekti bazë, pa rrugicën e piketës 30. Për pasojë, ky pretendim *nuk merret në konsideratë*.

2. "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" Bashkia Prrenjas.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 3025 prot, datë 06.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga zv. Kryetari i Bashkisë z. A. K. dhe Operatori Ekonomik "I." SHPK, me përfaqësues z. F. Ç., me licencë profesionale NZ 3.../18. Vlera e kontratës është 39,444,209 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3056 prot, datë 07.11.2023, është lidhur kontrata me OE "G. C. E." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2.../5 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 555,170 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3047 prot, datë 04.12.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi ing. A. H. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2.../2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 66,118 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, grupi i punës, me përbërje A. E., E. D., Y. K., H. K., G. B., P. Ç. dhe E. B.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 27.12.2024, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Deklaratë për kryerje punimesh me nr. 185, datë 01.11.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike me nr. 1219/2 prot., datë 30.10.2024, në mospërputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

- Në dosje nuk administrohet asnjë projekt zbatimi. Me vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Prrenjas nr.12, datë 27.01.2023, është vendosur që të miratohet fondi prej 20% të totalit (42,800,000 lekë) për përmirësimin e banesave për familje të kategorisë PAK, familje me një prind, familje me më shumë se 4 fëmijë, të moshuar, familje egjiptiane dhe ato me ndihmë ekonomike dhe të ardhura shume të ulëta. Bashkëlidhur këtij vendimi është lista nominale me 41 familje dhe me vlerat preventive për përmirësimin e banesave të tyre.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 08.11.2023 dhe kanë përfunduar me datë 08.05.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohen 3 "procesverbale" pa datë dhe të nënshkruara vetëm nga kontraktori, në të cilat citohet që nuk është punuar në 3 objekte (K. D., R. H. dhe Z. M.). Nisur nga sa sipër, është hartuar tabela e ndryshimit të volumeve, me punime që pakësohen prej 2,540,869 lekë pa TVSH.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" Bashkia Prrenjas</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 3025 prot, datë 06.11.2023</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
39,444,209 lekë
Sipërmarrës "I." ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me TVSH 36,395,166 lekë
-Vlera pa TVSH 30,329,305 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 180 ditë , Zbatuar 180 ditë.
Fillimi punimeve: 08.11.2023
Perfundimi punimeve : 08.05.2024</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës
Nuk ka</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "G. C. E." SHPK</td><td>Licenca Nr:
MK 2.../5</td><td>Kontrata me nr. 3056 prot, datë 07.11.2023</td><td>Likuiduar
lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
Ing. A. H. PF</td><td>Licenca Nr:
MK 2.../2</td><td>Kontrata nr. 3047 prot, datë 04.12.2024</td><td>Likuiduar
(.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (.....
lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 06.12.2024</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim, datë
27.12.2024</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë
.....lekë (për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në 10 banesa të përzgjedhura, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të kryera jo në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

1. Për banesën e qytetarit Sh. H., në librin e masave, për zërin "Brez b/a C20/25 mbi mure me t=15 cm" u konstatua se gjerësia e mureve me gjatësi 10 m, 8 m dhe 5 m është marrë respektivisht 1.5 m, 1.2 m dhe 2.02 m. Nga verifikimi i projektit është konstatuar se gjerësia e mureve është 50 cm. Nga rillogaritja, sasia e këtij volumi është 1.7 m^3 (23 ml x 0.5m x 0.15m), ose 3.5 m^3 më pak se volumi i stituacionuar, **ose 41,300 lekë,** të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi**.**
2. Për banesën e qytetarit I. K., në librin e masave, për zërin "Brez b/a C20/25 mbi mure me t=15 cm" u konstatua se gjerësi e mureve me gjatësi 10 m, 8 m dhe 5 m është marrë respektivisht 1.5 m, 1.2 m dhe 2.02 m. Nga verifikimi i projektit është konstatuar se gjerësia e mureve është 50 cm. Nga rillogaritja, sasia e këtij volumi është 1.7 m^3 (23 ml x 0.5m x 0.15m), ose 3.5 m^3 më pak se volumi i stituacionuar, **ose 41,300 lekë,** të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi**.**
3. Për banesën e qytetarit Xh. K., në librin e masave, për zërin "Mur tulle i lehtësuar" rezultoi se janë bërë muret e jashtme me material guri dhe muret e brendshme me mur tulle. Nga verifikimi i projektit është konstatuar se në një nga muret e jashtme, me gjatësi 10 ml, është librezuar edhe muri i tullës me përmasa 0.3 m dhe lartësi 3 m, gjithsej 9 m^3, **ose 88,200 lekë,** të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi**.**
4. Për banesën e qytetarit A. G., nuk është kryer asnjë punim, **në vlerën 967,536 lekë,** të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,138,336 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "G. C. E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 2423 prot, datë 02.06.2025.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** ing. A. H. PF nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 3047 prot, datë 04.12.2024.


Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. G. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. H. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
3. Grupi i marrjes në dorëzim të objektit me përbërje A. E., E. D., Y. K., H. K., G. B., P. Ç. dhe E. B..

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr. 920/48 prot, datë 28.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/9, datë 29.07.2026, është observuar nga përfaqësuesit e mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësit dhr kolaudatorit të punimeve, si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
1. Për banesat e qytetarëve **Sh. H.** dhe **I. K.**.

Sic edhe konstatohet lehtesisht nga forma gjeometrike e mureve behet fjale per te njetat mure edhe pse ne nje rast quhet “gjeresi” (qe eshte librezuar) dhe nje rast tjeter quhet lartesi sic duhet te jete por ky konsiderohet “menyre te shprehuri” dhe jo dem ekonomik pasi mur eshte faktik dhe mund te vertetohet serish ne terren.

PUNIME NE BANESEN E Z.SH. H. dhe I. K.										
Nr	**Skica**	**Nr. Analiz**	**Pershkrimi i zerit te punimeve**	**Njesia**	**Sasia**	**Faktoret**				**Totali**
						Gjatesia (m)	**Gjeresimesatare (m)**	**Lartesia (m)**	**Trashesia (m)**	
4		2.121/1	Brez b/a C20-25 mbi mure t= 15 cm	m3	5.2					
			Muri 1			10	1.5		0.15	**2.3**
			Muri 2			8	1.2		0.15	**1.4**
			Muri 3			5	2.02		0.15	**1.5**
			Totali							**5.2**

Nr	**Skica**	**Nr. Analiz**	**Pershkrimi i zerit te punimeve**	**Njesia**	**Sasia**	**Faktoret**				**Totali**
						Gjatesia (m)	**Gjeresimesatare (m)**	**Lartesia (m)**	**Trashesia (m)**	
4		2.121/1	Brez b/a C20-25 mbi mure t= 15 cm	m3	5.2					
			Muri 1			10		1.5	0.15	**2.3**
			Muri 2			8		1.2	0.15	**1.4**
			Muri 3			5		2.02	0.15	**1.5**
			Totali							**5.2**



- **Rasti i parë:** 1,50 m; 1,20 m; 2,02 m vendosen horizontalisht si **gjerësi**. Elementi duket si brez/pllakë horizontale me trashësi 0,15 m.
- **Rasti i dytë:** të njëjtat vlera vendosen vertikalisht si **lartësi muri**, ndërsa 0,15 m është trashësia e murit.

Vëllimi del njësoj, sepse:

$$L \times G \times t = L \times H \times t$$

Pra ndryshimi i emërtimit nuk e ndryshon shumëzimin, por ndryshon plotësisht formën e elementit.

Per sa me siper, **Ky ze nuk duhet konsideruar dem ekonomik**

<u>Opinioni i grupit të auditimit:</u>

Përsa observohet në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron se nuk e ka nxjerrë diferencën e volumit për shkak të ndërrimit të vendit të faktorëve të prodhimit, por, siç e kemi cituar edhe në aktkonstatim dhe Projektraportin e auditimit, gjerësia e brezit nuk është marrë sa gjerësia e murit (0.5 m), por më e madhe. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

2. Për banesën e qytetarit **Xh. K.**, në librin e masave, për zërin "Mur tulle i lehtësuar" rezultoi se janë bërë muret e jashtme me material guri dhe muret e brendshme me mur tulle. Nga verifikimi i projektit është konstatuar se në një nga muret e jashtme, me gjatësi 10 ml, është librezuar edhe muri i tullës me përmasa 0.3 m dhe lartësi 3 m, gjithsej 9 m³, ose **88,200 lekë**, të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Përgjigje;

Për murin e tullës janë marrë:
gjatësi: 10 m; trashësi: 0.30 m;lartësi: 3 m.
Volumi: $10\times0.30\times3=9\ m^3$

Pra konstatohet se nuk ka diferenca ne volum!

Kuptimi i konstatimit është se në këtë pjesë të murit të jashtëm ishte realizuar **mur guri**, por në librezën e masave ishte regjistruar dhe paguar edhe **9 m³ mur tulle**. Sipas audituesve, ky mur tulle nuk ishte realizuar dhe është paguar padrejtësisht.
Nga vete grupi i auditmit konstatohet ne terren se muri është ndertuar, dhe per volumin nuk ka pretendime. Fakti ne terren qe eshte mur guri dhe jo mur tulle edhe pse mund te jete librezuar me lapsus, por ne rastin me te keq diferenca totale eshte 1800 lek (9m3 * 200 lek= 1800 lek) por duke qene se kemi te bejme me mur guri.
Per sa me siper **ky ze nuk duhet konsideruar dem ekonomik**

PUNIME NE BANESEN E znj.XH. K.						
Nr	**Nr analiz**	**EMERTIMI I PUNIMEVE**	**Njesia**	**Sasia**	**Cmimi**	**Vlefta**
2	2.52/1	Mur guri themel e xokol me llaç përzier M15	m3	9	10,000	90,000
4	2.70/2	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri ne 3m me llaç perzier M25	m3	9	9,800	88,200
		SHUMA 11				**(1,800)**

Opinioni i grupit të auditimit:

Përsa observohet në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron se diferenca e volumit nuk ka të bëjë me ndonjë lapsus, por, siç e kemi cituar edhe në aktkonstatim dhe Projektraportin e auditimit, është librezuar në të njëjtin vend edhe mur guri edhe mur me tulla. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

3. Për banesën e qytetarit **N. K.**
Ne fakt , po te shihet tabela lartesia eshte marre 2..e rastin e pare (dhe serish nuk del 9 m² por 9.2 m²), gjithesesi, ne table e meposhtme shpjegohet edhe me qarte, pasi lartesia reale është 2.1 m, por ne programin excel ka qene me zero Shifra pas presjes, dhe shumezimet jane bera manualisht.
Ne tabelen e dyte tregohen veprimet reale, me Shifra pas presj dhjetore (gje qe mund te provohet edhe manualisht)

PUNIME NE BANESEN E Z. N. K.								
							Faktoret	

Nr	Skica	Nr. Analiz	Pershkrimi i zerit te punimeve	Njesia	Sasia	Cope	Gjatesia (m)	Gjeresi mesatare (m)	Lartesia (m)	Trashesia (m)	Totali
6		2.395 /a	Dyer d/alumini dopio xham.	m²	9.7	2		0.8	2		3
						2		1	2		4
						1		1	2		2
											9

PUNIME NE BANESEN E Z. N. K.											
Nr	Skica	Nr. Analiz	Pershkrimi i zerit te punimeve	Njesia	Sasia		Faktoret				Totali
						Cope	Gjatesia (m)	Gjeresi mesatare (m)	Lartesia (m)	Trashesia (m)	
6		2.395 /a	Dyer d/alumini dopio xham.	m²	9.7	2		0.8	2.10		3.36
						2		1	2.10		4.20
						1		1	2.10		2.10
											9.7

Per sa me siper, **Ky ze nuk duhet konsideruar dem ekonomik**

Opinioni i grupit të auditimit:

Përsa observohet në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron se diferenca e volumit ka dalë nga shqyrtimi i librit të masave të hartuar nga sipërmarrësi dhe miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, por pranon diferencën e cituar në observacion në lidhje me prodhimin e 2 copë x 0.8 m x 2 m, i cili është 3.2 m^2 dhe jo 3 m^2 dhe diferenca totale e volumit është 0.5 m^2 dhe jo 0.7 m^2. Sa sipër, ky pretendim merret në konsideratë dhe do të reflektohet në tabelën e dëmit ekonomik.

Pretendimi i subjektit:

4. Për banesën e qytetarit **A. G.**

Sic u konstatua edhe ne terren, familjari në prezencë të audituesve pranoi që firma sipërmarrëse më ka sjellë materialet në objekt, por për shkak të rrethanave, pasi materialet e preventivuara nuk mjaftonin për të bërë një shtëpi funksionale, i biri i përfituesit me fondet e tij, duke shtuar edhe materialet e perfituara nga bashkia, në konsulence edhe me miratimin verbal të autoritetit kontraktor u vendos që të ndërtojë shtëpinë e re ku jeton bashke me prindërit, në të njëtin oborr

Opinioni i grupit të auditimit:

Përsa observohet në këtë pikë të observacionit, grupi i auditimit sqaron se në objektin, për të cilin është gjykuar nga investitori që do të ndërhyhet për përmirësim, është konstatuar në prani të përfaqësuesit të mbikëqyrësit, që nuk është kryer asnjë punim. Për sa pretendohet nga observuesit, është një ndryshim që nuk duhet të kishte mbetur në kuadrin e miratimit verbal, por siç përcaktohet edhe në kontratë, të gjitha ndryshimet e kontratës, përfshi edhe ndryshimet në

projektpreventiv, si pjesë integrale e kontratës, bëhen me amendamente të nënshkruara nga të dyja palët. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

5. Për banesën e qytetarit **Z. Ç.**

Mendoj se ne kete ze ka nje lapsus pas sipas LM jane librezuar 4.9 m^2 dhe jane situacionuar 4.5 m^2 (bashkelidhur tabela), pasi kaq kishim gjithsej ne preventivin baze dhe nuk mund te situacionomim me shume sasi per te njetin ze

PUNIME NE BANESEN E Z.ZAIM ÇAKO

Nr	Skica	Nr. Analiz	Pershkrimi i zerit te punimeve	Njesia	Sasia		Faktoret				Totali
						Kope	Gjatesia (m)	Gjeresi mesatare (m)	Lartesia (m)	Trashesia (m)	
10		2.375/a	F.V dritare duroalumini dyfish xham	m²	4.5	4		0.85	1.15		**3.9**
						1		0.9	1.15		**1**
											4.9

Per sa me siper, **Ky ze nuk duhet konsideruar dem ekonomik**

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se:

Së pari, konstatimi i bërë nga grupi i auditimit, rrjedh nga verifikimi i librezës së masave të administruar në dosjen teknike të zbatimit të punimeve të këtij objekti, e cila rezulton që të ketë qenë siç është shprehur grupi i auditimit në aktkonstatimin nr. 17.

- Nisur nga sa sqarojnë observuesit në këtë observacion dhe nga shqyrtimi i librezës së masave të ardhur në adresën zyrtare të KLSH-së, grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin dhe do ta reflektojë në Projektraportin e Audimit.

3. "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NJA Qukës" Bashkia Prrenjas.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 613 prot, datë 11.03.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe Operatori Ekonomik "R." SHPK, me përfaqësues z. L. K., me licencë profesionale NZ 3.../17. Vlera e kontratës është 48,333,972.82 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 612 prot, datë 11.03.2025, është lidhur kontrata me OE "G. C. E." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2.../7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 808,414 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2759 prot, datë 20.11.2025 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "G & C." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2.../18 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 97,009 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 525, datë 15.12.2025 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje G. K., G. B. dhe H. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 09.12.2025, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 01, datë 03.02.2025. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "A." ShPK në Qershor 2024.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 07.04.2025 dhe kanë përfunduar me datë 05.09.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

-Me shkresën nr. 1343/2, datë 07.08.2025 sipërmarrësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 26 ditë, për shkak të motit të papërshtatshëm të periudhës kur është realizuar objekti. Me shkresën nr. 613/7, datë 07.08.2025, është bërë amendimi i kontratës për afatin e zbatimit të saj, duke zgjatur këtë afat me 26 ditë, deri në datën 06.09.2025.

- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 6,126,590 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 4,960,256 lekë pa TVSH, duke përdorur fondin rezervë në vlerën 1,173,154 lekë pa TVSH.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NJA Qukës" Bashkia Prrenjas</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 613 prot, datë 11.03.2025</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
48,333,972.82 lekë
Sipërmarrës "R.." ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar deri dt 12.02.2026
48,325,787 lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me TVSH 48,325,788 lekë
-Vlera pa TVSH 40,271,490 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 153 ditë , Zbatuar 179 ditë.
Fillimi punimeve: 07.04.2025
Perfundimi punimeve : 05.09.2025</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës
Amendament nr. 613/7 prot, datë 07.08.2025, shtyrje afati me 26 ditë, deri në dt. 06.09.2025</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "G. C. E." SHPK</td><td>Licenca Nr: MK 2.../7</td><td>Kontrata me nr. 2423 prot, datë 02.06.2025</td><td>Likuiduar lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
"G & C." SHPK</td><td>Licenca Nr: MK 2.../18</td><td>Kontrata nr. 2759 prot, datë 20.11.2025</td><td>Likuiduar (.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (..... lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 25.11.2025</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim, datë 09.12.2025</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje

me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,713,914 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
II	**Punime Shtresash rrugore**							
4+5+6	Shtresë stabilizanti t=10 cm + shtresë binder 6 cm + shtresë asfaltobetoni 4 cm	m^2	2420 (320+1100+1000)	8430	8439.73	7784	646	1,563,320
12	FV Guardrails N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë, Ë4	ml	3190	350	354	323	27	86,130
III	**Punime për veprat e artit**							
	Beton C 16/20 për muret mbajtës dhe pritës	m^3	9480	730	733.8	723.2	6.8	64,464
							Total	**1,713,914**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

IV- Punime Shtresash rrugore

1. Zëri 4+5+6. Shtresë stabilizanti t=10 cm + shtresë binder 6 cm + shtresë asfaltobetoni 4 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 6730 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 8430 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 8439.73 m^2, i detajuar sipas seksioneve të rrugës, me gjerësi 3.5 m. Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se gjatësia e rrugës është marrë 2352.4 ml, nga 2165 ml që është në librin e masave. Nga rillogaritja me gjatësinë e rrugës sipas projektit dhe faktit (2165 ml) dhe gjerësisë 3.5 m sipas projektit dhe librezës së masave + 11 xhepat me gjatësi 12.5 ml dhe gjerësi 1.5 m, volumi i këtyre zërave është 7784 m^2, ose 646 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e shtuar e këtij volumi, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 12 FV Guardrails N2 anësore me 2 valëzime në 1 anë, W4. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 350 ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 350 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 350 ml, i detajuar në 6 piketa. Nga verifikimi në objekt rezulton se volumi i këtij zëri pune është 323 ml, ose 27 ml më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 3 Beton C 16/20 për muret mbajtës dhe pritës. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 658 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 730 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 733.8 m^3, i detajuar për 15 mure mbajtës dhe pritës. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se muri i librezuar në pik. 87, me përmasa të themelit 70 ml x 1 m x 0.6 m, është realizuar afër piketës 15, me përmasa 51.9 m x 1 m x 0.6 m, ndërsa muri është 25.7 m x 1 m x 0.6 m + 26.2 m x 1.5 m x 0.6 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 723.2 m^3, ose 6.8 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,713,914 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "G. C. E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

4) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 2423 prot, datë 02.06.2025.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "G & C" ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

4) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

5) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

6) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 2759 prot, datë 20.11.2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. G. B. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. S. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr. 156 prot, datë 17.08.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/9, datë 29.07.2026, është observuar nga përfaqësuesit e mbikëqyrësit të punimeve, sipërmarrësit dhr kolaudatorit të punimeve, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Zëri 4+5+6 Shtresë Stabiliznati 10 cm + shtresë binder 6 cm + shtrese asfaltobetoni 4 cm

Në Akt-Konstatim, sipërfaqja faktike e shtresave rrugore është përllogaritur duke shumëzuar gjatësinë fizike të aksit të rrugës, prej 2,165 ml, me gjerësinë fikse 3.50 m dhe duke i shtuar

sipërfaqen e 11 xhepave. Nëpërmjet kësaj metode është përllogaritur sipërfaqja prej 7,784 m² dhe është evidentuar një diferencë prej 646 m² kundrejt sasisë së situacionuar prej 8,430 m².
Kundërshtojmë përdorimin e gjerësisë fikse 3.50 m si përfaqësuese të të gjithë gjendjes faktike të rrugës. Libreza e masave, e mbajtur gjatë zbatimit të punimeve dhe e verifikuar nga palët përgjegjëse, përbën dokumentin teknik bazë mbi të cilin janë evidentuar dhe certifikuar sasitë e punimeve të realizuara.
Në segmentet me kthesa, rakordime, ndryshime të kuotave dhe përshtatje me konfiguracionin faktik të terrenit, gjerësia e shtresave rrugore ka rezultuar më e madhe se 3.50 m. Sipërfaqet e realizuara përtej kësaj gjerësie referuese janë reflektuar në llogaritje nëpërmjet gjatësive ekuivalente përkatëse. Si rrjedhojë, krahasimi i drejtpërdrejtë ndërmjet gjatësisë fizike të aksit, prej 2,165 ml, dhe shumës së gjatësive llogaritëse të evidentuara në librezën e masave nuk përbën metodë të plotë dhe teknikisht të përshtatshme për përcaktimin e sipërfaqes faktike të realizuar.
Për shkak të kurbaturës së aksit, rrezeve të kthesave, ndryshimeve të kuotave të trasesë dhe nevojës për përshtatjen e rrugës me konfiguracionin real të terrenit, gjerësia 3.50 m nuk mund të zbatohej në mënyrë të pandryshueshme në të gjitha seksionet. Në kthesa dhe në segmente të caktuara janë realizuar zgjerime të nevojshme të shtresave rrugore, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë gjeometrike të trasesë, funksionalitetit të rrugës dhe sigurisë së qarkullimit.
Për të shmangur çdo paqartësi të krijuar nga mënyra e paraqitjes së sasive në librezën e masave, këtij observacioni i bashkëlidhen rilevimi topografik, matjet faktike instrumentale dhe tabela e rakordimit. Në këtë tabelë paraqiten, për çdo segment, piketat përkatëse, gjatësia fizike, gjerësia reale e matur, sipërfaqja faktike e realizuar.
Rilevimi topografik dhe matjet instrumentale të bashkëlidhura konfirmojnë se gjerësia e rrugës është e ndryshueshme dhe se në segmente të veçanta janë realizuar sipërfaqe më të mëdha se ato që rezultojnë nga shumëzimi mekanik i gjatësisë së aksit me gjerësinë fikse 3.50 m. Për rrjedhojë, verifikimi i sasisë së realizuar duhet të kryhet duke krahasuar sipërfaqen totale të situacionuar me sipërfaqen faktike që rezulton nga matjet instrumentale dhe nga gjeometria reale e rrugës.
Përfundimi se 646 m² përbëjnë punime të parealizuara nuk mbështetet në një matje të plotë të sipërfaqes faktike, por në një përllogaritje teorike që konsideron të pandryshueshme gjerësinë 3.50 m në të gjithë gjatësinë e rrugës. Kjo metodë nuk merr në konsideratë zgjerimet faktike të realizuara në kthesa dhe në segmentet e diktuara nga kushtet e terrenit.
Pavarësisht se në momentin e auditimit nuk ishte paraqitur projekti përfundimtar “as built”, kjo mungesë dokumentare nuk mund të konsiderohet, në vetvete, provë e mosrealizimit të punimeve. Situacionimi dhe certifikimi i sasive janë kryer mbi bazën e librezës së masave dhe të matjeve të mbajtura gjatë zbatimit të punimeve. Dokumentacioni “as built”, i hartuar tashmë mbi bazën e rilevimit topografik dhe të matjeve instrumentale, paraqitet bashkëlidhur si dokument plotësues dhe verifikues i gjendjes faktike të realizuar.
Në këto kushte, kërkojmë që diferenca e pretenduar prej 646 m² të rivlerësohet mbi bazën e matjeve faktike instrumentale, rilevimit topografik, tabelës së rakordimit dhe gjeometrisë reale të rrugës, dhe jo vetëm mbi bazën e shumëzimit të gjatësisë fizike të aksit me gjerësinë teorike fikse prej 3.50 m.

2. Zeri 3 Beton C16/20 per muret mbajtes dhe prites

Ne Akt-Konstatim është evidentuar nje diference prej 6.8 m³, duke u mbeshtetur ne matjen e mureve mbajtese dhe prites te pasqyruara ne librin e masave. Ky konstatim nuk perfshin te gjithe elementet prej betoni te realizuara faktikisht ne objekt.
Gjatë zbatimit të punimeve, në varësi të kushteve faktike gjeologjike, konfiguracionit të terrenit dhe nevojës për garantimin e qëndrueshmërisë së trupit të rrugës, rezultoi e domosdoshme realizimi i një sasie më të madhe muresh prej betoni krahasuar me atë të parashikuar fillimisht në preventiv. Këto punime janë kryer për nevoja reale dhe të verifikueshme teknikisht në objekt, me qëllim mbrojtjen e skarpatave, stabilizimin e trasesë, shmangien e rrëshqitjeve dhe garantimin e funksionimit të sigurt e të qëndrueshëm të veprës. Pavarësisht rritjes së volumit të mureve të betonit, punimet janë realizuar brenda vlerës së përgjithshme të kontratës, pa sjellë tejkalim të fondit kontraktor. Për këtë arsye, vlerësimi i sasisë së betonit nuk duhet të kufizohet vetëm te elementet dhe sasitë e parashikuara në preventivin fillestar, por duhet të përfshijë të gjithë volumin faktik të realizuar në objekt, të evidentuar në librezën e masave dhe të verifikueshëm nëpërmjet matjeve, skicave, fotografive dhe dokumentacionit teknik përkatës. Vetëm pas këtij inventarizimi të plotë mund të përcaktohet nëse ekziston ose jo diferencë ndërmjet sasisë së situacionuar dhe punimeve të realizuara faktikisht.
Ne kete faze nuk pretendojme qe çdo punim shtese te pranohet automatikisht pa dokumentim. Kerkojme qe vleresimi te behet mbi volumin e pergjithshem faktik te betonit te realizuar, duke verifikuar njekohesisht dokumentacionin teknik qe lidhet me keto nderhyrje.
Per sa me siper, kundershtojme cilesimin e menjehershem te volumit 6.8 m³ si "punim i pakryer", pasi verifikimi i kryer nuk rezulton te kete perfshire te gjitha strukturat prej betoni te realizuara ne objekt.

3. Zeri 12 FV Guardrails N2, Anesore me 2 valezime ne 1 ane Ë4

Per zerin "FV Guardrails N2, anesore me 2 valezime ne nje ane Ë4", pranojme diferencen faktike prej 27 ml ndermjet sasise se situacionuar dhe gjatesise se realizuar ne objekt. Pranojme efektin financiar perkates sipas çmimit kontraktor, te pasqyruar ne Akt-Konstatim ne vleren 86,130 leke pa TVSH. Ju bejme me dije se kjo diference ka ardhur si pasoje e nje gabimi njerezor gjate matjeve per secalin segment te guardrails te vendosur ne objekt.
Në përfundim, theksojmë se dokumenti bazë për evidentimin dhe certifikimin e sasive faktike të punimeve është libreza e masave, në të cilën gjerësitë e trasesë janë pasqyruar sipas piketave dhe gjendjes reale të çdo seksioni. Projekti "as built", me planimetrinë, profilet, seksionet dhe tabelën e gjerësive e të sipërfaqeve faktike, është hartuar mbi bazën e rilevimit topografik dhe matjeve instrumentale dhe bashkëlidhet me këtë observacion si dokument plotësues. Të dyja këto dokumente provojnë përputhjen e sipërfaqes faktike të asfaltuar me sasinë e situacionuar.
Kërkojmë që, gjatë shqyrtimit të këtij observacioni, konstatimi për diferencën prej 646 m² të rivlerësohet mbi bazën e librezës së masave, gjerësive faktike të shënuara sipas piketave, rilevimit topografik dhe matjeve instrumentale, dhe jo vetëm mbi bazën e gjerësisë teorike fikse 3.50 m. Në kushtet kur kurbaturat, ndryshimet e kuotave dhe konfiguracioni i terrenit kanë kërkuar zgjerime faktike të trasesë, diferenca e pretenduar nuk mund të cilësohet si punim i pakryer.
Në mbështetje të këtij observacioni bashkëlidhen: libreza e masave me gjerësitë faktike të pasqyruara sipas piketave; projekti "as built", i hartuar mbi bazën e rilevimit topografik dhe matjeve faktike instrumentale; tabela e piketave, gjerësive dhe sipërfaqeve faktike; përllogaritjet e sipërfaqes së asfaltuar; skicat dhe llogaritjet e volumeve të kokave të tombinove dhe pusetave;

fotografitë dhe dokumentacioni teknik i disponueshëm; si dhe procesverbali i matjeve të përbashkëta.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se:

1. Përsa pretendohet në lidhje me llogaritjen e gjerësisë fikse të shtresave 3.5 m në të gjithë gjatësinë e rrugës, grupi i auditimit ka konkluduar sipas librezës së masave të administruar në dosje, e hartuar nga kontraktori dhe miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, pikërisht siç pretendohet edhe nga observuesit, sipas të cilëve "*Libreza e masave, e mbajtur gjatë zbatimit të punimeve dhe e verifikuar nga palët përgjegjëse, përbën dokumentin teknik bazë mbi të cilin janë evidentuar dhe certifikuar sasitë e punimeve të realizuara*". Pra shumëzimi mekanik i pretenduar është bërë nga kontraktori dhe miratuar nga mbikëqyrësi dhe jo nga grupi i auditimit. Përsa i përket rilevimit topografik të bërë pas hartimit të aktkonstatimit nga ana e Grupit të Auditimit, sqarojmë se ky veprim duhet të kryhet në fazën e zbatimit të punimeve dhe duke patur parasysh që gjerësia e shtresës në pjesët e drejta të rrugës, nuk librezohet më e madhe se gjerësia e shtresës sipas projektit, vetëm për shkak se kontraktori nuk ka mundur ta realizojë me gjerësinë e përcaktuar në projekt. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
2. Nisur nga sa pretendohet për diferencën e volumit në zërin "Beton C16/20 per muret mbajtes dhe prites", sqarojmë se nga ana e grupit të auditimi është bërë matja në terren me përfaqësuesin e mbikëqyrësit e të gjitha mureve të paraqitur në librin e masave dhe diferenca ka dalë nga volumet e librezuara me ato të matura në terren, siç citohet në aktin e konstatimit dhe Projektraportin e auditimit. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.
3. Diferenca e volumit të guardrails është pranuar dhe do të mbetet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4. "Rikonstruksion i rrugës Rrashtan" Bashkia Prrenjas.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 508 prot, datë 16.02.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe Operatori Ekonomik "K." SHPK, me përfaqësues z. K. C., me licencë profesionale NZ 7.../11. Vlera e kontratës është 34,826,282.4 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 4 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 523 prot, datë 17.02.2023, është lidhur kontrata me OE "A.-V." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1.../5 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 581,569 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2125 prot, datë 09.08.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "I.- 18" SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3331/5 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 69,788 lekë me TVSH. Lidhja e kontratës me kolaudatorin e punimeve rreth 1 vit pas përfundimit të punimeve, është në kundërshtim me UKM Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", kreu II, sipas të cilit "*Kolaudatori ose grupi i kolaudimit caktohet nga investitori, i cili duhet t'ia komunikojë, me shkrim, këtë person apo grup personash, Sekretariatit Teknik të KRRT-së, pranë zyrës dhe seksionit urbanistik përkatës në rreth, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve. Punëdhënësi duhet të përcaktojë, gjithashtu, në marrëveshje me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin (ose grupin e kolaudimit), mënyrën dhe afatet e procesit të kolaudimit*". Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Prrenjas.

Për marrjen e përkohshme dhe përfundimtare në dorëzim të objektit, në dosje administrohen urdhrat për ngritjen e grupit të punës, me nr. 2193, datë 23.08.2024 dhe nr. 59, datë 29.01.2026 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje M. P., E. V. dhe H. K.. Janë hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 27.08.2024 dhe e marrjes përfundimtare në dorëzim datë 09.02.2026, nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 09, datë 14.02.2023. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".

Në dosjen e zbatimit nuk administrohet Oponenca Teknike me nr. 1219/2 prot., datë 30.10.2024, në mospërputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Prrenjas z. N. B..

- Projekti i zbatimit është hartuar nga ing. K. B. në vitin 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 17.02.2023 dhe kanë përfunduar me datë 15.07.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

-Me shkresën e protokolluar me nr. 1568, datë 09.06.2023 sipërmarrësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 1 muaj, për shkak të kërkesave të banorëve, ndryshimit të projektit të ndriçimit dhe motit të papërshtatshëm në periudhën kur është realizuar objekti. Me shkresën nr. 1569 prot., datë 09.06.2023, është bërë amendimi i kontratës për afatin e zbatimit të saj, duke zgjatur këtë afat me 1 muaj, deri në datën 15.07.2023.

- Në dosjen teknike administrohet projekti i azhurnuar, i cili nuk shoqërohet me preventiv të ripunuar. Nga krahasimi i bërë ndërmjet preventivit të ofertës dhe situacionit përfundimtar, rezulton se nga 39 zëra të preventivit të ofertës, në 18 prej tyre kanë ndryshuar volumet e punës. Këto ndryshime nuk janë marrë në shqyrtim për miratim nga Investitori, në kundërshtim me VKM nr. 610, datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve", neni 12, sipas të cilit "*Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi*" dhe Neni 41, sipas të cilit "*1. Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si:....*

f) ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai". Mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve dhe titullarin e Bashkisë Prrenjas.

Në dosje administrohet procedura për miratimin e përdorimit të fondit rezervë në vlerën 844,856 lekë pa TVSH.
Nga auditimi i projektit bazë, mbi të cilin është ofertuar dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se ka mangësi në planimetrinë e objektit, në të cilat mungojnë piketat dhe distancat ndërmjet tyre.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrugës Rrashtan" Bashkia Prrenjas				
14.Lidhja e kontratës Nr. 508 prot, datë 16.02.2023	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 34,826,282.4 lekë **Sipërmarrës "K." ShPK**		**16.Likuiduar**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 34,825,752 lekë** **-Vlera pa TVSH 29,021,460 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 120 ditë , Zbatuar 150 ditë. Fillimi punimeve: 17.02.2023 Perfundimi punimeve : 15.07.2023		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament nr. 1569 prot, datë 09.06.2023, shtyrje afati me 30 ditë, deri në dt. 15.07.2023	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE "A.-V." SHPK	Licenca Nr: MK 1.../5	Kontrata me nr. 523 prot, datë 17.02.2023	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. **Kolaudatori i punimeve** "I.- 18" SHPK	Licenca Nr: MK 3.../5	Kontrata nr. 2125 prot, datë 09.08.2024	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 19.08.2024	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 09.12.2025		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **850,820 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
III	**Punime betoni, guri dhe tombino**							
1	Beton C020/25 për mure anësore mbajtës	m^3	10000	254	254	209	45	450,000
6	Stuktura monolite beton C 12/15 për kanal dhe kuneta	m^3	9000	208	208	174.5	33.5	301,500
IV	**Punime për ndriçimin rrugor**							
5	FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+4086	copë	4000	44	44	36	8	32,000
5	FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC	copë	4000 lekë/copë	44	36	2755 lekë/copë	1245 lekë/copë	44,820

	1084+4086, çmimi							
6	Shtresë betoni C 12/15	m^3	7500	16	13	13	3	22,500
							Total	**850,820**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

III- Punime betoni, guri dhe tombino

1. Zëri 1 Beton C 20/25 për mure anësore mbajtës. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 388 m^3. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 254 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 254 m^3, i detajuar për 516 ml mur dhe themel, me përmasa të ndryshueshme. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se gjerësia mesatare e murit është marrë nga 30 cm (nga pik 8 – pik 12) deri në 50 cm për pjesën tjetër të murit, nga 0.3 m që është në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 209 m^3, ose 45 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 6 Stuktura monolite beton C 12/15 për kanal dhe kuneta. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 278 m^3. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 208 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 208 m^3, i detajuar për 1158 ml kanal me përmasa 1.2 m x 0.1 m dhe kunetë me përmasa 0.5 m x 0.12 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se gjatësia e kunetës ishte nga fillimi i objektit deri në prog 0+600 (shtylla e ndriçimit nr. 15) dhe jo 1158 ml. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 175 m^3, ose 33 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

IV- Punime për ndriçimin rrugor

3. Zëri 5 FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+1086. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 44 copë. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 44 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 44 copë. Nga verifikimi në objekt rezulton se volumi i këtij zëri pune është 36 copë, ose 8 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 5 FV pusetë plastike 40x40x40, kapak i fortë RIC 1084+4086, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave dhe situacionit përfundimtar, rezulton se janë situacionuar 44 copë puseta, me çmim 4000 lekë/copë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur 36 copë puseta me përmasa 30x30x30 cm. Nisur nga analiza 3.An/pp, kostoja e pusetës është 72% e kostos totale të këtij zëri. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri është 2755 lekë/copë ((72% x 4000 lekë/copë x 27/64 + 0.28 x 4000) x 1.18), ose 1245 lekë/copë më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 1245 lekë/copë (për 36 puseta), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5. Zëri 6 Shtresë betoni C 12/15. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 16 m^3. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 16 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 13 m^3, i detajuar për 44 shtylla me përmasa 0.5 m x 0.6 m x 1 m, ose 3 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 850,820 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "A.-V." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

5) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

6) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 523 prot, datë 17.02.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "I. - 18" ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

8) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>*ku përcaktohet se:*</u>

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: *a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.* *b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.* *c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.* *ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes*

9) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 2125 prot, datë 09.08.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A. D. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. A. N. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
3. Grupi i marrjes në dorëzim të objektit me përbërje M. P., E. V. dhe H. K..

Për objektin e mësipërm, nuk janë paraqitur observacione nga palët përgjegjëse.

<u>5. "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Dalip Toçka" Kotodesh" Bashkia Prrenjas.</u>

<u>Kontratat</u>

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 815 prot, datë 07.03.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe BOE "M." SHPK & L. K." SHPK, me përfaqësues z. I. M. dhe znj. D. M., me licencë profesionale respektivisht NZ 2.../19 dhe NZ 3.../20. Vlera e kontratës është 25,912,506 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 824 prot, datë 07.03.2024, është lidhur kontrata me OE "Z." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../2/9 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 496,547.7 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3207 prot, datë 23.12.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "2 .." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 65,880 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 620, datë 27.12.2024 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje E. V., M. P. dhe H. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 30.12.2024, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe zv.Kryetari i Bashkisë z. A. K.për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Vendimi nr. 38, datë 06.03.2024 "Për miratimin e Deklaratë për kryerje punimesh". Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit", pasi nisur nga preventivi i punimeve, duhet të ishte dhënë leje ndërtimi.
- Projekti i zbatimit është hartuar nga ing. E. M. PF në vitin 2023.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 08.03.2024 dhe kanë përfunduar me datë 30.10.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 5,277,452 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 5,042,925 lekë pa TVSH, duke përdorur fondin rezervë në vlerën 213,799 lekë pa TVSH.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Dalip Toçka" Kotodesh" Bashkia Prrenjas</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës
Nr. 815 prot, datë 07.03.2024</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me TVSH)
25,912,506 lekë
Sipërmarrës "M. SHPK & L. K. ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar deri dt 07.02.2025, 25,890,474 lekë</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
-Vlera me TVSH 25,890,474 lekë
-Vlera pa TVSH 21,575,395 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kontratës në dite
Parashikuar 240 ditë , Zbatuar 233 ditë.
Fillimi punimeve: 08.03.2024
Perfundimi punimeve : 01.11.2024</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës
Nuk ka</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
OE "Z." SHPK</td><td>Licenca Nr:
MK 3.../2</td><td>Kontrata me nr. 824 prot, datë 07.03.2024</td><td>Likuiduar
lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
"2 .." SHPK</td><td>Licenca Nr:
MK 3.../1</td><td>Kontrata nr. 3207 prot, datë 23.12.2024</td><td>Likuiduar
(.....lekë)</td><td>Pa likuiduar (.....
lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi
Datë 23.12.2024</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim, datë
30.12.2024</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë
.....lekë (për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara

si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **352,492 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
B	**Punime suvatimi dhe shtrim me pllaka brenda**							
6	Plintus grez importi h=10 cm	ml	140	760.8	760.8	630.5	130.3	18,200
C	**Punime fasade jashtë**							
1	Suvatim fasade me granil e çimento të bardhë	m^2	800	856.6	856.6	824.4	32.2	25,760
5	Bojë hidroplastike importi, cilësia I	m^2	220	856.6	856.6	756.1	100.5	22,110
10	Shtresë betoni C 7/10 në themele t=10 cm	m^3	10000	15.19	15.19	12.15	3	30,000
I	**Rrethimi i shkollës**							
5	Bojë vaji sipërfaqe metalike	m^2	220	644.72	644.72	320.1	324.6	22,110
	Sistemim sheshi + fushat sportive							
	FV bordura 20x30 cm, çmimi	ml	1200 lekë/ml	451.3		996 lekë/ml	204 lekë/ml	71,412
	Diferenca në pajisjet elektrike	lekë						162,900
							Total	**352,492**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

B- Punime suvatimi dhe shtrim me pllaka brenda

1. Zëri 11. Plintus grez importi h=10 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1040 ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 760.8 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 760.8 ml, i detajuar sipas ambienteve të shkollës. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se hapësirat e dyerve nuk janë hequr 2 herë por janë shtuar një herë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 630.5 ml, ose 130.3 ml më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e shtuar e këtij volumi, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C- Punime fasade jashtë

2. Zëri 1. Suvatim fasade me granil e çimento të bardhë. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1139.8 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 856.6 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 856.6 m^2, i detajuar sipas fasadave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se lartësia e jashtme është marrë 7.67 m nga 7.4 m (përfshirë xokolin). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune

është 824.4 m^2, ose 32.2 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 5. Bojë hidroplastike importi, cilësia I. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1139.8 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 856.6 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 856.6 m^2, i detajuar sipas fasadave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se lartësia e jashtme është marrë 7.67 m nga 6.8 m (pa përfshirë xokolin). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 756.1 m^2, ose 100.5 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 10. Brez betonarme C 16/20. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 16.1 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 15.19 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 15.19 m^3, i detajuar sipas parapetit të tarracës së katit përdhe dhe katit të parë. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, konstatohet se lartësia e këtij brezi, është marrë 0.5 m nga 0.4 m që është në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 12.15 m^3, ose 3 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

I. Rrethimi i shkollës

5. Zëri 10. Bojë vaji mbi sipërfaqe metalike. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 884.8 m^2. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 644.72 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 644.72 m^2, i detajuar sipas rrethimi të shkollës dhe portës kryesore. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se lartësia e kangjellave është marrë 2.9 m, nga 1.4 m që është në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 320.1 m^2, ose 324.6 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Sistemim sheshi + fushat sportive

6. Zëri FV bordura 20 x 35 cm, çmimi. Në preventivin e ofertës ky zë pune është me çmim 1200 lekë/ml. Në situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 451.3 ml (305.62 ml oborri + 86 fusha e basketbollit + 58.68 ml fusha e volejbollit). Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 451.3 ml i detajua, për pjesët e oborrit dhe sipas fushave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, konstatohet se janë vendosur bordura 15 x 35 cm. Nisur nga analiza me nr. 2.290, çmimi i nënzërit bordura zë 68 % të të gjithë zërit. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri është 996 lekë/ml (68% x 1200 x 15/20 + 32% x 1200 lekë). Për pasojë, diferenca e çmimit prej 204 lekë/ml për gjithë gjatësinë e bordurave (451.3 ml) është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Gjithashtu, nga verifikimi në terren, rezultoi se ka patur diferenca në volume:

- në zërin "FV ndriçues Led 4000 K, 60 x 60 cm", 20 copë (nga 120 në 100 copë), me çmim 2500 lekë/copë, me vlerë 50,000 lekë;
- në zërin "FV prizë2P+T universale", 70 copë (nga 140 në 70 copë), me çmim 320 lekë/copë, me vlerë 22,400 lekë;
- në zërin "FV Kuadër elektrik kryesor, 54 module", 1 copë (nga 3 në 2 copë), me çmim 1,500 lekë/copë, me vlerë 1,500 lekë;
- në zërin "FV UPS Trefazor me kohëmbajtje 15 min", nuk është vendosur, me vlerë 30,000 lekë;
- në zërin "FV Detektor tymi", 3 copë (nga 30 në 27 copë), me çmim 3000 lekë/copë, me vlerë 9,000 lekë;

- në zërin "FV ndriçuesa emergjence", 5 copë (nga 32..ë 27 copë), me çmim 2200 lekë/copë, me vlerë 50,000 lekë;

Këto diferenca përbëjnë dëm ekonomik, **në total 162,900 lekë**, të cilat janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 352,492 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "Z." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

8) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 824 prot, datë 07.03.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "2." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

10) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

11) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>*ku përcaktohet se:*</u>

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi: *a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.* *b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.* *c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.* *ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes*

12) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 3207 prot, datë 23.12.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L. H. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. J. M. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për objektin e mësipërm, nuk janë paraqitur observacione nga palët përgjegjëse.

<u>6. "Ndërtimi i shkollës së mesme "Sali Halili", Rrajcë Fushë" Bashkia Prrenjas.</u>

<u>Kontratat</u>

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2598 prot, datë 11.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga zv Kryetari i Bashkisë z. A. K.dhe Operatori Ekonomik "E." SHPK, me përfaqësues z. E. B., me licencë profesionale NZ 4.../20. Vlera e kontratës është 151,856,222 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2596 prot, datë 11.10.2024, është lidhur kontrata me OE "M. Ch. SHPK & H. C." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../9 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,866,178 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2988 prot, datë 24.12.2025 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "M. C." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1.../7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 207,443 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 552, datë 29.12.2025 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje G. K., G. B. dhe H. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 31.12.2025, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe zv.Kryetari i Bashkisë z. A. K. për Investitorin.
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, administrohet në dosje Vendimi nr. 76, datë 13.12.2024 "Leje për ndryshimin e projektit" me nr. 35 prot, datë 13.12.2024. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
Në dosjen e zbatimit administrohet Oponenca Teknike me nr. 559/4 prot., datë 06.12.2024, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "E.-G" ShPK në vitin 2024.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 15.10.2024 dhe kanë përfunduar me datë 30.10.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
-Me shkresën nr. 16/2, datë 29.10.2024 sipërmarrësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë, për shkak se është bërë projekti i rishikuar, pasi konturet e objektit sipas projektit fillestar nuk përputhen dhe dalin jashtë kufijve të pronës ekzistuese, duke kaluar murin rrethues të objektit ekzistues. Me shkresën nr. 2598/11, datë 07.08.2025, është bërë amendimi i kontratës për afatin e zbatimit të saj, duke zgjatur këtë afat me 45 ditë, deri në datën 28.11.2025. Punimet janë ndërprerë në 29.10.2024 dhe kanë rinisur në datën 13.12.2024.
- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 17,367,666 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 12,147,522 lekë pa TVSH, duke përdorur fondin rezervë në vlerën 5,283,750 lekë pa TVSH.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Ndërtimi i shkollës së mesme "Sali Halili", Rrajcë Fushë" Bashkia Prrenjas				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2598 prot, datë 11.10.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 151,856,222 lekë **Sipërmarrës "E." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt 27.04.2026, 151,856,222 lekë**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 151,856,222 lekë** **-Vlera pa TVSH 117,269,352 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 365 ditë , Zbatuar 380 ditë. Fillimi punimeve: 15.10.2024 Perfundimi punimeve : 30.10.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament nr. 2598/11, datë 07.08.2025, shtyrje afati me 45 ditë, deri në dt. 28.11.2025	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "M. Ch. SHPK & H. C." SHPK	Licenca Nr: MK 3.../9	Kontrata me nr. 2596 prot, datë 11.10.2024	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve "M. C." SHPK	Licenca Nr: MK 1.../7	Kontrata nr. 2988 prot, datë 24.12.2025	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Pa datë	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 31.12.2025		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **576,405 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
	GODIN E SHKOLLËS							
6	**Punime shtresash**							
2	Shtresë betoni C 7/10 në themele t=10 cm	m^3	12,200	44.3	44.33	34.5	9.8	119,560
11	Plintus grez importi h=10 cm	ml	320	1426	1426	1374.3	51.7	16,544
11	Plintuse grez importi, h=10 cm, çmimi	ml	320 lekë/ml	1426	1426	279 lekë/ml	41 lekë/ml	58,466
7	**Punime suvatimi dhe veshje**							
1+2	Veshje fasade me polisterolt=5 cm+rrjetë+suva & suva me grafiato h>4m	m^2	3750 (2450+1300)	1310.5	1310.5	1263	47.5	178,125
	Palestra							
	FV hekur betoni periodik d=6-10 mm	ton	109,000	3.9	2.37	2.37	1.53	163,710
	Pajisje							
1	FV kasetë + hidrant zjarri i brendshëm	copë	40,000	5	5	4	1	40,000
							Total	**576,405**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

GODI..E SHKOLLËS

4- Punime shtresash

1. Zëri 2. Shtresë betoni C 7/10 në themele t=10 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 29.5 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 44.3 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 44.33 m^3, i detajuar sipas themeleve të shkollës dhe të palestrës, me gjatësi të ndryshme dhe me gjerësi 1 m dhe 0.65 m. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se për themelin e palestrës me gjatësi 15.5 m, trashësia e shtresës së betonit është marrë 1.1 m dhe jo 0.1 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 34.5 m^3, ose 9.8 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 11. Plintus grez importi h=10 cm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1292 ml. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1426 ml. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1426 ml, i detajuar sipas ambienteve të shkollës. Nga verifikimi i librit të masave, konstatohet se hapësirat e dyerve nuk janë hequr 2 herë por vetëm një herë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1374.3 ml, ose 51.7 ml më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e shtuar e këtij volumi, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 4. Plintus grez importi h=10 cm, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 1426 ml plintus pllaka grez me h=10 cm, me çmim 320 lekë/ml, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punës. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është 279 lekë/ml (65% x 320 lekë/ml x 8cm/10cm + 35 % x 320 lekë/ml), ose 41 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 41 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 1426 ml), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 7. Veshje fasade me polisterolt=5 cm+rrjetë+suva suva & suva me grafiato h>4m. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 1416 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 1310.5 m^2. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1310.5 m^2, i detajuar sipas fasadave. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, konstatohet se janë zbritur 261.85 m^2 dyer të jashtme + dritare + vetrata, nga 309.5 m^2 (251.55 m^2 dyer dritare + 58 m^2 vetrata). Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1263 m^2, ose 47.5 m^2 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

PALESTRA

14- Punime hekurbetoni

5. Zëri 1. FV hekurbetoni i zakonshëm me d = 6-10 mm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 3.9 ton. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 3.9 ton. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 3.9 ton, i padetajuar, por me një tabelë specifikimi të armaturës, sipas të cilit kjo sasi është 2.37 ton, ose 1.53 ton më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

PAJISJE

6. Zëri 1. FV kasetë + hidrant zjarri i brendshëm. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 5 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në

sasinë 5 ton. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 5 ton, i padetajuar, Nga verifikimi në terren, rezulton se janë vendosur 4 copë, ose 1 copë më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 576,405 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** BOE "M. Ch." SHPK & H. C." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

9) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

10) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 2423 prot, datë 02.06.2025.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "M. C." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

13) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

14) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

15) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 2759 prot, datë 20.11.2025.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. A. Sh. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Gj. D. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Për objektin e mësipërm, nuk janë paraqitur observacione nga palët përgjegjëse.

7. "Rikonstruksioni i kanalit të Lingajcës, Faza II" Bashkia Prrenjas.
Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2849 prot, datë 06.11.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe Operatori Ekonomik "O." SHPK, me përfaqësues z. M. H., me licencë profesionale NZ 4.../11. Vlera e kontratës është 13,742,911 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 1 muaj. Pas kërkesës së sipërmarrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të motit të papërshtatshëm, është hartaua Amendamenti nr. 2849/4 prot., datë 26.11.2024, sipas të cilit miratohet shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 9 ditë.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2881 prot, datë 11.11.2024, është lidhur kontrata me OE "L. -G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 506,154 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3162 prot, datë 18.12.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "G & C." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2.../18 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 78,000 lekë me TVSH.
Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 3297, datë 31.12.2024 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje E. B., G. B. dhe H. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 29.01.2025, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.
Për marrjen e përhershme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 514 prot.,, datë 16.02.2026 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje G. K., E. V. dhe H. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes përfundimtare në dorëzim me nr.514/1 prot., datë 23.02.2026, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 155, datë 04.11.2024. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "E.-G" ShPK në Janar 2024 (kontratë dhurimi me nr.346 prot, datë 29.01.2024).
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 11.11.2024 dhe kanë përfunduar me datë 20.12.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
-Me shkresën nr. 1/2, datë 25.11.2024 sipërmarrësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri në datën 20.12.2024, për shkak të motit të papërshtatshëm të periudhës kur është realizuar objekti. Me shkresën nr. 2849/4, datë 26.11.2024, është bërë amendimi i kontratës për afatin e zbatimit të saj, duke zgjatur këtë afat me 9 ditë, deri në datën 20.12.2024.
- Në dosjen teknike administrohet korrespondenca midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë miratuar ndryshime volumesh, me punime që shtohen prej 5,353,873.4 lekë pa TVSH dhe punime që pakësohen prej 5,020,307.6 lekë pa TVSH, duke përdorur fondin rezervë në vlerën 333,565.8 lekë pa TVSH. Është bërë shtimi i një zëri të ri pune ("Prerje pemë me d~25 cm"), për të cilin është bërë negocimi i çmimit me procedurë të rregullt.

Nga verifikimi të tabelës së ndryshimit të volumeve (+/-), e miratuar nga palët dhe situacionit përfundimtar u konstatua se, ka ndryshime në volume në 5 zëra pune nga 10 zëra që janë gjithsej. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i kanalit të Lingajcës, Faza II" Bashkia Prrenjas				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2849 prot, datë 06.11.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 13,742,911 lekë **Sipërmarrës "O." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt 20.03.2025** **13,742,910 lekë**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 13,742,910 lekë** **-Vlera pa TVSH 11,452,425 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 30 ditë , Zbatuar 39 ditë. Fillimi punimeve: 11.11.2024 Perfundimi punimeve : 20.12.2024		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament nr. 2489/4 prot, datë 26.11.2024, shtyrje afati me 9 ditë, deri në dt. 20.12.2024	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "L. -G." SHPK	Licenca Nr: MK 3.../1	Kontrata me nr. 2881 prot, datë 11.11.2024	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve "G & C." SHPK	Licenca Nr: MK 2.../18	Kontrata nr. 3162 prot, datë 18.12.2024	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 30.12.2024	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 29.01.2025		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **516,000 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
II	**Ndërtim vepra arti + kanalizime**							
9	Mbushje me çakëll pas mureve	m^3	600	860	860	0	860	516,000
						Total		**516,000**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

3- Ndërtim vepra arti + kanalizime

1. Zëri 3. Mbushje me çakëll pas mureve. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është 7300 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 860 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 860 m^3, i detajuar për gjatësinë (500 ml) dhe gjerësinë e vazhduar të kanalit 8.6 m (2.8 m + 3 m + 2.8 m), me t=20 cm. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të zbatimit, konstatohet se ky volum është librezuar dhe situacionuar në zërin 9 "Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri". Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 516,000 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "L.-G." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

11) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

12) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 2881 prot, datë 11.11.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "G & C " ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

16) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

17) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

18) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 3162 prot, datë 18.12.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. L. K.me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. S.me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr. 08/18 prot, datë 08.09.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/19, datë 14.09.2026, është observuar nga përfaqësuesi i mbikëqyrësit të punimeve z. L. K.dhe përfaqësuesi i kontraktorit të punimeve OE "O." SHPK, me të njëjtat pretendime, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në matjet faktike në terren, të pasqyruara në librin e masave dhe situacionit përfundimtar, volume 860 m^3, është mbushja e kanalit për riseksionim, pasi kanali ka qenë I dëmtuar nga

grryerja dhe amortizimi në kohë. Ndërsa zëri nr. 9 i përket mbushjes së rrugës, jo kanalit dhe në këto kushte nuk përbën dëm ekonomik shuma prej 516,000 lekë.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit, sqaron se:

Në të dy zërat e punës, si ai i pretenduar si mbushje për seksionimin e kanalit, edhe ai i mbushjes së rrugës, volumet janë llogaritur me të njëjtën gjerësi, 8.6 m, që, sipas projektit dhe librit të masave, përkon me dy skarpatat + baza e kanalit. Gjerësia e rrugës, edhe sikur të ishte detyrim kontraktual për t'u sistemuar (e cila në fakt nuk është), nuk e kalonte gjerësinë 3 m. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

8. "Rikonstruksioni i kanalit të Xhelos, Faza II dhe sistemimi i ujërave të larta në Krastën e Prrenjasit" Bashkia Prrenjas.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2705 prot, datë 24.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, të përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. N. B. dhe Operatori Ekonomik "A. I." SHPK, me përfaqësues z. Sh. D., me licencë profesionale NZ 8.../1. Vlera e kontratës është 14,505,977 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2719 prot, datë 25.10.2024, është lidhur kontrata me OE "L. -G." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3.../1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 462,199 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3188 prot, datë 20.12.2024 është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "M. C." ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1503/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 69,330 lekë me TVSH.

Për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit, në dosje administrohet urdhër për ngritjen e grupit të punës, me nr. 3293 prot., datë 31.12.2024 të titullarit të Bashkisë Prrenjas, me përbërje G. B., M. H. dhe P. K.. Është hartuar Certifikata e Marrjes së Përkohshme në dorëzim pa nr. prot., datë 31.12.2024, i nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi, kolaudatori i punimeve, si dhe nga grupi i punës dhe Kryetari i Bashkisë z. N. B. për Investitorin.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, administrohet në dosje Leje infrastrukturore me nr. 32, datë 18.10.2024. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria "V. E." ShPK në Janar 2024 (kontratë dhurimi me nr.346 prot, datë 29.01.2024).

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 25.10.2024 dhe kanë përfunduar me datë 23.12.2024, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike **nuk** administrohet korrespondencë midis sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe Investitorit, në lidhje me ndryshimet në projekt dhe miratimi i preventivit të ripunuar. Nga auditimi i preventivit të ofertës dhe situacionit përfundimtar, të miratuar nga titullari i Bashkisë z. N. B., konstatohet se volumet në 11 nga 31 zëra pune, nuk janë të njëjta. Sa sipër është miratuar situacioni përfundimtar i ndryshëm nga preventivi i ofertës. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 610, datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të

mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve", neni 28, pika 2, sipas të cilës "*Për përcaktimin e vlerës përfundimtare të punimeve të kryera në objekt, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe përllogarit koston përfundimtare, duke përputhur vlerën e preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe bën sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes*" dhe ngarkon me përgjegjësi Mbikëqyrësin e punimeve dhe Titullarin e Bashkisë Prrenjas.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivi bazë dhe i ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i kanalit të Xhelos, Faza II dhe sistemimi i ujërave të larta në Krastën e Prrenjasit" Bashkia Prrenjas				
14.Lidhja e kontratës Nr. 2705 prot, datë 24.10.2024	**15.Vlera e kontratës (me TVSH)** 14,505,977 lekë **Sipërmarrës "A. I." ShPK**		**16.Likuiduar deri dt 31.12.2024** **14,505,970 lekë**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me TVSH 14,505,970 lekë** **-Vlera pa TVSH 12,088,308 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 90 ditë , Zbatuar 59 ditë. Fillimi punimeve: 25.10.2024 Perfundimi punimeve : 23.12.2024		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "L. -G" SHPK	Licenca Nr: MK 3.../1	Kontrata me nr. 2719 prot, datë 25.10.2024	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve "M. C." SHPK	Licenca Nr: MK 1.../7	Kontrata nr. 3188 prot, datë 20.12.2024	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 27.12.2024	**23.Akt i marrjes në dorëzim**, datë 30.12.2024		**24**. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **387,800 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
4	**Punime betoni dhe betonarmeje**							
11	Strukturë monolite b/a C25/30	m^3	14000	158.4	158.4	133.2	25.2	352,800
8	**Punime gërmimi**							
22	Transport dheu me auto deri në 5 km	m^3	500	422	422	352	70	35,000
							Total	**387,800**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

4- Punime betoni dhe betonarmeje

1. Zëri 11. Strukturë monolite b/a C25/30. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është në total 155 m^3. Në situacionin përfundimtar volumi i këtij zëri pune është 158.4 m^3. Në librin e

masave volumi i është 158.4 m^3, i detajuar për gjatësitë, gjerësitë mesatare të bazës së kanalit dhe trashësitë e shtresës së betonit 0.15 m, për të tre kanalet. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të zbatimit dhe verifikimit në terren, konstatohet se gjerësia mesatare e bazës së kanalit nr. 2 dhe nr. 3 është respektivisht 0.9 m dhe 0.8 m për gjatësitë e strukturës 240 ml për secilin kanal, nga 1.5 m dhe 1.4 m që është marrë në librin e masave. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 133.2 m^3, ose 25.2 m^3 më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

8- Punime gërmimi

2. Zëri 22. Transport dheu me auto deri në 5 km. Në preventivin e ofertës volumi i këtij zëri pune është në total 350 m^3. Në situacionin përfundimtar volumi i këtij zëri pune është 422 m^3. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 422 m^3, i detajuar për 492 m^3 gërmim – 70 m^3 gjendje në objekt për mbushje. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të zbatimit, konstatohet se gërmimi është 422 m^3, ose 70 m^3 më pak se volumi i librezuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 387,800 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "L.-G." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit nr. 2719 prot, datë 25.10.2024.
- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** "M. C." ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve nr. 3188 prot, datë 20.12.2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. L. K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. Gj. D. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Lidhur me objektin e mësipërm, me emailin e datës 14.09.2016 me shkresën me nr. 41/1 prot, datë 03.09.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/9, datë 29.07.2026, është observuar nga përfaqësuesi i Mbikëqyrësit "L.-G." & "M." SHPK , si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Mbi volumin e strukturës monolite C25/30

Sipas matjeve faktike në terren, të pasqyruara në Librin e Matjeve dhe Situacionit Përfundimtar volumi strukturës monolite betoni C-25/30 është 158.4 m^3, që i përgjigjet seksioneve të kanaleve KUL me trashësi t=15cm dhe nuk përbën dëm ekonomik.

2. Mbi volumin e gërmimeve dhe transportit të dheut

Volumi prej 422 m^3 i transportit të dheut me auto deri 5 km është volumi i gërmimeve të zërave 23&26=192+300=422 m^3 dhe nuk ka si të jetë 350 m^3. Nga Sipërmarrësi volumi i dheut është transportuar detyrimisht pasi punimet kryhen në qytet dhe nuk mund të lihen pranë kanalit.Volumi transportit është korrekt dhe nuk përbën dëm ekonomik.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, sqaron se:

1. Konstatimi i cituara në aktkonstatimin nr. 19 në lidhje me volumet e betonit, rrjedhin nga verifikimi i librezës së masave të administruar në dosjen teknike të zbatimit të punimeve të këtij objekti dhe nga verifikimi në terren në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit të punimeve, sipas të cilit, përmasat e kanalit janë ato të cituara në aktin e konstatimit dhe në Projektraportin e Auditimit. Sa sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Përsa i përket volumit të transportit të dheut, edhe grupi i auditimit është shprehur njësoj si observuesi, I cili, në ndryshim nga grupi I auditimit, nuk ka cituar volumin prej 70 m^3, i cili është përdorur për mbushje. Sa sipër ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Gjithashtu, lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën me nr. 41/1 prot, datë 03.09.2026, protokolluar në KLSH me nr. 380/9, datë 29.07.2026, është observuar nga përfaqësuesi i kontraktorit të punimeve OE "A. I." SHPK, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Mbi volumin e strukturës monolite C25/30

Për zërin "Struktura monolite betoni C25/30", në Librin e Masave është dokumentuar volumi faktik prej 158.40 m^3, i ndarë sipas segmenteve:
Segmenti 1 – 54.00 m^3;
Segmenti 2 – 50.40 m^3;
Segmenti 3 – 54.00 m^3;
Total – 158.40 m^3.
Këto volume janë nxjerrë mbi bazën e dimensioneve faktike të punimeve të realizuara dhe janë kontrolluar dhe firmosur nga mbikëqyrësi i punimeve.
Për rrjedhojë, diferenca prej 25.2 m^3, e evidentuar nga KLSH në raport me sasinë e preventivuar, nuk mund të konsiderohet si volum i parealizuar apo dëm ekonomik vetëm për faktin se tejkalon

sasinë e parashikuar fillimisht. Bëhet fjalë për një volum që është realizuar fizikisht në objekt dhe është dokumentuar teknikisht.
Për të konsideruar shumën 352,800 lekë si dëm ekonomik, duhet të provohet konkretisht se kjo sasi prej 25.2 m³ nuk është realizuar fizikisht, është matur në mënyrë të pasaktë ose është paguar për punime të pakryera. Dokumentacioni teknik i objektit tregon të kundërtën.

3. Mbi volumin e gërmimeve dhe transportit të dheut

Për zërin "Transport dheu me auto deri 5.0 km", sasia prej 422.00 m³ është e dokumentuar në Librin e Masave. Nga dokumentacioni teknik rezulton përllogaritja: 492.00 m³ – 70.00 m³ = 422.00 m³.
Edhe kjo sasi është rezultat i matjeve dhe përllogaritjeve faktike të punimeve të realizuara dhe është pasqyruar në Librin e Masave dhe kontrolluar në kuadër të mbikëqyrjes së punimeve.
Për këtë arsye, diferenca prej 70 m³ ndaj sasisë së parashikuar fillimisht nuk mund të konsiderohet automatikisht si dëm ekonomik, pasi bëhet fjalë për punime të realizuara dhe të dokumentuara.

4. Mbi ndryshimin e volumeve dhe preventivin e ripunuar

Në Projekt-Raport është ngritur pretendimi se për ndryshimin e volumeve nuk është ndjekur procedura përkatëse dhe se nuk është kryer ripunimi i preventivit.
Lidhur me këtë konstatim, sqarojmë se ndryshimi i volumeve është kryer dhe preventivi është ripunuar, së bashku me dokumentacionin përkatës të objektit. Për këtë arsye, konstatimi se ky dokumentacion nuk është hartuar nuk përputhet me gjendjen faktike të dokumentacionit të administruar për objektin.
Vlerësojmë se ky përfundim është arritur pa u kryer një verifikim i plotë i dokumentacionit përkatës të ndryshimit të volumeve dhe preventivit të ripunuar. Kërkojmë që ky dokumentacion të administrohet, të verifikohet dhe të merret në konsideratë përpara hartimit të Raportit Përfundimtar.

5. Mbi dallimin ndërmjet diferencës së volumeve dhe dëmit ekonomik

Duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet sasisë së parashikuar në preventivin fillestar, sasisë faktike të realizuar, dokumentimit dhe verifikimit të sasisë së realizuar, procedurës së ndryshimit dhe formalizimit të volumeve dhe ekzistencës së një dëmi ekonomik.
Në rastin konkret, punimet janë realizuar faktikisht, janë matur, janë pasqyruar në Librin e Masave dhe janë kontrolluar nga mbikëqyrja. Për rrjedhojë, vetëm fakti që sasia faktike është më e madhe se sasia e parashikuar fillimisht në preventiv nuk provon në vetvete ekzistencën e një dëmi ekonomik.
Për të konsideruar shumën prej 387,800 lekë pa TVSH si dëm ekonomik, duhet të provohet konkretisht se këto punime nuk janë realizuar, janë matur në mënyrë të pasaktë ose janë paguar për punime të pakryera. Në rastin konkret, dokumentacioni teknik i objektit tregon të kundërtën.

6. Mbi verifikimin e dokumentacionit nga grupi i auditimit

Vlerësojmë se konstatimi i paraqitur në Projekt-Raport është mbështetur kryesisht në krahasimin e preventivit fillestar me situacionin përfundimtar, pa u bërë një verifikim i plotë dhe i gjithanshëm i dokumentacionit teknik dhe administrativ që shoqëron ndryshimin e volumeve.
Në mënyrë të veçantë, kërkojmë të verifikohen Libri i Masave, matjet faktike të punimeve, dokumentacioni i ndryshimit të volumeve, preventivi i ripunuar, dokumentacioni i situacionit përfundimtar, dokumentacioni i mbikëqyrjes dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë ndryshimin e volumeve.

Nuk mund të arrihet në përfundimin se një dokumentacion mungon pa u verifikuar në mënyrë konkrete ekzistenca dhe përmbajtja e tij në dosjen e objektit. Në rastin konkret, dokumentacioni ekziston dhe duhet të merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar.

7. Mbi përgjegjësinë e mbikëqyrësit të punimeve

Në lidhje me përgjegjësinë e mbikëqyrësit, theksojmë se dokumentacioni provon se mbikëqyrësi nuk ka certifikuar volume fiktive apo të parealizuara. Përkundrazi, mbikëqyrësi ka kontrolluar dhe nënshkruar volumet e punimeve të realizuara në terren, të cilat janë pasqyruar në Librin e Masave.

Për zërin e betonit C25/30 është kontrolluar volumi 158.40 m³, ndërsa për gërmimet/transportin e dheut është dokumentuar volumi 422.00 m³. Këto janë volume të punimeve të kryera realisht dhe të verifikueshme fizikisht në objekt.

Për këtë arsye, çdo vlerësim mbi përgjegjësinë individuale duhet të bazohet në dokumentacionin real dhe në veprimet konkrete të personit përgjegjës dhe jo vetëm në diferencën aritmetike ndërmjet preventivit fillestar dhe situacionit përfundimtar.

8. Kërkesa

Për sa më sipër, kërkojmë që grupi i auditimit:

a) Të verifikojë dokumentacionin e ndryshimit të volumeve dhe preventivin e ripunuar, të cilat janë hartuar për objektin.
b) Të verifikojë Librin e Masave, ku janë dokumentuar volumet faktike të realizuara.
c) Të marrë në konsideratë faktin se volumi 158.40 m³ i betonit C25/30 dhe volumi 422.00 m³ i gërmimeve/transportit të dheut janë punime të realizuara faktikisht, të matura dhe të verifikuara.
d) Të rishikojë konstatimin se këto volume përbëjnë dëm ekonomik vetëm për shkak të tejkalimit të sasisë së preventivit fillestar.
e) Të rishikojë vlerën e pretenduar si dëm ekonomik prej 387,800 lekë pa TVSH.
f) Të rishikojë konstatimin lidhur me mungesën e procedurës dhe të preventivit të ripunuar, pasi këto dokumente janë hartuar dhe ndodhen në dokumentacionin e objektit.
g) Të rishikojë përgjegjësinë e mbikëqyrësit të punimeve, duke marrë në konsideratë faktin se volumet e realizuara janë kontrolluar dhe certifikuar nëpërmjet Librit të Masave dhe dokumentacionit teknik përkatës.
h) Të hiqet ose rishikohet konstatimi për dëm ekonomik në vlerën 387,800 lekë pa TVSH, pasi punimet përkatëse janë realizuar faktikisht, janë matur, dokumentuar dhe verifikuar.

Duke ju falënderuar për shqyrtimin e këtij observacioni, kërkojmë që argumentet e paraqitura më sipër të administrohen dhe të merren në konsideratë gjatë hartimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Opinioni i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, sqaron se:

Së pari, konstatimi i bërë nga grupi i auditimit, duhet të ishin kundërshtuar nga përfaqësuesit e palës përgjegjëse, të cilët janë mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve dhe jo nga sipërmarrësi i punimeve.

- Konstatimet e cituara në aktkonstatimin nr. 19 rrjedhin nga verifikimi i librezës së masave të administruar në dosjen teknike të zbatimit të punimeve të këtij objekti dhe nga verifikimi në terren në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit të punimeve. Sa sipër këto *pretendime nuk merren në konsideratë.*

Pika 2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Bashkia Prrenjas ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT), nr. 03, datë 14.04.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTP e Bashkisë Prrenjas, janë miratuar 17 leje ndërtimi, ndër të cilat leje për ndërtim të ri/ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2 janë miratuar 2 leje, leje ndërtimi për ndërtim deri në 250 m^2 janë miratuar 15 leje. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet përmbledhja e listës së lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Prrenjas, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025:

Nr.	Vendimi leje ndërtimi	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi sipas subjektit
1	Vendim nr. 55, datë 08.04.2024	Ngritje kati me funksion "Banesë" mbi objektin ekzistues soc-ekonomik 1 kat	M. O.	M. O.	322.6 m^2	10,265,970
2	Vendim Nr. 67 date 08.05.2024	Banesë 1 kat + çati	Xh. B.	Xh. B.	115.5 m^2	4,521,407
3	Vendim Nr. 57 date 15.04.2024	Magazinë bujqësore 1 kat (për agrobiznes) + banesë 1 kat (me mbulesë çati)	L. P.	L. P.	197.4 m^2	6,777,674
4	Vendim Nr. 56 date 05.04.2024	Magazinë bujqësore 1 kat (për agrobiznes) + banesë 1 kat (me mbulesë çati)	Sh. P.	Sh. P.	192 m^2	6,545,678
5	Vendim Nr. 68 date 08.05.2024	Prishje objekti ekzistues 2 kat + Ndrëtim banese e re individuale 2 kat (me mbulesë e çati)	A. B.	A. B.	202 3m^2	8,240,152
6	Vendim Nr. 76 date 23.05.2024	Shtesë e përparme e pasme në objektin ekzistues 1 kat + ngritje kati (me mbulesë çati)	M. H.	M. H.	157.4 m^2	4,733,019
7	Vendim Nr. 97 date 02.07.2024	Banesë 1 kat + çati	A. H.	A. H.	144 m^2	6,180,674
8	Vendim Nr. 98 date 03.07.2024	Ndërtim banesë e re individuale 2 kat + çati	E-G	L. K.	243 m^2	6,493,734
9	Vendim Nr. 88 date 19.06.2024	Ndërtim banesë e re individuale 2 kat	R. R.	R. R.	248 m^2	8,391,630
10	Vendim Nr. 121 date 20.08.2024	Shtesë e përparme dhe anësore në të dyja katet e objektit ekzistues 2 kat të z. G. B. dhe zj. I. B.	K. B.	G. B.	55.4 m^2	4,801,355
11	Vendim Nr. 82 date 11.06.2025	Ngritje kati (me funksion banese), mbi objekt ekzistues	A. Sh.	A. Sh. & M. Sh.	230.1 m^2	8,815,345
12	Vendim Nr. 09 date 03.06.2025	Ngritje kati me funksion banesë mbi objektin ekzistues soc-ekonomik 1 kat, të z. D. K. dhe zj. L. K.	K. B.	D. K.	249.5 m^2	8,800,,839
13	Vendim Nr. 92 date 30.06.2025	Ndërtim papafingo mbi banesën	K. B.	D. B.	105.5 m^2	3,471,808

		ekzistuese 1 kat, të z. D. B.				
14	Vendim Nr. 170 date 10.11.2025	Banesë 1 kat + papafingo	E. O.	E. O.	179.6 m^2	7,788,311
15	Vendim Nr. 182 date 26.11.2025	Prishje e pjesshme në pjesën anësore të objektit ekzistues + shtesë e përparme + ngritje kati (me mbulesë çati) mbi objektin ekzistues të z. Y. G. dhe zj. M. G.	K. B.	Y. G.	133.8 m^2	4,577,078
16	Vendim Nr. 191 date 11.12.2025	Linja elektrike ajrore 35KV Hec Bushtrica 2 – NST Prrenjas	B. 20.	B. 20.	7,072 metër gjatësi lineare, 6,192 rrugë lidhëse	45,770,132
17	Vendim Nr. 163 datë 27.10.2025	Ndërtim papafingo mbi objekt ekizstues 4 kat	K. B.	Dh. K. 92.	92.4 m^2	3,629,901

-Mbi auditimin e lejeve të ndërtimit

Nga auditimi, janë konstatuar mangësi në lejet e mëposhtme:

1.Sipas regjistrit elektronik nr. 717 në emër të zhvilluesit M. O. dhe M. O., me datë aplikimi 08.04.2024, për objektin: *""Ngritje kati me funksion "Banesë", mbi objektin ekzistues soc-ekonomik 1 kat"*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1.Planvendosja e miratuar nuk është e saktë, pasi nuk pozicionohet mbi rilevimin topografik, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (c) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

2.Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi nuk paraqiten prerjet dhe fasadat teknike, sipas pikës 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

3.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

4. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 24.10.2023, ndërkohë që aplikimi është i datës 08.04.2024.

-Gjithashtu, sipas kartelës së lëshuar, ajo rezulton në seksionin D të saj "Kufizimet e Pronësisë" me kufizime, pasi sipas përshkrimi ajo është e bllokuar deri në krijimin e marrëdhënieve mbi truallin.

5.Projekti Elektrik, nga inxhinier E. B., mungon kopje e policës së sigurimit të projektuesve për mbulimin e përgjegjësive profesionale, në kundërshtim me nenin 15 pika 1 germa (g) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.;

6.Mungon projekti për eficiencën energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

7.Mungon mendimi i Institucioneve, konkretisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
8.Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 789</u> në emër të zhvilluesit L. P., me datë aplikimi 15.04.2024, për objektin: "Magazinë bujqësore 1 kat (për agrobiznes) + banesë 1 kat (me mbulesë çati)*".*

1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2.Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi nuk paraqiten prerjet dhe fasadat teknike, sipas pikës 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
3.Në planvendosjen e miratuar ka mangësi pasi nuk pasqyrohet qartë aksesi për në objekt, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (c) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
4.Nuk respektohet distanca në veri dhe në perëndim të pronës e cila rezulton sipas planvendosjes 3 metër. Referuar nenit 57 pika 10 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Prrenjas, Miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 3, datë 14.04.2017, përcaktohet se distancat nga kufiri i pronës llogariten d=hst x 0.4, pra lartësia e pronës x 0.4. Objekti është në lartësinë 8 m x 0.4 = 3.2 metër.
5. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 22.11.2023, ndërkohë që aplikimi është i datës 15.04.2024.
6.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
7.Mungon mendimi i Institucioneve pasi nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
8.Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.

3.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 795/1</u> në emër të zhvilluesit Sh. P., me datë aplikimi 15.04.2024, për objektin: "Magazinë bujqësore 1 kat (për agrobiznes) + banesë 1 kat (me mbulesë çati)*".*

1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2.Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi nuk paraqiten prerjet dhe fasadat teknike, sipas pikës 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

3.Nuk respektohet distanca në veri dhe perëndim të pronës e cila rezulton sipas planvendosjes 1.5 metër. Referuar nenit 57 pika 10 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Prrenjas, Miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 3, datë 14.04.2017, përcaktohet se distancat nga kufiri i pronës llogariten d=hst x 0.4, pra lartësia e pronës x 0.4. Objekti është në lartësinë 8 m x 0.4 = 3.2 metër.
4. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 17.11.2023, ndërkohë që aplikimi është i datës 15.04.2024.
5.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
6.Mungon mendimi i Institucioneve pasi nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
7. Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
4.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 891/1</u> në emër të zhvilluesit A. B., me datë aplikimi 08.04.2024, për objektin: *"Prishje objekti ekzistues 2 kat + Ndertim banese e re Individuale 2 kat (me mbulese cati)"*.
1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2.Planvendosja është e pa plotë, pasi nuk ka pasqyruar katet e objekteve me të cilat kufizohet objekti i ri për përcaktimin e distancave, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (c) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
3.Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi nuk paraqiten prerjet dhe fasadat teknike, sipas pikës 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
4.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
5.Mungon mendimi i Institucioneve pasi nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
6. Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
5.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 1444</u> në emër të zhvilluesit Luan Kojo, me datë aplikimi 03.07.2024, për objektin: *"Ndërtim banesë e re individuale 2 kat + çati"*.
1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

2. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 29.02.2024, ndërkohë që aplikimi është i datës 03.07.2024.
3.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
4.Mungon mendimi i Institucioneve pasi me përjashtim të PMNZSH Prrenjas nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
5. Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
6.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 1605</u> në emër të zhvilluesit R. R., me datë aplikimi 03.07.2024, për objektin: *"Ndërtim banese e re individuale 2 kat"*.
1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar 3 muajt e fundit. Referuar Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457. Datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45 germa (c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jetë e rifreskuar 3 muajt e fundit, referuar datës së aplikimit. Nga auditimi, rezulton se kartela është e datës 13.03.2024, ndërkohë që aplikimi është i datës 19.06.2024.
3.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
4.Mungon mendimi i Institucioneve pasi me përjashtim të PMNZSH Prrenjas nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
5. Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
7.<u>Sipas regjistrit elektronik nr. 923</u> në emër të zhvilluesit A. Sh. dhe M. Sh., me datë aplikimi 28.04.2025, për objektin: *"Ngritje kati (me funksion banese), mbi objekt ekzistues" "*.
1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2.Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi nuk paraqiten prerjet dhe fasadat teknike, sipas pikës 1/1 germa (i) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
3.Planvendosja është e pa plotë, pasi nuk ka pasqyruar katet e objekteve me të cilat kufizohet objekti i ri për përcaktimin e distancave, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (c) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

4.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
5.Mungon mendimi i Institucioneve pasi me përjashtim të PMNZSH Prrenjas nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
6.Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
8.Sipas regjistrit elektronik nr. 1018 në emër të zhvilluesit Dashamir Kryeziu, me datë aplikimi 03.06.2025, për objektin: *"Ngritje kati (me funksion banesë) mbi objektin ekzistues soc-ekonomik 1kat", të z. D. K. dhe znj. L. K."*.
1.Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore, në kundërshtim me pikën 1, germa (ë) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
2.Mungon projekti për eficiencën e energjetike, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1 (v) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
3.Mungon mendimi i Institucioneve pasi me përjashtim të PMNZSH Prrenjas nuk janë bërë kërkesa për mendim, në kundërshtim me pikën 6 të nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
4. Mungojnë projektet në dëg, në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (ç) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar.
Lidhur me mangësitë e mësipërme, për miratimin e lejes në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, ngarkohen me përgjegjësi M. P. dhe E. B.– Drejtues, M. H.dhe O. A. - Kontrollues, N. B.– Nëpunës, z. N. B. – Kryetar i Bashkisë Prrenjas.

Pika 2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

Organizimi dhe funksionimi i IMTV Bashkia Prrenjas

Përshkrimi i situatës.

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme".* Në strukturën aktuale, IMTV ka në përbërje 4 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 3 inspektor.
-Për periudhën objekt auditim 01.01.2024 deri 31.12.2025 IMTV është drejtuar nga K/inspektor J. K. deri më 01.02.2024, i cili rezulton me arsim për Teknologji Informacioni, nga data 01.02.2024 deri më 10.07.2024 është drejtuar nga K/inspektor G. Ç. me arsim Inxhinier Shkenca Toke, E. K. nga data 16.09.2024 deri më 27.04.2025 me arsim Inxhinier Miniere dhe nga periudha 27.04.2025 e në vijim sërish nga G. Ç..
Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe janë, A. A. me arsim inxhinier për Burimet Natyrore, E. D. – Akademia e Sigurisë, A. T. – Inxhinier Mjedisi , M. A. – Inxhinier Gjeolog, M. M.– Inxhinier Mjedisi.
Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Prrenjas, përgjatë periudhës objekt auditimi, përgjithësisht pjesën më të madhe të stafit të rekrutuar e ka me profilin e kërkuar, por rezulton se 2 prej punonjësve nuk kanë arsimin e nevojshëm (Akademia e Sigurisë, Teknologji Informacioni)

në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"* i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

NR	Emër Mbiemër	Pozicioni sipas strukturës	Profesioni	Arsimi	Periudha e Punës
	Viti 2024				
1	J. K.	Kryeinspektor	Teknologji Informacioni	I Lartë	22.11.2023 - 01.02.2024
2	A. A.	Inspektor	Inxhinier Burimet Natyrore	I Lartë	18.06.2020 – 18.04.2024 Larguar me Dorëheqje
3	G. Ç.	Kryeinspektor	Inxhinier Shkenca Toke	I Lartë	01.02.2024 – 10.07.2024 Larguar Dorëheqje
4	E. K.	Inspektor Kryeinspektor	Inxhinier Miniere	I Lartë	15.05.2024– 16.09.2024 16.09.2024– 27.04.2025
5	E. D.	Inspektor	Akademia e Sigurisë	I Lartë	02.08.2024 – 31.12.2025
	G. Ç.	Inspektor/ Kryeinspektor	Inxhinier Shkenca Toke	I Lartë	11.12.2024 – 27.04.2025 27.04.2025 – 31.12.2025
6	A. T.	Inspektor	Inxhinier mjedisi	I Lartë	20.05.2025 – 06.10.2025
7	M. A.	Inspektor	Inxhinier Gjeolog	I lartë	07.10.2025 – 31.12.2025
8	M. M.	Inspektor Mjedisi	Inxhinier Gjeodet	I artë	

Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje.

-Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025, janë mbajtur 52 akte konstatimi për punime pa leje, të evidentuara sipas tabelës si më poshtë:

Viti 2024

Nr	Kundërvajtësi (adresa)	PVKK Nr.Serie	Përshkrimi	Inspektorët	Pezullimi Nr.Serie	Vendim gjobë Nr.Serie	Vendim prishje Nr.Serie	K/Inspektori
1	B. M.	Nr.00122 03.04.2024	Shtesë objekti + ndërtim mur guri	A. A. J. K.	Nr. 000094 12.04.2024	Nr.000079 12.04.2024 500,000 lekë	Nr.0000063 12.04.2024	G. Ç.
2	K. Q.	Nr. 00123 03.04.2024	Sistemim shkallësh	A. A. J. K.				
3	N. M.	Nr. 00124 08.04.2024	Shkelje projekti	A. A. J. K.		Nr. 000080 18.04.2024 20,000 lekë		
4	G. A.	Nr. 00125 15.04.2024	Objekt 1 kat banimi	A. A. J. K.	Nr. 000096 26.04.2024	Nr. 000082 26.04.2024 500,000 lekë	Nr. 0000065 26.04.2024	G. Ç.

5	G. S.	Nr. 00126 17.04.2024	Rikons. objekti ekzistues	G. Ç. J. K.	Nr. 000095 26.04.2024	Nr. 000081 26.04.2024 20,000 lekë	Nr.0000064 26.04.2024	G. Ç.
6	F N.	Nr. 00127 15.05.2024	Konstrukt metalik, kapanon pa leje	E. K. J. K.				G. Ç.
7	A H.	Nr. 128 16.05.2024	Ndërtim kolonash, zaptim i pronës publike	E. K. J. K.				G. Ç.
8	N. B.	Nr. 129 28.05.2024	Ndërtim kolonash, zaptim i pronës publike	E. K. G. A.				G. Ç.
9	M. H.	Nr.00001 04.11.2024	Objekt 1 kat banese	E. K. E. D.				E. K.
10	Xh. Gj.	Nr.00002 08.11.2024	Objekt 1 kat banese	E. K. E. D.				E. K.
11	N.T.	Nr. 00003 18.12.2024	Ndërtim kolonash pa leje	G. Ç. E. D.				E. K.
12	Pa autor	Nr. 00004 27.12.2024	Objekt 1 kat banimi	E. D. G. Ç.				E. K.

Viti 2025

Nr	Kundërvajtësi (adresa)	PVKK Nr.Serie	Përshkrimi	Inspektorët	Pezullimi Nr.Serie	Vendim gjobë Nr.Serie	Vendim prishje Nr.Serie	K/Inspektori
1	R. H.	Nr.00005 14.01.2025	Ndërtim Objekti 2kate	E. D. G. Ç.	Nr.000097 17.01.2025	Nr.000084 17.01.2025 500,000 lekë	Nr.0000066 14.01.2025	E. K.
2	F B.	Nr.00006 15.01.2025	Ndërtim çatie	E. D. G. Ç.	Nr.000098 18.01.2025	Nr.000085 18.01.2025 500,000 lekë	Nr.0000067 18.01.2025	E. K.
3	Q. M.	Nr.00007 14.02.2025	Mur rrethues	E. D. G. Ç.	Nr.000099 14.01.2025	Nr.000086 14.02.2025 500,000 lekë	Nr.0000068 14.02.2025	E. K.
4	N. Ç.	Nr.00008 14.02.2025	Ngritje kati	E. D. G. Ç.	Nr.000100 14.02.2025	Nr.000087 14.02.2025 500,000 lekë	Nr.0000069 14.02.2025	E. K.
5	G. G.	Nr.00009 14.02.2025	Objekt 2 kate	E. D. G. Ç.	Nr.00034 14.02.2025	Nr.000088 14.02.2025 500,000 lekë	Nr.0000070 14.02.2025	E. K.
6	R. G.	Nr.00010 19.02.2025	Ngritje kati	E. D. G. Ç.	Nr.00035 19.02.2025	Nr.000089 19.02.2025 500,000 lekë	Nr.0000071 19.02.2025	E. K.
7	R. A.	Nr.00011 19.02.2025	Ngritje kati	E. D. G. Ç.	Nr.00036 19.02.2025	Nr.000090 19.02.2025	Nr.0000072 19.02.2025	E. K.
8	M. S.	Nr.00012	Garazh	E. D.	Nr.00037	Nr.000091	Nr.0000073	E. K.

		19.02.2025		G. Ç.	19.02.2025	19.02.2025 500,000 lekë	19.09.2025	
9	H. M.	Nr.00014 28.02.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00038 28.02.2025	Nr.000092 28.02.2025 500,000 lekë	Nr.0000074 28.02.2025	E. K.
10	A. K.	Nr.00015 03.03.2025	Shtesë objekti	E. D. G. Ç.	Nr.00039 03.03.2025	Nr.000093 03.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000075 03.03.2025	E. K.
11	K. H.	Nr.00016 05.03.2025	Ngritje kati	E. D. G. Ç.	Nr.00040 03.03.2025	Nr.000094 03.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000076 03.03.2025	E. K.
12	K. S.	Nr.00017 05.03.2025	Ndërtim çatie	E. D. G. Ç.	Nr.00041 05.03.2025	Nr.000095 05.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000077 03.03.2025	E. K.
13	O. T.	Nr.00018 05.03.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00042 05.03.2025	Nr.000096 05.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000078 03.03.2025	E. K.
14	V. K.	Nr.00019 05.03.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00043 05.03.2025	Nr.000097 05.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000079 05.03.2025	E. K.
15	K. SH.P.K	Nr.00020 05.03.2025	Hedhje Inertesh	E. D. G. Ç.	Nr.00044 05.03.2025	Nr.000098 05.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000080 05.03.2025	E. K.
16	A. H.	Nr.00021 11.03.2025	Mosrespekt im afati lejes ndërtimit	E. D. G. Ç.	Nr.00045 11.03.2025	Nr.000083 18.03.2025 100,000 lekë	Nr.0000081 11.03.2025	E. K.
17	F. A. D.	Nr.00022 11.03.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00046 11.03.2025	Nr.00001 14.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000082 11.03.2025	E. K.
18	R. H.	Nr.00023 28.03.2025	Ndërtim Objekti Solete 1kt	E. D. G. Ç.	Nr.00047 28.03.2025	Nr.00002 28.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000083 28.03.2025	E. K.
19	N. A. D.	Nr.00024 28.03.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00048 28.03.2025	Nr.00003 28.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000084 29.03.2025	E. K.
20	R. R.	Nr.00025 28.03.2025	Ndërtim Objekti 1 kat	E. D. G. Ç.	Nr.00049 28.03.2025	Nr.00004 28.03.2025 500,000 lekë	Nr.0000085 29.03.2025	E. K.
21	I. S.	Nr.00026 09.04.2025	Ndërtim objekti Xogel	E. D. G. Ç.	Nr.00050 09.04.2025	Nr.00005 09.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000086 09.04.2025	E. K.
22	R. V.	Nr.00027 09.04.2025	Mur guri	E. D. G. Ç.	Nr.00051 09.04.2025	Nr.00006 09.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000087 09.04.2025	E. K.
23	Xh. M. B.	Nr.00028 14.04.2025	Banesë	E. D. G. Ç.	Nr.00052 14.04.2025	Nr.00007 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000088 14.04.2025	E. K.
24	G. H.	Nr.00029 14.04.2025	Banesë	E. D. G. Ç.	Nr.00053 14.04.2025	Nr.00008 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000089 14.04.2025	E. K.
25	R. T. V.	Nr.00030 14.04.2025	xogel	E. D. G. Ç.	Nr.00054 14.04.2025	Nr.00009 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000090 14.04.2025	E. K.

26	K. Z.	Nr.00031 14.04.2025	Shtesë, anësore	E. D. G. Ç.	Nr.00055 14.04.2025	Nr.00012 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000091 14.04.2025	E. K.
27	Sh. B.	Nr.00032 14.04.2025	Banesë	E. D. G. Ç.	Nr.00056 14.04.2025	Nr.00013 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000092 14.04.2025	E. K.
28	S. K.	Nr.00033 14.04.2025	Banesë	E. D. G. Ç.	Nr.00057 14.04.2025	Nr.00014 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000093 14.04.2025	E. K.
29	B. S. H.	Nr.00034 14.04.2025	Ngrehine (Stan)	E. D. G. Ç.	Nr.00058 14.04.2025	---	Nr.0000094 14.04.2025	E. K.
30	Pa autor	Nr.00035 14.04.2025	Shesh ndërtimi	E. D. G. Ç.	---	---	---	E. K.
31	L. M.	Nr.00036 14.04.2025	Banesë	E. D. G. Ç.	Nr.00059 14.04.2025	Nr.00015 14.04.2025 500,000 lekë	Nr.0000095 14.04.2025	E. K.
32	F. N. K.	Nr.00037 29.04.2025	Ngritje kolonash për ndërtim garazhi	E. D.	Nr.00060 07.05.2025	Nr.00016 07.05.2025 500,000 lekë	Nr.0000096 07.05.2025	G. Ç.
33	G. dhe M. K.	Nr.00038 29.04.2025	Ndërtim Garazhi përpara banesës së tyre	E. D.	Nr.00061 07.05.2025	Nr.00017 07.05.2025 500,000 lekë	Nr.0000097 07.05.2025	G. Ç.
34	F. A. D.	Nr.00039 02.05.2025	Ndërtim objekti pa leje ndërtimi	E. D.	Nr.00062 09.05.2025	Nr.00018 09.05.2025 500,000 lekë	Nr.0000098 09.05.2025	G. Ç.
35	V. M.A.	Nr.00040 22.05.2025	Ndërtimi objekti 1-kat	E. D. A. T.	Nr.00063 28.05.2025	Nr.00019 28.05.2025 500,000 lekë	Nr.0000099 28.05.2025	G. Ç.
36	S.P. SH.P.K	Nr.00041 02.06.2025	Shkelja e projektit	E. D. A. T.	Nr.00064 03.06.2025	Nr.00020 03.06.2025 500,000 lekë	-----	G. Ç.
37	Q. A. R.	Nr.00042 05.06.2025	Xogel e betonuar , kolona kati-1 , soletë , kolona kati 2	E. D. A. T.	Nr.00065 05.06.2025	Nr.00021 05.06.2025 700,000 lekë	Nr.0000100 16.06.2025	G. Ç.
38	K. Q.	Nr.00043 14.08.2025	Banesë	E. D. A.T.	Nr.00066 15.08.2025	Nr.00022 15.08.2025 500,000 lekë	Nr.0000101 58.2025	G. Ç.
39	E. K.	Nr.00045 25.09.2025	Mos respektim afati lejes ndërtimit	E. D. A. T.	---	Nr.00023 15.09.2025 100,000 lekë	Miratim Leje shtyrje afati	G. Ç.
40	E. “S.”	Nr.00046 26.11.2025	Mosrespektim afati lejes ndërtimit	E. D. M. A.	---	Nr.00024 26.11.2025 500,000 lekë	Miratim Leje shtyrje afati	G. Ç.

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2025, janë mbajtur **52 procesverbale konstatimi** për subjekte që lidhen me shkelje për ndërtimet pa leje, nga të cilat rezulton se janë nxjerrë 39 Vendime për prishjen e ndërtimit pa leje, në 7 raste mungon vendimi i prishjes, në kundërshtim me nenin 5 germa (d) të ligjit nr. 9780, datë 16.072007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar. Në 6 raste, për shkak të tipologjisë së kundërvajtjes, nuk janë nxjerr vendime për prishje pasi janë konstatime që lidhen me shkelje afatesh, punime sistemimi etj. Konstatohet se në 30 raste, vendimet e prishjes së ndërtimit pa leje, vendimi i nxjerrë nga Kryeinspektori, konkretisht E. K., është i pa firmosur dhe vulosur nga Kryeinspektori.
Lidhur me ekzekutimin e vendimeve për prishje të nxjerra nga Kryeinspektorët për periudhën objekt auditimi, në asnjë rast nuk dokumentohet ekzekutimi i këtyre vendimeve. Nuk ka asnjë urdhër nga K/inspektorët për ekzekutimin e prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm. Nuk disponohet asnjë plan masash ose plan organizimi për planifikimin për ekzekutimin e tyre. Nga ana e K/Inspektorit G. Ç., është vënë në dispozicion një kërkesë me nr. 2173 prot., datë 02.09.2025 drejtuar Agjencisë së Shërbimeve për mbështetje me mjete logjistike për lirimin e hapësirëve publike, kioska, garazhe dhe shtesa objektesh. Agjencia e Shërbimeve te Bashkisë Prrenjas ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 03.09.2025 sipas të cilës makineritë (fadromë) nuk janë në gjendje pune (me defekt). Gjithashtu, në vijim i është përcjellë kërkesë IKMT Drejtorisë Rajonale Elbasan me shkresën nr. 2223 prot., datë 25.09.2025 për mbështetje me mjete logjistike për prishjen e objekteve, por nuk disponohet përgjigje nga IKMT DR Elbasan lidhur me këtë kërkesë.
Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me nenin 52, pika 6 e Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, i cili përcakton se: *""Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit ";* si dhe -Vendimin nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore" në pikën 1 (b)/(iv) përcakton se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore, përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, **prishjen e objektit**, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve te MTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

Për periudhën objekt auditimi, janë evidentuar nga IMTV Bashkia Prrenjas 52 raste për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse për ndërtim pa leje, të evidentuara në tabelat e mësipërme.
Në 41 raste është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, ndërsa në 9 raste nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit, në kundërshtim me përcaktimin e nenit 5 pika germa (ç) *"Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore" të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.*
-Në 41 raste nga 52 konstatime, rezulton se është nxjerrë gjoba për kundërvajtjet e konstatuara, nga ku rezulton se për 41 raste rezultojnë gjoba në vlerën **18,940,000 lekë,** nga të cilat 4 gjoba për vitin 2024 në vlerën 1,040,000 lekë dhe për vitin 2025 janë 37 gjoba në vlerën 17,900,000 lekë.
Nga gjobat e vitit 2024, është arkëtuar vetëm 1 gjoba në vlerën 20,000 lekë, konkretisht nga Niko Mytarjos, ndërsa gjobat tjera nuk janë arkëtuar, por rezulton se me shkresën pa numër, datë

06.01.2025 të IMTV përcjellë Drejtorisë së Menaxhimit dhe Planifikimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale, i është përcjellë lista e gjobave të shfuqizuara sipas Ligjit nr. 127/2014 "Për shfuqizimin e masave Administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024", vlerë e cila duhet të zbritet nga llogarita e debitorëve në pasqyrat financiare të vitit 2024. Kësaj liste, i janë bashkëlidhur edhe 3 gjoba të mbajtura për vitin 2024 në vlerën 1,020,000 lekë.
Për vitin 2025, nga 37 gjoba të nxjerra në vlerën 17,900,000 lekë, rezulton se janë arkëtuar 4 gjoba në vlerën 1,200,000 lekë, konkretisht 100,000 lekë nga A. H., 500,000 lekë nga S. P. shpk, 100,000 lekë nga E. K. dhe 500,000 lekë nga E. S., ndërsa diferenca prej 16,700,000 lekë nuk është arkëtuar, por është kontabilizuar.
Pavarësisht vendosjes së gjobave për secilin nga rastet e kundërvajtjeve të mësipërme ku konstatohet se vendosen gjoba në vlerën 500,000 lekë, rezulton se vendosja e gjobave për ndërtimet pa leje nuk është sipas përcaktimeve të nenit 52 pika 1 germa (e) të ligjit nr. 107 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, i cili përcakton se:
"Kundërvajtjet administrative"

e. kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, sipas preventivit përkatës të depozituar pranë autoriteteve përgjegjëse, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi....

Nga 52 Akt Konstatime të mbajtura, rezulton në 9 raste mos nxjerrja e vendimit të gjobës për subjektet kundërvajtës, duke vepruar në kundërshtim me nenin 5 germa (b) të Ligjit nr. 9780 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar dhe nenit 52 pika 1 germa (e) të Ligjit nr. 107/2014 i cituar më sipër.
-Lidhur me gjobat e pa likuiduara, rezulton se për asnjë nga praktikat e mbajtura nuk disponohen kërkesa drejtuar gjykatës për pajisjen me titull ekzekutimi. Referuar nenit 30 pika 4 germa (b) të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" përcaktohet se kërkesa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga:
b)Titullari i organit që ka nxjerr vendimin për kundërvajtjen administrative.
Në rastin konkret, kërkesa duhej bërë nga Kryeinspektori i IMTV.
-Në praktikat e mësipërme, ka rezultuar në 5 raste të jetë përcjellë kallëzimi penal për subjektet kundërvajtjës, konkretisht ndaj shtetasve F. A. D., V. M. A., F. N. K., G. K. dhe M. K., Q. A. R., kallëzime të cilat të gjitha mbajnë datën 27.06.2025, ndërsa për kundërvajtësit tjerë nuk janë përcjellë kallëzime penale, sipas përcaktimeve të nenit 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 cituar më sipër, i cili përcakton se,
Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

-Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se me përjashtim të një rasti (Bashkim Hana), të gjitha procedurat e mbajtura nuk disponojnë fotot e konstatimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer. Mungesa e fotografive, është veprim në kundërshtim me nenin 41 "Të drejta të tjera të inspektorit", germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se:
Inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta

a)të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit.

2. Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se IMTV kanë mbajtur 2 akt kontrolle për objektet e pajisura me leje ndërtimi, ndërkohë për lejet tjera nuk ka akte kontrolli të mbajtura, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar dhe nenin 51 "Inspektimi" të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".

3. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në kundërshtim me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar.

4.Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët, për periudhën objekt auditimi janë miratuar planet mujore të punës vetëm për periudhën Maj 2025 e në vijim, ndërsa për periudhën nga data 01.01.2024 deri në Maj 2025 nuk ka planet mujore pune, veprim ky në kundërshtim me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".

<u>Konklузion</u>

1.Nga auditimi, rezulton se IMT Bashkia Prrenjas, nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar, ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore". Mangësitë e trajtuara në këtë akt konstatim janë të përhapura, dhe IMT nuk jep garanci për një kontroll efektiv të territorit.

Lidhur me mangësitë e trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi,
G. Ç. – Kryeinspektor
E. K. – ish Kryeinspektor
A. A. – Ish Inspektor
E. D. – Inspektor
A. T. – Inspektor
M. A. - Inspektor

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga punonjësit e IMTV Bashkia Prrenjas është paraqitur observacioni me nr. 920/66 prot., datë 09.09.2026, administruar në KLSH me nr. 380/17 prot., datë 10.09.2026 si vijon:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

1.Lidhur me prishjen e objekteve, sqarohet se nuk është marrë në konsideratë fakti se Bashkia Prrenjas nuk disponon mjete teknike të nevojshme për realizimin e prishjes. Është kërkura nga Agjencia e Shërbimeve Publike me anë të shkresës zyrtare nr. 2173 prot., datë 02.09.2025 për të bërë të mundur sigurimin e logjistikës, mjeteve dhe punonjësve të cilat janë të domosdoshëm për realizimin me sukses në përputhje me

legjislacionin në fuqi të vendimeve të prishjes. Agjencia e Shërbimeve Publike ka kthyer përgjigje zyrtare ku shprehet se nuk mund të ofrojë logjistikën e kërkuar pasi mjete janë jashtë funksionit. IMTV i është drejtuar IKMT Drejtorisë Rajonale Elbasan me shkresën nr. 2223 prot., datë 25.09.2025 me kërkesë për mbështetje për ekzekutimin e vendimeve të prishjes.

2.Lidhur me mos nxjerrjen e vendimit të pezullimit në 9 rsate, sqarohet se në disa raste objektet kishin përfunduar ose nuk po zhvillohej më aktivitet ndërtimor në momentin e konstatimit. Për rrjedhojë vendimi i pezullimit nuk do të kishte efekt praktik pasi nuk ekzistonin punime në zhvillim për tu pezulluar.

3.Lidhur me masat e gjobave të vendosura në vlerën 500,000 lekë, sqarohet se vlerësimi i masës së gjobës është bërë mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm gjatë inspektimit. Në shumë raste nuk ka qenë e mundur të përcaktohej menjëherë vlera reale e investimit pa kryer një ekspertizë teknike, prandaj nuk mund të konkludohet se çdo gjobë është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 107/2014, i ndryshuar.

Në bllokun e vendimeve të dënimit me gjobë ka pasur ndryshime të herëpashershme në strukturën e IMTV si dhe mungesë të një juristi, mgjth IMTV ka përmbushur detyrimet ligjore duke hartuar preventivat në bazë të manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave përkatëse, referuar VKM-së nr. 216, datë 13.04.2023 dhe ligjin nr. 107/2014 i ndryshuar, edhe pse në strukturë nuk ka pasur jurist dhe preventivues, si dhe nuk ka pasur askes në sistemin zyrtar SIM.

4.Lidhur me gjobat e paarketuara, sqarojmë se nuk është kompetencë e IMTV. Pas nxjerrjes së vendimeve administrative, ato janë përcjellë pranë strukturave përgjegjëse për ndjekjen e procedurave të mëtejshme dhe janë regjistruar në kontabilitet.

Gjithashtu, 5 vendime gjobe të nxjerra gjatë vitit 2025 ndodhen në proces ankimimi pranë organeve kompetente. Përsa kohë këto procedura nuk kanë përfunduar me një vendim përfundimtar, IMTV nuk mund të ndërmarrë veprime të mëtejshme për ekzekutimin e tyre, pasi përfundimi i procedurës së ankimimit përbën parakusht për vijimin e procedurave sipas legjislacionit në fuqi.

Për rrjedhojë konstatimi i KLSH lidhur me mos arkëtimin e këtyre gjobave nuk merr në konsideratë faktin se këto janë ende në shqyrtim nga organet kompetente dhe për këtë arsye IMTV nuk mund të veprojë për ekzekutimin e tyre deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

5.Lidhur me mungesën e fotografive, ato janë realizuar gjatë inspektimeve, por një pjesë e tyre nuk janë administruar në dosje për shkak të ndryshimit të personelit dhe ndryshimeve organizative.

6.Lidhur me mungesën e akteve të kontrollit për objektet me leje, sqarohet se gjatë periudhës janë mbajtur 2 akte kontrolli për objekte të pajisura me leje ndërtimi, përveç këtyre dy rasteve. Vetë ekzistenca e një lejeje ndërtimi nuk nënkupton domosdoshmërisht fillimin e punimeve apo detyrimin e për hartimin e një akti kontrolli.

7.Lidhur me raportimin 3 mujor pranë IKMT dhe planet mujore të punës, sqarohet se gjatë periudhës objekt auditimi, ka psaur ndryshime të vazhdueshme të personelit. Aktiviteti inspektues është zhvilluar mbi bazën e nevojave operative dhe në rastet kur planet mujore nuk janë formalizuar me shkrim. Kjo nuk ka penguar ushtrimin e funksionit inspektues.

Gjatë periudhës Maj 2025 – Dhjetor 2025 e në vijim, janë hartuar plane mujore, analiza dhe informacioe 3 mujore për IVMT Elbasan, IKMT Tiranë dhe Ministinë e Brendshme.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>

Lidhur me sqarimet dhe pretendimet e paraqitura nga punonjësit e IMTV, ato nuk qëndrojnë dhe nuk pranohen, konkretisht:

1.Lidhur me prishjen e ndërtimeve pa leje, IMTV e Bashkisë Prrenjas rezulton dhe argumenton me vetëm 2 shkresa për pa mundësinë për prishjen e ndërtimeve pa leje, duke referuar fillimisht një shkresë drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Prrenjas e muajit Shtator 2025, ndërkohë që proceset që lidhen me nevojën e prishjes së këtyre ndërtimeve, janë procese që vijojnë për gjithë vitin 2024, 2025 dhe në vijim përgjatë periudhës nën auditim ku në asnjë rast nuk evidentohet se si institucioni do menaxhojë procesin e prishjes së këtyre ndërtimeve. Nuk ka asnjë informacion apo kërkesë drejtuar Titullarit të Bashkisë për mbështetje për procesin e prishjes së ndërtimeve pa leje, të cilat rezulton se për gjithë periudhën objekt auditimi, nuk ka asnë rast ku të jenë marrë masa.

2.Lidhur me 9 rastet ku mungon vendimi për pezullimin e punimeve, observuesit pretendojnë se objekti kishte përfunduar ose nuk zhvillohej aktivitet ndërtimore. Kjo situatë nuk argumentohet, pasi praktikisht inspektorët pranojnë se nuk kanë ushtruar kontroll mbi territor, duke lejuar kryerjen e punimeve dhe mos marrjen e masave përkatëse deri në përfundimin e objekteve, përsa kohë shprehen se ato kishin përfunduar. Gjithashtu, pretendimi se nuk po zhvillohej ndërtim në momentin e konstatimit, nuk qëndron, pasi së pari inspektori kryen kontrolle në objektet në të cilat kryhen ndërtime. Në rast se nuk kryhen ndërtime, nuk argumentohet se në çfarë forme u konstatua kryerja e ndërtimit pa leje, për sa kohë nuk konstatohet ndërtim në proces.
3.Lidhur me vendosjen e gjobave, observuesit shprehen se nuk mund të konkludohet se çdo gjobë është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 107/2014. Atëherë mbi cilën dispozitë ligjore janë vendosur gjobat?? Masa e gjobës e përcaktuar në pothuaj gjitha rastet në vlerën 500,000 lekë, nuk ka asnjë mbështetje në një dispozitë ligjore për periudhën objekt auditimi. Përcaktimi i vlerës së gjobës nuk lidhet me mungesën e juristit, pasi përllogaritja e saj është proces i cili kryhet nga inxhinierët, përllogaritje e cila rregullohet me aktet ligjore dhe nënligjore të cituara edhe nga ana juaj në observacion.
4.Lidhur me gjobat e paarkëturara, së pari, sqarohet se proceset që lidhen me kërkimin në gjykatë të kërkesës për kthimin e gjobës në titull ekzekutiv, janë të pëckatuara qartë dhe të cituara në gjetje në nenin 30 pika 4 germa (b) të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ku përcaktohet qartë se kërkesa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit në gjykatë për kundërvajtjen administrative bëhet nga Titullari i organit që ka nxjerr vendimin. Kryeinspektori i IMTV është Titullari i organit dhe personi i cili nxjerr vendimet, dhe në këto kushte është ai i cili angazhohet për kërkesën drejtuar gjykatës, ose në mungesë të stafit të kualifikuar për përgatitjen e kërkesës, ti drejtohej Drejtorisë Juridike për përgatitjen e kërkesave, proces i cili nuk është realizuar.
Gjithashtu, pretendimi se 5 vendime gjobe të nxjerra përgjatë vitit 2025 janë në proces ankimimi pranë organeve kompetente nuk qëndron. Kërkesa drejtuar gjykatave për vendosjen e gjobave nuk pezullon ekzekutimin e tyre, me përjashtim të rasteve kur për këto gjoba është marrë sigurimi i padisë në gjykatë. Nga ana juaj në asnjë rast nuk është referuar asnjë vendim gjyqësor për pranimin e sigurimit të padisë për asnjë gjobë të vetme. Është evidentuar regjistrimi i tyre në kontabilitet, por proceset e kërkimit nuk janë ezauruar.
5.Lidhur me mungesën e dokumentimit të kundërvajtjeve me fotografi, pretendimi nuk pranohet. Përsa kohë pertendohet se ato janë realizuar gjatë inspektimeve, është e nevojshme që ato të jenë pjesë përbërëse e dosjeve për dokumentimin e situatës. Fotot janë gjithashtu të nevojshme për të evidentuar ndryshimet e mundshme të objektit dhe mungesa e tyre e bën të pamundur evidentimin nëse ka ndryshime në objekt. Është pjesë e rëndësishme e procesit dokumentues të kundërvajtjes pasi krahasohet përputhja e konstatimit me faktin.
6. Lidhur me pretendimin për mbajtjen e akteve të kontrollit pretendimi nuk pranohet. Mbajtja e akteve të kontrollit nuk lidhet vetëm me lejet e miratuara për vitet 2024 – 2025 të cilat rezultojnë 17, por është proces pune edhe i lejeve të mëparshme ku inspektorët kryejnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit (kuota themelit, kuota 0-0, karabI..etj).
7.Lidhur me sqarimet për informacionion periodik për IKMT dhe planet mujore, sqarohet se veç pretendimeve nuk dokumentohet asnjë informacion/dokumentacion. Lidhur me planet mujore, është evidentuar edhe në material se planet janë miratuar vetëm për periudhën Maj 2025 e në vijim.

Pika 2.7. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

Asetet e transferuara në pronësi të bashkive me VKM përbëjnë pasuri publike, administrimi dhe regjistrimi i të cilave duhet të kryhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.Në këtë kuadër auditimi synon të vlerësojë përputhshmërinë e veprimeve të ndërmarra nga Bashkia Prrenjas për marrjen në administrim, regjistrimin, evidentimin dhe menaxhimin e këtyre aseteve.

- Kuadri ligjor mbi të cilin u mbështet auditimi:

- VKM nr. 438 dt. 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore" i ndryshuar me VKM nr. 438 datë 17.05.2017;
- VKM nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore";
- Udhëzimi Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"
- Ligji nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar;
- Ligji nr. 5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 20 datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- VKM nr. 438 datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore";
- Udhëzimit të MMPAU nr. 2 datë 06.03.2013 "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup-ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime, mirëmbajtje e prerje ripërtëritëse, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera drusore e jodrusore"; etj

- VKM e transferimit të pronave për Bashkinë Prrenjas:

- <u>Për Bashkinë Prrenjas</u>: VKM nr. 698 datë 19.10.2007 "Miratimi i listës përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Prrenjas, të qarkut Elbasan" i ndryshuar me VKM nr. 1642 datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Prrenjas, të Qarkut Elbasan" i ndryshuar me VKM nr. 668 datë 11.06.2009 "Për një ndryshim në VKM nr. 1642 datë 17.12.2008" i ndryshuar me VKM nr. 525 datë 30.06.2010 "Për një ndryshim në VKM nr. 1642 datë 17.12.2008";
- <u>Për NJA Rrajcë</u>: VKM nr. 50 datë 26.01.2012 "Miratimi i listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Rrajcë, të qarkut Elbasan";
- <u>Për NJA Qukës</u>: Me VKM nr.531, datë 01.05.2008, "Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qukës, të qarkut Elbasan";
- Për NJA Stravaj: Me VKM nr.299, datë 12.03.2008, "Miratimi i listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Stravaj, të qarkut Elbasan";

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se në Bashkinë Prrenjas, me regjistrimin dhe administrimin e pronave të paluajtshme është detyrë funksionale e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Pronës/Sektori i Planifikimit Territorit,administrimit lejeve,regjistrimit pronës/Specialist i aseteve, i cili inventarizon vetëm pronat e llojit: godina, rrugë, hapësira publike etj., dhe merret me procedurën e regjistrimit të tyre në ASHK, dhe Struktura e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit/Sektori Bujqësisë & Sektori i menaxhimit, është e organizuar si në *tabelën 1* të Aneks/Asetet:

1.1 Inventarizimi i pronave të paluajtshme publike në Bashkinë Prrenjas

Referuar VKM-ve të cilat kanë transferuar në *përdorim apo pronësi* të Bashkisë Prrenjas asetet shtetërore, pasqyrohen në tabelën më poshtë, konkretisht:

Tabela nr. 1

Nr.	Njësia	VKM		Në perdorim	Në pronësi		
		Numër	Datë		Numër total	Regjistruar	Proces
1	Bashkia Prrenjas	698	19.10.2007	440	325	34	1
		1642	17.12.2008				
		668	11.06.2009				
		525	30.06.2010				
2	Nj. Administrative Rrajcë	50	26.01.2012	65	205	7	
3	Nj. Administrative Qukës	531	01.05.2008		Nuk ka VKM transferimi	3	
4	Nj. Administrative Stravaj	299	12.03.2008	35	176	0	
4		**3797 prona total**		**540**	**3257**	**43**	**1**

Burimi: SPTALRP/Bashkia Prrenjas

Nga auditimi dhe informacioni i vënë në dispozicion nga struktura e aseteve pasqyrohet i përmbledhur në *tabelën 2*, **rezulton s**e:

- Në total janë 3797 prona nga të cilat: 540 janë në përdorim dhe 3257 janë në pronësi të Bashkisë Prrenjas së bashku me Njësitë administrative; janë 43 [33 në B.Prrenjas, 7 NJA Rrajcë dhe 3 NJA Qukës)] prona të regjistruara me titull pronësie dhe vetëm 1 [vetëm në Bashkinë Prrenjas] është në proces;

Me Urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 120 datë 27.03.2025 dhe me nr. 727 prot., datë 27.3.2025 prot., datë 13.10.2025 ndryshuar me Urdhrin nr. 424 datë 13.10.2025 dhe me nr. 2396 prot., datë 13.10.2025, është ngritur Struktura e posaçme për përditësimin e listave të pronave shtetërore [SPPLPSH], me këtë përbërje:

1. E. B.	Drejtor i DPTP	*ndryshuar me*	G. K.	Drejtor i DPTP
2. O. A.	Përgjegjës i Leje & pronave	≠	M. P.	Përgjegjës i Leje & pronave
3. J. B.	Specialist i aseteve			
4. G. B.	Specialist për projektet			
5. H. K.	Punonjës për ndjekjen dhe zb. e kontrat	≠	E. K.	Specialist Legalizimet
6. M. P.	Specialist i Planifikimit të Territorit	≠	E. M.	Specialist finance
7. A. K	Specialist jurist	≠	M. Xh.	Specialist jurist

≠Detyrat e ngarkuara kësaj strukture janë:

1. Të inventarizojë
2. Të plotësojë
3. Të përditësojë
4. Të ndjekë procesin e rregjistrimit të tyre në ASHK dhe pajisjen me çertifikatë pronësie

Për sa më lartë mbi veprimtarinë e Strukturës së Posaçme referuar detyrave dhe përgjegjësive nga auditimi ***rezultoi se:***

- Kjo strukturë *nuk ka bërë* verifikime në terren për gjithë pronat e transferuara me VKM, me qëllim saktësimin e statusit të tyre: ekzistojnë apo jo fizikisht referuar kjo listës së VKM përkatëse dhe inventarit ekonomik, janë të lira apo të zëna, kanë ndryshuar apo jo destinacionin e përdorimit etj; vërtetuar kjo nga mungesa e procesverbaleve apo akt konstatimeve që mbahen në çdo rast verifikimi;

- janë bërë verifikime për ato prona për të cilat janë paraqitur kërkesa të orientuara nga nevoja për zhvillim; rrjedhimisht plotësimi dhe përditësimi është bërë vetëm për praktikat e këtyre pronave;
- Për këto prona është vijuar me procedurat e regjistrimit dhe pajisjes së tyre me çertifikatë pronësie;
- pronat e pajisura me certifikatë pronësie nga ASHK, nuk i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit të tyre;
- Struktura e posaçme *nuk ka informacion* nëse ka prona të zëna forcërisht;
Në mënyrë të detajuar informacioni trajtohet si më poshtë vijon:

- Regjistri i inventarizimit të pronave të transferuara me VKM në Bashkinë Prrenjas të klasifikuara sipas destinacionit të përdorimit, pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur në *tabelën nr.2* të Aneksit/Asetet, në të cilin ***rezulton se*** numri në total i pronave në Bashkinë Prrenjas është 4031, ndërkohë nga struktura e posacme e administrimit të pronave [SPAP] është komunikuar se ka informacion për 3797; pra 234 prona më pak për të cilat edhe pse janë në regjistrat bashkëlidhur VKM transferuese të tyre, Bashkia Prrenjas nuk ka informacion mbi statusin e tyre në terren.
- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga SPAP (përmbledhëse)[26], rezulton se ndarja e pronave në çdo Njësi Administrative sipas statusit juridik, është pasqyruar në tabelën 3 të Aneksit/Asetet.
- Referuar VKM përkatëse dedikuar Bashkisë Prrenjas, pronat e ndara sipas llojit, janë si në *tabelat 4.1-4.2-4.3* të Aneksit/Asetet, konkretisht: tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Prrenjas, sipas statusit dhe kanale vaditës dhe kanale kullues në pronësi të Bashkisë Prrenjas.
-Klasifikimi i pronave me destinacion arsimor paraqiten sipas *tabelës nr. 5 t*ë Aneksit/Asetet, nga ku *rezulton se* janë 31 prona (objekte) arsimore me destinacion arsim pashkollor dhe parauniversitar në pronësi të Bashkisë Prrenjas dhe në përdorim nga ZAV[27] Prrenjas.
- Klasifikimi i pronave me destinacion shëndetësor paraqiten sipas *tabelës nr. 6 t*ë Aneksit/Asetet, nga ku *rezulton se* janë 31 prona (objekte) shëndetsore me destinacion shërbim parësor, farmaceutik, spitalor, dentar dhe mjekësor në pronësi të Bashkisë Prrenjas dhe në përdorim nga DSHP[28] Prrenjas dhe DSHP Librazhd.

- ***1.2. Regjistrimi i pronave të paluajtshme publike në pronësi të Bashkisë Prrenjas, në DV ASHK Elbasan.***

- Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në *tabelën 3* dhe *tabelën 7 të Aneksit/Asetet rezulton* se:

- Deri në fund të vitit 2010 janë pajisur me çertifikatë pronësie 17 prona në total: 1-truall, 5-godina, 2-arë, 1-shkëmbore dhe 8 –pyje;
- Nga 2011 deri në 2020 janë pajisur me çertifikatë pronësie 11 prona në total: 1-truall, 6- godina, 2-apartamente, 1-shkëmbore, 1-kullotë;
- Nga viti 2021 deri në vitin 2023 janë pajisur me çertifikatë pronësie 9 prona në total të cilat janë pyje;
- Në vitin 2024 nuk ka asnjë pronë të pajisur me çertifikatë pronësie;
- Në vitin 2025 janë pajisur me çertifikatë pronësie 7 prona në total: 2-truall dhe 5-pyje;

- Praktikat dokumentare për proçedurën e rregjistrimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie në ASHK Rajonale Elbasan, janë si vijon:
- Shkresa nr. 765 prot., datë 02.04.2025 për 5 prona, kategoria pyll, sip. totale 2,438,400 m2;

[26] Informacioni i detajuar pasqyrohet në regjistrat inventareve në Aneks të Aseteve
[27] Zyra Vendore Arsimore
[28] Drejtoria e Shërbimit Parësor

Me nr. të kodit unik: 2248009107, 2248009096, 2248009104, 2248009103, 2248009103;
- Shkresa nr. 1620 prot., datë 05.11.2025 për 2 prona, kategoria truall, sip.totale 290 m2;
Me nr. të kodit unik: 2924005022, 2924005021;
- Shkresa nr. 2653 prot., datë 07.11.2025 për 1 pronë, kategoria ndërtesë (qendër shëndetsore), procedurë e mbyllur në vitin 2026;
Për sa më lartë, nga auditimi ***rezultoi se***:
- *për vitin 2024* nuk ka asnjë praktikë dokumentare të përgatitur nga Bashkia Prrenjas për në ASHK Rajonale Elbasan;
- *për vitin 2025* nga SPAP janë përgatitur 8 praktika dokumentare, nga të cilat 7 prona janë pajisur me certifikatë pronësie brenda vitit 2025 dhe 1 pronë është pajisur me certifikate pronësie në vitin 2026;
- është i vogël numri i praktikave dokumentare të përgatitura nga SPAP dhe ai i pronave të pajisura me çertifikatë pronësie;
Edhe pse në shtator ASHK nëpëmjet shkresës nr, 11564 prot., datë 19.09.2025 i ka përcjellë Bashkisë Prrenjas (dhe jo vetëm) tarifat e reja lehtësuese për aplikimet e pajisjes me certifikatë pronësie të pronave, nga struktura e posaçme nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për të përshpejtuar procesin e regjistrimit dhe pajisjes me çertifikata të pronave.
Praktika dokumentare për procedurën e pajisjes me çertifikatë pronësie në ASHK përgatitet nga Struktura e posaçme. Nga komunikimi me subjektin mbi arsyet e numrit të vogël të praktikave si dhe mbi kriteret e përzgjedhjes së objekteve të cilave do u përgatitet praktika dokumentare për procedurën e pajisjes me çertifikatë pronësie, na u komunikua se për periudhën deri në fund *të vitit 2025*, është ndjekur si praktikë trajtimi i atyre pronave, për të cilat ka kërkesa për tu zhvilluar;
Nga auditimi ***konstatohet s****e* nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është miratuar asnjë plan vjetor dhe strategjik mbi pajisjen e aseteve me çertifikatë pronësie, ku të përcaktohen kriteret orientuese për përzgjedhjen e atyre prioritare veçanërisht ato arsimore e shëndetsore, si dhe afati kohor për përmbylljen e kësaj procedure, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2011 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Kreu II neni 8 pika 8 dhe Manualin MFK i ndryshuar miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 108 datë 17.11.2016 i ndryshuar, Kap. 2../Kap 2.4.1 "përgjegjësitë e titullarit të njësisë pblike", Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;.si dhe Udhëzimeve të MARS dhe MSHMS: Udhëzimi i MARS nr. 30 datë 12.09.2014 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit parashkollor"; Udhëzimi i MARS nr. 18 datë 04.05.2018 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit profesional dhe konviktet"; Udhëzimi i MSHMS nr. 12 datë 20.03.2015 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve qendrave shendetsore dhe ambulancave" etj.
Ky konstatim vjen nga numri i ulët i procedurave të ndjekura për pajisjen me çertifikatë pronësie të aseteve.
Konstatim: Menaxhimi i pronave të transferuara me VKM dhe i aseteve në Bashkinë Prrenjas nuk mbështetet nga një strukturë e dedikuar, por nga punonjës me funksione të tjera, ndërsa vetëm një specialist është caktuar për këtë proces, duke kufizuar efektivitetin e administrimit të pronave, mosveprim në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 3, neni 9 pika 1/c dhe neni 27.
Tabelë përmbledhëse për grupimin e pronave të pajisura me titull pronësie dhe trendi i procesit sipas periudhave:

Tabela nr.2

	2000-2010	2011-2020	2021-2023	2024	2025	Totali

Prona të regjistruara sipas periudhave	**17**	**11**	**9**	**0**	**7**	**44**
Trendi	↘	↘			↗	
Truall	1	1			2	**4**
Objekt/godinë	5	6				**11**
Arë	2					**2**
Apartament	-	2				**2**
Shkëmbore	1	1				**2**
Pyll	8		9		5	**22**
Kullotë	-	1				**1**

Burimi: DPTP/Punoi:Grupi i auditimit

- Nga ana e SP për praktikat e përfunduara, është aplikuar në ASHK si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.3

Viti	Shkresa	Nr. pasurie	Dok.pronësie	Dokumentacioni në praktikë
2024	Nuk ka asnjë praktikë	-	-	Kopje të VKM Harta e Pasurisë Kartela e pasurisë Plan rilevimi Aplikimi e albania U. Shpenzimi/M.P
2025	Nr. 765 prot., dt. 02.04.2025	Nr. 739 ZK 2248 Nr. 741 ZK 2248 Nr. 742 ZK 2248 Nr. 743 ZK 2248 Nr. 746 ZK 2248		
	Nr. 1620 prot., dt. 05.11.2025	Nr. 203/1 ZK 2248 Nr. 203/2 ZK 2248		
	Nr. 2653 prot., dt. 07.11.2025	Nr. 89 ZK 2116		
	3 - SHKRESA	44 -PRONA		6 dokumente

Burimi: DPTP/Bashkia Prrenjas

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar edhe në *tabelën 3, **rezulton** se* nga SIPP janë dërguar në ASHK 10 shkresa përcjellëse për 21 prona për periudhën 2021 dhe 2023-2024 (në vitin 2022.nuk është dërguar asnjë praktikë). Praktika dokumentare përmban 6 dokumente si në tabelë. Nga sa më lart rezulton se është i vogël numri i praktikave që përgatit SIPP, i cili i ka burimet njerëzore ashtu edhe ato financiare të planifikuara nga DFB në PBA apo në Planin vjetor të vitit ushtrimor, që për vitin 2024 ka qenë në vlerën 1,000,000 lekë dhe për vitin 2025 ka qenë në vlerën 1,430,000 lekë.
Çertifikatat e pronësisë dalin në pronësi të Bashkisë Prrenjas, dhe sipas kërkesave të të interesuarve, fillon procedura për lidhjen e kontratave të qirasë.
Konkluzion: Numri i pronave të pajisura me çertifikatë pronësie rezulton i ulët. Gjithashtu nuk është përcaktuar një objektiv vjetor për numrin e procedurave që duhet të përfundohen, ndërsa performanca ka shënuar rënie nga viti në vit, duke dëshmuar një ecuri me efektivitet të ulët të procesit.

- ***Procedura e pajisjes me titull pronësie të pronave (banesave) të cilat ia janë nënshtruar procedures së privatizimit nga EKB (Enti kombëtar i banesave)***

Procedura e Privatizimit të pronave i nënshtrohet zbatimit të VKM nr. 179 datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*", dhe të Ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "*Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore*".
Për të trajtuar këtë nënpikë, subjektit iu kërkua ky informacion: gjithë dokumemtacioni mbi administrimin e pallateve të transferuar nga EKB, informacion mbi numrin e apartamenteve, statusin e tyre (të privatizuara, të zëna apo të lira), si evidencat përkatëse të pronësisë dhe regjistrimit. Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion ***rezultoi si*** më poshtë vijon:

1. Janë pajisur me titull pronësi 2 apartamente, me shkresën nr. 202 prot., datë 04.02.2015 të ZVR Librazhd janë dërguar certifikatat e pronësisë nr. 740862 dhe nr. 740881 datë 13.12.2014 në emër të Bashkisë Prrenjas me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë bashkëlidhur;

Tabela nr. 4

Nr	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m²	Sip nd. m²	Shenime
1	Apartament, Bashkia Prrenjas	5/21+1-10	638/2	19.11.2014	2924	Prrenjas	65.33	-	Zene nga banoret
2	Apartament ,Bashkia Prrenjas	5/21+1-6	638/1	19.11.2014	2924	Prrenjas	60.54	-	Zene nga banoret

Burimi:DPTP/Bashkia Prrenjas

Konstatohet se nga struktura e posaçme nuk është bërë asnjë inspektim në terren i apartamenteve të pajisura me Çertifikatë pronësie, me qëllim komunikimin dhe orientimin e banorëve të akomoduar në këto apartamente për nisjen e procedurave të privatizimit, duke mundësuar fitimin e të drejtës së pronësisë.

- Njëkohësisht, mungesa e këtyre veprimeve ka penguar edhe identifikimin dhe aplikimin e saktë të taksa e tarifave vendore në dobi të interesave financiare të bashkisë.

Deri në 31.12.2025 nga ana e familjeve që janë akomoduar në këto 2 apartamente nga mungesa e informacionit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për privatizim.

Mosveprimet nga ana e Bashkisë Prrenjas janë në kundërshtim me me Ligjin nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" i ndryshuar, neni 1, neni 5, neni 7 dhe neni 10, për mos sensibilizimin e komunitetit me VKM nr. 179/2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të Ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore".

2. Nga ana Strukturës së posaçme nuk është ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin dhe verifikimin në terren të pronave me qëllim fillimin e procedurave të regjistrimit në ASHK të apartamenteve të ndërtuara nga ish-ndërmarrjet, të cilat faktikisht janë në përdorim nga banorët. Këto inspektime do të mundësonin njohjen e objekteve dhe karakteristikat e tyre, mundësinë e administrimit të dokumentacionit që disponojnë banorët, duke orientuar më mirë veprimet për identifikimin dhe procedurën e regjistrimit të apartamenteve në ASHK, nisjen e procedurave të privatizimit, si dhe për aplikimin e drejtë dhe me vlerë të saktë të taksa e tarifave vendore.

Konkluzion: Mungesa e verifikimit në terren të pronave nga struktura e posaçme, ka sjellë mungesën e një regjistri administrativ si dhe pamundësinë e hartimit të regjistrit ekonomik të tyre nga ana e sektorit të financës dhe kontabilitetit, i cili do të shërbejë si bazë për krijimin e regjistrit kontabël të pronave dhe aseteve të Bashkisë Prenjas.

- Nga auditimi për këtë procedurë nisur nga mungesa e procedurës për privatizim nga ana e strukturës së posaçme apo dhe mungesa e kërkesave për privatizim nga banorët, ***rezulton*** se nga ana e Bashkisë Prrenjas nuk është sensibilizuar opinioni publik dhe grupet e interesit përfitues sipas VKM nr. 179/2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*" i ndryshuar, dhe të Ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "*Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore*" i ndryshuar. Komuniteti nuk ka marrë informacion nga strukturat përkatëse të bashkisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" i ndryshuar, neni 1, neni 5, neni 7 dhe neni 10, Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar, neni 3 dhe neni 9, pika 1.2/a.

1.3 Auditim mbi proçedurat e dhënies me qira dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

- Bashkia Prrenjas deri në 31.12.2025 *nuk ka tokë bujqësore* të dhënë me qira.
- Sipërfaqet pyjore e kullosore të dhëna me qira dhe informacion i detajuar mbi kontratat pasqyrohen sipas *tabelës nr.* 8 të Aneksit/Asetet, nga ku rezulton si vijon:

Për vitin 2024 nga Bashkia Prrenjas janë lidhur *5 kontrata*, në të cilat janë përfshirë 8 ekonomi kullosore/ 10 ngastra. Shuma totale e sipërfaqes së kullotës është 187.976 ha, me kapacitet: 759 krerë dhën, 400 krerë dhi, sipërfaqe totale të stanit 800 m², qendër përpunimi bulmeti me sipërfaqe 60 m², ngrehinë banimi për bari me sipërfaqe 49 m², dhe vlera totale e kontratës 155,850 lekë. Deri në 31.12.2024 *nuk ka* debitorë nga kontratat e qirave të kullotave verore.

Për vitin 2025 nga Bashkia Prrenjas janë lidhur 5 kontrata, në të cilat janë përfshirë 5 ekonomi kullosore/ 9 ngastra. Shuma totale e sipërfaqes së kullotës është 138.87 ha, me kapacitet: 537 krerë dhën, 469 krerë dhi, sipërfaqe totale të stanit 570 m², qendër përpunimi bulmeti me sipërfaqe 60 m², ngrehinë banimi për bari me sipërfaqe 49 m², dhe vlera totale e kontratës 129,470 lekë. Deri 31.12.2025 nuk ka debitorë nga kontratat e qirave të kullotave verore.

Numri i kontratave të lidhura është i njëjtë për dy vitet, janë 4 ekonomi kullosore të njëjta për të njëjtët persona, 1 ekonomi kullosore është e ndryshuar për ndryshim dhe të personit (blegtorit) që ka lidhur kontratë.

Kontratat për dhënien me qira të pyjeve e kullotave përpilohen nga Sektori i Pyjeve dhe kullotave dhe Sektori Juridik dhe miratohet nga Kryetari i Bashkisë si përfaqësues i Bashkisë në cilësinë e palës qiradhënëse dhe nënshkruhet edhe nga personi në cilësinë e palës qiramarrëse. Deri në 31.12.2025 *nuk ka* debitorë nga kontratat e qirave të kullotave verore.

Konkluzion: Për sa trajtuar në Akt rezulton se: Administrimi i pronave (aseteve) në Bashkinë Prrenjas paraqet një nivel të ulët efektiviteti, si pasojë e mungesës së një strukture të dedikuar dhe angazhimit të kufizuar të burimeve njerëzore.

Proceset e evidentimit dhe verifikimit të pasurive në terren nuk kryhen në mënyrë të plotë dhe sipas një grafiku dhe plani konkret, duke ndikuar në saktësinë e të dhënave dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu mungojnë të dhëna të plota për objektet e banimit të trashëguara nga ish-ndërmarrjet apo Enti Kombëtar i Banesave, ndërsa për 2 apartamentet e pajisura me çertifikatë pronësie që prej vitit 2014, nuk janë nisur ende procedurat e privatizimit, duke vonuar formalizimin e pronësisë dhe administrimin e plotë të aseteve.

≠Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme nga ana e titullarit dhe menaxherëve të njësisë publike nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit ligjor si më poshtë:

- Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar
- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar
- Manualin MFK i ndryshuar, i miratuar së fundmi me Urdhrin e MF nr. 4 datë 26.01.2024
- Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016."Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK-së dhe të riskut në njësitë publike"
- Udhëzim nr. 21, datë. 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve"
- Ligjin nr. 119 datë "Për të drejtën e informimit" (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit")

Pika 2.8. Auditimi mbi "Zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm".

8.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

8.2. Realizimi programit (plan veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor;
8.3**.** Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
Në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën 403/9 prot. dt. 22.10.2025, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 203 datë 15.10.2025, mbërritur në Bashkinë Mirditë dhe regjistruar me nr. 1647/17 prot., datë 18.10.2025, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

a. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi ***nuk është*** lënë masë;
b. Masa Organizative janë lënë **33** nga të cilat janë pranuar **33** masa: **13** masa janë zbatuar, **17** masa janë në proces zbatimi, **3** masa janë pjesërisht zbatuar dhe **0** masë pa zbatuar;
c. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore/të ardhura të munguara, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) në Bashkinë Prrenjas janë lënë **6** masa në vlerën totale 97,796,446 lekë (pa kamatë) ose 103,063,541 lekë (me kamatë) nga të cilat: **5** masa janë në proces zbatimi dhe **1** masë është pjesërisht zbatuar;
d. Masa disiplinore është lënë **1** masë për 4 punonjës e cila është pranuar dhe është zbatuar.
e. Njoftimi i Departamentit të administratës publike dhe Komisionerit të mbikëqyrjes të shërbimit civil është pranuar dhe është në proces zbatimi.

- **Drejtimet e auditimit**

I *Mbi hartimin dhe miratimin e "Planit të veprimit" dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për ktjimin e përgjigjes në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA*

- Për rekomandimet e lëna në RPA "Auditim financiar në Bashkinë Prrenjas" përcjellë me shkresën nr. 403/ 9 prot. dt. 22.10.2025, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Prrenjas me nr. 794/39 prot., datë 23.10.2025, nga ana e Bashkisë Prrenjas janë marrë këto masa:
- Është hartuar nga grupi i punës dhe miratuar nga Kryetari i bashkisë me nr. 794/40 prot., datë 10.11.2025, plani i veprimit për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në RPA për Auditimin financiar në Bashkinë Prrenjas.

1. A. K. - N/Kryetar i Bashkisë
2. S. K. – Drejtore e DPMFSHS/NZ
3. Z. Ç. - Drejtore e BNJSHM
4. B. K. - Përgjegjës SAB
5. A. G. - STTV
6. S. D. - Përgjegjës SBNJ

Koordinatori i caktuar për monitorimin dhe ndjekien e zbatimit të rekomandimeve nga ana e strukturave dhe personave të ngarkuar me përgjegjësi është znj. Z. Ç. me detyrë Sekretare e përgjithshme. Në Bashkinë Prrenjas, nga kryetari i bashkisë është miratuar plani i veprimit dhe është dërguar në KLSH me shkresën nr. 794/42 prot., datë 10.11.2025 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA", konceptuar nga përgjegjësit e SF dhe SBNJ dhe pranuar nga Drejtoret e DPMFSHS dhe DBNJSHM, në të cilin janë caktuar dhe personat përgjegjës për ndjekjen e çdo rekomandimi dhe afatet konkrete për zbatimin e tyre.
- Bashkia Prrenjas ka hartuar dhe miratuar nga kryetari i bashkisë Planin e veprimit *"Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit"* dërguar me shkresën nr.

403/9 prot., datë 22.10.2025 dhe regjistruar me nr. 794/39 prot., datë 23.10.2025 në zyrën e protokollit të bashkisë. "Plani i veprimit" ***është dërguar*** në KLSH me shkresën nr. 794/42 prot., datë 10.11.2025 dhe rezulton të jetë hartuar, miratuar dhe dërguar në KLSH *brenda afatit 20 ditor*, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin në afat të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit "Bashkia Prrenjas* ***ka kthyer përgjigje*** *zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon "Planin e Veprimeve", duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.*

Zbatuar

II. *Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të RPA, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm*:

- Nga ana e saj Bashkia Prrenjas iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: *Në zbatim të ligjit nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor* nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt "Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit", dërguar me shkresën nr. 403/9 prot., datë 22.10.2025. Nga verifikimi rezultoi se ***ky raportim është bërë*** me shkresën nr. 794 prot., datë 07.04.2026 *brenda afatit 6 mujor*.

Zbatuar

III. *Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të KLSH, sipas përcaktimeve në nenin 50-Auditimi i jashtëm, pika 5, të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar::*

- Nga Bashkia Prrenjas deri në 19.06.2026 ***nuk është raportuar*** në Këshillin Bashkiak lidhur me "Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së" përcjellë me shkresën nr. 403/9 prot., datë 22.10.2025.

Pazbatuar

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

- *Rekomandime të lëna në RPA me shkresën përcjellëse nr. 403/9 prot. dt. 22.10.2025*

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, grupi i auditimit bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testimeve të kryera ka konstatuar se, komponentët e MFK-së nuk kanë funksionuar plotësisht dhe me efektivitet, në të gjithë strukturat e njësisë, pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit. Më konkretisht u konstatua se në "Rregulloren e Brendshme" nuk janë të përcaktuara të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mbi organizimin e veprimtarisë së institucionit sipas strukturës organizative të miratuar. Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "Kodin e Punës", nuk janë të përcaktuara mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion pune. Për largimet nga puna nuk është zbatuar VKM nr. 124, datë 17.02.2016, neni 29, ku me Proces Verbal të dorëzohen inventari në ngarkim i pajisjeve në njësinë përgjegjëse.

- Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dizpozicion u konstatua se Bashkia Prrenjas nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi.
- Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel mesatar. Bashkia Prrenjas ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni.,
-Nga auditimi i dokumentacionit që ka të bëjë me shkresat e përpiluara midis strukturave të Bashkisë konstatohet se, rakordimet për debitorët janë bërë me shkresa të pa protokolluara në zyrën e protokoll arkivës, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "*Për arkivat*", neni 22. Rakordimet midis strukturave të Bashkisë në lidhje me debitorët nuk janë bërë në përputhje me nenet 11-20 të "*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
-Regjistrimet kontabël në Bashkinë Prrenjas nuk mbahen në programe financiare, por në Excel. Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; ligjin nr. 139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, germa "b"; Ligjin nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, neni 13; VKM nr. 117/2014, i ndryshuar me VKM nr. 833, datë 28.10.2020, Kreu nr. 1, pika nr. 1; VKM nr. 142, datë 12.03.2014, *"Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura"*; Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "*Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike*", pika 2.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

<u>1.1 Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për analizimin e mangësive, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konkretisht:
-të kryej vlerësime periodike të ekspozimit ndaj riskut për mashtrime.
-të përcaktoj në "Rregulloren e Brendshme" detyrat dhe përgjegjësitë mbi organizimin e veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë e në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas me Urdhër të Kryetarit nr. 72 datë 20.02.2025 dhe me nr. 447 prot., datë 20.02.2025 është ngritur grupi i punës "Për rishikimin dhe përmirësimin e Rregullores së brendshme të Bashkisë Prrenjas mbështetur në Planin e Integritetit 2025-2027", i cili përbëhet nga 10 anëtarë/punonjës të nivelit menaxherial të mesëm, të ulët dhe ekzekutiv/specialist të fushës, për një afat 10 ditor nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Me Vendimin e Kryetarit nr. 53 datë 26.03.2025 dhe me nr. 726 prot., datë 26.03.2025, është miratuar Rregullore e Brendshme e përditësuar e Bashkisë Prrenjas, e Institucioneve në varësi dhe e Njësive Administrative; ka miratuar Strategjinë dhe regjistrin e riskut për vitin 2025. Pra ***Rekomandimi 1.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në <u>*proces zbatimi.*</u>

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitin 01.01.2024-31.12.2024 u konstatua se, kjo njësi nuk ka kryer trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010 për "*Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit*" i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin

e riskut. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Prrenjas nuk ka hartuar "Programin e veçantë për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm dhe nuk ka përcaktuar indikatorët e matjes dhe vlerësimit të performancës së veprimtarisë audituese" në mospërputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII. Njëkohësisht nuk janë dhënë rekomandime për përmirësimin e punës audituese aty ku janë vërejtur mangësi e difekte në zbatimin e standardeve të auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që të:
- Planifikojë dhe kryej trajnime për punonjësit në lidhje me auditimet që paraqesin risk të lartë;
- Të hartojë programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të njësisë së auditimit të brendshëm, ku të përcaktojë indikatorët e matjes dhe vlerësimit të performancës së veprimtarisë audituese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: NJAB e Bashkisë Prrenjas ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit: Ka planifikuar në Planin Strategjik dhe Planin vjetor si dhe ka marrë pjesë në trajnimet e detyrueshme dhe jo vetëm, të zhvilluara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dhe nga ASPA; Ka hartuar programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë së NJAB për vitin 2025. Pra ***Rekomandimi 2.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar.*

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe i tarifave vendore u konstatua se, nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ku për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta (si të ardhurat nga tarifat e ujit të pijshëm në 6 %) nga 14,000,000 lekë planifikuar, janë realizuar vetëm 862,780 lekë dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin deri në 336% (taksa e kalimit të drejtës së pronës) nga 20,000 lekë e planifikuar, janë realizuar 67,259 lekë. Kjo gjë tregon se planifikimi i të ardhurave nuk bëhet bazuar në të dhëna dhe analiza reale, kjo vjen për shkak të mos planifikimin mbështetur në të dhëna reale dhe mos marrjen e të gjitha masave të nevojshme për arkëtimin e të ardhurave, në kundërshtim më përcaktimet e Ligjit nr.68/2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", neni 5, gërma (a). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë planifikime reale bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë. Të marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm dhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse, me qëllim që planifikimi dhe realizimi i buxhetit të jetë sa më i saktë.

Në vijimësi

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit: Në takimet e GMS referuar procesverbaleve të takimeve, mungon analiza cilësore e treguesve, pasi raportimet kufizohen në paraqitjen e shifrave pa identifikuar shkaqet e realizimit të të ardhurave dhe buxhetit vjetor jo sipas pritshmërive apo mundësive reale; nga STTV janë paraqitur plani i të ardhurave vendore për përgatitjen e PBA, por nuk rezulton të jetë hartuar një plan masash mujor e vjetor për të siguruar vjeljen e taksa e tarifave vendore në kohë por dhe për arkëtimin në masë të konsiderueshme nga debitorët familjarë dhe ata subjekte. Pra ***Rekomandimi 3.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në *proces zbatimi*.

4. **Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" janë përfshirë projekte në vlerën 9,622,240 lekë (kosto historike), të cilat nuk janë kontabilizuar drejt, pA... I....imet për të cilat janë hartuar këto projekte kanë përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projekteve duhet të kishte kaluar në vlerën e investimit. Këto veprime janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Aneksi 1 "*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*" pika 2, klasa 2, "*Aktivet afatgjata*" (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe .44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria financës në Bashkinë Prrenjas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 "Studime dhe Kërkime" dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga DPMFSHS/Sektori i Financës janë marrë masat që më mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, të sistemojë llog.202 "studime e projektime" për ato projekte investimet e të cilave janë mbyllur, duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të klasës 21- AAM, në investimin respektiv. Pra ***Rekomandimi 4.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se, kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 1,290,000 lekë, pasi nuk është kontabilizuar vlera e aksioneve të Ujësjellës Kanalizimeve Bashkia Prrenjas e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec me Nipt M24416601U. Sipas të dhënave të QKB-së rezulton se vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Prrenjas është 12.9% ose 1,290,000 lekë (12.9*10,000,000/100=1,290,000 lekë). Këto veprime janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*"; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", Kreu 3.1, pika 31, 125 shkronja "b", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Prrenjas, të marrë masat e nevojshme, që të saktësojë regjistrimet kontabël duke debituar llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredituar llogarinë 1011, "Shtesa të fondit bazë".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga DPMFSHS/Sektori i Financës janë marrë masat që më mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, të sistemojë llog.26 "pjesëmarrje në kapitalin e vet" duke kontabilizuar në vlerën 1,290,000 lekë për ato projekte investimet e të cilave

janë mbyllur, duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të klasës 21- AAM, në investimin respektiv. Pra ***Rekomandimi 4.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Prrenjas, në fund të vitit 2024 ka në përbërje të saj fonde në vlerën 36,630,270 lekë, të cilat përfaqësojnë vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit. Nga Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve pasi nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 36,630,270 lekë. Kjo ka ndodhur pasi nuk është bërë shkëmbim informacioni midis drejtorive Të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve dhe Drejtorisë së Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale në lidhje me adresën e saktë të subjekteve sipas llojit të investimit të kryer. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve, të marrin masat e nevojshme për saktësimin e adresave të subjekteve që u ka kaluar afati për vlerën e garancisë së kontratave, të kryhen njoftimet përkatëse në mënyrë që të bëhet i mundur zhbllokimi i fondeve, gjendje në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje" dhe ne rast të mos reagimit të subjekteve të shihet mundësia që këto fonde të përdoren për interes publik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Planifikimit të territorit dhe projekteve, janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Po verifikohet dokumentacioni i çdo investimi dhe po analizohet situata rast pas rasti. Deri tani rezulton se ***Rekomandimi 6.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në *proces zbatimi*.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në gjendjen e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" është përfshirë vlera 6,969,028 lekë (kosto historike) e cila është e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga vitet e mëparshme.
Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtesa e konstruksione" në vlerën 703,306,598 lekë (kosto historike) është përfshirë vlera 57,966,654 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga vitet e mëparshme nga bilanci i ish-komunave.
Këto aktive të pa analizuara ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.
Veprime këto në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin

e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit, i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale, të saktësojnë në mënyrë të detajuar në sasi dhe vlerë llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarinë 211"Pyje, kullota, plantacione".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga DPMFSHS/Sektori i Financës janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit të lënë: me Urdhrin e Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr. 404 datë 01.10.2025 dhe me nr. 2274 prot., datë 01.10.2025, janë ngritur 6 komisione inventarizimi fizik dhe vlerësimi paraprak i aktiveve në ngarkim të Bashkisë Prrenjas, Njësive Administrative dhe strukturave vartëse; gjithashtu që me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, të sistemojë llog.211 "Pyje, kullota, plantacione", duke e ulur me 4,198,999 lekë nga 6,969,028 lekë që ishte. Shuma e llog.211 është e mbivlerësuar për 2,770,029 lekë;
Lidhur me llog.212 "ndërtesa e konstruksione" me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, vlera prej 57,966,654 lekë e paanalizuar llog. 212 është pjesërisht sistemuar me 15,046,714 lekë nga 57,966,654 lekë që ishte, duke e lënë aktualisht këtë llog. me shumën 42,919,940 lekë të paanalizuar. Pra ***Rekomandimi 7.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është pjesërisht zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale" paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" në vlerën 82,708,067 lekë, ku totali i tyre shkon në vlerë 82,708,067 lekë, e cila nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 "Nga fondet e veta të investimeve" e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 "Teprica e grandeve kapitale të brendshme" në vlerën 0 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Prrenjas, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 230 "Investime për aktive afatgjata jo materiale", llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" me kundër partitë përkatëse të këtyre llogarive.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Drejtoria e Financës ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit, duke plotësuar llogaritë kontabël me vlerat përkatëse të investimeve sipas Udhëzimit MF nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar. Pra ***Rekomandimi 8.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,450,630,388 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet

për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 17,449,305,980 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 22,108,530 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 80,356,394 lekë, amortizimin shtesë në vlerën 73,025,701 lekë, sistemimet e bëra si rezultat i konstatimeve për kontabilizimet e dubluara në periudha të mëparshme në vlerën 132,618,378 lekë dhe amortizimin e pakësimit në vlerën 4,280,413 lekë për vitin ushtrimor 2024 sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 është nënvlerësuar në vlerën 127,145,303 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 101"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" dhe kundër partisë përkatëse të kësaj llogarie.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga DPMFSHS/Sektori i Financës janë marrë masat që më mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, të verifikojë dhe sistemojë llog.101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar", duke saktësuar vlerën e çdo llogarie kontabël përfshirëse. Pra ***Rekomandimi 9.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar.*

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 190,338,038 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 237,089,210 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumës së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 267,205,176 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 38,675,760 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me; Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, pika 3, shkronja "ë"; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 44-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat për të bërë verifikimet dhe sistemimet përkatëse në kontabilitet të llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe kundër partisë përkatëse të kësaj llogarie.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga DPMFSHS/Sektori i Financës janë marrë masat që më mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2025, të sistemojë llog.520 "Disponibilitete në thesar", duke saktësuar vlerën e çdo llogarie kontabël përfshirëse [llog.85 +llog.466]. Pra ***Rekomandimi 10.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar.*

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm përcjellë me shkresën nr.189/19, datë 25.06.2024 rezultoi se:

-Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/2 prot., datë 15.07.2024 ka dërguar në KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Bashkia Prrenjas me shkresën nr.1796/4 prot., datë 06.12.2025 ka dërguar në KLSH, raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda afatit prej 6-muajsh, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
-Janë lënë 21 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht nga të cilat, 8 janë zbatuar, 4 zbatuar pjesërisht, 2..ë proces dhe 3 nuk janë zbatuar;
-Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre, rezulton e pazbatuar;
-Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia në vlerën 5,561 mijë lekë, rezulton e pazbatuar;
-Për 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, në vlerën 116,511 mijë lekë, rezulton se janë zbatuar pjesërisht 3 masa për vlerën 13,629 mijë lekë, si dhe nuk janë zbatuar 3 rekomandime për vlerën 22,903 mijë lekë.
Nisur nga sa më sipër, veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15, "Të drejtat e KLSH" të ligjit Nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 71-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit*", si edhe konstatimit të përsëritjes së problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara, për përmirësimin e gjendjes, si dhe me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar si më poshtë:

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: gjithë strukturat e Bashkisë Prrenjas kanë marrë masat për të zbatuar rekomandimet e lëna në RPA, duke paraqitur situatën si më poshtë vijon.

Masat organizative të lëna në auditimet e mëparshme.

1.1.Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Përrenjas, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Bashkia Prrenjas ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Ka hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, hartuar e miratuar planin vjetor të trajnimit të punonjësve ku janë përfshirë të gjithë punonjësit e bashkisë, ka bërë rregullisht raportimet e analizave dhe veprimtarisë brenda afateve ligjore, përmirësuar

komunikimin në nivel vertikal e horizontal etj. Pra ***Rekomandimi 11/1.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 1.1)*** është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi</u>****.***

<u>9.1. Rekomandimi:</u> Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Përrenjas), të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Titullari i bashkisë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Drejtoria Juridike, menaxhimit të burimeve njerëzore, në planin vjetor të trajnimeve ka përfshirë gjithë stafin e administratës dhe në veçanti specialistët që janë anëtarë të Njësive të prokurimit, KVO-ve etj, për ngritjen e profesionale të tyre në drejtim të procedurave të prokurimit. Pra ***Rekomandimi 11/9.1*** është pranuar nga subjekti dhe *<u>është zbatuar</u>*.

<u>10.1.Rekomandim</u>: Bashkia Përrenjas të marrë masa që për procedura të ndara me faza, me objekt hartimin e planeve të mbarështimit, vlerësimi i fazës së parë kualifikuese të jetë i tillë që të mundësojë konkurrimin e shumë operatorëve ekonomikë në fazën e dytë, duke i konsideruar urdhrat e ministrit për miratimin e planeve të mbarështimit si vërtetime që provojnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Janë hartuar Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për vitin 2025, në vlerën totale të parashikuar në buxhet prej 20,864,790 lekë me afat 2 vjeçar; për vitin 2025 është parashikuar dhe realizuar në vlerën 10,000,000 lekë ose 100% të vlerës parashikuar *për vitin 2025* dhe 48% të vlerës totale të parashikuar; *për vitin 2026* është parashikuar në vlerën 10,864,790 lekë ose 52% e vlerës totale. Pra ***Rekomandimimi 11/10.1 (****është i njëjtë me* ***Rekomandimin 11/15.1)*** është pranuar nga subjekti dhe *<u>është zbatuar</u>*.

<u>11.1.Rekomandimi:</u> Bashkia Përrenjas të marrë masa që në punimet për rikonstruksione të rrugëve të përfshijë zërat për asfaltim dhe punime të tjera, me qëllim realizimin e investimeve në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme si dhe të argumentojë përmes një relacioni teknik arsyet e ndryshimeve të zërave të punimeve për procedura me objekt të ngjashëm prokurimi.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Bashkia Prrenjas ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit, duke e patur parasysh në punimet e realizuara në periudhën në vijim. Pra ***Rekomandimi 11/11.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi</u>****.***

<u>14.1.Rekomandimi</u>: Bashkia Përrenjas të marrë masa për ngritjen e një strukture të posaçme për të koordinuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në funksion të përditësimit të inventarit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, përmes verifikimit juridik dhe faktik (evidentim në terren) të gjendjes së pronave. Në veçanti, të përcaktojë si prioritet regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shërbimeve arsimore, si shkolla, kopshte dhe çerdhe.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Me Urdhrin e Kryetarit nr. 120 datë 27.03.2025 dhe me nr. 727 prot., datë 27.03.2025 ndryshuar me Vendimin nr. 424 datë 13.10.2025 me nr. 2396 prot., datë 13.10.2025, është ngritur Struktura e Posaçme për përditësimin e listave të pronave shtetërore prej 7 anëtarësh;

verifikimi në terren është bërë sporadik dhe jo sipas një plani të miratuar. Pra ***Rekomandimi 11/14.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

15.1.Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masa që të parashikojë fonde për miratimin e planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore, regjistrimin e sipërfaqeve pyjore si dhe për plotësimin e numrit të inspektorëve në pyje në raport me sipërfaqet në hektarë që i janë transferuar.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit: Janë hartuar Planet e mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për vitin 2025, në vlerën totale të parashikuar në buxhet prej 20,864,790 lekë me afat 2 vjeçar; për vitin 2025 është parashikuar dhe realizuar në vlerën 10,000,000 lekë ose 100% të vlerës parashikuar *për vitin 2025* dhe 48% të vlerës totale të parashikuar; *për vitin 2026* është parashikuar në vlerën 10,864,790 lekë ose 52% e vlerës totale; Lidhur me numrin e strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, rezulton se me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 16 datë 10.01.2025 dhe me nr. 101 prot., datë 10.01.2025 është miratuar struktura organizative ku kjo strukturë është e organizuar në Inspektorat i Mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave me 10 punonjës (1 kryeinspektor+5 inspektorë zone +4 roje). Pra ***Rekomandimimi 11/15.1 (****është i njëjtë me* ***Rekomandimin 11/10.1)*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Bashkia Prrenjas i ka likuiduar të gjitha detyrimet e prapambetura dhe deri në 31.12.2025 ka 0 lekë detyrime të prapambetura. Pra ***Rekomandimi 11/16.01*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

16.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka rritur bashkëpunimin me Drejtorinë e të ardhurave, duke planifikuar PBA dhe Planin vjetor mbi bazë analizash të realizimit të 3 viteve të fundit dhe trendit të arkëtimeve nga të ardhurat vendore (tatimore dhe jo tatimore, të ndara). Pra ***Rekomandimi 11/16.2*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 3.1***) është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi.*

17.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Përrenjas, të vijojë procedurën për nxjerrjen e Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë "Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm".
17.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Përrenjas, të marrë masa si vijon:

-Mbajtjen e aktkontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.
-Moslejimin e zhvillimit të ndërtimit në kushtet e mungesës së lejes së zhvillimit dhe të ndërtimit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
-Në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.
-Rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Politikave Urbane, për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Realizimin e kontrolleve periodike mbi objektet në zhvillim, të pajisur me leje ndërtimi, për të verifikuar nëse zbatimi i punimeve kryhet sipas projektit të miratuar.
-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga IMT Bashkia Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit.

Viti	Procesverbale/Akt Konstatimi	Vendime pezullimi	Vendime prishje objekti	Ekzekutuar	Vendime me gjobë	Vlera arkëtuar		Kallëzim penal
						po	jo	
2024	12	3	3	0	4	20,000	1,020,000	0
2025	40	37	36		36			5
	62	**40**	**39**		**40**			

Burimi: IMTV/Bashkia Prrenjas

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga IMT, rezulton se:
- janë mbajtur akt kontrollet për objektet me leje ndërtimi, me specifikimet e duhura teknike;
- janë parandaluar rastet për vijimin e punimeve të objekteve pa u pajisur më parë me leje zhvillimi apo ndërtimit;
- Nuk ka patur shmangie të projektit të miratuar, vetëm raste të tejkalimit të afateve të punimeve;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi i IMT me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe pronave nuk është në çdo rast i dokumentuar dhe në kohë, që do të thotë se nga DPTP nuk përcillet periodikisht regjistri i lejeve të miratuar;
- IMT përgatit Planin vjetor të punës duke e detajuar dhe zbërthyer në plane mujore;
- raporton rregullisht në IKMT, mbi aktivitetin 3 mujor të saj.

Pra *Rekomandimi 11/17.1 dhe Rekomandimi 11/17.2* janë pranuar nga subjekti dhe janë *<u>në proces zbatimi</u>*.

<u>1.1. Rekomandimi</u>: Titullari i Bashkisë Përrenjas dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për arkëtimin e detyrimeve të palikuiduara nga debitorët progresivë për vitin 2022, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara në paketën fiskale nga subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet për qëllime biznesi si dhe nga subjektet familjare në vlerën totale 63,391,576 lekë.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas, Titullari dhe DTTV janë marrë masat për zbatimin në vijimësi të rekomandimit. Kështu detri në 31.12.2024 vlera totale debitore për të gjitha kategoritë e taksa e tarifave vendore (tatimore e jotatimore) ka qenë 97,796,446 lekë dhe me kamatë të llogaritur por të papërfshirë 103,063,541 lekë; janë arkëtuar nga kjo debi në vitin 2025 vlera prej 16,940,218 lekë, duke e cuar vlerën e mbetur në 31.12.2025 prej 80,856,228 lekë dhe me kamatë 86,123,323 lekë. Duhet theksuar se vlera prej 63,391,576 lekë e lënë si vlerë debitore e periudhës 31.12.2022, me arkëtimet dhe mosarkëtimet e detyrimeve vjetore

ka një diferencë prej 34,404,870 lekë për periudhën 31.12.2022 deri në 31.12.2024. Pra ***Rekomandimi 11/1.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 3.1*** të kategorisë "Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara"), është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë listën me subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe në vijim Bashkia Përrenjas të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 2,526,900 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i dërgon Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore informacion periodik mbi subjektet debitorë për TNI për legalizimet. Kështu deri në 31.12.2024 vlera progresive nga TNI ishte 1,942,440 lekë (diferenca prej 95,351 lekë është arkëtuar në periudhën deri para datës 31.12.2024), janë arkëtuar në vitin 2025 nga kjo debi 1,727,098 ;lekë dhe deri në 31.12.2025 vlera debitore progresive e mbetur është 215,342 lekë. Pra ***Rekomandimi 11/2.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

6.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës, personit të ngarkuar për llogaritjen e TNI për objektet e reja që kanë tipologjinë e mësipërme, taksa të përllogaritet bazuar në çmimin e shitjes.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit dhe pronave janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Personi i ngarkuar përllogarit TNI mbështetur në kuadrin ligjor të përditësuar në vijimësi. Pra ***Rekomandimi 11/6.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar.*

6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 10,047,964 lekë ndaj 2 subjekteve për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga të cilat 4,170,770 lekë për subjektin "L. B. dhe E. B." si dhe 5,877,194 lekë për subjektin "M. –P".

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas janë marrë masat për arkëtimin e vlerës debitore të krijuar nga llogaritja e gabuar e vlerës së TNI. Kështu

- Subjekti "M. P" – deri në 09.10.2024 ka arkëtuar në total 5,977,194 lekë duke e likuiduar detyrimin në masë të plotë;
- Subjekti "L. B." – me MA nr. 992 datë 07.10.2024 ka arkëtuar 347,600 lekë, nga *debia totale 4,170,770 lekë* për të cilën është lidhur Akt marrëveshje nr. 650/1 prot., datë 08.10.2024 me 11 këste mujore në vijim prej 347,561 lekë. Me shkresat: nr. 2351 prot., datë 08.10.2025, nr. 2887 prot., datë 10.12.2025 dhe nr. 40 prot.,06.01.2026 i janë dërguar për kujtesë debitorëve L.B. & E.B. kryerja e pagesave në zbatim të akt marrëveshjes të shumës së mbetur 3,823,170 lekë. Deri në datën 19.06.2026 nuk është kryer asnjë pagesë nga ana e subjektit për llogari të Bashkisë Prrenjas. Pra subjektit "L. B." i ka mbetur për të arkëtuar në llogari të Bashkisë Prrenjas vlera debitore prej 3,823,170 lekë e cila do të rikërkohet. Pra ***Rekomandimi 11/6.2*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 5.1*** të rubrikës "Masa Për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (Të Ardhura të munguara)", është pranuar nga subjekti dhe është *pjesërisht zbatuar* .

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përrenjas të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas deri në 31.12.2024 janë 6 vendime gjyqësore në vlerën totale të fituar prej 19,254,637 lekë, prej të cilëve 4 vendime (për çështje të nisura para vitit 2019) janë për tu ekzekutuar nga fondet e buxhetit të Bashkisë Prrenjas për të larguarit nga puna në vlerën totale prej 2,707,494 lekë dhe 2 vendime janë për tu ekzekutuar nga fondet e MSHMS në vlerën totale prej 16,547,143 lekë. Pra ***Rekomandimi 11/1.1*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përrenjas, Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave, dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve kontraktuale në vlerën **2,729,835 lekë**, si dhe kamatëvonesa deri më 31.12.2023 në vlerën **2,831,729 lekë.**

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Drejtoria e të ardhurave dhe liçencave, Drejtoria e Financës kanë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra ***Rekomandimi 11/1.1 (***është i njëjtë me ***Rekomandimin 11/6.1*** te rubrika ‘‘Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash”) është pranuar nga subjekti dhe është në *proces zbatimi*.

Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash.

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **2,037,791 lekë.**

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit i dërgon Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore informacion periodik mbi subjektet debitorë për TNI për legalizimet. Kështu deri në 31.12.2024 vlera progresive nga TNI ishte 1,942,440 lekë (diferenca prej 95,351 lekë është arkëtuar në periudhën deri para datës 31.12.2024), janë arkëtuar në vitin 2025 nga kjo debi 1,727,098 ;lekë dhe deri në 31.12.2025 vlera debitore progresive e mbetur është 215,342 lekë. Pra ***Rekomandimi 11/1.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Licensave, në bashkëpunim Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve

që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse. Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit. Gjithashtu të ndiqen të gjitha rrugët ligjore deri në arkëtimin e vlerës 16,865,439 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Përrenjas.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Drejtoria e të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative përditësojnë çdo fillim viti regjistrin e tokës bujqësore; bëhen verifikimet dhe për cdo ndryshim të treguesve të parcelave përllogaritet taksa e tokës bujqësore mbi akt konstatimin e mbajtur; debitorëve u dërgohen njoftim vlerësimet pë detyrimin vjetor dhe vlerën debitore. Kështu deri në 31.12.2024 vlera debisë progresive e tokës bujqësore është 2,773,869 lekë, janë arkëtuar gjatë vitit 2025 vlera prej 1,787,228 lekë dhe kanë mbetur për arkëtim për periudhën në vijim 986,641 lekë nga vlera totale progresive e periudhës deri në 31.12.2024. Pra ***Rekomandimi 11/2.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 4.1*** te kategoria "Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara") është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi</u>*

<u>3.1.Rekomandimi:</u> IMTV dhe Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave në Bashkisë Përrenjas të ndjekin të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **4,000,000 lekë**.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas me masat e marra për zbatimin e rekomadimit dhe veçanërisht për arkëtimin e vlerës debitore në tërësi dhe nga gjobat e vendosura nga IMT në veçanti, është mundur të arkëtohet shuma prej 586,120 lekë (282,300+303,820) nga 2 subjekte. Vlera debitore ka mbetur është 3,413,880 lekë. Pra ***Rekomandimi 3.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi.</u>*

<u>4.1.Rekomandimi:</u> Drejtoria e të Ardhurave dhe Licencave Bashkia Përrenjas në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Përrenjas, si, Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **87,518,388** lekë kjo për subjekte/abonent familjare**,** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas, STTV ka marë masat që me pagesën e detyrimit vjetor, familjarët të paguajnë në masë të plotë apo të pjesshme detyrimin debitor të akumuluar. Pra ***Rekomandimi 11/4.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 2.1*** dhe ***Rekomandimin 3.1*** te kategoria "Masa për Uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)", është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi</u>*.

<u>5.1.Rekomandimi:</u> Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve bashkia Përrenjas, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,600,000** lekë nga 2 subjektet, respektivisht;

-Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti "L. B." SHPK.
-Vlera 600,000 lekë nga subjekti "K." SHPK.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Bashkia Prrenjas nëpërmjet masave të marra, janë kryer arkëtimet për llogari të Bashkisë Prrenjas si vijon:
- Subjekti "K." shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas shumat: 200,000 lekë në datën 06.08.2024 dhe 400,000 lekë në datën 29.05.2025;
- Subjekti "L. B." shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas shumën 100,000 lekë në datën 05.10.2020;
Pra ***Rekomandimi 11/5.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 1.1*** të kategorisë "Masa për Uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) është pranuar nga subjekti dhe *është në proces zbatimi*.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e *"Mjedisit"* dhe tarifën e *"Pastrimit"* për 25 subjektet në vlerën **4,490,000 lekë**, respektivisht:
-Vlera 700,000 lekë për 2 subjekte HEC. (Grupi I)
-Vlera 2,250,000 lekë për 9 subjekte me lloj aktiviteti si, karrierë guri, inerte etj. (Grupi II)
-Vlera 1,540,000 për 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni etj. (Grupi III)
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Drejtoria e të ardhurave, liçencave dhe lejeve ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Një informacion i plotë paraqitet në tabelën më poshtë:

Grupi I

2 SUBJEKTET ME AKTIVITET HEC								
Nr.	Subjekti	statusi	Nipti	Zona	Lloji I aktivitetit	Niveli I tarifes rekomanduar	Aplikuar nga zyra taksave	Vlera debitore deri 31.12.2025
1	B. 17	aktiv	L.....K	Bashkia Prrenjas	HEC	350,000	-	-
2	R. E.	aktiv	L.....N	Bashkia Prrenjas	HEC	350,000	350,000	-
						700,000	**350,000**	**-**

Burimi: DAVLL/Bashkia Prrenjas

Nga informacioni dokumentar i vënë në dispozicion nga subjekti, *rezulton se* 2 subjektet: "B. 17" dhe "R. E."i kanë paguar detyrimet vjetore dhe ato debitore, dhe në 31.12.2025 nuk kanë detyrime ndaj Bashkisë Prrenjas.

Grupi II

9 SUBJEKTET ME AKTIVITET: KARRIERË GURI, INERTE, HEC								
Nr	Subjekti	statusi	Nipti	Zona	Lloji I aktivitetit	Niveli I tarifes I rekomanduar	Aplikuar nga zyra taksave	Vlera debitore deri 31.12.2025
1	N.- 18 shpk	nuk punon	L.....G	Bashkia Prrenjas	kontrate qeraje	250,000	-	380,000
2	F. – A. B.	aktiv	K.....V	Bashkia Prrenjas	Grumbullim kromi	250,000	250,000	-
3	K - 12 SHPK	mbyllur/larguar	K.....C	Bashkia Prrenjas	Perpunim mineralesh	250,000	-	905,000
4	B. - X SHPK	mbyllur/larguar	K.....N	Bashkia Prrenjas	Ndertime,punime dheu	250,000	-	-
5	D. E. & T. SHPK	punon import/eksport	L.....O	Bashkia Prrenjas	Import eksport, shumic-pakice	250,000	-	proces gjyqsor
6	E. SHPK	larguar/nuk punon	K.....C	Bashkia Prrenjas	shfrytezim pyjesh	250,000	-	285,000
7	L.- B.	punon vetem karburant	J.....M	Bashkia Prrenjas	karburant,nxjerrje minerari	250,000	250,000	2,704,470
8	A. SHPK	larguar	J.....Q	Bashkia Prrenjas	shfrytezim karrierash lumore	250,000	250,000	-
9	E.- F.	punon grumbullim	L.....I	Bashkia Prrenjas	pike grumbullimi	250,000	-	276,975
	Totali					**2,250,000**	**750,000**	**4,551,445**

Burimi: DAVLL/Bashkia Prrenjas

Nga informacioni dokumentar i vënë në dispozicion nga subjekti, për 9 subjektet me aktivitet: karrierrë guri, inerte dhe HEC *rezulton se*:

- 5 subjekte *nuk e ushtrojnë* më aktivitetin: "N.18" shpk, dhe "K-2" shpk, "B.X" shpk, "E." shpk dhe "A." shpk; prej të cilëve 3 subjekte janë debitore në vlerën totale 1,190,000 lekë dhe 2 subjekte nuk kanë detyrime ndaj Bashkisë Prrenjas;
- 4 Subjekte janë aktiv prej të cilëve: 2 subjekte janë debitorë në vlerën totale 1,181,975 lekë, 1 është në process gjyqësor dhe 1 nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Prrenjas;
Në total deri në 31.12.2025 vlera debitore është *4,551,445 lekë për 5 subjekte*;

Grupi III

14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni								
Nr.	Subjekti	statusi	Nipti	Zona	Lloji I aktivitetit	Niveli I tarifes rekomanduar	Aplikuar nga zyra taksave	Vlera debitore deri 31.12.2025
1	F.-A. B.	aktiv	K.....V	Bashkia Prrenjas	grumbullim kromi	110,000	120,000	-
2	T.	mbyllur/larguar	K.....P	Bashkia Prrenjas	shfrytezim miniere	110,000	-	1,270,560
3	N.-18 SHPK	nuk punon	L.....G	Bashkia Prrenjas	shfrytezim miniere	110,000	-	380,000
4	P. 20. shpk	aktiv	L.....E	Bashkia Prrenjas	gurore,prodhim inertesh	110,000	120,000	327,807 me akt marrëveshje
5	E. T. shpk	larguar/nuk punon	K.....I	Bashkia Prrenjas	nxjerrje kromi	110,000	-	700,000
6	K -2 SHPK	mbyllur/larguar	K.....C	Bashkia Prrenjas	perpunim minerartesh	110,000	-	905,000
7	B. 20.	aktiv	L.....K	Bashkia Prrenjas	HEC	110,000	-	ska filluar/vetem kontarte qeraje
8	E.	aktiv	L.....B	Bashkia Prrenjas	HEC	110,000	-	ska filluar/vetem kontarte qeraje
9	K. shpk	aktiv	K.....H	Bashkia Prrenjas	Gurore	110,000	120,000	1,222,001
10	S.& D.	mbyllur/larguar		Bashkia Prrenjas	shfrytezim lende drusore	100,000	-	ska vlere rregjister
11	S. & R. SHPK	larguar/nuk punon	L.....P	Bashkia Prrenjas	shfrytezim minerartesh	110,000	-	ska vlere rregjister
12	E. H.	aktiv	L.....M	Bashkia Prrenjas	HEC	110,000	-	ska filluar/vetem kontarte qeraje
13	M. F. N.	nuk punon	L.....F	Bashkia Prrenjas	prodhime karbonike	110,000	120,000	374,690
14	L.– B. shpk	aktiv	J.....M	Bashkia Prrenjas	Karburant	110,000	120,000	2,704,470
	Totali					**1,530,000**	**600,000**	**7,556,721**

Burimi: DAVLL/Bashkia Prrenjas

Nga informacioni dokumentar i vënë në dispozicion nga subjekti, për 14 subjektet me aktivitet: HEC, miniera, gurore, nyje betoni *rezulton se*:
- 6 subjekte *nuk e ushtrojnë* më aktivitetin: "T.", "N. 18" shpk, "K-2" shpk, "E. T." shpk, "S. & D." shpk dhe "M. F. N." shpk; prej të cilëve 5 subjekte janë debitore në vlerën totale 3,630,250 lekë dhe për 1 subjekt nuk ka informacion mbi detyrime ndaj Bashkisë Prrenjas;
- 4 Subjekte janë aktiv prej të cilëve: 2 subjekte janë debitorë në vlerën totale 1,181,975 lekë, 1 është në proces gjyqësor dhe 1 nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Prrenjas;
Në total deri në 31.12.2025 vlera debitore është *7,556,721 lekë për 5 subjekte*;
Konkluzion: Deri në 31.12.2025 vlera debitore totale progresive sipas grupimeve është 12,108,166 lekë për 10 subjekte, pa përfshirë 1 subjekt në proces gjyqësor dhe 1 subjekt pa informacion detyrimesh. Pra ***Rekomandimi 11/6.1*** është pranuar nga subjekti dhe është *pjesërisht zbatuar*

6.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas të ushtrojë kontrolle pranë aktiviteteve të subjekteve të cituar më sipër, me qëllim identifikimin nëse, ushtrohet ose jo veprimtaria prej tyre.

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Drejtoria e të ardhurave vendore në verifikimet periodike apo të përvitshme në terren, për subjektet që nuk ushtrojnë më aktivietetin e tyre, përpilojnë akt konstatim apo verifikim sipas rastit, kërkojnë informacion në QKB mbi statusin e subjektit dhe marrin masat përkatëse. Pra ***Rekomandimi 11/6.2*** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar.*

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2024 në territorin e Bashkisë Prrenjas kanë ushtruar aktivitet 5 (pesë) subjekte me objekt veprimtarie tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore, gjë e cila ka sjell të ardhura të munguara për bashkinë Prrenjas në vlerën prej 4,400,000 lekë. Në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre*", të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2 si dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017 pika 2/9. Këto subjekte duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë/autorizim, për aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor, si dhe të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të krijuara nga subjektet me tregtim të lëndëve djegëse.

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga Bashkia Prrenjas, nëpërmjet Urdhrit të kryetarit të bashkisë nr. 483 datë 10.11.2025 dhe me nr. 2673 prot., datë 10.11.2025, është ngritur komisioni (task-force) për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në afat sipas paketës fiskale 2025 të miratuar me VKB nr. 3274 prot., datë 27.12.2024, i përbërë nga:

1. O. M. specialiste e tatimeve –kryetare e komisionit
2. A. B. specialist finance
3. A. A. Policia Bashkiake
4. B. O. specialist tatimeve
5. L. B. Policia Bahkiake
6. I. G. Administratot NJA Rajcë
7. A. A. Specialist tatimeve Qukës

Në zbatim të tij, komisioni mori masa dhe referuar akt rakordimit me Degën e Thesarit apo pagesave bankare, situata e vlerës debitore për këtë kategori biznesi paraqitet si më poshtë vijon:

- Subjekti "K." shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas (likuidim) shumat: 1,000,000 lekë në daten 14.02.2024 dhe 100,000 lekë në datën 16.04.2025;
- Subjekti "A... G... T..."-shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas (likuidim) shumën 1,000,000 lekë në datën 29.10.2025;
- Subjekti "K." shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas shumat: 200,000 lekë në datën 06.08.2024 dhe 400,000 lekë në datën 29.05.2025;
- Subjekti "L. B." shpk ka arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas shumën 100,000 lekë në datën 05.10.2020; Ndaj subjektit janë dërguar Urdhra bllokimi 6 bankave të nivelit të dytë me nr. 1536/3 prot., datë 24.05.2022 dhe DRSHTRR Elbasan me nr. 2375 prot., datë 01.09.2022. Pas këtyre masave nuk është vijuar me hapa të mëtejshëm sipas kuadrit ligjor.

- Subjekti “B. G” shpk ka paguar në momentin e marrjes së Autorizimit datë 07.01.2022 me afat 5 vjeçar, shumën prej 100,000 lekë (sipas klasifikimit të bërë në vitin 2022). Me shkresën nr. 2700 prot., datë 13.11.2025 i është dërguar njoftim subjektit “B. G” për likuidim të detyrimit në vlerën 900,000 lekë. Sipas komunikimit zyrtar të dokumentuar: përgjigjja e subjektit me nr. 795 prot., datë 10.12.2025 (të bashkisë); përgjigjes së Bashkisë Prrenjas me nr. 795/1 prot., datë 22.12.2025, rezulton se Subjekti debitor “B. G” nuk e ka pranuar dhe deri në datën 19.06.2026 nuk ka kryer asnjë pagesë për llogari të Bashkisë Prrenjas. Pra ***Rekomandimi 1.1*** është pranuar nga subjekti dhe konsiderohet i zbatuar për 3 subjektet: “K.” shpk, “K.” shpk, “A. G. T.” shpk ndërsa për 2 subjektet: “L. B.” shpk dhe “B. G” Shpk është në *proces zbatimi*.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditëimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, në 31.12.2024 bizneset kanë krijuar një borxh progresiv prej 24,050,662 lekë. Drejtoria e të Ardhurave nuk ka aplikuar penalitetete në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 114 (24,050,662x21.9%=5,267,094), për arkëtimin e vlerës së detyrimit prej 5,267,094 lekë, vlerë kjo që duhet të kontabilizohet në vijim. Në përfundim, bizneset kanë krijuar një borxh prej **29,317,757 lekë**, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Prrenjas. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*.
2.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për të nxjerrë njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve, duke përllogaritur edhe penalitetet përkatëse, si dhe të kryejë kontabilizimin e tyre, në vlerën prej 29,317,757 lekë.

Deri në fund të vitit 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga STTV janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, si rezultat i të cilave nga subjektet debitore janë arkëtuar për llogari të Bashkisë Prrenjas si më poshtë vijon:

Subjekte debitorë Bashkia Prrenjas
- N. 20. me MA nr. 564 datë 23.09.2025 shumën 52,400 lekë;
- A. Ll. me MA nr. 493 datë 05.02.2025 shumën 41,202 lekë;
- E.-T me MP në OTP bankë datë 07.07.2025 shumën 286,935 lekë;
- T. me MP në bankë datë 21.01.2025 shumën 220,360 lekë;
- P.2010 me MP datë 14.07.2025 shumën 109,724 lekë; MA nr. 689 datë 21.02.2025 dhe MA nr. 907 datë 21.03.2025 shumat 250,000 lekë;
- M. shpk me MP datë 01.08.2025 shumën 155,000 lekë;
- Shoqëria Rajonale UK Pogradec me MP datë 17.10.2025 shumën 76,500 lekë;
- L. C. D. me MP datë 17.06.2025 shumën 36,507 lekë;
- A. T. me MA nr. 1510 datë 05.06.2025 shumën 41,094 lekë;
- SH. M. me MP datë 30.09.2025 shumën 50,000 lekë;
- B. Ch. me MP datë 25.07.2025 shumën 51,343 lekë;

Nëntotali I = 1,371,065 lekë

Subjekte debitorë nga biznesi i vogël
- NJA Prrenjas - 56 subjekte në shumën totale 1,548,241 lekë;
- NJA Qukës - 9 subjekte në shumën totale 197,963 lekë;
- NJA Rrajcë – 14 subjekte në shumën 235,944 lekë;

Nëntotali II = 1,982,148 lekë

Totali I+II = 3,353,213 lekë

Deri tani nga vlera totale debitore prej 29,317,757 lekë (24,050,662 principal + 5,267,094 kamatvonesë), janë arkëtuar në total 3,353,213 lekë dhe kanë mbetur për tu arkëtuar në llogari të Bashkisë Prrenjas vlera debitore e deri 31.12.2024 prej 25,964,544 (20,697,449 lekë principal + 5,267,094 kamatvonesë) lekë. Pra ***Rekomandimi 2.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në *proces zbatimi*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën 91,432,408 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2024 është 63,907,340 pakësimet gjatë vitit 2024 janë 57,543,302 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2024 është në vlerën **97,796,446 lekë** (nga të cilat vlera 24,050,662 i përket biznesit). Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, nuk duhej të ndalej, por duhet të vijojnë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me sektorët e tjerë të Bashkisë Prrenjas, të marrin masa konkrete duke përdorur të gjithë instrumentet ligjorë të parashikuar për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara me qëllim uljen e borxhit nga taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Në Bashkinë Prrenjas, STTV në bashkëpunim me sektorët e tjerë që sigurojnë të ardhura jotatimore, duke sjellë këtë pasqyrë përmbledhëse të ardhurash për periudhën deri në 31.12.2025, të cilën me anë të shkresës nr. 300 prot., datë 31.01.2025 i është përcjellë Drejtorisë së Financës.

Tabela përmbledhëse e vlerës debitore totale			
Lloji i taksa/tarifa	**Vlera debitore deri në dt. 31.12.2024**	**Paguar në vitin 2025 nga debia progresive 31.12.2024**	**Vlera debitore progresive e mbartur nga 2024 deri në 31.12.2025**
≠Biznesi≠			
Biznes i madh	16,264,058	4,582,015	11,682,044
Biznes i vogël	7,786604	2,181,702	5,604,902
	24,050,662	***6,763,717***	***17,286,946***
Kamatëvonesa	5,267,094		5,267,094
Nëntotali I	***29,317,757***	***6,763,717***	***22,554,040***
≠Taksa e tarifa familjare≠			
Qyteti Prrenjas	19,589,530	2,739,366	16,850,164
NjA Qukes-Rrajce-Stravaj	36,300,412	4,168,927	32,131,485
Taksa toka bujqësore	2,773,869	1,787,228	986,641
Nëntotali II	***55,889,942***	***6,908,293***	***48,981,649***
Debitorë për Ujin e Pijshëm	13,257,779	398,263	12,859,516
Debitorë për kopësht e çerdhe	1,255,623	642,847	612,776
Debitorë TNI	1,942,440	1,727,098	215,342
Pikat e Karburanteve	1,400,000	500,000	900,000
Nëntotali III	***17,855,842***	***3,268,208***	***14,587,634***
Totali I+II+III (pa kamatë)	**97,796,446**	**16,940,218**	**80,856,228**
Totali me kamatë	**103,063,541**	**16,940,218**	**86,123,323**

Burimi: STTV/Bashkia Prrenjas

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë *rezulton se:*

- Vlera debitore në total deri në 31.12.2024 është në shumën 97,796,446 lekë, vlerë të cilën e ka deklaruar dhe sektori i të ardhurave; nga rekomandimi rezulton se është llogaritur dhe kamatvonesa për vlerën debitore të biznesit prej 5,267,094 lekë duke e çuar vlerën totale të debisë në 103,063,541 lekë.

- Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar në total 16,940,218 lekë, ku peshën më të madhe e kanë arkëtimet nga debitorët TNI në masën 88.9% të debisë së vet; arkëtimet nga debitorët e "tokës bujqësore" në masën 64.4% të debisë së vet; arkëtimet nga debitorët "kopshte e çerdhe" në masën 51.2% të debisë së vet;
Me vlerën më të vogël janë arkëtimet nga debitorët "uji i pijshëm" në masën 3% të debisë së vet; arkëtimet nga "taksa e tarifa familjare" (qytet +NJA) në masën 12.4% të debisë së vet dhe arkëtimet nga debitorët "biznes" në masën 28% të debisë së vet (pa kamatë).
- Nga ana e subjektit nuk janë aplikuar penalitete.
Pra ***Rekomandimi 3.1*** (është i njëjtë me ***Rekomandimin 11/4.1)*** është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi</u>*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me debitorët për taksën e tokës bujqësore, për vitin 2024, për 4 njësit administrative rezultoi të jetë në vlerën 2,773,869 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Gjithashtu, në regjistrin e debitorëve familjarë me datë 31.12.2024 konstatohen 42 familjarë punonjës të Bashkisë Prrenjas, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet për taksën e tokës. Vlera debitore e krijuar nga 42 punonjësit e Bashkisë Prrenjas është në vlerën 499,923 lekë. Rrjedhimisht, mundësia e arkëtimit të tyre nga titullari i Bashkisë Prrenjas dhe Drejtoria e të Ardhurave është e mundur. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>4.1 Rekomandimi:</u> Kryetari Bashkisë Prrenjas dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore 2,773,869 lekë, përfshi këtu edhe 42 punonjës të Bashkisë Prrenjas debitorë.

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Bashkia Prrenjas ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit:
a. deri në 31.12.2024 vlera debisë progresive e tokës bujqësore është 2,773,869 lekë, janë arkëtuar gjatë vitit 2025 vlera prej 1,787,228 lekë dhe kanë mbetur për arkëtim për periudhën në vijim 986,641 lekë nga vlera totale progresive e periudhës deri në 31.12.2024.
b. ndaj 42 punonjësve debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën e debisë prej 499,923 lekë, konkretisht:
- A.G. me MA nr. 849 datë 31.10.2025 shumën 2,900 lekë;
- G.K. me MA nr. 279 datë 10.02.2026 shumën 5,000 lekë;
- G.B. (Sh.B.) me MA nr.154 datë 06.01.2026 shumën 16,120 lekë;
- S.K. me MA nr. 378 datë 24.02.2026 shumën 4,177 lekë;
- B.H. me MA nr. 96 datë 28.07.2025 shumën 21,290 lekë;
- V.H.(P.H.) me MA nr. 1029 datë 17.11.2025 shumën 14,072 lekë;
- F.K. (Sh.K.) me MA nr. 514 datë 15.09.2025 shumën 13,029 lekë.

Totali i arkëtuar = 76,588 lekë
Vlera debitore e mbetur = 423,335 lekë

Pra, ***Rekomandimi 4.1 (****është i njëjtë me* ***Rekomandimi 11/2.1***) është pranuar nga subjekti dhe është *<u>në proces zbatimi.</u>*

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi masat e marra për faturimin dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga objektet e legalizuara u konstatua se nga STTV, nuk janë ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj.) për arkëtimin e TNI nga legalizimi

i objekteve informale. Vlera debitore progresive është 2,046,409 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Prrenjas. Veprime këto në kundërshtim me pikën 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; si dhe të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore"* të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,046,409 lekë.

Menjëherë

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Sektori i Taksa e Tarifave Vendore, si pasojë e masave të marra për uljen e vlerës debitore nga TNI, ka mundur të arkëtojë për llogari të Bashkisë Prrenjas si më poshtë vijon:

Leje apo autorizime ndërtime të reja:

- Subjekti "M. P" – deri në 09.10.2024 ka arkëtuar në total 5,977,194 lekë;
- Subjekti "L.B." – me MA nr. 992 datë 07.10.2024 ka arkëtuar 347,600 lekë, nga *debia totale 4,170,770 lekë* për të cilën është lidhur Akt marrëveshje nr. 650/1 prot., datë 08.10.2024 me 11 këste mujore në vijim prej 347,561 lekë. Me shkresat: nr. 2351 prot., datë 08.10.2025, nr. 2887 prot., datë 10.12.2025 dhe nr. 40 prot.,06.01.2026 i janë dërguar për kujtesë debitorëve L.B. & E.B. kryerja e pagesave në zbatim të akt marrëveshjes të shumës së mbetur 3,823,170 lekë. Deri në datën xx.06.2026 nuk është kryer asnjë pagesë nga ana e subjektit për llogari të Bashkisë Prrenjas.
- Subjekti "E. S." me administrator R. K., ka arkëtuar me MA nr. 806 datë 27.10.2025 ka arkëtuar shumën 283,111 lekë nga debia totale 3,425,855 lekë, për të cilën është lidhur Akt marrëveshje nr. 1276/1 prot., datë 05.05.2023 dhe aktivizuar për mospagesë në datë 23.10.2025 me 12 këste mujore në vijim prej 250,000 lekë. Me shkresat: nr. 243/1 prot., datë 24.01.2023, nr. 2356 prot., datë 08.10.2025 dhe nr. 39 prot.,06.01.2026 i janë dërguar për kujtesë Subjektit "E. S." kryerja e pagesave në zbatim të akt marrëveshjes të shumës së mbetur 3,000,000 lekë. Deri në datën xx.06.2026 nuk është kryer asnjë pagesë nga ana e subjektit për llogari të Bashkisë Prrenjas.

Nëntotali I = 6,607,905 lekë

Legalizime:

Vlera debitore deri në 31.12.2024 është në shumën 1,942,440 lekë, për të cilën vetëm 3 debitorë kanë paguar në vlerën totale 108,702 lekë;

- F.H. me MA nr. 188 datë 08.01.2025 shumën 40,721 lekë;
- E.D. me MA nr. 492 datë 05.02.2025 shumën 49,807 lekë;
- B.Ç. me MA nr. 44 datë 06.01.2025 shumën 18,174 lekë;

Nëntotali II = 108,702 lekë

Totali I+II = 6,716,607 lekë

Rezulton se janë arkëtuar nga TNI në total shuma prej 6,716,607 lekë**.** P*ra* ***Rekomandimi 5.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në *proces zbatimi.*

6. Gjetje nga auditimi: Sipas VKB-së nr.4, datë 27.12.2023 Për "Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2024", si agjent tatimor për vjeljen e taksës vjetore të mjeteve të transportit rrugor, është përcaktuar "Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRSHPTRR)", e cila derdh me anë të faturës për arkëtim përqindjen e përcaktuar të totalit mujor të të ardhurave në

llogarinë bankare të degës së thesarit. Nga rakordimet mujore të bëra me këtë drejtori, konkludohet se realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2024 është 11,861,483 lekë, ose 11,7% e të ardhurave totale për Bashkinë Prrenjas. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2024 agjenti tatimor DRSHTRR rezulton debitor në vlerën prej **3,072,588 lekë,** vlerë e cila nuk është kontabilizuar dhe që përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Prrenjas.
Për këtë agjent, Bashkia Prrenjas duhet të llogarisë gjobë në masën 0.06% për çdo ditë vonese, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike, në bazë të ligjit nr. 9920 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 117, pika a. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1.Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të transportit rrugor në vlerën 3,072,588 lekë dhe penalitet, si dhe të kryejë kontabilizimin e saj.

Deri në fund të vitit 2025

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Agjenti tatimor DRSHTRR Elbasan, ka arkëtuar në llogari të Bashkisë Prrenjas detyrimin vjetor mbi taksën e mjeteve në qarkullim të vitit 2024 në shumën 3,072,588 lekë. Nga ana e Bashkisë Përrenjas deri tani nuk është llogaritur kamatvonesa dhe as nuk është vënë në dijeni zyrtarisht DRSHTRR Elbasan. Pra ***Rekomandimi 6.1*** është pranuar nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar***.**

D. MASA DISIPLINORE

D1. Për punonjësit në marrëdhënie pune Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSh-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje", për punonjësit e mëposhtëm:
9. **Znj. M. Z.** (V.) në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë e të Ardhurave për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.
-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.
10. **Znj. O. M.** në cilësinë e Specialiste Biznesi, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.
-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.

11. Z. I. G. në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 89,90,91,93, ku masat e ndërmarra për uljen e borxhit janë të pjesshme dhe jo mjaft efektive.
-Për shkeljet e konstatuara në ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2024 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse, apo pa likuiduar të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore
12. Znj. B. K., me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Aktiveve, për mangësitë e trajtuara në pikën 2.3 të Raportit Përfundimtar të auditimit "Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar".
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Prrenjas janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit, konkretisht:
- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 83 datë 04.02.2026 dhe me nr. 378 prot., datë 04.02.2026, i është dhënë masë disiplinore "vërejtje me shkrim" për Z.I. G.;
- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 84 datë 04.02.2026 dhe me nr. 379 prot., datë 04.02.2026, i është dhënë masë disiplinore "vërejtje me shkrim" për Znj.O. M.;
- Me Urdhrin e Kryetarit nr. 85 datë 04.02.2026 dhe me nr. 380 prot., datë 04.02.2026, i është dhënë masë disiplinore "vërejtje me shkrim" për Znj.B. K.;
- Për znj. M. Z. nuk ka dalë vendim. Nga komunikimi me Sektorin e burimeve njerëzore na u dha ky informacion: nga data 01.09.2025 deri në 17.10.2025 ka qenë me raport mjekësor; rikthyer në datë 18.10.2025 dhe deri në datën 16.11.2025 ka konsumuar lejen vjetore; Në datën 17.11.2025 ka paraqitur dorëheqjen me nr. 2715 prot., për arsye personale (për trajtim shëndetësor); me Urdhrin nr. 490 datë 17.11.2025 dhe me nr. 2714 prot., datë 17.11.2025 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare; Meqënëse zbardhja e vendimit/eve të Kryetarit të Bashkisë për punonjësit e propozuar në kategorinë "Masa displinore" të RPA të datës 22.10.2025 kanë qenë pas një periudhe relativisht të gjatë (më shumë se 3 muajve kalendarik), për znj. M. Z. nuk është marrë vendim.
Pra ***Rekomandimi*** është pranuar nga subjekti dhe *<u>është zbatuar</u>*.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Prrenjas, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:
a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.
Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: <u>a.</u> Urdhrat e Titullarit të Bashkisë Prrenjas për dhënie mase "vërejtje" janë administruar fizikisht në dosjen e personelit. Sektori i burimeve njerëzore është në proces trajnimi për hedhjen në sistem të masave disiplinore. Referuar dhe në

zbatim te Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, neni 58 pika1, neni 59 pikat 1 dhe 9;

b. Në rastet e masës disiplinore "vërejtje me shkrim" nga Titullari**,** njoftimi në KMSHC bëhet nëpërmjet raportit vjetor apo kërkesave periodike të KMSHC. Meqënëse masa "vërejtje me shkrim" është dhënë në vitin 2026, ky raportim mbetet të bëhet në raportin vjetor të vitit 2026 dhe/ose në informacionet që do kërkohet nga KMSHC. Deri në 19.06.2026 nuk është kërkuar informacion. Pra ***Rekomandimi*** është *në proces zbatimi*.

Konkluzion: Në përfundim të procesit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, rezulton se nga 41 rekomandime të lëna në total, janë pranuar nga subjekti Bashkia Prrenjas të gjitha rekomandimet; janë verifikuar 41 rekomandimet nga të cilat: janë zbatuar 14 masa ose 34.2% e tyre; 23 masa janë në proces zbatimi; 4 masa janë pjesërisht zbatuar dhe 0 masa janë pa zbatuar; pra 4 masa mbeten për tu zbatuar nga Bashkia Prrenjas.

Grupi i auditimit duke analizuar rekomandimet e pranuara dhe të zbatuara nga Bashkia Prrenjas (njësitë përgjegjëse të saj) apo dhe ato në proces zbatimi, arriti në konkluzionin që:
- Për kategorinë "Masa organizative" – Rekomandimet: R2.1; R4.1; R5.1; R8.1; R9.1; R10.1; R11/9.1; R11/10.1; R11/15.1; R11/16.1; R11/6.1; R11/1.1; R11/6.2 (janë zbatuar)
- Rekomandimet: R1.1; R3.1; R6.1; R11/1.1; R11/11.1; R11/14.1; R11/16.2; R11/17.1; R11/17.2; R11/1.1; R11/2.1; R11/1.1; R11/1.1; R11/2.1; R11/3.1; R11/4.1; R11/5.1 (janë në proces zbatimi)
- Për kategorinë "Masa për uljen e borxhit tatimor" – Rekomandimet: R1.1; R2.1; R3.1; R4.1; R5.1; (janë në process zbatimi)
- Për kategorinë "Masa disiplinore" rekomanduar për 4 punonjës (janë zbatuar)

Janë pranuar dhe zbatuar apo në proces zbatimi nga Bashkia Prrenjas, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

IV. REKOMANDIME.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK u konstatua se:

Mjedisi i kontrollit

1. Nga Bashkia Prrenjas për pozicionet me Kod Pune (pa afat apo provizorë), nuk bëhet shpallja në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, por publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas, në rrjetet sociale, dhe në stendat e Bashkisë, në mospërmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 19 pika 1, 2;

2. Verifikimi i dokumentacionit në dosjet e personelit për të punësuarit në vitin 2025, *rezultoi me* këto mangësi: vërtetim nga prokuroria dhe gjykata, certifikata familjare, formulari i vetëdeklarimit si dhe mospërditësimi i raportit të aftësisë për punë dhe i certifikatës familjare, mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 117/2014 datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" i ndryshuar me VKM nr. 833/2020 datë 28.10.2020, kreu I/pika 3;

3. Në Relacionin bashkëlidhur VKB të miratimit të strukturës organizative dhe numrit të punonjësve në Bashkinë Prrenjas , nuk paraqiten pozicionet dhe strukturat për të cilat nevojiten punonjësit provizorë;
- Në strukturën organizative të miratuar, nuk janë parashikuar pozicione nga "ekselenca" dhe "grupi i veçantë" në mos përmbushje të VKM nr. 586, datë 30.08.2019 "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore"; Ligjit nr. 15/2019 "*Për nxitjen e punësimit*" neni 3, pikat 1,2,3,4 e në vijim;

Menaxhimi i Riskut

1. Në Bashkinë Prrenjas deri më 31.12.2025 nuk ka takime të dokumentuara të Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Grupit të Menaxhimit të Riskut lidhur me ushtrimin e rolit të tyre në kuadër të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke e kufizuar aktivitetin e tyre vjetor vetëm me takimet e zhvilluara për hartimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor;
- GMS dhe GMR përbëhen nga të njëjtët anëtarë, dhe referuar detyrave, përgjegjësive dhe rolit të secilit grup në njësinë publike, njehsimi i përbërjes së GMS dhe GMR paraqet risk në arritjen e objektivave të njësisë;
- Në Bashkinë Prrenjas GMS është kryesuar nga nënkryetari i bashkisë dhe jo nga kryetari i bashkisë si titullar i njësisë publike;
2. Në Bashkinë Prrenjas nuk ka një Plan të mirëfilltë të Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh), me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme për arritjen e objektivave;

Veprimtaritë e Kontrollit

1. Bashkia Prrenjas deri më 31.12.2025 nuk ka hartuar Gjurmët e unifikuara të Auditimit;
2. Sistemi i kontrollit dhe administrimit të teknologjisë së informacionit nuk është i plotë dhe nuk përmbush plotësisht kërkesat rregullatore dhe standardet përkatëse, konkretisht: nuk ka dhomë serverësh, nuk monitoron sistemin back up, nuk ka rregullore për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjeve IT, dhe në mungesë të saj nuk janë zhvilluar programe trajnimi me punonjësit, mungon dokumentimi i procedurave dhe veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave (incidenteve).
Mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar dhe Manualin MFK i ndryshuar; Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut*", Udhëzimit nr. 21 datë 25.10.2016 "*Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve*"; VKM nr. 710/2013 "*Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*"; "Rregullore për ndërtimin e dhomës së serverëve" hartuar nga AKSHI/2008; *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 1, faqe 21-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK dhe veçanërisht për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë nëpërmjet: krijimit dhe funksionalizimit të Grupit të Menaxhimit të Riskut si strukturë e veçantë nga GMS, riorganizimin dhe funksionimin e GMS duke ushtruar funksionin e kryetarit të këtij grupi, si dhe rritjes dhe forcimit të aktivitetit të GMS, GMR dhe Koordinatorit të MFK dhe Riskut; miratimit të gjurmëve të auditimit dhe planit vjetor të kontrollit të brendshëm me qëllim identifikimin, analizën dhe kontrollin e risqeve; forcimit dhe standardizimit në

implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT të avancuara, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit , informimit dhe monitorimit në Bashki.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandim: GMS, GMR, Koordinatori MFK dhe Koordinatori i Riskut të marrin masa për hartimin e planit strategjik dhe planit vjetor të aktiviteteve të tyre mbi çështjet që duhet të analizojnë dhe grafikun e takimeve që do realizojnë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator në mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës të çdo drejtorie dhe njësisë publike në tërësi, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3 Rekomandim: Drejtoria e burimeve njerëzore dhe prokurimit të marrë masa për të hartuar programe trajnimi mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen bazë të pajisjeve IT si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj duke zbatuar procedurat ligjore të punësimit, përditësimin e formularëve të përshkrimit të punës për pozicionet me Kod pune dhe dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që bashkisë i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së Njësisë së auditimit të brendshëm u konstatua se:

1. NJAB/Bashkia Prrenjas administron një regjistër risku të miratuar, por nga auditimi *rezultoi se* në planin strategjik e vjetor të auditimeve [2024-2025-2026] dhe [2025-2026-2027] nuk janë përfshirë auditime në fushën e prokurimeve publike, zbatimit të kontratave, sistemet e monitorimit me kamera etj., gjë që tregon se planifikimi i auditimeve nuk është bazuar në një vlerësim të plotë të riskut;

2. Nga auditimi i 9 dosjeve të auditimit të realizuara në vitin 2025, rezultoi se:

- Nga ana e subjekteve të audituara, nuk janë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor nga dorëzimi i RPA në subjektin e audituar, mosveprime në kundërshtim me Manualin AB miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, Kapitulli IV, paragrafi 4.1.12 Hapi 11;
- Nga NJAB nuk janë planifikuar dhe rrjedhimisht as zhvilluar angazhime "shërbime këshilluese" të cilat ofrojnë këshilla, lehtësira dhe orientime në fushat e kontrollit të brendshëm, kontrollit të menaxhimit financiar, etikës së institucionit, për vlerësimin e riskut etj. Mosveprimet nga ana e NJAB nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në Manualin e AB miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, Kapitulli II, paragrafi 2.4.5;

Mosveprimet nga NJAB janë në kundërshtim me Ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, neni 2, neni 6, neni 9 si dhe "Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" i ndryshuar, kapitulli II paragrafi 2.1, kapitulli III. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 1, faqe 21-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Njësia e Auditimit të brendshëm të marrë masa që planifikimi strategjik dhe vjetor i auditimit të bazohen në një vlerësim të plotë dhe objektiv të riskut, duke përfshirë misione auditimi në fushat me risk të lartë, me qëllim ofrimin e sigurisë së arsyeshme për efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe përmirësimin e menaxhimit të njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi, kundrejt plani të rishikuar gjatë vitit në vlerën 1,329,712 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 1,058,747 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 270,965 mijë lekë ose 20% e totalit të shpenzimeve të planifikuara. Mosrealizimi rezultoi kryesisht në shpenzimet operative, me 51,050 mijë lekë, pasi nga 137,206 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 86,156 mijë lekë, ose 63%, si dhe në shpenzimet për investime, me 134,472 mijë lekë, pasi nga 352,305 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 217,833 mijë lekë, ose 62%. Mosrealizimi i shpenzimeve për investime lidhet me lidhjen e kontratave në fund të periudhës buxhetore, duke sjellë shtyrjen e likuidimit të tyre në vitin pasardhës dhe, për rrjedhojë, ndikim në realizimin e shpenzimeve brenda vitit buxhetor dhe në ofrimin në kohë të të mirave publike për komunitetin. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar neni 5, germa **"a".** *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 48-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Prrenjas nëpërmjet strukturave përgjegjëse, gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programeve buxhetore afatmesëm, të bazohet në parashikimet reale të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm, duke pasur në konsideratë mosrealizimin e të ardhurave dhe analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime.

Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 17,346,680,860. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari është kontabilizuar vlera 2,770,029 lekë për shpenzime "Prodhim, transport dhe stivim dru zjarri" si shtesa aktivesh duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione", në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b). *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Prrenjas të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të inventarit kontabël në llogarinë 211 "Pyje, kullota plantacione" të vlerës 2,770,029 lekë që janë shpenzime për prodhim , transport dhe stivim dru zjarri.

Menjëherë.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" paraqitet në vlerën 759,238,243 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari vlera prej 42,919,940 lekë nuk është e analizuar me objekte, nuk ka regjistër me të dhëna për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare për kryerjen e inventarit fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar,

Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b). *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiarë dhe Shërbimeve Sociale, Bashkia Prrenjas, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me vlerë kontabël (kosto-amortizim/provigjone) është larg vlerës reale të tyre. Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 0 – 8,025 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105 "Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar" dhe Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël). *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për rivlerësimin e aktiveve të klasifikuara në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" si dhe sistemimin e veprimeve kontabël pas rivlerësimit të tyre.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 213 "*Rrugë rrjete vepra ujore*" referuar analizës së inventarit kontabël të kësaj llogarie konstatohet se, nuk është zbritur vlera prej 215,844,097 lekë, për 22 artikuj kontabël për ujësjellës-kanalizimeve, që sipas VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" duhej transferuar në Ujësjellës Kanalizime Pogradec, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 57-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" SH.A, të 22 artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 215,844,097 lekë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Blerje karburant me lote – Loti 1: Naftë"***, rezultoi se Drejtoritë/Sektorët e Bashkisë administrojnë dhe paraqesin kërkesat për nevojat e tyre për karburant, të cilat shërbejnë si bazë për përllogaritjen e fondit limit dhe planifikimin e procedurës së prokurimit, por konstatohet se kërkesat e paraqitura përmbajnë vetëm vlerën financiare të nevojës për karburant, pa specifikuar sasinë e kërkuar (në litra) dhe pa

u shoqëruar me një argumentim ose përllogaritje të bazuar në konsumin real, aktivitetin e planifikuar apo të dhënat historike të konsumit. Mungesa e përcaktimit të sasive konkrete kufizon gjurmueshmërinë dhe verifikueshmërinë e procesit të planifikimit të nevojave, duke e bërë të vështirë vlerësimin nëse fondi limit dhe sasia e planifikuar janë ndërtuar mbi nevoja reale dhe të dokumentuara. Mangësitë e mësipërme, janë në kundërshtim me nenin 21 pika 2 të Ligjit me nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe nenin 2 pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor dhe komisionet e përfshira për përllogaritjen e fondit limit, të marrin masa që, në procedurat e planifikimit të nevojave për karburant, çdo Drejtori/Sektor, gjatë paraqitjes së kërkesave për prokurim, të dokumentojë vlerën financiare dhe sasinë e kërkuar të karburantit (në litra), të mbështetur në analizën e konsumit historik, numrin dhe llojin e mjeteve, aktivitetet e planifikuara dhe nevoja të tjera objektive.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"**Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik)**"*, me FL 8,754 mijë lekë, u konstatua mangësi në hartimin e specifikimeve teknike, konkretisht në përcaktimin e disa parametrave teknikë të mjetit:

Në dokumentet e procedurës rezultoi se është kërkuar gjatësia maksimale e mjetit **6,223 mm**, pa u shoqëruar me argumentim teknik apo funksional që të justifikojë domosdoshmërinë e këtij kufizimi, duke mos evidentuar nevojat konkrete të autoritetit kontraktor apo kushtet specifike të përdorimit të mjetit që do të impononin një parametër të tillë.

Gjithashtu, është kërkuar që koha e kompresimit të jetë **fikse 35 sekonda**, ndërkohë që ky parametër teknik duhej të ishte përcaktuar në formën e një intervali ose me vlera të arsyeshme tolerance, në mënyrë që të lejonte pjesëmarrjen e mjeteve me karakteristika të ngjashme teknike, të afta për të përmbushur të njëjtin funksion.

Përcaktimi i këtyre parametrave pa argumentim teknik nuk rezultoi të jetë mbështetur në një analizë të dokumentuar të nevojave funksionale të autoritetit kontraktor, duke krijuar kufizime të panevojshme në hartimin e specifikimeve teknike.

Sa më sipër, hartimi i këtyre specifikimeve teknike nuk rezulton i mbështetur në argumentim të mjaftueshëm teknik dhe funksional, duke mos qenë në përputhje me kërkesat e nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe pikës 2 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për forcimin e kontrolleve në fazën hartimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, duke siguruar që kriteret dhe karakteristikat teknike të jenë të argumentuara, objektive dhe proporcionale. Të shmanget përcaktimi i parametrave teknikë me kufizime të panevojshme ose vlera fikse me përjashtim të rasteve kur këto mbështeten me analizë dhe dokumentacion teknike përkatës.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 7 raste për procedura të realizuara nga Bashkia Prrenjas me fond limit 339,740 mijë lekë pa TVSH, u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, konkretisht në procedurat:

- *"Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë*" e vitit 2024 me FL 142,631 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas*" – e vitit 2024 me FL 17,507 mijë lekë;
- "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas*" – e vitit 2024 me FL 16,709 mijë lekë;
- "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"*, - e vitit 2025 me FL 80,783 mijë lekë;
- *"Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas"* – e vitit 2025 me FL 17,387 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas",* - e vitit 2025 me FL 32,570 mijë lekë;
- *"Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara"*, - e vitit 2025 me FL 32,153 mijë lekë;

Mangësitë konsistojnë në kërkesat e kategorisë së licencës NP-12 për punime të cilat nuk kanë për objekt "*Punimet e inxhinierisë së mjedisit",* kërkesat për dëshmitë e sigurimit teknik të lëshuara nga ISHTI ose institucionet e autorizuara, ndërkohë objekti për të cilin lëshohen këto dëshmi nuk lidhet me profilet e punonjësve dhe zërat e punimeve që ata kryejnë, kërkesa për kontrata furnizimi me prodhues ose distributor për produkte të cilat gjenden lehtësisht në treg, kërkesa për deklarimin e drejtuesit teknik të pa angazhuar në kontrata të tjera për punime me vlerë nën 30 milion lekë, kërkesa për numër të lartë inxhinierësh që të figurojnë njëkohësisht në listëpagesat e shoqërisë, kërkesë e dublikuar për tipologjinë e mjetit, janë kërkesa të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurave të zhvilluara, veprime jo në përputhje me ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2 "Qëllimi, neni 21 pika 6 "Autoriteti ose enti kontraktor", neni 77 "Kërkesat për kualifikim", si dhe neni 39, 40, 41, 73, 74 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit, të marrë masa për përzgjedhjen e zyrtarëve pjesëmarrës në proces, duke siguruar që ata të jenë specialistë të fushës përkatëse. Gjithashtu Njësia e Prokurimit të marrë masa që kërkesat, specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht, të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 15 procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Prrenjas përgjatë periudhës 01.01.2024 deri më 31.12.2025, në 4 raste me vlerë totale të lidhjes së kontratave prej **227,568 mijë lekë**, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së disa kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, konkretisht në procedurat me objekt,
- *"Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë"* – e vitit 2024 me fitues OE "E." shpk me vlerë kontrate 128,614 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2024 me fitues OE "O." shpk me vlerë kontrate 11,452 mijë lekë;

- *"Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2025 me fitues OE "M." shpk me vlerë kontrate 61,945 mijë lekë;
- *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"* – e vitit 2025 me fitues "K." shpk me vlerë kontrate 25,557 mijë lekë;

Mangësitë konsistojnë në mos përmbushje të kritereve për likuidimin e taksave dhe detyrimeve vendore, ku OE shmangin hapjen e NIPT-e sekondare dhe likuidimin e detyrimeve, mangësi me autorizimet e prodhuesve ose dokumente në gjuhë të huaj e të pa përkthyera, mangësi në dokumentacion e mjeteve, mangësi në kapacitetin e mjeteve.

Kualifikimi i OE në këto procedura është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2023, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 *"Qëllimi"*, neni 3 "*Parimet të përgjithshme"*, nenin 21 pika 5 "Autoriteti ose enti kontraktor", nenin 87 *"Kriteret për shpalljen e ofertës fituese"* pika 3*",* neni 92, *"Shqyrtimi i ofertave". (Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mos realizimin me sukses të kontratës.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik me objekt *"Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas"* dhe *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas"*, ka rezultuar vonesë në përfundimin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO, duke tejkaluar afatin prej 15 ditësh të përcaktuar për procedurat nën kufirin e lartë monetar, mangësi e ardhur si pasojë e mungesës së administrimit në kohë të procesit të vlerësimit nga KVO. Vonesa e konstatuar ndikon negativisht në miradministrimin e procedurave të prokurimit publik, duke shtyrë afatet për lidhjen e kontratave dhe fillimin e zbatimit të tyre, si pasojë e së cilës cenohet realizimi në kohë i investimeve dhe përfitimi në kohë i shërbimeve, veprim në kundërshtim me nenin 82, pika 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.*2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. (Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas, personat e ngarkuar si anëtarë të Komisionit për Vlerësimin e Ofertave, të marrin masa për kryerjen e vlerësimit të ofertave brenda afatit, ky jo vetëm si detyrim ligjor, por për të shmangur çdo vonesë të paargumentuar që lidhet me shpenzimin e planifikuar nga Bashkia Prrenjas.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi programimin e nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve /Blerjet me vlerë të vogël, u konstatua se:

- Bashkia Prrenjas për vitin 2024 ka bërë 3 ndryshime dhe për vitin 2025 ka bërë 12..dryshime në regjistrin fillestar të parashikimeve; Ndryshimet në regjistrat e Planifikimit janë miratuar nga Titullari pa një relacion shpjegues, ku të pasqyrohej nevoja për kryerjen e procedurës dhe të argumentohej pamundësia për parashikim, mosveprime në mospërputhje me VKM nr. 285/2021

"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu I, neni 1 pika 2; kreu II, neni 3 pika 7.
-Për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar në 2 raste copëzim i fondit, konkretisht 1 rast për vitin 2024 për proceduarat me *"Blerje materiale për riparime, sistemime dhe mirëmbajtje rrjetit ujitës dhe kullues"* dhe *"Mbrojtja dhe rehabilitimi i tokave të dëmtuara, ndërtim i mureve mbajtëse dhe argjinaturave të ndryshme"* me FL 1,164,667 lekë;
Për vitin 2025 janë procedurat me objekt *"Blerje pajisje mobilierie për kopshtin Sutaj"* dhe *"Blerje dhe mirëmbajtje orendish për çerdhe dhe kopsht Bashkia Prrenjas"* me FL 1,050,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 dt. 23.12.2020 "Mbi prokurimin publik" i ndryshuar; VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 2, neni 13 dhe neni 15 dhe pikën 5 të Udhëzimit nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
13.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të marrë masa që, çdo njësi shpenzuese të parashikojë mallra, shërbime apo punë sipas nevojave reale, duke hartuar regjistrin e parashikimeve në përputhje me këto nevoja, si dhe që çdo ndryshim në regjistrin e parashikimeve të dokumentohet dhe argumentohet me relacion shpjegues dhe të miratohet nga titullari i autoritetit kontraktor.
13.2. Rekomandimi: Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël të marrë masat për planifikimin dhe trajtimin e konsoliduar të nevojave për mallra të të njëjtit lloj apo shërbime të së njëjtës tipologji me procedurë prokurimi blerje me vlerë të vogël, me qëllim parandalimin e veçimit të fondeve në procedura të veçanta kur vlera totale e tyre e tejkalon fondin limit prej 1,000,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit blerje në vlerë të vogël të përzgjedhura për periudhën 2024 – 2025 dhe i dokumentacionit përkatës, rezultoi se: fleta e inventarit të dosjes mungonte në të 8 procedurat, në 1 rast nuk është respektuar subjekti i radhës i cili i është nënshtruar procedurës së shortit, vërtetim mbi detyrimet tatimore në njësinë e vetëqeverisjes vendore mungon në 4 raste; raporti përmbledhës dhe deklarata e konfliktit të interesit të OE fitues mungonin në të gjitha rastet. Mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu I neni 1, neni 2/pika 1 e 2, neni 84. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 77-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1. Rekomandim: Komisioni i procedurave të prokurimit blerje në vlerë të vogël të dokumentojë dhe të administrojë në dosjen e procedurës BVV çdo hallkë të procesit sipas kërkesave ligjore dhe të urdhrit të prokurimit, të bëjë inventarizimin e plotë të dokumentacionit të dosjes së procedurave të prokurimit blerje në vlerë të vogël, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, transparencës dhe ligjshmërisë së procedurës së realizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Prrenjas, u konstatua se ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë me detyrimet që përcakton ligji, si vijon:
- Struktura e IMTV-së nuk është organizuar në përputhje me dispozitat ligjore, pasi 1 nga ish – Kryeinspektorët, dhe 1 Inspektor nuk kanë arsimin e nevojshëm;

- Për periudhën objekt auditimi janë mbajtur **52** procedura për ndërtimet dhe punimet pa leje, nga të cilat **12** procedura për vitin 2024 dhe **40** procedura për vitin 2025, nga ku rezulton se në **8** raste për vitin 2024 dhe në **2** raste për vitin 2025, mungon masa administrative e gjobës.
- Në të gjitha rastet e vendosjes së gjobave për ndërtimet pa leje, nuk dokumentohet përllogaritja e saj duke mos përcaktuar vlerën e punimeve të kryera pa leje sipas preventivit përkatës si dhe duke mos evidentuar sipërfaqet e këtyre ndërtimeve. Referuar procesverbaleve të konstatimit dhe vlerës së gjobave të vendosura për ndërtimet pa leje, rezultojnë jo në përputhje me aktet ligjore, konkretisht nenin 52 pika 1 germa (e) të Ligjit Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.
- Kryeinspektori ka miratuar vetëm 2 akte kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, ndërkohë për lejet tjera të pajisura me leje ndërtimi nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli;
- Kryeinspektori, ka miratuar planet mujore të punës nga periudha Maj 2025 e në vijim ndërkohë për periudhat e mëparshme mungojnë planet mujore të punës;
- Kryeinspektori, ka përcjellë për periudhën objekt auditimi vetëm 5 kallëzime penale, ndërkohë për pjesën tjetër të kundërvajtjeve mungojnë kallëzimet penale për subjektet kundërvajtës;
- Me përjashtim të një rasti, në të gjitha procedurat mungojnë fotografitë e konstatimit të kundërvajtjes;
- Për periudhën objekt auditimi, nuk disponohej informacioni periodik 3 – mujor drejtuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për masat e marra;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, neni 5 germat (a, dh, f), neni 11 të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar, neni 51, neni 52 pika 1 germa (e), Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 41, si dhe me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore". *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 6, faqe 192-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke siguruar përbërjen e tij me specialistë të kualifikuar, kryesisht të profilit inxhinierik, me qëllim garantimin e kryerjes së inspektimeve dhe verifikimeve teknike në përputhje me kërkesat ligjore dhe rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të lejeve të ndërtimit.

15.2. Rekomandimi: Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrin masa për aplikimin e gjobave duke u bazuar në përllogaritjen sipas vlerës së punimeve ose minimumit të përcaktuar për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe dokumentimin e kësaj përllogaritjeje.

-Kryeinspektori i IMTV në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të përgatisin kallëzimet penale përkatëse për subjektet kundërvajtës.

15.3. Rekomandimi: Struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të marrë masa për ri-inspektimin dhe përcaktimin e tipologjisë për objektet për të cilat nuk është nxjerrë masa e gjobës, si dhe të bëhen përllogaritjet përkatëse për përcaktimin e masës administrative të gjobës për këto subjekte, si dhe në çdo rast të mbajtjes së procesverbalit të konstatimit për objektet/punimet pa lejen përkatëse të ndërtimit, të mirëpërcaktohet tipologjia e çdo ndërtimi (banim ose qëllim fitimi) të konstatuar.

15.4. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV, të vijojë me përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës si dhe të përgatis informacionin periodik tre mujor për Inspektoratin Kombëtar të

Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat e mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.
-Të evidentohet në mënyrë të plotë e gjitha procedura duke i pasqyruar edhe me elementët fotografik, për dokumentimin e situatës.

Në vijimësi

16. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e marra nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Prrenjas për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi konstatohet se:
- Janë proceduar gjithsej **52** subjekte për ndërtime dhe punime pa leje ndërtimi, si dhe për objektet në shkelje të lejes së ndërtimit nga të cilat **12** raste për vitin 2024 dhe **40** raste për vitin 2025 për të cilat në **39** raste është nxjerrë vendimi për "Prishje të Objektit të Kundërligjshëm", nga të cilat janë **3** vendime për vitin 2024 dhe **36** vendime për vitin 2025.
-Në **7** raste të cilat përkojnë me vitin 2024, Kryeinspektori nuk ka nxjerrë "Vendim për Prishje";
-Në **30** raste, "Vendimi për Prishje" pavarësisht se është hartuar, nuk është firmosur nga Kryeinspektori si dhe nuk ka vulën e institucionit;
-Në **39** raste, nga Kryeinspektori i IMTV-së nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e "Urdhrit të Ekzekutimit për Prishjen e Objektit të Kundërligjshëm", që do të thotë se objektet e konstatuara të Kundërligjshëm për të cilat ka një vendim prishjeje vijojnë të pa ekzekutuara nga IMTV-ja e Bashkisë Prrenjas.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 5, pika (d) të ligjit nr. 9780/ 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar; nenin 52 (6) i Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar; pikën 1 (b)/(iv) dhe 4 të Vendimit nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore". *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 6, faqe 192-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV-së Bashkia Prrenjas, të marrë masa për vijimin e procedurës për nxjerrjen e Vendimit për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm", për 7 subjekte që janë me procesverbal konstatimi për objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi dhe të nxjerrë "Urdhër Ekzekutimi" për prishjen e objekteve të kundërligjshëm për 39 subjekte që janë me Vendim për "Prishje Objekti të Kundërligjshëm". Kryetari i Bashkisë, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatuan disa mangësi si më poshtë:
-Në 8 raste mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve për ushtrimin e aktivitetit për hartuesit e projekteve ndërtimore;
-Në 4 raste, konstatohen mangësi me Planvendosjen si mos pozicionimi saj mbi rilevimin topografik, mos pasqyrimi i aksesit për në objekt, mos pasqyrimi i kateve të objekteve me të cilën kufizohet aplikanti;
-Në 5 raste konstatohen mangësi me Projektin Arkitektonik, pasi ai paraqitet i pa plotë, duke mos pasqyruar prerjet dhe fasadat teknike;
-Në 5 raste kartelat e pasurisë nuk janë të rifreskuara 3 muajt fundit;
-Në 1 rast, mungon kopja e policës së sigurimit të projektuesit për mbulimin e përgjegjësisë profesionale;
-Në 8 rastet e audituara, mungon projekti për eficiencën energjetike;

-Në 8 rastet e audituara, përgjithësisht mungojnë Mendimet e Institucioneve të cilat duhet të shprehen përpara miratimit të lejes së ndërtimit;
-Në 2 raste, konstatohen mangësi me distancat e objektit me kufirin e pronës;
-Në 8 raste mungojnë projektet në DWG.
Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me pikën nenin 52 pika 1 germa (c) të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar; nenin 1, germa (a, c, ë, g) të nenit 15, neni 21 pika 6, neni 45 germa (c) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar; Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6; VKM-së nr. 457 datë 29.06.2022, Neni 18 dhe 21, Neni 57 pika 10 e Rregullores së Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Prrenjas, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit me nr. 3, datë 14.04.2017. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 5, 186-192 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Aplikimit të Projekteve dhe Pronave, të marrë masa që, para miratimit të lejeve të ndërtimit, të verifikohet dhe dokumentohet plotësisht përmbushja e të gjitha kërkesave ligjore dhe procedurale, përfshirë përditësimin e dokumentacionit kadastral, saktësinë e planvendosjeve, licencimin e projektuesve, saktësinë e projekteve arkitektonike dhe disponimin e projekteve të eficiencës energjetike si dhe respektimin e distancave, me qëllim garantimin e ligjshmërisë së procesit.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (aseteve dhe pyje e kullota) të transferuara sipas VKM u konstatua se:
1. Menaxhimi i pronave të transferuara me VKM dhe i aseteve në Bashkinë Prrenjas nuk mbështetet nga një strukturë e dedikuar, por nga punonjës me funksione të tjera të organizuar si "Struktura e posaçme e administrimit të pronës", ndërsa vetëm një specialist është caktuar për këtë proces, duke kufizuar efektivitetin e administrimit të pronave, mosveprim në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 3, neni 9 pika 1/c dhe neni 27;
2. Bashkia Prrenjas dhe Struktura e posaçme e administrimit të pronës nuk kanë hartuar një plan pune vjetor për verifikimin në terren të pronave të transferuara me VKM, duke realizuar certifikimin e atyre pronave për të cilat është paraqitur kërkesë për zhvillimin e saj.
Mungesa e verifikimit të plotë në terren të pronave ka sjellë mospërputhje ndërmjet numrit të pronave të evidentuara në listën bashkëlidhur VKM-ve dhe informacionit të raportuar nga SPAP si dhe mos regjistrimin e plotë të tyre në regjistrin ekonomik të pasurive të paluajtshme nga drejtoria e financës dhe buxhetit;
Mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, Ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*" i ndryshuar, Ligjin nr. 10296/2010 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar;
3. Nga Bashkia Prrenjas dhe SPAP nuk është miratuar asnjë plan vjetor dhe strategjik mbi pajisjen e aseteve me certifikatë pronësie, ku të përcaktohen kriteret orientuese për përzgjedhjen e atyre prioritare veçanërisht ato arsimore e shëndetësore, si dhe afati kohor për përmbylljen e kësaj procedure, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2011 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Kreu II neni 8 pika 8 dhe Manualin MFK i ndryshuar, Kap. 2../Kap 2.4.1, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i

ndryshuar si dhe Udhëzimeve të MARS dhe MSHMS: Udhëzimi i MARS nr. 30 datë 12.09.2014 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit parashkollor"; Udhëzimi i MARS nr. 18 datë 04.05.2018 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve arsimore të arsimit profesional dhe konviktet"; Udhëzimi i MSHMS nr. 12 datë 20.03.2015 "Për pajisjen me Certifikatë pronësie të objekteve qendrave shëndetësore dhe ambulancave" etj.

4. Numri i pronave të pajisura me certifikatë pronësie rezulton i ulët. Gjithashtu nuk është përcaktuar një objektiv vjetor për numrin e procedurave që duhet të përfundohen, ndërsa performanca ka shënuar rënie nga viti në vit, duke dëshmuar një ecuri me efektivitet të ulët të procesit.

5. Nga Struktura e posaçme e administrimit të pronës nuk është bërë asnjë inspektim në terren i apartamenteve të pajisura me certifikatë pronësie, me qëllim komunikimin dhe orientimin e banorëve të akomoduar në këto apartamente për nisjen e procedurave të privatizimit, duke mundësuar fitimin e të drejtës së pronësisë.

- Njëkohësisht, mungesa e këtyre veprimeve ka penguar edhe identifikimin dhe aplikimin e saktë të taksa e tarifave vendore në dobi të interesave financiare të bashkisë.
- Nga ana Strukturës së posaçme nuk është ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin dhe verifikimin në terren të pronave me qëllim fillimin e procedurave të regjistrimit në ASHK të apartamenteve të ndërtuara nga ish-ndërmarrjet, të cilat faktikisht janë në përdorim nga banorët.

Mosveprimet nga ana e Bashkisë Prrenjas dhe e SPAP janë në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*" i ndryshuar, neni 1, neni 5, neni 7 dhe neni 10, VKM nr. 179/2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "*Për privatizimin e banesave shtetërore*" i ndryshuar, dhe të Ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "*Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore*" i ndryshuar; *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 7, faqe 202-209 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për forcimin e kapaciteteve ekzistuese ose krijimin e një strukture të dedikuar për verifikimin në terren, regjistrimin, administrimin, monitorimin dhe kontrollin e pronave të transferuara me VKM dhe aseteve publike në Bashkinë Prrenjas.

18.2. Rekomandim: Struktura e posaçme e administrimit të pronës të marrë masat:

- Për hartimin e një plani pune për verifikimin në terren të pronave të transferuara me VKM, për saktësimin e numrit dhe statusit fizik e juridik të tyre, me qëllim edhe plotësimin e regjistrit ekonomik të pasurive nga drejtoria e financës;
- Për hartimin e grafikut të përgatitjes së praktikave dokumentare të pajisjes me certifikatë pronësie të pronave sipas llojit, funksionit dhe rëndësisë së tyre;
- Fillimin e procedurës së privatizimit të pronave që janë objekte banimi të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie;
- Verifikimin në terren dhe sensibilizimin e komunitetit, banorë në objektet e banimit të ndërtuara nga ish ndërmarrjet, për regjistrimin, pajisjen me certifikatë pronësie në ASHK dhe procedurës së privatizimit të tyre;

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike , u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Prrenjas, për 6 objekte infrastrukturore të audituara (rikonstruksion rrugësh), të cituara në Aneksin nr.12, bashkëlidhur, nuk është marrë Oponenca Teknike, në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.

8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të marrë masa për pajisjen me Oponencë Teknike të çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit dhe kushtet teknike të zbatimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë në RPA me shkresën e saj nr. 403/9 prot., datë 22.10.2025, konstatohet se është një numër i vogël masash, për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit"*, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht:

a. Masa Organizative janë lënë 33 masa që janë pranuar 33 masa nga subjekti, nga të cilat: 13 masa janë zbatuar, 17 masa janë në proces zbatimi, 3 masa janë pjesërisht zbatuar dhe 0 masa pa zbatuar; **rikërkohen 3 masa të cilat janë zbatuar pjesërisht;**

b. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj. (të ardhura të munguara) janë lënë 6 masa në vlerën totale 97,796,446 lekë (pa kamatë) ose 103,063,541 lekë (me kamatë) që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat: 5 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe **rikërkohet 1 masë pjesërisht e zbatuar**;

c. Masa disiplinore është lënë 1 masë për 4 punonjës e cila është pranuar dhe është zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 209-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan pjesërisht zbatuar si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Masa organizative

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas të marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit, i cili në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve Sociale, të saktësojnë në mënyrë të detajuar në sasi dhe vlerë llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe llogarinë 211"Pyje, kullota, plantacione".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të viti 2026

Masa për shpërblim dëmi

11/6.2 Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 4,170,770 lekë ndaj subjektit "L. B. dhe E. B." për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

11/6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve Bashkia Përrenjas, të marrë të gjitha masat duke zbatuar të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për nxjerrjen dhe kontabilizimin e detyrimeve për tarifën e *"Mjedisit"* dhe tarifën e *"Pastrimit"* për 25 subjektet në vlerën **4,490,000 lekë**, respektivisht:

-Vlera 700,000 lekë për 2 subjekte HEC. (Grupi I-"B. 17" dhe "R. E.)

-Vlera 2,250,000 lekë për 9 subjekte me lloj aktiviteti si, karrierë guri, inerte etj. (Grupi II- Neg 2018, F.-A. B., K. 2, B X, D. EnE. &T., E., L. B., A., E.-F.);

-Vlera 1,540,000 për 14 subjekte me veprimtari Hec, Gurore, Minierat dhe Nyje betoni etj. (Grupi III- N. 20., F.-A. B., K..2, L. B., T., P. 20.., E. T., B. 20, E., K., S. & D., S. & R, E. H., M. F. N.)

Menjëherë

Masa për uljen e borxhit tatimor

6.1.Rekomandimi: Bashkia Prrenjas, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për llogaritjen e penalitetit të taksës vjetore të mjeteve të transportit rrugor në vlerën 3,072,588 lekë, arkëtimin dhe të kryejë kontabilizimin e saj.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*" nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 93, Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Nëpunësin zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit në vlerën **6,763,485 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Asfaltim i rrugës së fshatit Kotodesh*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "I. - 8" SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 436 prot, datë 09.02.2023, me vlerë 12,410,031.9 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA me afat 3 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **175,678 lekë pa TVSH** në 3 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **175,678 lekë** pa TVSH, nga OE "Rr. U. A. Nr. 2 E." SHA , për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", Bashkia Prrenjas*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "G. C. E." SHPK, rezultoi se në përfundim të

procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 3025 prot, datë 06.11.2023, me vlerë 39,444,209 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "I..." SHPK me afat 6 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **1,138,336 pa TVSH** në 4 banesa. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. (M*ë hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,138,336 lekë** pa TVSH, nga OE "I..." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës së fshatit Gurrë, NJA Qukës*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "G. C. E." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 613 prot, datë 11.03.2025, me vlerë 48,333,972.82 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "R." SHPK me afat 5 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **1,713,914 pa TVSH** në 5 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,713,194 lekë** pa TVSH, nga OE "R.." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Rrashtan*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "A.-V." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 508 prot, datë 16.02.2023, me vlerë 34,826,282.4 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia

Prrenjas dhe OE "K." SHPK me afat 4 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **850,820 pa TVSH** në 5 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **850,820 lekë** pa TVSH, nga OE "K." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksion i shkollës së mesme "Dalip Toçka" Kotodesh*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "Z." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 815 prot, datë 07.03.2024, me vlerë 25,912,506 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe BOE "M." SHPK & L. K." SHPK me afat 8 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **352,492 pa TVSH** në 12 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **352,492 lekë** pa TVSH, nga BOE "M." SHPK & Lis Konstruksion" SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Ndërtimi i shkollës së mesme "Sali Halili", Rrajcë Fushë*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë BOE "M. Ch. SHPK & H. C." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 2598 prot, datë 11.10.2024, me vlerë 151,856,222 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "E." SHPK me afat 12 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura

në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **576,405 pa TVSH** në 6 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **576,405 lekë** pa TVSH, nga OE "E." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksioni i kanalit të Lingajcës, Faza II", Rrajcë Fushë*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "L. G." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 2849 prot, datë 06.11.2024, me vlerë 13,742,911 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "O." SHPK me afat 1 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **516,000 pa TVSH** në 1 zë pune. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **516,000 lekë** pa TVSH, nga OE "O." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksioni i kanalit të Xhelos, Faza II dhe sistemimi i ujërave të larta në Krastën e Prrenjasit*", me mbikëqyrës punimesh shoqërinë OE "L. G." SHPK, rezultoi se në përfundim të procedurës përkatëse të prokurimit është lidhur kontrata e sipërmarrjes më nr. 2705 prot, datë 24.10.2024, me vlerë 14,505,977 lekë me TVSH, ndërmjet AK Bashkia Prrenjas dhe OE "A. I." SHPK me afat 3 muaj. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar, librezën e masave dhe vizatimeve sipas sipas faktit, si dhe nga verifikimi në terren, janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit shuma prej **387,800 pa TVSH** në 2 zëra punimesh. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë

10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, neni 7/1, VKM nr.610, datë 22.09.2022 "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*", neni 1 dhe 12, si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 148-186 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Bashkia Prrenjas, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe, sipas rastit, procedurat në të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **387,800 lekë** pa TVSH, nga OE "A. I." SHPK, për diferencat e konstatuara në volumet e punimeve të likuiduara dhe të pakryera në fakt.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të vitit 2024 me objekt *"Blerje kamioni për mbetjet urbane (Mjeti Teknologjik)"*, me fond limit prej 8,754,458 lekë dhe vlerë kontrate 8,490,000 lekë me fitues OE "T." shpk, u konstatua se operatori ekonomik ka dorëzuar mjetin me 31 ditë vonesë, për të cilin duhet të mbahej penaliteti i cili sipas përllogaritjeve rezulton në vlerën **1,052,760 lekë,** vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Prrenjas, *veprim në kundërshtim me nenin 17 "Dëmet e likuiduara" pika 17.1 të Kontratës me nr. 1943 prot., datë 16.07.2024. (Më hollësisht janë trajtuar në pikën 4, faqe 78-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Prrenjas në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **1,052,760 lekë**, që përfaqëson penalitetin e paaplikuar për vonesën në përmbushjen e kontratës nr. 1943 prot., datë 16.07.2024, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, u konstatua se në fund të periudhës rezultojnë debitorë progresivë 261 subjekte për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 27,795,242 lekë, nga të cilat 13,896,788 lekë i përkasin vitit 2025; 5,415 familje për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 61,122,267 lekë, nga të cilat 12,138,013 lekë i përkasin vitit 2025; si dhe debitorë për tarifën e regjistrimit në kopshte dhe çerdhe në vlerën 1,016,760 lekë. Debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 89,934,269 lekë, **nga e cila vlera prej 27,051,761 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë ",** në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*". *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 48-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksa e tarifa vendore për 261 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 5415 familje, me vlerë 89,934,269 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 1,942,440 lekë për gjatë vitit 2025, janë shtuar detyrimet në shumën 2,219,268 lekë dhe janë arkëtuar detyrime në vlerën 1,342,557 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **92 objekte të personave** në vlerën 2,819,151 lekë, **nga e cila vlera prej 2,219,268 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3/c. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 48-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 92 persona me vlerë 2,819,151 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të autorizimeve/licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, u konstatua se, pavarësisht njoftimit për shlyerjen e detyrimit në vlerën 900,000 lekë ndaj subjektit "L. B.", me shkresën nr. 55 prot., datë 07.01.2026, dhe kërkesës për bllokim të llogarisë bankare për shlyerjen e detyrimit në vlerën 900,000 lekë ndaj subjektit "B. G", me shkresën nr. 1536/3, datë 24.05.2022, këto detyrime nuk janë likuiduar gjatë periudhës objekt auditimi. Në total, detyrimet e paarkëtuara nga këto dy subjekte rezultojnë në vlerën **1,800,000 lekë, duke përbërë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Prrenjas.** Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, nenin 35, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*", i ndryshuar. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 48-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Sektori Taksave e Tarifave Vendore, Bashkia Prrenjas, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për pajisjen me Autorizim/Licence për shitje karburanti nga 2 subjekte të vlerës 1,800,000 lekë.

Menjëherë

4. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi për vendimet e gjobave të nxjerra nga IMTV për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2025, rezultoi se janë nxjerr 41 vendime gjobash në vlerën **18,940,000 lekë**, nga të cilat janë likuiduar 5 gjoba në vlerën **1,220,000 lekë**, ndërsa 3 gjoba për vlerën **1,020,000 lekë,** janë falur në zbatim të Ligjit nr. 127/2024 *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.....",* neni 2 dhe pika 3 e VKM-së nr. 274, datë 09.05.2025 *"Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të pa ekzekutuara".* Lidhur me gjobat e mbetura për vlerën **16,700,000 lekë,** rezultoi se nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e tyre si dhe për dërgimin e kërkesave drejtuar gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, veprim në kundërshtim me nenin

30 pika 4 germa (b) të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 6, faqe 192-201 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marra masa për përgatitjen e kërkesë padive për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, si dhe për ndjekjen e procedurave ligjore dhe administrative për arkëtimin e tyre, në vlerën 16,700,000 lekë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar nenin 58 "*Llojet e masave disiplinore*" dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore **"Vërejtje", për 15 punonjës** si vijon:

1. Zj. Z. Ç., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësitë në procedurat e prokurimit:

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë",*'
2. "*Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas*";
3. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas*";
4. "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas*";
5. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas";*
6. "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara";*

për hartimin e kritereve kualifikuese në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2. Zj. M. P.*,* me detyrë Përgjegjës Sektori në Sektorin e planifikimit të Territorit, Administrimit të lejeve/legalizimet dhe regjistrimit të pronave, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit**:**

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë",*'
2. "*Rikonstruksion i kanalit të "Xhelos" faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas*";
3. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas*";
4. "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas*";

për hartimin e kritereve kualifikuese në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

3. Z. E. B.*,* në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë",*'
2. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas*";

3. “*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas*”;
4. “*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas”;*
5. “*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;*
për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
4. Zj. R. D.*,* me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik dhe të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:
1. “*Ndërtim i shkollës së mesme “Sali Halili” 3kat, Rrajcë Fushë”;*
2. “*Rikonstruksion i kanalit të “Xhelos” faza e II (dytë) dhe sistemim i ujrave të larta në Krastën e Prrenjasit, Qyteti Prrenjas*”;
3. “*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas*”;
4. “*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas”;*
5. “*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”;*
për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
5. Zj. N. B., në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:
1. “*Ndërtim i shkollës së mesme “Sali Halili” 3kat, Rrajcë Fushë”;*
për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
6. Z. G. B., me detyrë Specialist në Sektorin e Planifikimit, hartimit dhe Implementimin e Projekteve, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:
1. “*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas*”;
për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
7. Z. Xh. Xh., me detyrë Përgjegjës në Sektorin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:
1. “*Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas*”;
për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.
8. Z. S. H., me detyrë Specialist në Sektorin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në cilësinë e anëtarit të NJP, për mangësinë në procedurat e prokurimit:
1. “*Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas*”;

për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pikës 3 të nenit 40 dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

9. Zj. M. R., me detyrë Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë";*

për vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

10. Zj. A. K, me detyrë Specialist në Sektorin Juridik dhe të Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë";*
2. *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas";*
3. "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas";*
4. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas";*

dhe në cilësinë e anëtarit të NJP në procedurën e prokurimit në procedurën me objekt:

5. "*Hartim i planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, ekonomia pyjore Prrenjas";*

për hartimin e kritereve kualifikuese dhe vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe pikës 2 të nenit 41 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

11. Z. O. A., në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. "*Ndërtim i shkollës së mesme "Sali Halili" 3kat, Rrajcë Fushë";*

për vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

12. Zj. M. Z., në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas";*
2. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas";*

për vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

13. Zj. M. H., në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. *"Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, faza II, fshati Rrajcë, Bashkia Prrenjas";*
2. "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas";*
3. "*Rikonstruksion i kanalit të Lingajcës, Faza III, Bashkia Prrenjas";*

për vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

14. Z. M. A., me detyrë Drejtor i Agjencisë së Funksioneve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për mangësinë në procedurat e prokurimit:

1. "*Rikonstruksion dhe asfaltim i unazave të fshatit Katjel, Urakë, fshatit Prrenjas dhe rrugëve të Lagjes Leka-Çela-Marta në fshatin Qukës, Bashkia Prrenjas";*

për vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

15. Z. G. Ç., me detyrë Kryeinspektor i IMTV, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit për ndërtimet pa leje, mos marrja e masave për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve pa leje, aplikimi i masës së gjobave i pa mbështetur në dispozita ligjore dhe mos marrja e masave për kthimin e tyre në titull ekzekutiv.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Prrenjas, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjorë për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT